



**HISTORIA E BANKËS QENDRORE NË SHQIPËRI**

*Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri*

*Recenzent  
Prof. Dr. Beqir Meta*

*Redaktore  
Adriana Meko*

*Fotografitë  
Shpresa Lubonja, Niko Shtrepi*

*Burimet arkivore  
Bledar Striniqi*

*Kopertina, përpunimi grafik dhe dizajni  
Brikena Berdo*

*Copyright ©2003 Banka e Shqipërisë*

*Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.*

*Tiranë, 2003*

## PËRMBAJTJA

Parathënie <i>Prof. Dr. Shkëlqim Cani</i>	5
Periudha 1863 - 1924 <i>Prof. Dr. Iljaz Fishta</i>	8
Periudha 1925-1939 <i>Prof. Dr. Iljaz Fishta</i> <i>Prof. Ass. Dr. Esmeralda Uruçi</i>	18
Periudha 1939-1944 <i>Prof. Dr. Iljaz Fishta</i> <i>Prof. Ass. Dr. Esmeralda Uruçi</i>	53
Periudha 1944-1990 <i>Kostaq Postoli</i> <i>Llazi Balliu</i> <i>Bledar Striniqi</i>	76
Periudha 1991-2002 <i>Miranda Ramaj</i> <i>Rudina Gorishti</i> <i>Gramoz Kolasi</i> <i>Aida Hysi</i>	128
Bibliografia	201



## PARATHËNIE

*Banka e Shqipërisë u krijua më 4 tetor të vitit 1913. Rrjedha e historisë e solli që në këtë 90 - vjetor, të jem në funksionin e lartë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Personalisht, mendoj se është nder të parathuash "vijën e jetës" të Bankës së Shqipërisë në një botim të vlefshëm si "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri".*

*Botimi, i pari i historisë së Bankës, do të mbetet përpjekja e fillimit për të përshkuar rrugën në të cilën ka ecur, është rritur e transformuar Banka e Shqipërisë. Ndjehem i lumtur që arritëm t'i jepnim publikut një libër që i ka munguar për një periudhë të gjatë kohore dhe shpresoj që në të ardhmen, historianë e studiues të shkencës së ekonomisë e financës do të hulumtojnë më tej në traditën e sistemit bankar shqiptar.*

*Banka e Shqipërisë dhe sistemi bankar shqiptar kanë shënuar zhvillime pozitive nga periudha në periudhë dhe ky botim do të shërbejë jo vetëm për renditjen historike të ngjarjeve dhe të përpjekjeve në këtë drejtim, por edhe si mirënjohje nëpërmjet evidencimit ndaj të gjithë atyre që kontribuan në ngritjen dhe në konsolidimin e sistemit bankar në Shqipëri.*

*Në këtë libër, paraqitet historia e institucionit të bankës qendrore si pjesë e sistemit bankar shqiptar dhe e cila vazhdimisht gjatë hapësirës kohore të trajtimit të saj, është orientuar pothuajse paralelisht me historinë e kombit shqiptar.*

### **1913—Qeveria e Ismail Qemalit vë themelin e Bankës**

*Ideja për ngritjen e një Banke Kombëtare Shqiptare zë fill që në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare. Në veprën e tij "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?", patrioti i shquar Sami Frashëri shtron domosdoshmërinë e ngritjes së një Banke Kombëtare të Shqipërisë dhe propozon si njësi monetare të Shtetit të ri Shqiptar, frangun shqiptar.*

*Menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor të vitit 1912, diplomati i shquar Ismail Qemali krahas detyrave të tjera për ndërtimin e Shtetit Shqiptar mori masat për ngritjen e Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Bisedimet e para, ai i kreu me Karol Pitner e Oskar Pollak, përfaqësues të Wiener Bank Verein që vepronte në emër të grupit bankar austro - hungarez dhe me Pietro Fenolio e Guido Ansbaher përfaqësues të Banca Commerciale Italiana. Gjatë kësaj kohe, u morën masa të gjithanshme për të mbështetur fillimin sa më të shpejtë të veprimtarisë së bankës. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, gazeta "Përlindja e Shqipërisë", organ i Qeverisë së Ismail Qemalit, depozitoi pranë Bankës Kombëtare të Shqipërisë fondet që dispononte. Sipas studjuesit Haxhi Shkoza, asokohe Inspektor i Përgjithshëm i Oborrit Mbretëror në kohën kur ka botuar librin -1935, veprimtaria e bankës nisi menjëherë në fillimin e tetorit 1913 ndërsa Qeveria Shqiptare do t'i bënte thirrje shtresave të pasura që mjetet e lira t'i depozitonin në bankë.*

*Marrëveshja e tetorit 1913, dinjitoze për kohën, tregoi jo vetëm orientimin politik properëndimor të Qeverisë së Ismail Qemalit, por njëkohësisht edhe vizionin shtetformues të saj. Një shtet pa bankën e tij nuk vlen asgjë. Dyqind e tre vjet më parë, pikërisht më 18 janar 1800, kur u krijua Banka Qendrore Franceze, Napoleoni do thoshte se "nëse shteti pret paratë nga bankierët, atëherë kontrollin e shtetit e kanë bankierët dhe jo shtetarët".*

*Ndërsa Ismail Qemali e konsideronte aktin e krijimit të Bankës Kombëtare si fitoren e dytë pas shpalljes së pavarësisë kombëtare. Ngjarjet që rodhën në këtë kohë, si shpërthimi i luftërave ballkanike dhe i Luftës së Parë Botërore e shndërruan Shqipërinë në një shesh lufte. Në këto rrethana, Banka Kombëtare e Shqipërisë, pa kaluar shumë kohë do të mbyllte veprimtarinë e saj.*

*Pas ripohimit me akte ndërkombëtare të Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1921, u bënë diskutime të shumta për ngritjen sërisht të një banke kombëtare, gjë që u bë realitet në bazë të marrëveshjes së përfunduar nga Mufid Libohova në emër të Qeverisë Shqiptare dhe Mario Albertit në emër të një grupi financiar italian. Qendra administrative e Bankës Kombëtare të Shqipërisë do të ishte në Durrës, ndërsa Komiteti Administrativ do ta kishte qendrën e tij në Romë. Kjo bankë u themelua më 2 shtator 1925 dhe në shkurt të vitit 1926 hodhi në qarkullim monedhën e parë kombëtare shqiptare. Duke mos qenë vetëm një bankë emisioni, ajo e shtriu veprimtarinë edhe në lëmin e kreditit, ku gjatë një periudhe 10-vjeçare veproi në kushte monopoli dhe nga viti 1938 u gjend në një*

*konkurrencë të fortë me degën në Shqipëri të Bankës së Napolit.*

*Në fjalimin e përrimit të ndërtesës së Bankës së Shqipërisë në Tiranë, në vitin 1938, drejtori i asokohe Antonio Moschetti do të shprehej "ndërtesa e re, vepër e ndritur e arkitektit Prof.Morpurgo dhe e bashkpunëtorve të tij, në vijat e saj të matura e hijerandë aq sa edhe artistikisht elegante, dëshiron me qënë pikërisht shprehja dhe sinteza e atij organizmi të fortë e të sigurtë siç është Banka Kombëtare e Shqipërisë".*

*Konventa ekonomiko-dogane e prillit 1939, që përkon me periudhën e luftës në Shqipëri, i dha mundësi Bankës Kombëtare të Shqipërisë të bëjë ndryshime thelbësore në politikën e saj monetare. Karakteristikë dalluese e kësaj periudhe ishte kalimi nga politika deflacioniste në atë inflacioniste në lëmin e monedhës. Ajo që aktive në fushën e kreditit ku, në konkurrencë me Bankën e Napolit dhe me Bankën Kombëtare të Punës, rriti shumë kreditimin dhe mbajti pozita sunduese në tregun shqiptar.*

#### **'44-'90, Banka e Shtetit në funksion të ekonomisë së centralizuar**

*Me çlirimin e Shqipërisë, më 29 nëntor 1944, filloi procesi i shtetëzimit. Më 13 janar 1945, u miratua ligji mbi anulimin e konvencionit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të aksioneve të saj. Po në këtë datë u miratua edhe ligji organik i Bankës së Shtetit Shqiptar. Kjo bankë u krijua si një institucion i rëndësishëm i sistemit financiar të Shtetit Shqiptar.*

*Pak kohë më vonë u morën masa të tjera për përqëndrimin e bankave në duar të shtetit. Kështu, në gusht të vitit 1945 u suprimua Banka Kombëtare e Punës, ndërsa në nëntor të vitit 1945 u suprimua Banka e Napolit në Shqipëri. Gjatë vitit 1945, Banka e Shtetit Shqiptar nisi të zhvillojë veprimtarinë e saj në lëmin e emetimit të monedhës dhe të kreditit.*

*Banka e Shtetit Shqiptar trashëgoi edhe aksionet që kishte Banka Kombëtare e Shqipërisë pranë Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare në Bazel. Por, disa vite më vonë, më 20 maj 1977 drejtorja e përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar i dërgon një telegram Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare ku kërkohet shitja e këtyre aksioneve dhe në këtë mënyrë vendoset largimi nga BIS Bazel-i.*

*Oqë nga shkurti i vitit 1946 deri në fund të vitit 1990, Banka e Shtetit mbështeti procesin e zhvillimit të ekonomisë socialiste. Gjatë kësaj periudhe, në Shqipëri kanë vepruar një numër i kufizuar bankash. Karakteristikë për këtë periudhë ka qënë centralizimi i skajshëm i këtij sistemi në duar të shtetit. Banka e Shtetit Shqiptar, si bankë qendrore ishte qendër e emisionit të monedhës. Ajo grumbullonte mjetet përkohësisht të lira dhe u jepte ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore dhe personave të veçantë kredi afatshkurtër dhe afatgjatë, kryente shërbimin e arkës unike, mbante llogaritë e të ardhurave dhe të shpenzimeve, ruante fondet në valutë të shtetit, kryente veprimet ekonomike e financiare të shtetit me vendet e tjera dhe me bankat e huaja.*

*Pas vitit 1990, transformimi i madh politik drejt demokracisë solli ndryshime thelbësore edhe për sistemin bankar. Tiparet kryesore të këtij transformimi ishin ndarja e funksioneve të bankës qendrore nga funksionet e bankave të nivelit të dytë (bankave tregtare), rritja e numrit të bankave, shtrirja e veprimtarisë së tyre të kreditit në disa degë të ekonomisë shqiptare si dhe hyrja e kapitalit të huaj në tregun bankar.*

#### **'92—Për herë të parë një Bankë Qendrore e mirëfilltë**

*Për periudhën 1992 – 2002, historiku përshkruan disa nga funksionet që kryen Banka e Shqipërisë si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë u krijua gjatë procesit të tranzicionit me kalimin në sistemin bankar dynivelor dhe me krijimin e hapësirës së nevojshme ligjore për një bankë qendrore, e cila u zyrtarizua me miratimin e ligjit nr. 7559 "Për Bankën e Shqipërisë", datë 22 prill 1992. Rishikimet e mëvonshme që iu bënë këtij ligji u hartuan sipas modeleve të vendeve perëndimore e rekomandimeve të organizmave ndërkombëtare.*

*Theksojmë se statusi i saj sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës dhe me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.*

*Banka e Shqipërisë është person juridik publik dhe përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë gëzon të gjitha funksionet e mirëfillta të një banke qendrore klasike: harton, miraton dhe zbaton politikën monetare të vendit; ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare; mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë; harton, miraton e zbaton regjimin e këmbimit valutor si dhe politikën e kursit të këmbimit; licencon ose revokon licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe*

*mbikëqyr aktivitetin bankar me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar; shërben si bankier, si këshilltar dhe si agjent fiskal i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë; shërben si bankë e bankave të nivelit të dytë si dhe nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave.*

*Me qendër në Tiranë dhe me 5 degë në Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë dhe Lushnjë, Banka e Shqipërisë drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryesohet nga Guvernatori. Brenda kompetencave të përcaktuara me ligj, ajo është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Çdo subjekt është i detyruar të respektojë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, të mos kërkojë të influencojë te ndonjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për të cënuar detyrimet e tij ndaj Bankës së Shqipërisë, si dhe të mos ndërhyjë në veprimtaritë e Bankës së Shqipërisë.*

### **E ardhmja, në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore**

*Si konkluzion do të thojë se historikisht, Banka e Shqipërisë ka qenë modeli i institucionit ndër më të konsoliduarit në vend, duke ruajtur me rigozitet marrëdhëniet ndërinsticionale brenda dhe jashtë vendit. Parimet dhe rregullat solide insitucionale, dëshmojnë se nga kjo pikëpamje, banka ka qenë vazhdimisht model për insitucionet e tjera shqiptare dhe ka qenë dinjitoze në raport me homologot e veta kudo në botë dhe insitucionet financiare ndërkombëtare.*

*Nga ana tjetër, evoluimi historik i vetë konceptit të bankës qendrore është po aq interesant sa edhe historia e këtij institucioni. Sot, Banka e Shqipërisë, zbaton parimet e një banke klasike qendrore, krejt ndryshe me fillimet e veta, kur i shihte bankat tregtare si konkurente dhe pengonte zgjerimin e rrjetit bankar.*

*Sfida e rradhës e Bankës së Shqipërisë është integrimi monetar drejt Sistemit Monetar Evropian dhe model referimi janë bankat më të njohura qendrore në botë dhe në veçanti Banka Qendrore Evropiane. Shqipëria është përfshirë ethshëm në një proces reformash ekonomike e financiare në rrugën e integritit në familjen evropiane dhe Banka e Shqipërisë synon të jetë përsëri e para me kontributin e saj në këtë proces historik për vendin.*

*Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, dua të falenderoj dhe të përgëzoj të gjithë ata që punuan dhe ndihmuan në përgatitjen e botimit "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", si dhe Arkivin Qendror të Shtetit, Institutin e Historisë pranë Akademisë së Shkencave, Bibliotekën Kombëtare—Tiranë, Bibliotekën "Marin Barleti" Shkodër, Bibliotekën e Universitetit "Luigj Gurakuqi" si dhe Fototekën "Marubi"-Shkodër. Gjithashtu, dëshiroj të falenderoj për zemërsisht të gjithë ata që ndihmuan në dhënien e mjaft dokumenteve të vyer dhe veçanërisht familjarët e atyre që drejtuan në vite insitucionin e rëndësishëm të Bankës së Shqipërisë. Krahas vlerave, një vepër e tillë mund të ketë edhe mangësi dhe Banka e Shqipërisë mirëpret çdo vërejtje apo sugjerim në drejtim të përsosjes së këtij botimi. Së fundi, shpresojmë që ky botim historik e përgjithësues do të ndihmojë në edukimin e mëtejshëm të publikut me njohuritë mbi historinë, funksionet dhe arritjet e Bankës Qendrore në Shqipëri.*

Shkëlqim Cani  
  
Guvernator

## PERIUDHA 1863 - 1924

Ngritja dhe zhvillimi i veprimtarisë së bankave lidhet ngushtë me zhvillimin e përgjithshëm politik dhe ekonomik të trojeve shqiptare, me përpjekjet e popullit tonë për të shpallur Shqipërinë, shtet të lirë dhe të pavarur. Këto përpjekje e kanë zanfillën e tyre në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe shtrihen deri në fund të çerekut të parë të shekullit XX.

Duke analizuar procesin e përpjekjeve që janë bërë për krijimin e Bankës Kombëtare, të sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri, ne dallojmë tre faza të rëndësishme që lidhen ngushtë me njëra-tjetrën, si pjesë të procesit për krijimin dhe konsolidimin e Shtetit Shqiptar:

1. Përpjekjet për krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare nga gjysma e dytë e shekullit të XIX deri në vitin 1912.
2. Marrëveshja e Qeverisë së Ismail Qemalit për ngritjen e Bankës Kombëtare të Shqipërisë me grupet bankare italiane dhe austriake, 4 tetor 1913.
3. Projektet për ngritjen e Bankës Kombëtare të Shqipërisë gjatë viteve 1913-1925

Shqipëria hyri në rrugën e zhvillimit kapitalist më vonë nga shtetet e tjera. Marrëdhëniet kapitaliste duken në fillim të shekullit të XIX. Në këtë proces u ngritën manufakturat e para dhe lindi kështu nevoja e krijimit të bankave, sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri.

### **4 shkurt 1863**

Krijimi i Bankës Perandorake Otomane si bankë emisioni e Perandorisë Turke. Kjo bankë, e cila ishte nën kontrollin e kapitalit anglo-francez, shtriu veprimtarinë e saj edhe në Shqipëri. Kapitali i saj në fillim ishte 2,7 milionë lira angleze ndërsa më vonë arriti në 5 milionë lira angleze.

Ajo zhvilloi veprimtarinë edhe në fushën e kreditit dhe kishte filialet e veta në Shkodër, në Janinë, në Shkup dhe në Manastir.



Marrë nga faqja e internetit e Arshivës dhe Qendrës së Kërkimeve të Bankës Perandorake Otomane  
<http://www.obarchive.com/english/welcome.html>





Selia e Bankës e cila gjendet në rrugën e bankave, në lagjen Gallata (Banks Street Galata), mbeti si e tillë deri në vitin 1999. Marrë nga website i Ottoman Bank Archives and Research Centre, <http://www.obarchive.com/english/welcome.html>

### **1888**

U krijua Banka Agrare Turke mbi bazën e “Arkave Krahinore” (Memleket Sandukları) dhe “Arkave të interesit” (Menafi Sandukları). Kapitali i kësaj banke ishte 10 milionë lira turke. Ky kapital formohej edhe nga një pagesë prej 1 për qind që fshatarësia ishte e detyruar të jepte mbi prodhimet e veta.

Banka Agrare Turke zhvilloi veprimtari në Shqipëri gjatë disa viteve me radhë. Ajo hapi degë, agjenci dhe arka në Shkodër, në Kavajë, në Tiranë, në Elbasan, në Berat, në Korçë etj.

Në vitin 1912 kjo bankë kishte dhënë në Shqipëri rreth 6,7 milionë goshë ar kredi, pjesën më të madhe të të cilave me afat të gjatë.

Botohet vepra e ideologut të shquar të Rilindjes Kombëtare Sami Frashëri, titulluar “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?”. Kjo është një vepër e shquar me karakter politik, ekonomik dhe shoqëror. Aty janë formuluar problemet e perspektivës së ndërtimit të Shtetit Shqiptar dhe, ndër të tjera, mbi baza botëkuptimore përparimtare e patriotike, janë dhënë mendime dhe ide për ngritjen e sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri, që paraqesin një interes të veçantë.

Sami Frashëri e vlerësoi ngritjen e sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri, si një nga masat e para të ngutshme të Shtetit të ri Shqiptar që do të krijohej me fitoren e pavarësisë. Sipas tij, në Shqipëri duhej medoemos të ngrihej një bankë emisioni, me funksione edhe të kreditit, e cila të kishte një karakter kombëtar dhe të ishte nën drejtimin e Qeverisë së Shqipërisë.

Në veprën e tij ai mendonte dhe kërkonte që sistemi ynë monetar të mbështetej në standardin e arit të monetuar sipas të cilit do të bëhej shkëmbimi i lirë i kartëmonedhave me ar. Në Shqipëri duhej të kishte në qarkullim kartëmonedha, dhe krahas tyre do të priteshin edhe monedhat prej ari, argjendi e nikeli. Samiu propozonte që si njësi bazë e sistemit tonë monetar të ishte frangu. Njëzet franga do të ishin baraz me 1(një) lirë. Lira do të kishte pjesët e saj gjysmë lire dhe një e katërta e lirës. Një frang do të ndahej në 100 qindar ose, sikurse i quante Samiu, cinga.

Banka e emisionit do të zhvillonte veprimtarinë e saj edhe në sistemin e kreditit. Sipas Samiut, banka duhej t’u kushtonte rëndësi të veçantë veprimeve për mobilizimin e mjeteve të lira. Ajo do të merrej edhe me dhënien e kreditit për sektorët e ndryshëm të ekonomisë.

### **prill 1901**

Në prill të vitit 1901, kur kontradiktat italo-austriake lidhur me interesat e tyre në Ballkan, ishin ashpërsuar, Antonio Baldacci botoi artikullin “Italia dhe tregtia jonë me Malin e Zi dhe Shqipërinë Veriore” (“*L’Italia e il nostro commercio con il Montenegro e con l’Albania settentrionale*”). Në këtë artikull ai propozonte që kapitali italian të ngrinte një bankë në Malin e Zi, që do të shërbente jo vetëm për investimin e kapitaleve në degë të ndryshme të ekonomisë së atij vendi, por edhe, të mundësonte rritjen e ndikimit italian në ekonominë shqiptare.

### **1903**

Në Gazetën e Italisë (*Giornale d'Italia*) që dilte në Romë, u botua artikulli i deputetit italian A. di San Giulliano me titull "Letra mbi Shqipërinë" (*Lettere sull'Albania*). Në këtë artikull, propozohej ngritja e një banke italiane në Shkodër.

### **1906**

U botua në Romë, libri i Batista Pellegrinit me titull "Drejt luftës? Mosmarrëveshjet mes Italisë dhe Austrisë" ("*Verso la Guerra? Il dissidio fra l'Italia e l'Austria*"). Në këtë veper, i propozohej Qeverisë Italiane dhe përfaqësuesve të kapitalit italian, që të investonin veçanërisht për ngritjen e bankave në Shqipëri.

### **1907**

Banca Commerciale d'Oriente hapi një filial të vetin në Shkodër, me emrin Banca "*Tozzi and Company*".

### **1909**

Disa kohë mbasi kishte qarkulluar vepra e Sami Frashërit, në Venecia të Italisë botohet vepra e ekonomistit të shquar nga Shkodra, Gaspër Guga, titulluar "Shqipëria e dy Vilajeteve të Adriatikut. Çështje të morfologjisë dhe të antropogjeografisë në rajonin shqiptar. Marrëdhëniet e saj tregtare me Italinë dhe Austrinë. E ardhmja e saj ekonomike." ("*L'Albania dei due Vilajet Adriatici. Appunti di morfologia e d'antropogeografia nella regione albanese. I suoi rapporti commerciali con l'Italia e con l'Austria. Il suo avvenire economico*").

Në këtë veper, ai jep skemën për themelimin e një banke e cila duhej të kishte degën tregtare, atë financiare dhe atë teknike. Sipas tij, kjo bankë do të ishte qendra kryesore për financimin e shoqërive të ndryshme aksionere, që do të ngriheshin në vend. Në krijimin e sistemit të kreditit në vend, Gaspër Guga shikonte një mjet për fuqizimin e ekonomisë shqiptare kapitaliste në rritje.

### **28 nëntor 1912**

Pas afro pesë shekujsh robërie, populli shqiptar shpalli pavarësinë e tij kombëtare. Kjo ishte një kthesë e rëndësishme në historinë e tij mijëvjeçare, e cila pati një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm dhe të shpejtë politik, ekonomik dhe shoqëror të vendit. Megjithë gjendjen tepër të vështirë në të cilën ndodhej, Qeveria e Përkohshme e Ismail Qemalit mori një sërë masash për konsolidimin e Shtetit të ri Shqiptar.

U bë hapi fillestar për ngritjen e strukturave të shtetit, të dikastereve qendrore dhe të organizmave të lidhur me to. Politika ekonomike e Qeverisë së Ismail Qemalit pati si qëllim t'i vinte në ndihmë borgjezisë shqiptare në rritje. Në kuadrin e këtyre masave një rol të veçantë do të luante bashkëpunimi i saj me shtetet e fuqishme perëndimore, për ngritjen e Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

### **4 tetor 1913**

Përfundoi Marrëveshja e Qeverisë së Ismail Qemalit, për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, me Karol Pitner e Oskar Pollak, përfaqësues të Wiener Bank Verein, që vepronte në emër të grupit bankar austro-hungarez dhe me Pietro Fenolio e Guido Ansbaher përfaqësues të Banca Commerciale Italiana, që vepronte në emër të grupit bankar italian.

Kjo marrëveshje përfaqësonte një koncesion për një periudhë 60 vjet nga data e themelimit të bankës, me të drejtë zgjatjeje. Një vit para skadimit të koncesionit, Qeveria mund të njoftonte prishjen e kontratës ose përndryshe koncesioni automatikisht quhej i shtyrë edhe për 30 vite të tjera.

Kapitali i bankës do të ishte 10 milionë korona ose 10,5 milionë lireta, i formuar në monedhë ari dhe do të derdhej sipas nevojave të bankës. Kapitali mund të rritej një herë a më shumë, me vendim të mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve.

Banka do të drejtohej nga një Këshill Administrimi me përbërje nga dy grupet themeluese dhe me përfaqësues shqiptarë. Këshilli ia delegonte fuqitë e veta Komitetit Drejtues me dy deri në katër anëtarë.

Marrëveshja parashikonte që Banka Kombëtare e Shqipërisë të kryente një numër të konsiderueshëm veprimesh: shitblerje titujsh, monedhash, metalesh të çmuara, mallrash tregtie, për llogari të vet dhe për llogarinë e të tjerëve, dhënie parapagesash (avansesh) për sigurim malli, tituj etj.. Gjithashtu, ajo merrte përsipër edhe pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive për shoqëritë dhe ndërmarrjet tregtare, industriale, financiare e bujqësore. Banka merrte përsipër edhe kryerjen e emisionit të obligacioneve të garantuara si dhe kryerjen e veprimeve hipotekore.

Banka Kombëtare e Shqipërisë mbetej i vetmi institucion të cilit i njihej e drejta për emetimin e kartëmonedhave (biletave bankare) që u vendos të emetoheshin në shqip dhe në frengjisht. Ajo duhej të mbante në ar 1/3 e sasisë totale të kartëmonedhës në qarkullim.

Banka do të ishte i vetmi agjent financiar i qeverisë, si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Vetëm ajo kishte të drejtën të tregtonte për llogarinë e qeverisë bonot e thesarit dhe letra të tjera me vlerë të qeverisë.

Qeveria e Ismail Qemalit synonte nga njëra anë të konsolidonte Shtetin e ri Shqiptar dhe nga ana tjetër të ndihmonte borgjezinë shqiptare, e cila ishte në hapat e parë të saj. *"E them me lavdurim- vinte në dukje Ismail Qemali në fjalimin që mbajti në sheshin e mbledhjes në Vlorë,- se puna e Bankës për Shqipërinë është një i dyti fitim, pas lirisë, edhe nga pikëpamja ekonomike dhe politike".*

Kështu, Ismail Qemali mori të gjitha masat që ndërsa përgatitej dhe firmosej marrëveshja mbi ngritjen e bankës kombëtare, të krijoheshin të gjitha kushtet që ky institucion të fillonte punën pa humbur kohë.

Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes, Qeveria e Ismail Qemalit depozitoi pranë bankës fondet që dispononte dhe u bëri thirrje tregtarëve që të depozitonin në bankë mjetet e tyre të lira.

### **1913-1914**

Studiuesi shqiptar Haxhi Shkoza, i cili në atë periudhë punonte në financat lokale të Elbasanit, të Beratit dhe të Vlorës, shkruan:

*"Dihet se këjo bankë filloj n'ushtrimin e veprimeve të saja me Qeverin lokale dhe me privatët, por nuk qe e mundun me vum në dorë ndonji akt zyrtar mbi ato veprime qi ajo bani gjatë periudhës së qëndrimit n'atë vend si dhe mbi kohën e largimit e mënyrën e likuidimit të sajë. Vetëm asht e mundun me marrë njoftim prej nji konti-korent qi banka ka pasun atëherë me financën e vendit së cilës i ka pasë lëshuem dokumentin qi pason:*

*Syndikati për Bankën Kombtare të Shqipnis*

*Me diftesën Nr.1 datë 6-X-1913 ka marrë nga arka e Financave të Vlorës grosh 545.283 (Nr.lib.arkës 930)*

*Terhequn nga banka në tri herësh grosh 257.000*

*Ngelun për të marrë nga banka grosh 288.283."*

Mirëpo banka veproi për një kohë shumë të shkurtër. Pasi kreu disa veprime me qeverinë e Ismail Qemalit dhe disa subjekte private e pushoi aktivitetin e saj. Kjo, jo për faj të Qeverisë Shqiptare, por për shkak të zhvillimeve politike që ndodhën me shpërthimin e lufrave ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore.

BANKA KOMBETARE

•

SHQYPERISE

---

Vlorë

Shqypshkronja e Shtetit Shqypar

1914

## AKT KONQESIE

Në vjetin 1913, më 4 të tetorit, midis:  
Qeverisë Shqiptare, nga njëra anë; dhe nga  
ana tjetër,

I. Zotërinjtë Baron Karol Pittler dhe Oskar  
Pollak, të cilët punojnë në emër të Wiener Bank-  
Verein, që ka ndërtjen në Vienë;

II. Zotërinjtë Pietro Fenoglio e Guido Ansbacher  
të cilët punojnë në emër të Banca Commerciale  
Italiana, që ka ndërtjen në Milano;

U venduan këto që vazhdojnë më poshtë:

### I.

Qeveria e Shqipërisë i jep Bankës Commerciale  
Italiana, që ka ndërtjen në Milano, dhe punon në  
emër të vet dhe të një togu Bankash Italiane, edhe

Bankës Wiener Bank-Verein që ka ndërtjen në  
Vienë dhe punon në emër të vet dhe të një togu  
Bankash Austriane e Ungare.

### Konqesien

Për të krijuar një institut Banke të privileji-  
gjuar, shoqërie anonyme Shqiptare, e cila do të  
emënohet:

BANKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË, dhe do të ketë  
të drejtën të mbajë armurat e Shtetit Shqiptar.

Konqesia është e dhënë për 60 vjet duke nisur  
nga dita kur banka u themelua përfundimisht dhe

### **1914-1918**

Gjatë kësaj periudhe trojet shqiptare u bënë shesh i luftimeve të fuqive të huaja. Për qëllimet e tyre ato ngritën në Shqipëri filiale të bankave, që financuan ushtritë me monedhat e tyre. Kështu, në qytetin e Shkodrës hapën degët Wiener Bank Verein, Pester Bank dhe Ungarische Bank. Por, veprimtaria e tyre qe e kufizuar në fushën e kreditimit.

### **6 maj 1920**

Me ligjin nr. 41 të kësaj date, u emetua huaja e brendshme e Shtetit Shqiptar me prerje *50 franga ari*. Kjo hua përbëhej nga një radhë me 40.000 pjesë të një shume prej 2 milionë frangash ari. Secila pjesë e radhës kishte çmimin 50 franga ari dhe ndahej në tri kupona. Çdo kupon kishte të shënuar shumën e të hollave, që do të shlyhej deri në fund të vitit si dhe përqindjen e interesit. Çdo kupon ishte caktuar, nga arkëtarët e zyrave të financave të shtetit, të shlyhej deri në 1 nëntor të viteve 1921, 1922, 1923.



*Huaja e Brendshme e Shtetit Shqiptar, 1920.*

### **gusht 1920**

Filluan bisedimet italo-shqiptare për një sërë çështjesh ekonomike me interes të ndërsjellë midis përfaqësuesve të Qeverisë Shqiptare, kryesuar nga Sulejman Delvina dhe përfaqësuesve të Qeverisë Italiane. Lidhur me çështjen e bankës kombëtare, Qeveria e Sulejman Delvinës deklaroi se marrëveshja e tetorit 1913 nuk ishte e përshtatshme për Shqipërinë dhe kërkoi kushte më të favorshme. Ajo shprehu gatishmërinë për të diskutuar me ndonjë grup financiar italian për krijimin e një banke të Shtetit Shqiptar, me kapital të përbashkët shqiptaro-italian, e cila duhet të kishte karakterin e një personi juridik shqiptar.

### **Vitet 1921-1924**

Pas Luftës së Parë Botërore, kapitali shqiptar i cili kishte realizuar akumulimin fillestar, filloi përpjekjet për zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese dhe për ngritjen e aktiviteteve të reja. Deri në vitin 1921 kishte një mori monedhash turke, austriake, italiane, greke, serbe etj., të cilat qarkullonin në tregun shqiptar. Në mungesë të sistemit bankar krediti ishte në

dorë të fajdexhinjve, gjë që në një shkallë të konsiderueshme frenonte zhvillimin e ekonomisë. Në këto rrethana, lindi si nevojë urgjente krijimi i sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri, me anë të të cilit jo vetëm do të krijoheshin lehtësi për rritjen e prodhimit dhe të shkëmbimit të mallrave, por edhe do të disiplinoheshin këto shkëmbime.

### ***Vitet 1923 – 1924***

Gjatë periudhës 1923-1924 pati një konkurrencë të madhe mes shteteve të zhvilluara ekonomikisht të Evropës Perëndimore si Anglia, Franca, Italia, lidhur me marrjen e koncesioneve ekonomike në Shqipëri, ku vend qendror kishte koncesioni mbi bankën.

### ***16 maj 1921***

Në Këshillin Kombëtar të Shqipërisë (Parlamenti Shqiptar) u diskutua për çështjen e themelimit të bankës kombëtare dhe u vendos dërgimi në Itali i një delegacioni parlamentar prej tre vetash, kryesuar nga Ministria e Financave për të biseduar lidhur me çështjen në fjalë. Kjo nismë nuk ia arriti qëllimit, pasi palët nuk ranë dakord për kushtet e marrëveshjes për krijimin e bankës.

### ***25 qershor 1921***

U vendos për herë të parë, që nxjerrja e të ardhurave shtetërore të llogaritej mbi bazën e frangut ar, sipas këtij kursi : lira stërlinë barazohej me 25 franga ar, lira turke me 22 franga ar, napoloni me 20 franga ar. Këtij kursi i bëhej një zbritje prej 10 për qind për kartëmonedhat e ndryshme (përveç dollarit) dhe një zbritje prej 5 për qind për monedhat e argjendta.



*20 Skënderë 9.11.1921, emetuar me rastin e caktimit të kufijve të Shqipërisë.*

### ***shkurt 1922***

Në Këshillin Kombëtar të Shqipërisë (Parlamenti Shqiptar) u diskutua për masat që duheshin marrë në fushën e monedhës dhe u paraqitën tre projekte për këtë qëllim.

### ***mars 1922***

Në bazë të tre projekteve të mësipërme, doli ligji për emetimin e kartëmonedhës kombëtare me një shumë prej 3 milionë frangash ar. Por, ky ligj nuk hyri në fuqi, për një sërë shkaqesh, ndër të cilat mungesa e përvojës dhe e përgatitjeve serioze për zbatimin e një mase të tillë.

### **qershor 1922**

Qeveria Shqiptare i drejtohet Lidhjes së Kombeve me kërkesën për të dërguar një këshilltar dhe disa teknikë, të cilët do të sugjeronin masa të mundshme për nxitjen e pjesëmarrjes së kapitaleve të huaja në shfrytëzimin e burimeve natyrore të vendit tonë.

### **shtator 1922**

Profesori luksemburgas, ekspert në fushën ekonomike dhe financiare, Albert Kalmes u dërgua nga Komiteti Financiar i Lidhjes së Kombeve, bazuar në kërkesën e Qeverisë Shqiptare, të qershorit 1922.

Ai paraqiti një raport të hollësishëm mbi gjendjen e atëhershme dhe mbi masat që duheshin marrë. Në Shqipëri në atë kohë vlerësohej të kishte 50-100 milionë franga ari monedha në qarkullim dhe të thesarisuara.

Kalmes propozonte që të krijohesh një bankë emisioni dhe e kreditit. Ai sugjeronte që banka të krijohesh pjesërisht me kapitale të huaja dhe pjesërisht me kapitale të vendit, e të drejtohej nga të huajt. Banka do të kishte të drejtën ekskluzive për hedhjen në qarkullim të kartëmonedhave. Përveç kësaj, do të merrej edhe me veprime krediti, madje, krahas kësaj banke do të krijohesh edhe një bankë e veçantë, që të zhvillonte veprimtarinë e kreditit.

### **janar 1923**

Qeveria nxori një ligj që autorizonte bashkitë e vendit të emetonin kartëmonedha në një shumë deri në 80 mijë franga ar dhe në prerje të ndryshme. Mbështetur në këtë ligj, bashkitë e Shkodrës, të Korçës, të Vlorës, të Fierit etj., nxorën në qarkullim kartëmonedhat e tyre.



50 qind kart, 01.05.1924 (Kartëmonedhë e Bashkisë së Vlorës).



50 qind kart, 1924 (Kartëmonedhë e Bashkisë së Fierit).





*1 lirë Italiane, 1924 (Kartëmonedhë e Dhomës Tregtare Berat).*

### **1923**

Gjatë këtij viti, Lidhja e Kombeve bëri disa orvatje për të ndihmuar Shqipërinë për krijimin e bankës. Me kërkesën e Qeverisë Shqiptare, ajo dërgoi një këshilltar holandez, Hunger, të cilit iu ngarkua detyra e parashtrimit të projektit për krijimin e bankës.

### **11 prill 1924**

Mendimtari përparimtar, Avni Rustemi, botoi në gazetën "Dajti" artikullin me titull "Kasat e Kursimit dhe Banka Kombëtare". Në këtë artikull ai dha mendime e zgjidhje dhe për çështjen e krijimit të bankës kombëtare. Aty ai i jepte rëndësi krijimit të bankës si institut kombëtar dhe veçanërisht përqendrohej në faktin që kapitali i bankës duhej të ishte tërësisht shqiptar.

## PERIUDHA 1925-1939

Në fillim të vitit 1925, kur në krye të Shtetit Shqiptar erdhi sërish Ahmet Zogu, konkurrenca për marrjen e koncesioneve ekonomike përfshirë këtu edhe koncesionin e bankës, mori zhvillime të reja. Kapitali anglez, italian, francez, jugosllav dhe grek bënë orvatje intensive në këtë drejtim.

Ahmet Zogu dhe Qeveria e tij bënë të njohur se dhënia e koncesioneve kushtëzohej me ndihmën financiare që këto vende do t'i jepnin Shqipërisë. Veprimtaria e Qeverisë tregonte se Zogu dhe Qeveria e tij ishin për një orientim përfundimor të Shqipërisë dhe sidomos kundrejt Italisë.

### **14 janar 1925**

Në bazë të direktivave të Romës, Carlo Durazzo i shoqëruar nga diplomati italian Ugo Sola, zhvilluan bisedime me Ahmet Zogun për zgjerimin e marrëdhënieve italo-shqiptare, propozim i cili gjeti edhe miratimin e Ahmet Zogut.

### **20 janar 1925**

Salvatore Contarinni, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë i paraqet Benito Musolinit planin prej 9 pikash për investimin me përparësi të kapitalit italian në Shqipëri, plan i cili u miratua në Romë. Ahmet Zogu e diskutoi planin me Mufid dhe Egerem Libohovën dhe përgjithësisht e pranuan atë, me përjashtim të koncesionit vajguror që i ishte premtuar kapitalit anglez.

### **shkurt 1925**

Vjen në Shqipëri një grup kapitalistësh anglezë për të biseduar me përfaqësues të Qeverisë Shqiptare, për marrjen e koncesioneve ekonomike në Shqipëri. Ky grup përfaqësohej nga Midland Bank dhe hartoi edhe një skemë marrëveshjeje lidhur me koncesionin e bankës.

Në këtë marrëveshje theksohej :

- 1) Të krijohet Banka e Shtetit Shqiptar me një kapital prej 500.000 lira stërlinash, prej të cilit 51 për qind do t'i rezervohej kapitalit anglez dhe 49 për qind kapitalit shqiptar. Qendra e Bankës do të ishte në Shqipëri.
- 2) Grupi anglez që do të merrte koncesionin e bankës do t'i siguronte Qeverisë Shqiptare një hua prej 2 milionë lira stërlinash, ndërsa 100.000 lira stërlina do të jepeshin në formë paradhënieje që në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes. Grupi anglez do të kishte epërsi në të gjitha koncesionet ekonomike në Shqipëri.

### **19 shkurt 1925**

Ugo Sola, i ngarkuari me punë në Italisë në Durrës, i dërgonte Romës një telegram, me të cilin e njoftonte për hapat që kishte bërë kapitali britanik dhe shtonte se ardhja e menjëhershme e përfaqësuesve të interesave bankare italiane do të mund të paralizonte veprimtarinë e grupit anglez.

Në këto rrethana, nisi letërkëmbimi diplomatik mes Romës dhe Londrës, për çështjen e përparësisë së Italisë në ekonominë shqiptare. Londra, e cila fill pas Luftës së Parë Botërore i kishte dhënë pëlqimin kapitalit italian për të patur një pozitë të veçantë në Shqipëri, u tërhoq nga plani i saj dhe i hapi rrugë Italisë.

### **21 shkurt 1925**

Ministri i Financave dhe Zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Mufid Libohova, hynë në bisedime me Ugo Solën, i ngarkuari me punë të Italisë në Shqipëri. Atij iu bë prezente draftmarrëveshja me grupin anglez dhe vështirësitë financiare që momentalisht kalonte Shqipëria. Njëkohësisht, u arrit marrëveshja për këto çështje :

- 1) Qeveria Shqiptare do t'i ndërpriste menjëherë tratativat me grupin anglez.
- 2) Qeveria Italiane jepte menjëherë një paradhënie prej 500.000 frangash ar.
- 3) Qeveria Shqiptare do t'i transferonte Qeverisë Italiane të gjitha klauzolat e kontratës së projektuar me grupin anglez.
- 4) Brenda datës 15 mars 1925 do t'i jepej Qeverisë Shqiptare një tjetër paradhënie prej 500.000 frangash ar.
- 5) Me rastin e firmosjes së marrëveshjes, Qeverisë Shqiptare do t'i jepeshin edhe 1.000.000 franga ar.
- 6) Huaja 2 milionë franga ari do të ndahej në kuota për 5 vjet.

### **6 mars 1925**

Mario Alberti i dërgonte një letër Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë me të cilën e njoftonte se sipas udhëzimeve që kishte patur nga Musolini, kishte përfunduar projekt-marrëveshjen e konventës për çështjen e bankës dhe të huasë, e cila sipas konventës do t'i jepej Qeverisë Shqiptare. Ai i parashtronte Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë dy çështje kryesore:

- 1) marrëveshja të nënshkruhej në emër të grupit financiar italian të rekomanduar nga Qeveria Italiane. Ky grup kryesohej nga Instituti Kombëtar për Këmbimet me Botën e Jashtme;
- 2) në krijimin e bankës dhe të shoqërisë SVEA të mos angazhoheshin në asnjë mënyrë kapitalet e Credito Italiano që drejtohej nga Mario Alberti.

Për këtë arsye, para se të nisej për në Tiranë, ai u përpoq të zgjidhte përfundimisht çështjen e kapitalit të huasë SVEA kuptohet edhe të huasë për Qeverinë Shqiptare.

Në krijimin e bankës dhe të shoqërisë SVEA, mori pjesë vetë Shteti Italian.

Në këto rrethana, midis Qeverisë Shqiptare të përfaqësuar nga Mufid Libohova, Ministër i Financave dhe Zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe Mario Albertit, përfaqësues i grupit italian, u arrit kompromisi i gjerë për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe për huanë SVEA. Banka krijohet si instiut i Shtetit Shqiptar.

### **11 mars 1925**

#### **KONVENTË**

Unë, Mufid Libohova, Ministër i Financave e Zëvendësministër i Punëve të Jashtme në përfaqësim të Shtetit Shqiptar nga njëra anë e Grand Ufficiale Mario Alberti nga tjetra anë, si përfaqësues i grupit financiar i rekomanduar nga Qeveria Italiane, kemi nënshkruar si vijon:

1. Grupi italian i përfaqësuar nga Gr.Uff. Mario Alberti, ka për të formuar brenda nëntëdhjetë ditëve prej ratifikimit të kësaj kontrate "Banka Kombëtare e Shqipërisë" (Banca Nazionale d'Albania) me një kapital nominal prej franga ari 12.500. 000 (dymbëdhjetë milionë e gjysmë) i ndarë në katërqind e nëntëdhjetë e pesë aksione të zakonshme me një vlerë secila 25 fr.ari e në 100.000 aksione themeltare me vlerë secili prej franga ari 1.25. Prej një kapitali të tillë nominal 2.500.000 fr.ari kanë për të qenë të nënshkruara menjëherë e banka mund të fillojë aktivitetin e saj porsa t'i ketë dhënë provë Qeverisë Shqiptare se ka dërguar efektivisht pranë një banke më në zë në Zvicër shumën në 2.500.000 fr.ari ose ekuivalenten e saj.
2. Shtetasit shqiptarë kanë të drejtën e pjesëmarrjes deri në masën 49 për qind të kapitalit aksioner.
3. Drejtoria qendrore e bankës do të vendoset në kryeqytetin e Shqipërisë.

4. Kjo konventë ka një afat 50-vjeçar, me të drejtë zgjatjeje sipas një marrëveshjeje ndërmjet të dyja palëve.
5. Banka do të jetë në harmoni me ligjet e shtetit dhe mund të çelë degë si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë.
6. Banka ka për të patur këto të drejta, ashtu siç lejohet në konventë:
  - a. të marrë mbi vete çdo lloj veprimi bankar e financiar;
  - b. privilegjin ekskluziv të nxjerrjes së kartëmonedhës, që do të ketë një kurs ligjor e një fuqi të patundshme për pagesat në Shqipëri;
  - c. të depozitojë fondet e shtetit, të ketë shërbimin e thesarit dhe të negociojë huanë qeveritare e të bashkive.
7. Çdo gjë që nevojitet për ndërtesën, për instalimet dhe për shtrimet në ndërtesat e bankës do të jetë e përjashtuar nga detyrimet doganore. Me përfundimin e koncesionit, ndërtesat e bankës do të jenë në pronësi të Shtetit Shqiptar sipas vlerës me të cilën do të çmohen. Çmimi do të caktohet nga një i tretë, i cili do të përcaktohet nga marrëveshja mes Shtetit dhe Bankës.
8. Të gjitha kapitalet dhe vlerat private që vendoseshin pranë Bankës së Shqipërisë do të ishin të lira prej çdo konfiskimi direkt apo indirekt nga çdo sekuestrim apo kontroll prej Shtetit, përveç rasteve të vendimeve formale ligjore të gjyqtarëve, për shkak se Banka i nënshtrohej ligjeve të Shtetit.
9. Drejtoria qendrore e bankës, në kryeqytetin e Shqipërisë, ka për t'u përbërë prej dy misave italianë e dy shqiptarë; kryesia i ngarkohet njërit nga dy misat italianë, që do të ketë votën përfundimtare. Dy misat shqiptarë do të emërohen nga Qeveria.

Derisa banka nuk do të ketë zhvillimin e nevojshëm, misat e drejtorisë qendrore të lartpërmendur mund të zbriten në dy misa, njëri italian me votë përfundimtare, tjetri shqiptar.

10. Në këshillin e administratës së bankës, një misë e një komisioner do të caktohen nga Ministria e Financave të Shqipërisë.
11. Banka do të përgatisë një rezervë metalike (ar ose argjend në shufra ose monedhë) me vlerë sa një e treta e bankënotave të lëshuara.

Nënshkruar  
*Mufid LIBOHOVA*  
*Mario ALBERTI*

**Nr. 26.**

**DEKRET LIGJË, 15 Mars 1925.**

**Mbi pranimin e Konvencionit për themelimin e  
Bankës dhe operacionet e huas**

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 18 Prill 1925, Nr. 13)

Mbasi u pa konvencjoni (marrëveshtja) me datë 15 Mars 1925 e nënshkrueme prej Zotit Ministrit të Financave dhe Grand Ufficiale Mario Alberti:

Mbasi u pa artikulli (neni) 88 i Statutit; u muer vendimi i Këshillit Ministrues;

**DEKRETOJMË**

Art. 1. - Asht i pranuem konvencjoni i nënshkruem ndër-mjet të Zotit Ministrit të Financave dhe Grand Ufficiale Mario Alberti për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqypnis edhe operacionet përkatëse të huasë.

Art. 2. - Konvencjoni i nëntëpërmendun do t'i paraqitet Parlamentit për ndërrimin e tij në ligjë.

Art. 3. - Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministrija e Financave.

*Kryetari i Republikës*  
**A. ZOGU**

*Ministri i Financave*  
*Zav. Ministri i P. të Jashtme*  
**MUFID LIBOHOVA**

### **15 mars 1925**

Mbi pranimin e marrëveshjes për themelimin e Bankës dhe operacionet e huasë (botuar në Fletoren Zyrtare, 18 prill 1925, Nr.15).

Mbasi u pa marrëveshja me datë 15 mars 1925 e nënshkruar prej Zotit Ministrit të Financave dhe Grand Ufficiale Mario Alberti:

Mbasi u pa artikulli (neni) 88 i Statutit; u muar vendimi i Këshillit të Ministrave;

### **DEKRETOJMË**

- Art.1. Është i pranuar konvencioni i nënshkruar ndërmjet Ministrit të Financave dhe Grand Ufficiale Mario Alberti për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë edhe operacionet përkatëse të huasë.
- Art 2. Konvencioni i lartpërmendur do t'i paraqitet Parlamentit për shndërrimin e tij në ligj.
- Art.3. *Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministria e Financave.*

Kryetari i Republikës  
*Ahmet ZOGU*

Ministri i Financave  
Zëvendësministri i Punëve të Jashtme  
*Mufid LIBOHOVA*

### ***mars –prill 1925***

Banka Serbo-Shqiptare me qendër në Cetinje dhe Banka e Athinës, bënë përpjekje për të hapur filialet në Shqipëri.

### **3 prill 1925**

Banka Serbo-Shqiptare me qendër në Cetinje, me autorizim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Shqipërisë, çeli filialin e saj në Shkodër. Në maj 1925 u legalizua plotësisht veprimtaria e kësaj banke.

### **23 prill 1925**

Pak kohë pas përfundimit të marrëveshjes së Qeverisë Shqiptare me grupin financiar italian, krijohet shoqëria SVEA me qendër në Romë, Itali.

Fillimisht u quajt SVEA (Societa per lo Sviluppo Economico d'Albania – Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë) pastaj, duke filluar nga 15 maji 1936 mori emrin Shoqëria për Financimet e Jashtme (Societa per i Finanziamenti Esteri).

SVEA ishte produkt i të njëjtit grup financiar Italian që ishte aksioner i Bankës Kombëtare të Shqipërisë qysh në momentin e krijimit të saj.

SVEA u krijua me qëllim që t'i siguronte një hua prej 50 milionë frangash ari Qeverisë Shqiptare për të financuar punët botore në Shqipëri.

SVEA financoi sipas tre programeve të huasë, një shumë prej 62.743.000 fr.a. deri me 31.12.1935 nga të cilat pjesa më e madhe ose 54,76 për qind për rrugë, ura e porta, kurse pjesa tjetër për , hekurudha, rrjete telefonie etj.. Për bujqësinë, megjithëse ishte dega kryesore e ekonomisë shqiptare, u dhanë shumë pak fonde, vetëm 2.43 për qind.

**18 maj 1925**

Mbi detyrimin e blerjes së aksioneve të Bankës Kombëtare  
(botuar në Fletoren Zyrtare, 26 maj 1925, Nr.22)

- Art.1. Çdo Ministër, Nëpunës i Shtetit dhe Oficer me rrogë mujore prej 100 (njëqind) Fr.ari e lart, Senator e Deputet detyrohet të blejë aksione të Bankës Kombëtare së paku për shumën e rrogës e shpërblimit të një muaji.
- Art.2. Pagesa e aksioneve do të bëhet me tri këste.
- Art.3. Ministria e Financave detyrohet të fillojë nxjerrjen e të hollave nga rroga më e parë që do të paguhet mbas këtij dekreti.
- Art.5. *Ata shqiptarë që paguajnë një vergji 100 fr.ari në mot detyrohen të blejnë një aksion të Bankës Kombëtare dhe ata që paguajnë më shumë se 100 fr.ari vergji në vit detyrohen të blejnë aksionet e Bankës në fjalë, të paktën nga një aksion për çdo 100 fr.ari.*

Kryetari i Republikës  
*Ahmet ZOGU*

Ministri i Financave  
Zëvendësministri i Punëve të Jashtme  
Zëvendësministri i Punëve të Brendshme  
*E. CENA*

Ministri i Drejtësisë  
Zëvendësministri i Punëve Botore  
*Pletër POGA*

POLITIKA MONETARE E BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË  
*në periudhën 1925 –1939.*

*Në vitin 1925 kur u krijua banka, në Shqipëri qarkullonin një mori monedhash të vendeve të ndryshme, ndaj Banka Kombëtare e Shqipërisë mori masa për t'i zëvendësuar këto me monedhën e vetme shqiptare.*

*Si njësi monetare zyrtare u caktua frangu ar. Monedha jonë kishte nënfishat e saj (leku, qindarka 1 franga ar ishte baraz me 5 lek dhe 100 qindarka) dhe shumëfishat e saj 5,20 dhe 100 franga ar.*

*Në bazë të marrëveshjes, grupi financiar italian kishte të drejtën ekskluzive në fushën e emisionit të kartëmonedhave dhe njëkohësisht ai përfitonte 50 për qind të fitimeve që rridhnin nga prerja dhe hedhja në qarkullim e monedhave (po aq sa edhe Shteti Shqiptar).*

- *Banka Kombëtare e Shqipërisë duhej të mbante parasysh koniukturën e brendshme monetare, pasi në Shqipëri qarkullonin monedha prej ari dhe argjendi dhe populli nuk i preferonte kartëmonedhat.*
- *Në atë moment, në mjaft vende të botës ishte vendosur standardi i arit në formë të cinguar, në formën e standardit të arit shufër ose në formën e standardit të arit dhe devizës.*

*Për arsytet e mësipërme, Banka Kombëtare e Shqipërisë zbatoi standardin e arit të cinguar ose standardin e arit dhe të devizës, që nënkuptonte se kartëmonedhat kthehen në ar dhe në valuta të huaja të forta në dollar, në lira, në stërlina etj..*

*Karakteristikat më kryesore të këtij standardi të adoptuar në Shqipëri ishin:*

- 1. Bankës Kombëtare të Shqipërisë iu dha e drejta ekskluzive për të nxjerrë bankënota. Në bazë të ligjit mbi rregullimin e monedhës, miratuar nga Parlamenti më 23 qershor 1925 dhe prej senatit më 5 korrik 1925, Banka Kombëtare e Shqipërisë do të përkujdesej, gjithashtu, për prerjen e monedhave ari prej 100 franga ar, 20 franga ar dhe 10 franga ar si dhe të monedhave prej argjendi prej 5 franga ar, 2 franga ar, 1 frang ar dhe 0,50 franga ar.*
- 2. Në bazë të Statutit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të ligjit së saj organik, kartëmonedhat do të shkëmbeheshin në valutë ari të Shtetit Shqiptar, në kartëmonedha të vendeve ku do të shkëmbeheshin, në ar dhe në çeqe. Në fakt, në bazë të Statutit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të ligjit së saj organik, shkëmbimi i kartëmonedhave në njërin nga dy format e para (në monedha ari të Shtetit Shqiptar ose në valutë të huaj) mund të bëhej vetëm në Durrës. Po ashtu, në bazë të Statutit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të ligjit së saj organik, shkëmbimi i kartëmonedhave me monedha ari dhe me valutë të huaj, mund të bëhej vetëm me autorizim dhe në përputhje me normat e caktuara nga Komiteti Administrativ i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Romë.*
- 3. Me rregullat në fuqi, për shkak të deficitit të thellë të bilancit të tregtisë së jashtme, e për shkaqe të tjera, u vendos që të mos lejohej dalja e arit jashtë, u ndalua eksportimi i tij. Eksportimi mund të bëhej me autorizim, edhe për sasi të që do të përdoreshin nga banka për prerjen e monedhave prej ari të Shtetit Shqiptar, monedha që priteshin jashtë vendit.*

*Pas themelimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, drejtuesit e saj morën masa për zbatimin e kushteve të marrëveshjes, duke hedhur në qarkullim kartëmonedhat dhe monedhat e reja, të cilat do të zëvendësonin ato ekzistuese. Për këtë qëllim, gjatë viteve 1925-1926 u përgatitën kartëmonedhat dhe një sasi e vogël monedhash metalike.*

*Komunikohet që me 19 dhjetor 1925 është dërguar përmes detit nga Firma Bradbury Wilkinson & C., Londër drejt degës së Barit të Banca d'Italia, sasia e parë e kartëmonedhave shqiptare.*

*Më 28 shkurt 1926 filloi hedhja në qarkullim e një sasi prej 5000 franga ar kartëmonedhash me prerje 20 franga ar. Prej këtij momenti e deri në fund të vitit 1926 u hodhën në qarkullim sasi të tjera kartëmonedhash me prerje 1frangë ar (5 lek), 5 franga ar, 20 franga ar, 100 franga ar.*

*Më 10 mars 1926 filloi hedhja në qarkullim e monedhave metalike prej nikeli, prerja "1/2 lek". Sasia totale 1000 franga ar dhe më vonë e prerjeve të tjera. Në fund të vitit 1926, qenë hedhur në qarkullim 331.000 franga ar monedha metalike.*

*Më 31 gusht 1927 filloi hedhja në qarkullim e monedhave prej ari në prerje "100 franga ar" në sasinë totale 27.000 franga ar.*

*Gjatë viteve 1926-1927 hedhja në qarkullim e kartëmonedhave dhe e monedhave erdhi në rritje. Në fund të vitit 1928 qenë hedhur në qarkullim 10.095.000 franga ar kartëmonedha dhe 422.000 franga ar monedha.*

*Me këta hapa, në fund të vitit 1928 qarkullimi i mëparshëm monetar u zëvendësua në një masë të konsiderueshme, nga monedhat e reja. Thuhet kështu, sepse vazhdonin të ishin në qarkullim koronat prej argjendi për tërheqjen e të cilave nga qarkullimi u bënë debate të ndryshme në organet shtetërore dhe jashtë tyre.*

*Në qershor të vitit 1930, u mbledh edhe Kongresi i Tregtarëve Shqiptarë, i cili diskutoi zëvendësimin e koronave prej argjendi që ishin akoma në qarkullim në Shqipëri. Mungesa e monedhave metalike krijonte vështirësi të shumta në transaksionet brenda vendit dhe çmimi i koronave të argjendta u rrit artificialisht.*

*Ky problem u zgjidh vetëm në mars të vitit 1936 me marrëveshjen mes Qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare, për hedhjen në qarkullim të 1.000.000 frangave ar, që e zbuste krizën e monedhës në qarkullim, por nuk e zgjidhte krejtësisht këtë problem.*



### **23 qershor 1925**

U miratua nga Parlamenti Shqiptar ligji për rregullimin e monedhës, i cili i jepte Bankës Kombëtare të Shqipërisë të drejtën ekskluzive për nxjerrjen e kartëmonedhave, si dhe për prerjen e monedhave prej ari dhe argjendi.

### **5 korrik 1925**

Kaloi në Senat ligji për rregullimin e monedhës, i cili i jepte Bankës Kombëtare të Shqipërisë të drejtën ekskluzive për nxjerrjen e bankënotave, si dhe për prerjen e monedhave prej ari dhe argjendi.

### **12 korrik 1925**

Ligj "Mbi pranimin e Konventës për Bankën Kombëtare, të konvencionit për huanë prej 50.000.000 franga ari për punë botore, të ligjit Organik të Bankës Kombëtare, të ligjit mbi rregullimin e monedhave".  
(Botuar në Fletoren zyrtare 31 korrik 1925, Nr.40.).

Kryetari i Republikës Shqiptare, urdhëron ekzekutimin e:

- a. Konventës së Bankës Kombëtare midis Qeverisë Shqiptare dhe grupit financiar italian me datë 15 mars 1925, i ratifikuar me dekretin e datës 15 mars 1925 dhe i shpallur në Fletoren Zyrtare më 18 prill 1925.
- b. Konventës mbi huanë për punërat botore të Shqipërisë prej 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) franga ari.
- c. Ligjit organik të Bankës Kombëtare të përbërë prej 60 artikujsh të përmbledhur në 8 kapituj.
- d. Ligjit mbi rregullimin e monedhës, me gjithë ndryshimet e bëra prej dy dhomave legjislative në konventën dhe në ligjin organik të sipërcituar.

Kryetari i Republikës  
*Ahmet ZOGU*

Ministri i Financave e  
Zëvendësministri i Punëve të Jashtme  
*Mufid LIBOHOVA*

**Nr. 48.**

LIGJË, 12 Korrik 1925.

**Mbi pranimin e Konventës për Bankën Kombëtare, të Konvencionit për huan prej 50.000.000 fr. ari për punë Botore, të Ligjit Organik të Bankës Kombëtare, të ligjit mbi rregullimin e monedhave**

(e botuene në Fletoren Zyrtare 31 Korrik 1925, Nr. 40)

Unë, Kryetari i Republikës Shqiptare urdhënoj ekzekutimin e  
a) Konvencionit të Bankës Kombëtare të shtipilluem midis Qeveris Shqiptare dhe Grupit Financjar Italian me datë 15 Mars 1925 e i ratifikuem me dekretin me datë 15 Mars 1925 dhe i shpallun në Fletoren Zyrtare me 18 Prillë 1925.

b) Konvencionit mbi Huan për punërat Botore të Shqipnis prej 50.000.000 (pesëdhjetëmiljor) Fr. ari.

c) Ligjit organik të Bankës Kombëtare të përbamun prej 60 artikujsh e të përmbledhun në 8 kapitula.

ç) Ligjit mbi rregullimin e Monedhës, me gjithë ndryshimet e bëmuna prej të dy Dhomave legjislative në konvencionet e në ligjin organik të sipërpërmendun.

*Ministri i Financave*  
*e Zau. Ministri i P. të Jashtme*  
MUFID LIBOHOVA

*Kryetari i Republikës*  
A. ZOGU

## **2 shtator 1925**

Në Romë, u bë konstituimi i "Bankës Kombëtare të Shqipërisë".

"Banka Kombëtare e Shqipërisë" krijohet si Bankë emisioni dhe aktiviteti i saj rregullohet prej Statutit, konform me Ligjën organike për Bankën.

Në bazë të Statutit, jetëgjatësia e Bankës u caktua 50 vjet, me të drejtë të zgjatjes së këtij afati me vendim të Kuvendit të Përgjithshëm të Aksionerëve.

Kapitali i bankës përbëhej prej 100.000 aksionesh themeltare (me vlerë 1,25 franga ar secili) dhe 495.000 aksionesh të zakonshme (me vlerë 25 franga ar secili) dhe ishte në total 12.500.000 franga ar.

Secili prej aksionerëve kishte vetëm një të drejtë vote në Kuvend dhe vendimet e Kuvendit merreshin me shumicë votash.

Banka kishte privilegjin ekskluziv të nxjerrjes së kartëmonedhës dhe ajo do të mbante një rezervë metali (ar dhe argjend, në shufra ose në monedha) në vlerë të paktën sa 1/3 e bankënotave të nxjerra në qarkullim.

Kuvendi i Përgjithshëm i Zakonshëm i Aksionerëve do të mbahej të paktën një herë në vit, kurse ai i jashtëzakonshëm, kur ta quante të nevojshme Këshilli i Administratës.

Drejtimi i politikës së përgjithshme të bankës i rezervohej Këshillit Administrativ, i cili formohej prej minimumi 9 vetash dhe maksimumi 13. Këta emëroheshin prej Kuvendit të Përgjithshëm, kurse njëri prej tyre prej Ministrisë të Financave të Shqipërisë.

Qendra e Komitetit Administrativ do të ishte në Romë dhe Drejtoria Qendrore fillimisht në Durrës e më vonë në Tiranë. Kjo e fundit do të kujdesej për zbatimin e vendimeve të Këshillit Administrativ dhe të Komitetit të Administratës. Përbërja e Drejtorisë Qendrore do të ishte 4 veta nga të cilët 2 italianë dhe 2 shqiptarë.

## **2 shtator 1925**

Në mbledhjen e parë për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, në prani të aksionerëve si dhe të personaliteteve shqiptare, italiane dhe jugosllave, u procedua për zgjedhjen e Këshillit Administrativ të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Nga zgjedhjet që u bënë, u vendos që në Këshillin Administrativ do të bënin pjesë :

### **A. Këshilltarë Administrativë**

Mario Alberti, Ministër i Plotfuqishëm i Italisë, President i Këshillit.

Frederico Brunner, Zëvendës-president i Këshillit Administrativ.

Chevalier de Wauters d'Oplinter, Zëvendës-president i Këshillit Administrativ.

Pietro Fenoglio, Këshilltar.

Giuseppe Bianchini, Këshilltar.

Lale N. Zuber, Këshilltar.

Amedeo Gambino, Këshilltar.

Vendi i një këshilltari i është rezervuar Qeverisë Shqiptare.

### **B. Sindikë efektive**

Vincenzo Azzolini.

Ajet Libohova.

Francesco Motta.

### **C. Sindikë plotësues**

Giuseppe Marino.

Massimo Aureli.

### **D. Inspektorët në Romë**

Guido Cordova –Inspektor.

Umberto Picardi –Kryekontabilist.

E. Drejtuesit e filialeve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë  
 bashkëdrejtorë: Giulio Gaudenzi dhe Loro Muzhani.  
 zëvendësdrejtorë: Armando Battisti, Luigi Magnolli, Ettore Melis.  
 prokuratorë: Ugo Olmastroni, Rafaele Razzini, Francesco Evangelista, Giuseppe Romani, Giuseppe Terrusi.

*Pasqyra e aksionerëve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë  
 më datë 2 shtator 1925*

<i>Aksionerët</i>	<i>Përfaqësuesit</i>	<i>Themelltarë</i>	<i>Të zakonshme</i>
<i>Credito Italiano</i>	<i>Mario Alberti</i>	<i>100.000</i>	<i>15.000</i>
<i>Banca Nazionale di Credito</i>	<i>Ing.P.Fonoglio</i>		<i>30.000</i>
<i>Banco Di Roma</i>	<i>Carlo Dazio</i>		<i>30.000</i>
<i>Banca Commerciale Italiana</i>	<i>Ing.L.di Stefano</i>		<i>30.000</i>
<i>4 banka të vogla italiane</i>	<i>Av.A.Gambino Av.G.Bianchini</i>		<i>20.000</i>
<i>Ugo Viali- Roma</i>			<i>40.000</i>
<i>Vincenzo Azzolini -Roma</i>			<i>25.000</i>
<i>Massimo Aurelio</i>			<i>30.000</i>
<i>Banque Commerciale de Bale</i>	<i>Frederico Brunner</i>		<i>50.000</i>
<i>Banque Belge pour l'Etranger</i>	<i>Av.R.Gambino</i>		<i>25.000</i>
<i>4 banka jugosllave</i>	<i>Lale N.Zuber</i>		<i>50.000</i>
<i>Ajet Bej Libohova</i>			<i>40.000</i>
<i>Ekrem Bej Vlora</i>			<i>58.000</i>
<i>Nexhet Pasha Vlora</i>			<i>52.000</i>
<b><i>GJITHSEJ</i></b>	<b><i>100.000</i></b>		<b><i>495.000</i></b>

**17 shtator 1925**

Mbledhja e parë e Komitetit Administrativ të Bankës Kombëtare të Shqipërisë

Ndërtimi i rezervës

Referuar artikullit 22 të Statutit Shoqëror, Komiteti vendosi që një pjesë e rezervës së kartëmonedhave përbëhet nga fonde të disponueshme, në dollarë, franga zvicerane ose stërlina, të mbajtura në llogari rrjedhëse pranë bankave primare të Evropës dhe të Amerikës.

Komiteti vendosi, gjithashtu, të ndërtojë, në harmoni me artikullin e cituar, një rezervë metalike efektive në monedha ari ose në vergje, në masën jo më pak se ajo e vendosur në të njëjtin artikull, ose të 11,11 për qind të importit total të biletave në qarkullim.

Komiteti i rezervohet e drejta të vendosë në cilat raste rezerva metalike duhet të jetë depozituar dhe në cilat mënyra duhet të jetë kustoduar.

Mënyrat e rimbursimit.

Referuar artikullit 24 të Statutit Shoqëror, Komiteti vendosi që rimbursimi i biletave pranë zyrës qendrore në Durrës do të bëhet në rrugë normale, përmes emisionit të *çeqeve* në dollarë, franga zvicerane ose stërlina, sipas bursës së New York, Zurih e Londër. Në raste përjashtimore, kur klientela nuk ka bërë kërkesë, rimbursimi mund të jetë i efektshëm nga zyra e Durrësit në valutë efektive ose në bankënota të vendeve të tjera.

Komiteti, gjithashtu, vendosi të bëjë të rimbursueshme biletat pranë Sukursales së Tiranës përmes *çeqeve*, cituar më sipër, duke përjashtuar filialet në rimbursimin e valutës ose në kartëmonedha të vendeve të tjera.

Komiteti vendosi, gjithashtu, të zhvillojë praktikat oportune me bankat kryesore të huaja për të siguruar rimbursimin e biletave sipas bursave më të rëndësishme të Evropës dhe të Amerikës, mbi bazën e kursit fiks 19,3 për qind dollarë për franga ar. Zyra e Durrësit mund të rimbursojë në dollarë, në bazë të kursit të sipërhënuar, biletat mujore të bankave të huaja, por, duke përjashtuar pagesat e shpenzimeve postare, të siguracionit ose të komisionit.

### **24 tetor 1925**

Komisioni Hetues parlamentar akuzoi për tradhti kombëtare, Mufid Libohovën, Ministër i Financave dhe Zëvendësministër i Punëve të Jashtme, përfaqësues i Shtetit Shqiptar në tratativat me italianët, për shkelje të rënda të interesave kombëtare në këto tratativa, gjatë përfundimit të marrëveshjes mbi bankën dhe huanë SVEA.

### **29 nëntor 1925**

Hapet Filiali i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë.

### **30 nëntor 1925**

Hapet Filiali i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Durrës.



*Foto e Filialit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, Durrës.*

### **23 dhjetor 1925**

Banka Kombëtare e Shqipërisë  
Zyra qendrore Durrës

Komunikohet që me 19 dhjetor 1925 është dërguar përmes detit nga Firma Bradbury Wilkinson & C., drejt degës së Barit të Banca d'Italia, sasia e parë e kartëmonedhave, të cilat mund të arrijnë në Bari me datë 30 ose 31 të muajit në vazhdim.

Bëhet fjalë për një sasi prej 10.000 copë kartëmonedhash prej 20 frangash dhe 40.000 copë kartëmonedhash prej 5 frangash, me një vlerë totale prej 400.000 franga.

### **28 shkurt 1926**

Filloi hedhja në qarkullim e bankënotave me prerje 20 franga ar në sasinë 5.000 franga ar, pasuar me sasi të tjera pothuaj çdo dhjetëditor. Po ashtu, filloi edhe hedhja në qarkullim e bankënotave me prerje 5 franga ar.



5 Lek/1 frank ar 1926



5 franga ari 1926

### **10 mars 1926**

Filloi hedhja në qarkullim e monedhave metalike në formën e monedhave prej nikeli ½ lek, në sasinë 1.000 franga ar, pasuar me sasi të tjera pothuaj çdo dhjetëditor.



20 franga ari 1926



100 franga ari 1926



5 qindar Leku 8.02.1926



10 qindar Leku 8.02.1926



1/4 Leku 01.09.1926



5 franga ari 18.11.1926



2 franga ari 1.12.1926



20 franga ari 21.08.1926

### **1 nëntor 1926**

Hapet Filiali i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Shkodër.



Filiali i Shkodrës, Marubi 1926.



*Foto e rrugës ku ndodhej selia e Filialit Shkodër, në vitet '30.*

### **1926**

Banka e Athinës, një nga bankat më të fuqishme të Greqisë, e krijuar në vitin 1893 dhe me qendër në Athinë, hapi dy degë të sajat në Durrës dhe në Korçë.

### **15 nëntor 1926**

Hapet Filiali i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Vlorë.



*Foto e godinës ku u vendos fillali i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Vlorë.*

### **28 nëntor 1926**

Hapet Filiali i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Korçë.

### **1927**

Disa sipërmarrës shqiptarë, sidomos të qytetit të Korçës, dhanë dhe zhvilluan idenë për krijimin e një banke me kapitale të përziera vendase dhe të huaja, me qëllim kreditimin e kapitalit vendas edhe për vetë arsyen se dega e Bankës Kombëtare të Shqipërisë nuk po jepte kredi. Pjesëmarrja e kapitalit të huaj dhe e atij vendas do të ishte e barabartë.





*100 franga ari 1927*



*1 Lek 1927*



*100 franga ari 15.12.1928*

### **1928-1929**

Me iniciativën e kapitalistëve shqiptarë, duke shpresuar edhe në ndihmën e dhomave të tregtisë, u projektua krijimi i "Banka Tregtare e Shqipërisë". Kapitalistët nga Tirana dhe Durrësi, krijuan një komision me: Isuf Beshirin, Aleksandër Hobdarin, Vlash Dovanën etj. dhe mendonin që projektin t'ia paraqitnin Kongresit të Dhomave të Tregtisë. Qendra e bankës mendohej të ishte në Durrës.

### **1929**

U diskutua gjerësisht ideja për krijimin e "Banka e Kreditit të Paluajtshëm" (*Banca di Credito Fondiario*). Sipas projektit banka do të krijohet me kapital italian nga grupi financiar që kishte marrë pjesë në krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Ajo mendohej të vepronte në fushën e kreditit hipotekar duke dhënë kredi për pasuri të patundshme, toka, banesa.

#### **4 dhjetor 1929**

U realizua "Marrëveshja Gambino-Tutulani" e cila u iniciua nga ana e Ahmet Zogut, me qëllim përmirësimin në favor të Qeverisë Shqiptare, të raportit aktual 50 për qind kundrejt 50 për qind, në rastin e prerjes dhe të hedhjes në qarkullim të monedhave prej argjendi.

Kushtet e marrëveshjes ishin :

- Banka mernte përsipër të priste për llogari të Shtetit Shqiptar monedhat e argjendta prej 5 dhe 10 lekë.
- Banka pranonte të hiqte dorë nga fitimet që i takonin sipas marrëveshjes së marsit të vitit 1925. Fitimet që do të rridhnin nga prerja e monedhës do të depozitoheshin në një llogari speciale me interes 4 për qind në vit, në Bankën Kombëtare të Shqipërisë në Durrës. Ky fond do shërbente si rezervë për monedhat prej argjendi në qarkullim.
- Në raste luftërash, fatkeqësish, varfërie, Ministria e Financave kishte të drejtë të hiqte 2/3 e këtij fondi, me detyrimin për ta kthyer brenda 3 muajve.
- Banka Kombëtare e Shqipërisë ishte e detyruar t'i çelte Qeverisë Shqiptare një kredi në llogari rrjedhëse , të barabartë me 2/3 e fondit dhe me një interes prej 7,5 për qind. Shumat duhet të ktheheshin brenda vitit financiar përkatës.
- Me përfundimin e marrëveshjes mbi Bankën Kombëtare të Shqipërisë, Shteti Shqiptar do të përfitonte komplet shumën e fondit të fitimeve, së bashku me interesat që nuk do të kapitalizoheshin dhe mbasi të ishin tërhequr monedhat prej argjendi, që banka do të kishte në arkat e saj ditën e likuidimit.
- Marrëveshja e re duhej miratuar nga Parlamenti Shqiptar.

#### **TRONDITJA E SISTEMIT MONETAR NË VITET E KRIZËS BOTËRORE 1929-1933**

*Stabilizimi i ekonomisë së shteteve të ndryshme, pas Luftës së Parë Botërore, bëri të mundur rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë, të financave dhe relativisht edhe të sistemeve të tyre monetare.*

*Kjo tendencë u shfaq edhe në Shqipëri. Duke filluar nga viti 1929, filloi të ndjehej e fuqishme mungesa e tregjeve për shifjen e produkteve, gjë që reflektoi në fillimin e një krize mbarëbotërore, e cila tronditi edhe sistemet e tyre monetare. Ndërkohë që kriza botërore zgjati nga vitet 1929-1933, në Shqipëri pasojat e saj vazhduan të jenë të pranishme deri në mesin e vitit 1935.*

*Kjo krizë goditi edhe sistemin monetar të Shqipërisë. Megjithatë Banka Kombëtare e Shqipërisë po zbatonte politikën e mbajtjes së monedhës në qarkullim nën nivelin e nevojave reale të ekonomisë sonë, frangu shqiptar dha shenjat e para të zhvleftësimit në masën 5-6 për qind.*

*Kjo u bë shkas për alarm në radhët e tregtarëve dhe të industrialistëve. Firma të ndryshme kapitaliste u turrën në sportelin e bankës për të këmbyer kartëmonedhat me monedha prej ari të Shtetit Shqiptar.*

*Udhëheqja e Bankës zvogëloi edhe më tepër sasinë e kartëmonedhave në qarkullim duke thelluar deflacionin. Nga 14.020.000 franga ar që ishin në qarkullim në prill të vitit 1933, shifra zbriti në 10.529.000 franga ar në fund të vitit 1938.*

*Përveç kësaj, udhëheqja e Bankës kufizoi në maksimum shkëmbimin e kartëmonedhave në monedha prej ari, duke kaluar nga sasia 325.000 franga ar që mesatarisht ishin shkëmbyer në vitet e para , në sasinë 8.000 franga ar në vit, gjatë periudhës 1932-1933, dhe në sasinë 2660 franga ar në vit, gjatë periudhës 1934-1936.*

**20 janar 1930**

Miratohet Statuti i Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Statuti i Bankës përbëhet nga 8 (tetë) seksione me gjithsej 60 nene (artikuj).

Seksioni I

Krijimi, selia dhe kohëzgjatja e Bankës.

Art.1.

Krijohet në Shqipëri një bankë emisioni emërtuar "Banka Kombëtare e Shqipërisë".

Aktiviteti i saj rregullohet nëpërmjet këtij Statuti që është formuluar konform Ligjës organike për Bankën si edhe prej Ligjës së vet dhe prej rregulloreve që do të bëhen në të ardhmen.

Në rastet kur Ligji ose Statutet heshtin, do të merren parasysh për analogji rregullat e legjislacionit italian lidhur me shoqëritë tregtare.

Seksioni II

Kapitali dhe aksionet e Bankës.

Seksioni III

Objekti dhe veprimtaria e Bankës.

Seksioni IV

Emisioni i bankënotave. (kartëmonedhave).

Seksioni V

Mbledhjet dhe kuvendet.

Seksioni VI

Administrimi i Bankës.

Seksioni VII

Buxheti i Bankës dhe ndarja e fitimeve.

Seksioni VIII

Likuidimi i Bankës.

BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS  
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

STATUT  
STATUTO

SEZIONE I.

*Istituzione, sede e durata della Banca.*

Art. 1.

E' istituita in Albania una Banca di emissione sotto la ragione sociale: « Banca Nazionale d'Albania ».

La sua attività è regolata dal presente Statuto compilato in armonia alla Legge organica per la Banca, nonché dalla Legge stessa e dai regolamenti che verranno in seguito stabiliti.

Ove la Legge o gli Statuti non dispongano, si farà ricorso, per analogia, alle norme della legislazione italiana relative alle Società commerciali.

Art. 2.

La Banca ha la Direzione Centrale nella capitale dell'Albania. La sede del Consiglio e del Comitato di Amministrazione è stabilita a Roma.

La Banca può, su semplice deliberazione del Comitato di Amministrazione, istituire sedi, succursali, agenzie e rappresentanze ovunque, nei territori dello Stato albanese od all'estero.

Art. 3.

La durata della Banca è fissata in 50 (cinquanta) anni. Essa potrà essere prorogata, una o più volte, con deliberazione dell'Assemblea generale degli azionisti, presa a semplice maggioranza di voti, senza che ciò possa dare luogo a diritto di recesso agli azionisti.

SEZIONE II.

*Capitale ed azioni della Banca.*

Art. 4.

Il capitale della Banca è di 12.500.000 (dodici milioni cinquecento mila) franchi oro, diviso in 495.000 (quattrocento novantacinque mila) azioni ordinarie dal valore nominale di franchi oro 25

SEKSION I.

*Ngrehje, ndëjë dhe të ngjaturun të Bankës.*

Art. 1.

Ngrehet në Shqipni një Bankë emisioni me emnin: « Banka Kombëtare e Shqipnis ».

Aktiviteti i saj rregullohet prej këtij Statuti që është i kompiluar në konformitet me Ligjin organikë për Bankën si edhe prej Ligjës vetë e prej rregulloreve që kanë për t'u bërë masandaj.

Ku Ligja ose Statutet heshtin, do të merren para sysh, për analogji, rregullat e legjislacionit italian për sa u përket shoqëritë tregtare.

Art. 2.

Banka ka Drejtorin Qendrorë në kryeqytetin e Shqipnis. Ndëja e Këshillit dhe e Komitetit të Administratës, është e caktuarë në Romë.

Me të vetmin vendim të Komitetit të Administratës, Banka mundet të ngrehë ndëja, dega, axhenci dhe përfaqsi kudo, në tokën e Shtetit Shqiptar ose jashtë.

Art. 3.

Të ngjaturit e Bankës është i caktuar për 50 (pesëdhjetë) vjet. Ky afat mundet të zgjatet, një ose më tepër herë, me vendim të Kuvëndit të përgjithshëm të aksionistëve, të dhanur me shumicë votash, pa munguar ky vendim t'u japë të drejtë aksionistëve të tërhiqur.

SEKSION II.

*Kapital dhe aksione të Bankës.*

Art. 4.

Kapitali i Bankës është prej 12.500.000 (dymbëdhjetë milion e pesëqint mijë) frankash ari, i ndamë në 495.000 (katërqintenantëdhjetepesë mijë) aksione ordinare me vlefë emnore (nominale) 25

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E ARKIVIT

### ***21 janar 1930***

Institucioni i Drejtorisë qendrore Romë drejtuar filialit të Tiranës, Drejtorisë Qendrore, Durrës dhe filialeve të Korçës, Shkodrës dhe Vlorës.

Ju informojmë që Komiteti i Administrimit, në mbledhjen e datës 10 janar, ka vendosur konstituimin e Drejtorisë Qendrore të parashikuar në art.42 të Statutit Shoqëror. Komiteti ka vendosur që Drejtoria Qendrore të drejtohet nga Këshilltari i Deleguar, Amedeo Gambino, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës.

Gjithashtu, u vendos Z.Giulio Gaudenzi, në cilësinë e Drejtorit të Bankës.

Anëtari i Qeverisë Shqiptare, Z.Giovani Bumçi do të bëjë pjesë në Drejtorinë e Përgjithshme.

Drejtoria Qendrore, përveç ushtrimit të kontrollit mbi filialet, do të ketë për detyrë mbajtjen e llogarive me të tretët dhe në veçanti me Autoritetet Qendrore Shqiptare, për të gjitha sqarimet e nevojshme që mund të kërkohen në veprimtarinë e Bankës. Llogari të tilla nuk sjellin asnjë të drejtë për impenjimin e Institutit si në operacione të veçanta apo në përgjithësi, sipas artikullit 41 të Statutit Shoqëror, parashikuar në kompetencë të Komitetit të Administrimit.

### ***21 janar 1930***

Në një letër drejtuar avokatit Gambino, konstatohet se nuk është zgjidhur çështja e blerjes së terrenit në kuadrin e përpjekjeve për transferimin e Selisë Qendrore të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, nga Durrësi në Tiranë.

Ndërkohë ishte kontaktuar me Bashkinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me një plan rregullues për qendrën e Tiranës, pasi me këtë plan lidhej direkt edhe vetë ndërtimi i Bankës.

### ***maj 1930***

Qeveria e Ahmet Zogut, shpalli ligjin për Reformën Agrare dhe bashkë me të u miratua edhe ligji për krijimin e bankës bujqësore.

Ligji për krijimin e bankës parashikonte që kapitali të ishte 5 milionë franga ar dhe do të formohej prej çmimit të tokave të shpronësuara, nga mbajtjet e kredive të dhëna nga ish-Banka Agrare Turke, të arkëtuara deri në atë kohë si të ardhura të shtetit, fitimet që do të kishte banka, shtesës së taksës mbi alkolin, ndalesat në rrogë për nëpunësit civilë e ushtarakë.

Në përputhje me ligjin e shpallur gjatë viteve 1930-1931 qe krijuar një fond prej 1.588.000 frangash ar kundrejt 5.000.000 frangash ar, që ishte parashikimi.

Në fakt, banka nuk u ngrit në këtë kohë, pasi fondi i krijuar i depozituar pranë Bankës Kombëtare të Shqipërisë, u përdor për mbulimin e deficitit buxhetor.

### ***18 qershor 1930***

U mbledh Kongresi me përfaqësuesit e tregtarëve nga e gjithë Shqipëria, me objekt kryesor çështjen e koronave prej argjendi që vazhdonin të qarkullonin në Shqipëri.

Tregtarët dhe shtresa të ndryshme të popullsisë ishin të shqetësuar nga fakti se koronat në qarkullim ishin bërë objekt spekulimi për shkak të sasive të vogla të monedhës metalike që Banka Kombëtare e Shqipërisë kishte hedhur në qarkullim.

Në prill të vitit 1930 edhe Ministria e Ekonomisë Kombëtare hartonte një koncept, i cili trajtonte vështirësitë e mësipërme në qarkullimin monetar. Vërehej se veprimtaria spekulative me koronën ishte në dëm të popullit pasi çmimi i saj në raport me argjendin shufër ishte më i lartë, për shkak se përdorej si zëvendësues i monedhave metalike.

### ***qershor 1931***

Me iniciativën e Mehmet Konicës, ish-Ministër i Qeverisë së Ahmet Zogut dhe kapitalistit shkodran Mark Kakarriqi, të nxitur edhe nga kapitali anglez, filloi diskutimi i projektit për ngritjen e një banke anglo-shqiptare me emrin "Anglo-Albanian Bank Ltd". Banka do të kishte kapital të autorizuar 2 milionë lira angleze.

***prill 1933***

Qeveria Italiane ndërpret dhënien e ndihmave për Qeverinë e Ahmet Zogut. Divergjencat patën filluar që në vitin 1931, pak kohë pas përfundimit të marrëveshjes 10-vjeçare për huanë 100 milionë franga ar.

***6 maj 1934***

U bë përirimi i filialit në Tiranë të Bankës së Eksportimit (Eksport Banka) me qendër në Beograd, themeluar në vitin 1901, me një kapital 30 milionë dinarë (2.7 milionë franga ar). Megjithëse kishte mbështetjen e Shtetit Jugosllav, ajo nuk arriti të kishte një veprimtari të ndjeshme në fushën e kreditit, për arsye të konkurrencës nga kapitali italian dhe nga Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Ajo e zhvilloi veprimtarinë deri në vitin 1939.



*1 qindar ar 28.03.1935*



*1 frang ar 28.03.1935*

## DEPOZITAT BANKARE DHE POLITIKA E KREDITIT NË SHQIPËRI 1924-1939

Në Shqipëri depozitat bankare, që shërbejnë si tregues i akumulimit të kapitaleve të lira, kanë shënuar një rritje të shpejtë gjatë periudhës 1925-1939. Kështu, nga 1.734.000 franga ar që ishin depozitat e Bankës Kombëtare të Shqipërisë në vitin 1926, që është edhe viti i fillimit të veprimtarisë së saj, erdhën duke u rritur dhe në vitin 1936 arritën nivelin e tyre më të lartë prej 20.775.000 frangash ar.

Pastaj, ecuria e tyre pati trajtën e zikzakut për të arritur në vitin 1938 në një shumë prej 12.155.000 frangash ar. Rritja, relativisht e shpejtë, e depozitave bankare përbën një karakteristikë për sistemin bankar shqiptar të asaj periudhe.

Pjesa më e madhe e depozitave bankare përbëhej nga depozitat e enteve publike, të bankave dhe të institucioneve financiare. Kjo, ka lidhje me përdorimin e fondit të huasë SVEA, të huasë prej 100.000.000 franga ar që Italia i dha Qeverisë Shqiptare për punët botore, për mbulimin e deficitit buxhetor etj..

Pjesërisht, kjo rritje ka lidhje me krijimin e kapitalit të Bankës Bujqësore të Shtetit. Zhvillimi me ritme të shpejta i depozitave të enteve publike financiare përbën një karakteristikë tjetër në fushën e depozitimit bankar.

Politika e mbajtjes së monedhës në qarkullim në një nivel më të ulët nga nevojat e ekonomisë sonë (deflacioni monetar) shpuri në mbajtjen artificiale të vlerës së depozitave bankare dhe në zhvlerësimin e tyre.

Gjatë viteve 1925-1939, kemi një rritje të veprimtarisë aktive të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Udhëheqja e kësaj banke investoi një pjesë të rëndësishme të mjeteve monetare që dispononte, në obligacionet dhe në titujt e tjerë të Shtetit Italian.

Nga 5.300.000 franga ar që ishin investimet e Bankës Kombëtare të Shqipërisë në titujt e Shtetit Italian në vitin 1926, ato arritën në 8.500.000 franga ar në vitin 1938. Duhet theksuar se ndërsa udhëheqja e bankës erdhi duke i rritur investimet e saj në obligacionet dhe titujt e tjerë të Shtetit Italian, ajo refuzoi dhënien e një huaje të vogël prej 2.500.000 frangash ar Qeverisë Shqiptare, për nevoja të përkohshme të Buxhetit të Shtetit.

Politika e kreditit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ka synuar që të mbështesë veprimtarinë ekonomike të shoqërive italiane që vepronin në industri, në bujqësi, në ndërtim dhe sidomos në tregti. Banka Kombëtare e Shqipërisë mbështeti me kredi edhe tregtarët shqiptarë e veçanërisht ata që kishin marrëdhënie tregtare me Italinë.

Për shumë vite me rradhë, udhëheqja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë pati monopolin e tregut të kreditit. Ajo pengoi zhvillimin më të shpejtë të vendit tonë. Kjo u duk në faktin se megjithë përpjekjet e kapitalit shqiptar, ky nuk arriti të ngrrejë një institut krediti të tijin, pasi Banka Kombëtare e Shqipërisë i shihte ata si konkurrentë të ardhshëm dhe u mundua t'i pengonte në forma të ndryshme.

Përveç kësaj, Banka Kombëtare e Shqipërisë ndoqi politikën e kreditimeve të kufizuara për kapitalin shqiptar. Kjo u duk në faktin se kjo bankë e mbajti masën e kredive në një nivel mjaft të ulët krahasuar me nevojat e ekonomisë shqiptare. Për këtë, flet edhe fakti se kreditë e përdorura ishin shumë nën nivelin e kredive të autorizuara.

### ***mars 1936***

Arrihet kompromisi mes Qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare në bazë të të cilit u parashikua hedhja në qarkullim e monedhave të vogla për një shumë prej 1.000.000 franga ar. Me këtë rast, Banka Kombëtare e Shqipërisë i dha Qeverisë Shqiptare një shumë "afrofe" prej 450.000 frangash ar.

Kjo zbuste mungesën e monedhave të vogla, por nuk i zgjidhte plotësisht problemet në qarkullimin monetar në Shqipëri.

### ***dhjetor 1936***

Qeveria Shqiptare për të dytën herë nxjerr ligjin për krijimin e Bankës Bujqësore (i pari në maj 1930).

### ***korrik 1937***

Qeveria Shqiptare për të tretën herë nxjerr dekretligjin për krijimin e Bankës Bujqësore (i pari në maj 1930). Kapitali i bankës mendohej të ishte 2,8 milionë franga ar dhe do të financohej krejtësisht nga Shteti Italian.

Në fund të vitit 1937, Banka Bujqësore filloi veprimtarinë me degën e saj në Tiranë dhe më vonë u shtri edhe në rrethe të tjera.

### ***nëntor 1937***

Përurohet krijimi i filialit të Banka e Napolit (Banca di Napoli) në Tiranë. Kjo bankë e krijuar në vitin 1539 me qendër në Napoli, ishte shtrirë në disa qytete të ndryshme të Italisë dhe jashtë saj.

Dega e hapur në Shqipëri, do të kishte autonomi, statut dhe bilanc të veçantë dhe do të emërtohej Banco di Napoli-Albania. Kapitali i saj fillestar do të ishte 1 milion franga ar.

Banka e Napolit Shqipëri (Banco di Napoli-Albania) hyri menjëherë në lidhje me shoqëri e ndërmarrje kapitaliste shqiptare dhe të huaja, duke u krijuar atyre lehtësi për të hyrë në marrëdhënie bankare, pa formalitete të shumta. Veçanërisht konkuroi me kushtet lehtësuese për tërheqjen e depozitave, kredidhënien, shitblerjen e valutave etj..

### ***1937***

Shoqëria SITA (Shoqëria Industriale Tregtare Shqipëri), themeluar në vitin 1927 me qendër në Tiranë, u orvat të hapte një shteg në sistemin e kreditit në Shqipëri. Veprimtaria e saj shtrihej në fushën e energjisë elektrike, në prodhimin e tullave, të tjegullave dhe të kripës.

Duke qenë një nga shoqëritë më të fuqishme në Shqipëri, ajo bëri përpjekje për krijimin e një banke me kapitale tërësisht shqiptare. Ajo kishte influencë në qarqet drejtuese të Qeverisë Shqiptare, gjë që lehtësonte zgjerimin dhe ritjen e veprimtarisë së saj.

Sipas projektit të SITA-s për bankën, kapitali i saj do të ishte 2.000.000 franga ar nga të cilat 600.000 do të derdheshin menjëherë. Banka planifikonte të mobilizonte depozitat e shqiptarëve dhe të vepronte në fushën e kreditimit.

Projekti, ashtu si edhe disa iniciativa të mëparshme të kapitalit shqiptar, nuk arriti të finalizohet.

### ***dhjetor 1937***

Banka e Napolit Shqipëri (Banco di Napoli-Albania) hapi degën e saj edhe në Durrës.



BANKA KOMBËTARE E SHQIPNÍS  
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

KAPITAL FR. A. 12,500,000 CAPITALE

TELEGRAFI: BANCALBA  
Telegrammi:

ROMA, Prill 1938  
VIA TORINO, 107 Aprile 1938

Qarkore  
Circolare N. 21

Nënshkrime të autorizuese  
Firme autorizzate

Kemi nderin të Ju dërgojmë me këtë qarkore listën e personave të  
Ci preglamo rimetterVi, con la presente circolare, l'elenco delle persone  
autorizuem me nënshkrue në emën të Istitutit t'onë si edhe ekzempletet e  
autorizzate a firmare in nome del nostro Istituto, nonché i relativi  
nënshkrimeve të tyre.  
facsimili di firma.

Tue Ju lutun qi të merrni shënim, Ju paraqesim nderimet t'ona.  
Vi preghiamo di voler prenderne buona nota e di gradire i nostri distinti saluti.

BANKA KOMBËTARE E SHQIPNÍS  
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

P. SH. - Kjo qarkore anulon të maparshmet. Hyn në fuqi prej datës 20 Prill 1938.  
N. B. - La presente circolare annulla le precedenti. Essa entra in vigore a partire dal 20 Aprile 1938.

DREJTORIA E PËRGJITHSËME  
E ARKIVAVE

ARSH. F. 279. V. 1938. D. 164. F. 1

Komiteti Administrativ  
Comitato d' Amministrazione

S. E. ANTONIO MOSCONI

Kryetar  
Presidente

Sig. FEDERICO BRUNNER

Nënkryetar  
Vice Presidente

M. AUGUSTE CALLENS

Nënkryetar  
Vice Presidente

Avv. AMEDEO GAMBINO

Këshilltar Delegat e Drejtor i Përgjithshëm  
Consigliere Delegato e Direttore Generale

Sig. FRANCESCO SFORZA

Këshilltar  
Consigliere

Antarët e Komitetit Administrativ kanë fakultetin e "nënshkrimit të parë" pranë Qendres së Komitetit e pranë  
I Membri del Comitato d'Amministrazione hanno facoltà di "prima firma" presso la Sede del Comitato e presso  
të gjitha Degave të Institutit.  
tutte le Filiali dell' Istituto.

DREJTORIA E P.C.  
E ARKIVAVE  
DREJTORIA E P.C.  
E ARKIVAVE

### **15 shtator 1938**

Me rastin e transferimit të Sellisë Qendrore nga Durrësi në Tiranë, diskutohet statusi i nëpunësve të huaj në Bankën Kombëtare të Shqipërisë. (në bazë të qarkores Nr.37/337, datë 29.XII.1936 dhe Nr.1600/II, datë 6.X.1936)

Mbretëria Shqiptare  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Drejtoria e Korrespondencës  
Drejtuar Prefekturës Tiranë  
Mbi çertifikatat e shpërnguljes për të huajt.

Nëpunësit e huaj të Bankës Kombëtare dhe asaj të Napolit nuk mund të quhen nëpunës të administratës (parastatalë), siç pretendohet prej tyre, pasi Institutet Bankare në Shqipëri janë ente private dhe jo Zyrtare të Mbretërisë.

Për këto arsye, të lartpërmendurit nuk mund të përjashtohen nga akordimi i lejeve të banimit, prandaj kundrejt tyre duhet vepruar ashtu si dhe për të gjithë shtetasit e tjerë të kësaj kategorie, në bazë të qarkores sonë Nr.37/337, datë 29.XII.1936 dhe Nr.1600/II, datë 6.X.1936.

Me shkresën e mësipërme përmendet edhe që shtetasit e huaj, kur vendosin të sjellin nga jashtë familjet e tyre, që të përjashtojnë nga taksat doganore rrobat shtëpiake, marrin nga Bashkia e Kryeqytetit, nga një çertifikatë për Doganën e Durrësit, e cila lëshohet pas paraqitjes së leje-banimit.

### DEFLACIONI NË SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS 1925-1939

*Banka Kombëtare e Shqipërisë gjatë periudhës 1925-1939 ndoqi politikën deflacioniste në lëmin e monedhës. Karakteristikat kryesore të kësaj politike ishin:*

- *Mbajtja e monedhës në qarkullim nën nivelin e nevojave të vendit.*
- *Grabitja e arit dhe e argjendit shqiptar.*
- *Rritja artificiale e vlerës së frangut.*
- *Rishpërndarja e të ardhurave kombëtare.*

*Në vitin 1927, duke analizuar politikën monetare të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, Amedeo Gambino, një nga drejtuesit kryesorë të saj, argumentonte se për Shqipërinë ishte i mjaftueshëm një qarkullim monetar prej 25 frangash ar për frymë, çka do të thoshte në total 20 milionë franga ar. Kjo për arsye të varfërisë, të çeqeve në qarkullim dhe të shpejtësisë së ulët të qarkullimit monetar.*

*Njëkohësisht, ai pranonte se me zhvillimin ekonomik nevojat për monedhë duhet të arrinin nivelin 40-50 franga ar të popullsisë, çka përbënte 32-40 milionë franga ar në total, të cilat mendohej se do të normalizonin qarkullimin monetar.*

*Realisht ky nivel i qarkullimit monetar nuk u arrit asnjëherë dhe tregu e ndjeu shumë nivelin e ulët të sasisë së monedhës në qarkullim, veçanërisht në levizjet ekonomiko-tregtare.*

*Emisioni i monedhave dhe i kartëmonedhave në 1000 franga ar.*

<i>Datat</i>	<i>Kartëmonedhat në qarkullim</i>	<i>Monedhat në qarkullim</i>	<i>Shuma totale në qarkullim</i>
31.12.1926	2.333	219	2.552
31.12.1927	6.320	330	6.650
31.12.1928	10.095	422	10.517
31.12.1929	11.536	451	11.987
31.12.1930	12.925	670	13.595
31.12.1931	765	12.634	
31.12.1932	13.025	934	13.959
31.12.1933	14.020	931	14.951
31.12.1934	12.165	893	13.058
31.12.1935	11.019	993	12.012
31.12.1936	12.243	1567	13.810
31.12.1937	10.653	1611	12.264
31.12.1938	11.031	1916	12.947
31.12.1939	10.529	1958	12.487

*Mbajtja e monedhës në qarkullim nën nivelin e nevojave reale të ekonomisë së vendit, solli daljen në qarkullim në sasi të konsiderueshme të monedhave prej ari dhe argjendi, si dhe blerjen e tyre me çmime spekulative nga ana e shoqërive dhe e ndërmarrjeve italiane në Shqipëri.*

*Gjithashtu, politika monetare e ndjekur nga Banka Kombëtare e Shqipërisë mbajti artificialisht vlerën e kartëmonedhave dhe mbajti çmimet në nivele më të ulëta se realja, çka dëmtoi kryesisht prodhuesit e vegjël në qytet dhe në fshat.*

Në këtë rast bashkia në fjalë, bazuar në rregulloret ekzistuese u lëshon këtyre të huajve çertifikatat e shpërnguljes të vlefshme për doganë etj., mbështetur në lejen e banimit lëshuar nga ajo prefekturë.

Prandaj shtetasit e huaj, përpara se të kërkojnë çertifikatat e shpërnguljes, duhet të paraqesin një deklaratë ndërrim banimi që kanë bërë në komunën e banesës së tyre të fundit. Pasi të kenë marrë edhe lejet e banimit, lëshuar nga ajo prefekturë, të huajt, në bazë të deklaratës së mësipërme, regjistrohen në librin e të huajve të bashkive ose të komunave, ku do të qëndrojnë, dhe vetëm pas kryerjes së këtij formaliteti, bashkitë e komunat mund të lëshojnë çertifikatat për shpërngulje.

Lutemi urdhëroni zbatimin e veprimeve pikërisht si më sipër.

MINISTRI

**30 tetor 1938**

Fjalimi në ditën e inagurimit të ndërtesës së Bankës të Shqipërisë Tiranë, mbajtur nga *Antonio Moschoni*.

*"Lartmadhëri, Shkëlqesi, Zonja, Zotëri,*

*Duke marrë fjalën për here të parë në tokën e Shqipërisë, kaq e dashur në zemrën time si italian edhe për shkak të kujtimeve shekullore historike që pasqyrohen në emrin e Heroit Kombëtar Skanderbe, për miqësinë e shtrenjtë që*

*bashkon prej kohësh në mënyrë vllazërore të dy popujt, mendimi im i parë përulet para Lartmadhërisë Mbretit Zog I, që aq me meritë personifikon Kombin Fisnik e të vlefshëm Shqiptar.*

...

Ceremonia e sotme shënon për ne një datë përkujtimore, duke qenë se inaugurimi i këtij pallati, me të cilin kemi dashur t'i japim Kryeqytetit një seli të plotë dhe të stolisur të Bankës Kombëtare të Emisionit, formon për ne Administratorët, dëshmi të vulosur që ia kemi arritur qëllimit.

...

Ndërtesa e re vepër e ndritur e arkitektit të vlefshëm Prof.Morpurgo dhe e bashkëpunëtorëve të tij të zotë, në konturet e saj të matura e hijerëndë aq sa edhe artistikisht elegante, dëshiron të jetë pikërisht shprehja dhe sinteza e atij organizmi të fortë e të sigurt siç është Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Krijuar diçka më shumë se dymbëdhjetë vjet më parë, me iniciativën e një grupi financiar Italian, dhe gjithashtu me pjesëmarrjen modeste në të vërtetë, por jo më pak sinjifikative dhe të pëlqyeshme, të kapitaleve të tjera të huaja, e krijuar në një vend ku lehtësirat dhe mjetet e kreditit mund të quheshin pothuaj të panjohura, ajo, Banka Kombëtare, kishte përpara vetes dy qëllime esenciale për të arritur: T'i jepte Shqipërisë një monedhë të mirë e të shëndoshë dhe njëkohësisht të krijojë një organ krediti që të përbënte një bazë dhe një shtytje drejt zhvillimit ekonomik të saj.

Mund të pohojmë me ndërgjegje të pastërt që të dy këtyre qëllimeve u kemi dalë në krye plotësisht.

...

Një ent bankar emisioni, të cilit i bie përgjegjësia e rëndë për mbrojtjen e vlerës së monedhës kombëtare, ka për detyrë kryesore që të mos i shmangët kurrë atyre principeve që janë themelore për të e që mund të përmbledhen: në mbajtjen e një ekuilibri të drejtë midis qarkullimit, mbulesës, depozitave e derdhjeve të ndryshme, si dhe në dhënien e kredive përgjithësisht afatshkurtra dhe vetëm atyre që janë në gjendje të paraqesin garancitë e nevojshme.



*Pamje e portalit të hyrjes kryesore, 1938.*

...

Kombi fisnik Shqiptar, që vetëm prej çerek shekulli ka mundur , pas shumë peripecish të hidhura historike, të formohet më vehte dhe i pavarur dhe të ndërtojë vetë sistemin e tij politik, gjatë kësaj periudhe ka filluar, ngadalë por me siguri, zhvillimin ekonomik të tij.

...

Ne e dimë mirë se një Institut emisioni, para se t'u sigurojë fitime materiale aksionerëve të vet (aksionerët tanë në të vërtetë, nuk marrin veçse një shpërblim modest të kapitalit të tyre) duhet të vendosë që të kryejë një mision të lartë, atë të mbrojtjes së interesave kombëtare në lëmin monetar dhe ekonomik.



*Pamje e fasadës lindore të godinës së Bankës, 1938.*

Duke i mbetur besnik dhe me dashuri këtij koncepti, ne interpretojmë plotësisht shpirtin e atyre që kanë kryesuar në themelimin e kësaj Banke si dhe të atyre që janë ende sot të interesuar për të.

Banka Kombëtare e Shqipërisë është, dhe duhet të jetë gjithmonë, jo vetëm një roje e fortë dhe e qëndrueshme e Shtetit Shqiptar, e ekonomisë dhe e Pavarësisë së Tij, por edhe shprehja më me rëndësi dhe më e patundshme e miqësisë vëllazërore që lidh Shqipërinë me Italinë dhe e bashkëpunimit të shtrenjtë mes dy popujve, që është për të gjithë garanci e sigurtë për paqen.

I frymëzuar nga këto ndjenja, Ju ftoj, Zotërinj, të brohoritni me mua për fatet e mbara të Shqipërisë."



*Pamje te zyrave, foto Vassari, 1938.*

### **Godina e Selisë së Bankës së Shqipërisë, Tiranë - Të përgjithshme**

*Me konsolidimin e Shtetit të ri Shqiptar në vitet 20-30, krahas rikonceptimit urban të qyteteve dhe në mënyrë të veçantë, të Tiranës, filloi edhe organizimi dhe zhvillimi i administratës shtetërore, sipas modeleve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore.*

*Në këtë këndvështrim, edhe sistemi bankar shqiptar filloi të konceptohej e të konturohej sipas modelit financiar të shteteve perëndimore, për të qenë i gatshëm e për t'u paraprirë marrëdhënieve financiare që kishin lindur dhe po ndryshonin me shpejtësi në shtetin, që pak vite më parë kishte fituar pavarësinë.*


*Në këtë periudhë u ndërtuan në qytetet kryesore të vendit si: Durrës, Vlorë, Korçë, Elbasan etj. godinat e para të personalizuar për bankë. Këto godina, me arkitekturën e tyre të spikatur dhe me pozicionin e saktë urban në qendrat e qyteteve edhe sot mbeten ndër veprat më të arrira në fushën e arkitekturës e të ndërtimit administrativ.*

*Në këtë këndvështrim edhe godina e selisë së Bankës së Shqipërisë, për nga rëndësia e saj në sistemin financiar e bankar, si banka e bankave, u gjykua të vendosej në godinat që do të formatonin sheshin qendror të kryeqytetit tonë, Tiranës.*

*Në këtë këndvështrim edhe godina e Bankës së Shqipërisë bën pjesë në ndërtimet më të spikatura të asaj kohe në llojin e vet, rymës Rracionaliste.*



Franta posteriore



Piasta del pianterreno: 1. - Saloni degli sportellisti; 2. - vestibolo; 3. - portico d'ingresso.

ARCH. VITTORIO BALLIO - BANCA NAZIONALE D'ALBANIA A TIRANA

244

Godina e Bankës së Shqipërisë ka një mision të studjuar urban në vendin ku është ndërtuar. Ndryshimi i karakterit të fasadës së bankës nga ndërtesat e tjera të rrugës së Kavajës, lajmëron ndryshimin e ambientit urban në hyrje të sheshit qendror të kryeqytetit, duke prezantuar ndërtimin administrativ, tepër të rëndësishëm.

Godina e Bankës së Shqipërisë ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1938. Projekti i godinës është realizuar nga arkitekti i njohur i asaj periudhe, italiani Vittorio Ballio Morpurgo. Stili arkitektonik i saj i përket rrymës së "Rracionalizmit", rrymë e cila lulëzoi në gjysmën e parë të shekullit tonë në Evropë. Ky stil shquhet për vëllimet e mëdha dhe për linjat e forta në fasada. Kryesisht ai është aplikuar në ndërtimet shtetërore me funksion administrativ zyrtar dhe synonte të shprehte forcën e qeverive perëndimore të asaj kohe.

### **Pak mbi rrymën racionaliste në arkitekturë.**

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Evropa duhet të përballonte probleme të mëdha në fushën e rikonstruktimit, të cilat shoqëroheshin me një boom demografik dhe si rrjedhim, me kërkesë të madhe për banim. Për këtë arsye, lindi, Protoracionalismi, cili deri në atë periudhë i ishte dedikuar zgjidhjes së problemeve abstrakte të karakterit estetik. Përfaqësuesit e kësaj rryme, në këtë periudhë filluan të merren me zgjidhjen e problemeve praktike të prodhimit në seri, të përdorimit të materialeve të reja të ndërtimit, të përdorimit të parafabrikateve në mënyrë që të ofronin produkte konkurruese dhe ekonomikisht të pranueshme. Ky ishte edhe fillimi i racionalizmit të vërtetë që përkufizohet si shfrytëzim racional i ambientit me burimet e disponueshme.

Eksperimentimi i parë me këto forma të reja arkitektonike që futi panelet modulare të xhamit dhe skelete prej çeliku dhe betoni filloi në ndërtimet industriale dhe pati si protagonist të parë Walter Gropius, i cili ishte instruktuar në shkollën Protoracionaliste të arkitektit P. Behrens. Gropius krijoi mbi bazën e përvojave racionaliste, në vitin 1919, në Waimar "BAUHAUS", një shkollë arkitekture dhe të arteve të aplikuara, e cila jo vetëm që mbledhi intelektualë dhe artistë të famshëm të kësaj epoke si Kandinsky dhe Klee, por vuri dhe bazat e dizajnit moderne dhe të një qendre të debatit mbi arkitekturën.

Nën këtë frymë në këtë periudhë në Itali vlen të përmendet krijimi i Gruppo 7, i cili u krijua si reaksion kundër Akademizmit. Ky grup duke u orientuar në dy epoka të rëndësishme të artit, në antikën dhe në rilindjen (rinascimento), realizoi aktualizimin me arkitekturën moderne botërore.

### **Selia e Bankës së Shqipërisë.**

Prania e kësaj godine racionaliste në sheshin "Skënderbej" e ka justifikuar plotësisht respektin e qytetarëve të Tiranës dhe të të gjithë shqiptarëve.

Në projektidenë e saj, godina ishte e konceptuar me planimetri shumëkëndëshe dhe e ndarë nga ana funksionale në dy pjesë, në korpusin kryesor të harkuar, që do të kryente funksionin prezantues të bankës dhe në pjesën operative të saj. Kjo e fundit do të ndërtohej në të dy krahët anësorë të prapëm të korpusit kryesor, por nuk arriti të ndërtohej për shkak të problemeve e ndryshimeve që shkaktoi Lufta e Dytë Botërore.

Korpusi kryesor i saj është i ndërtuar në formën e një harku, i detyruar nga pozicioni në hyrje të sheshit kryesor të qytetit. Hyrja e saj kryesore është realizuar me një portal madhështor, i mbështetur në kolona të forta, që përfshin të gjithë lartësinë e fasadës dhe e zbukuruar me relieve murale në argjil të pjekur në ngjyrën karakteristike të saj, që në kompleks i jep një paraqitje shumë dinjitoze godinës.

Në organizimin dhe funksionimin e aktivitetit të bankës, krahas godinës komplekse me të dyja pjesët e saj, parashikohej edhe ndërtimi i një pallati rezidencial për banimin e punonjësve të bankës, i vendosur sa më pranë saj.

Sipas studimit urban të atyre viteve kjo godinë me projekt të realizuar po nga arkitekti Morpurgo ishte gjykuar të ndërtohej përbri godinës së Parlamentit Shqiptar (sot Teatri i Kukullave).

### **Gjendja aktuale.**

Aktualisht, selia e Bankës së Shqipërisë përbëhet nga korpusi i saj qendror në formë harku dhe nga dy shtesa të vogla (do të prishen pas rikonstruksionit) që janë ndërtuar në periudha të ndryshme të mëvonshme, për të përballuar rritjen e numrit të personelit operativ të saj.

Ndryshimet e mëdha që shoqëruan fillimin e viteve '90, impononin krijimin e institucioneve prestigjioze demokratike, njëri prej të cilëve do të ishte banka qendrore e vendit. Për rrjedhim, në prill të vitit 1992, krijohet Banka e Shqipërisë, së cilës, ashtu si simotrave të saj kudo në botë, iu besuan funksione jetike për zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.

Në kushtet e kufizimeve të mëdha hapësinore me të cilat përballemi aktualisht, konstatojmë se aktiviteti i përditshëm i Bankës, po has pengesa artificiale, të cilat në një mënyrë ose në një tjetër po ndikojnë në performancën e Bankës së Shqipërisë.



**23 nëntor 1938**

Banco di Napoli-Albania hapi degën e saj edhe në Shkodër.



*Ambiente të brendshme të godinës, foto Vassari.*

**26 nëntor 1938**

Banco di Napoli-Albania hapi degën e saj edhe në Korçë.



*Foto e selisë së Banco di Napoli-Albania, Shkodër, 1938.*

## 21 janar 1939

Letër ngushëllimi e Ministrin të Financave Milto Tutulani dërguar Drejtorit Qendror të Bankës Kombëtare të Shqipërisë

*Me hidhërimin më të thellë morëm njoftimin për vdekjen e Shkëlqesisë së tij Mario Alberti, themelues dhe President i parë i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, për të cilin kam ushqyer përherë admirim për veprën e zhvilluar nga ky italian i madh në favor të Shqipërisë dhe në nderim të lidhjeve miqësore që bashkojnë të dy shtetet.*

*Ju lutem Zoti Drejtor bëhuni interpret i këtyre ndjenjave pranë familjes së të ndjerit Alberti, dhe pranë familjes tjetër, Bankës Kombëtare të Shqipërisë.*

### SHTRIRJA E SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR NË FUND TË PERIUDHËS 1924-1939

*Gjatë viteve 1924-1939 u bënë përpjekje të njëpasnjëshme për nisjen e aktivitetit bankar në Shqipëri. Mirëpo, industrialistët dhe tregtarët shqiptarë, megjithë hapat e bërë në rrugën e zhvillimit, nuk kishin akoma as përvojën e duhur në ngritjen e institucioneve financiare dhe as fuqinë e mjaftueshme financiare.*

*Si rrjedhim, disa përpjekje që u bënë për krijimin e bankave me kapitale shqiptare, nuk arritën të finalizoheshin. Përveç kësaj, Banka Kombëtare e Shqipërisë i shihte nismat shqiptare si konkurrencë serioze, ndërsa ajo vetë nuk donte të hiqte dorë nga funksionet depozituese-kredituese dhe pengoi çdo orvatje të kapitalit shqiptar në fushën e sistemit bankar.*

*Në prill të vitit 1939, sistemi bankar në Shqipëri paraqitej si më poshtë :*

Nr.	Emërtimi i bankave	Numri i degëve dhe i agjencive
1	Banka Kombëtare e Shqipërisë	8
2	Banka e Napolit	4
3	Banka Bujqësore e Shtetit	4
4	Banka e Eksportimit e Beogradit	1
	Gjithsej	17

*Pamje e fasadës lindore së godinës së bankës, 1938.*



*Pamje veriore e fasadës, foto Vassari.*



*Ambiente të brendshme të godinës, foto Vassari.*

### FITIMET E BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

Veprimtaria e Bankës Kombëtare të Shqipërisë rezultoi fitimprurëse, megjithëse ajo e mbajti masën e kreditimit në nivelin real të nevojave të ekonomisë shqiptare.

Fitimi u bë i mundur në sajë të : *Interesave të lartë të aplikuar në fushën e kreditimit .  
Komisioneve të larta që banka mernte për shitblerjen e valutave të huaja.*

*Interesat e zbatuar në vende të ndryshme të Evropës.  
Interesi për skontim në fund të vitit (%)*

SHTETET	1929	1932	1938
Shqipëria	9	8	6
Zvicra	3 ½	2	1 ½
Franca	3 ½	2 ½	2 ½
Anglia	5	2	2
Çekosllovakia	5	4 ½	3
Holanda	4 ½	2 ½	2
Portugalia	8	6 ½	4 ½
Belgjika	4 ½	3 ½	2 ½
Austria	7 ½	6	4
Danimarka	5	3 ½	4
Finlanda	7	6 ½	4
Italia	5	4 ½	
Rumania	9	7	3 ½
Spanja	5 ½	6	4
Bullgaria	10	8	6
Polonia	8 ½	6	4 ½
Hungaria	7 ½	4 ½	4
Greqia	9	9	6

Vihet re se interesat për kreditë e dhëna nga Banka Kombëtare e Shqipërisë gjatë periudhës 1929-1938, kanë qenë nga më të lartët në Evropë.

SHTETET	1928			1929		
	Shuma e fitimit dhënë shtetit	Në % mbi fitimin bruto	Në % mbi fitimin neto	Shuma e fitimit dhënë shtetit	Në % mbi fitimin bruto	Në % mbi fitimin neto
Shqipëria	32.979	1,70	10,00	33,125	1,54	10,00
Greqia	18.900.000	16,21	32,00	36.000.000	16,40	33,00
Jugosllavia	44.640.792	34,77	56,40	42.336.008	32,35	56,20
Bullgaria	50.000.000	15,00	66,20	131.000.000	25,26	77,06
Rumania	43.967.275	6,40	23,09	46.285.715	4,86	24,66

Fitimet e realizuara nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, në pjesën më të madhe të tyre, kanë shkuar në favor të aksionerëve të bankës dhe shumë pak në favor të Shtetit Shqiptar. Kjo duket edhe nga krahasimi i të dhënave me bankat e vendeve të rajonit (nga pasqyra e mësipërme).



*Salla e klientëve, foto Vassari, 1938.*

## PERIUDHA 1939-1944

### **20 prill 1939**

Miratohet konventa ekonomiko-doganore valutore, midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Italiane. Kjo konventë ishte një reformë në sistemin monetar dhe të kreditit në Shqipëri. Thelbi i saj ishte shndërrimi i këtij sistemi në shtojcë të sistemit monetar dhe të kreditit italian. Ndryshimet që solli kjo konventë ishin:

- 1) u hoq standardi i arit dhe i valutave të forta në formë të cinguar, që falë politikës deflacioniste kishte vepruar në vendin tonë sidomos para fillimit të krizës botërore të viteve 1929-1933. Me ndryshimet që u bënë në ligjin organik të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, kjo e fundit hoqi detyrimin për shkëmbimin e kartëmonedhave shqiptare në franga ari të emetuara nga organet shtetërore të Shqipërisë. Një masë e tillë shënonte thellimin e krizës në lëmin e monedhës e për rrjedhojë edhe të kreditit. Pak kohë më vonë udhëheqja e Bankës zëvendësoi në korrespondencën e saj formulimin franga ar me formulimin franga shqiptare, duke ligjësuar ndryshimet që solli Konventa Ekonomiko-Doganore Valutore në sistemin tonë monetar;
- 2) ndryshoi rrënjësisht mënyra e barazimit të frangut shqiptar me liretën italiane. Sipas konventës, këmbimi i frangut me liretën nuk bëhej si më parë, nisur nga përmbatja e tyre në ar, por në bazë të një pariteti fiks 1 fr.shqiptare = 6,25 lireta. Kështu, luhatja e monedhës shqiptare me monedhat e huaja tani varej nga kursi i liretës me këto monedha;
- 3) ndryshoi rrënjësisht mbulesa e monedhës sonë në qarkullim. Në bazë të konventës, mbulesa e vjetër me përbërje prej ari dhe valutash të huaja të qëndrueshme u zëvendësua me liretën italiane. Në lidhje me këtë në konventë thuhej shprehimisht kështu: *"Mbulesa e qarkullimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë do të përbëhet prej liretës italiane, kartëmonedha ose kredi të tjera të Banca d'Italia. Frangu Shqiptar do të gëzojë mbulesën në ar që i korrespondon asaj të liretës italiane. Të vlefshme për frangun shqiptar ishin dhe bonot e thesarit të Shtetit Italian."*;
- 4) ndryshuan dispozitat në lidhje me përdorimin e monedhës sonë në marrëdhëniet e tregtisë së jashtme. Konventa bënte edhe bashkimin doganor mes Shqipërisë dhe Italisë.

Me marrëveshjen ekonomike-doganore-valutore, me dekretin mbi tregtinë e kambiove dhe të divizave dhe me dispozitat e Bankës Kombëtare të Shqipërisë u vendosën kufizime të mëdha edhe në drejtim të përdorimit të valutës shqiptare për importimin e mallrave nga vendet e tjera. Kështu, cilido që do të importonte mallra nga vendet e tjera, me përjashtim të mallrave nga Italia apo nga kolonitë e saj, duhej t'i drejtonte bankës një kërkesë, me qëllim që kjo e fundit të lëshonte autorizimin për kryerjen e pagesës së mallrave. Në të njëjtën kohë u vendosën norma të forta kufizuese në eksportimin e kartëmonedhave, të monedhave metalike shqiptare dhe italiane nga Shqipëria në shtetet e tjera.

Me 7 prill 1939, Italia fashiste pushtoi Shqipërinë, dhe si rrjedhim, e ashtuquajtura Asamble Kushtetuese shpalli fundin e Mbretërisë së Zogut dhe ia ofroi kurorën Viktor Emanuelit III. Shteti Shqiptar mbeti formalisht Mbretëri Kushtetuese nën sundimin italian.

Efektet e këtij pushtimi i ndjeu gjithë ekonomia shqiptare dhe pa dyshim edhe sistemi monetar dhe i kreditit. Banka Kombëtare e Shqipërisë vazhdoi thujse pa ndërprerje aktivitetin e saj, por sidoqoftë i ndjeu pasojat e luftës mbarëbotërore.

Pas prillit 1939, nisi një konkurrencë e madhe mes grupeve të ndryshme bankare të pranishme në Shqipëri, për zotërimin e sistemit të kreditit. Kjo luftë u zhvillua në tre drejtime kryesore : zgjerimi i rjetit bankar, tërheqja e depozitave bankare, shpërndarja e kreditit bankar.

Banka Kombëtare e Shqipërisë synonte rritjen e numrit të degëve dhe të agjencive në qendrat më të zhvilluara dhe të populluara ndërkohë që pesha e saj në sistemin bankar ra ndjeshëm si rezultat i fuqizimit të Banka e Napolit-Shqipëri, sidomos në vitin 1943.

*Pasqyra e aksionerëve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë  
në tre periudha të ndryshme*

<i>Aksionerët</i>	<i>viti</i>		
	<i>1925</i>	<i>1935</i>	<i>1939 (data 10 qershor)</i>
<i>Credito Italiano</i>	<i>15.000</i>	<i>145.000</i>	<i>145.000</i>
<i>Banca Nazionale di Credito</i>	<i>30.000</i>	-	-
<i>Banco Di Roma</i>	<i>30.000</i>	<i>30.000</i>	-
<i>Banca Commerciale Italiana</i>	<i>30.000</i>	<i>30.000</i>	-
<i>4 banka të vogla italiane</i>	<i>20.000</i>	-	-
<i>Banque Commerciale de Bale</i>	<i>50.000</i>	-	-
<i>Banque Belge pour l'Etranger</i>	<i>25.000</i>	<i>25.000</i>	-
<i>4 banka jugosllave</i>	<i>50.000</i>	<i>50.000</i>	<i>50.000</i>
<i>Ugo Viali</i>	<i>40.000</i>	-	-
<i>Vincenzo Azzolini</i>	<i>25.000</i>	-	-
<i>Ajet Bej Libohova</i>	<i>40.000</i>	-	-
<i>Ekrem Bej Vlora</i>	<i>58.000</i>	-	-
<i>Nexhet Pasha Vlora</i>	<i>52.000</i>	-	<i>86.699</i>
<i>Roberto Gambino</i>	-	-	-
<i>Ernesto Rizzo</i>	-	<i>60.000</i>	<i>60.000</i>
<i>Alfredo Roncuzzi</i>	-	-	-
<i>Rafaele Ciucci</i>	-	<i>189.616</i>	-
<i>Ettore Cauli</i>	-	-	<i>110.000</i>
<i>Të papërfaqësuar</i>	-	<i>65.384</i>	-
<i>Societe Generale de Belgique</i>	-	-	<i>25.000</i>
<i>GJITHSEJ</i>	<i>495.000</i>	<i>595.000</i>	

#### **4 maj 1939**

Zhvillohen bisedime në mes drejtuesve të Bankës në Romë dhe drejtuesve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë, lidhur me zëvendësimin e monedhave prej argjendi të emisionit të vjetër, me monedha të emisionit të ri.

#### **maj 1939**

Banka e Napolit, e cila që në vitin 1937 qe tepër aktive në tregun shqiptar të kreditit, thithi Bankën Bujqësore të Shtetit, dhe fitoi kështu monopolin e kreditit bujqësor. Që nga 15 maji 1939, ajo vepronte në Shqipëri me dy seksione : Seksioni i Kreditit dhe Seksioni i Kreditit Bujqësor.

#### **22 gusht 1939**

U hodhën në qarkullim monedhat prej argjendi prej 1 dhe 2 franga ar shqiptar dhe monedhat prej 5 dhe 10 lekë.

#### **2 shtator 1939**

Zhvillohen bisedime në mes Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave për emisionin e monedhave prej 2 lekësh. Udhëheqja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Romë i dërgon Drejtorisë Qendrore të Bankës në Tiranë, karakteristikat e monedhave italiane.



*Pamje nga holli i sallës së klientëve, foto Vassari.*

### **1939**

Vihen re ndryshime në strukturën e sistemit bankar në Shqipëri. Pas prillit 1939, Banka e Eksportimit të Beogradit, duke mos përballuar konkurrencën e kapitalit italian dhe si pasojë e kësaj konkurrence, mbylli filialin e saj në Tiranë.

Po në këtë vit, hapi filialin e saj në Tiranë, Banka Kombëtare e Punës (Banca Nazionale del Lavoro). Kjo ishte një nga bankat më të vjetra në Itali, themeluar në vitin 1913 me qendër në Romë. Ajo u bë shpejt një konkurrence serioze për Bankën Kombëtare të Shqipërisë dhe për Bankën e Napolit.

### **3 janar 1940**

Miratohet dekreti për emisionin e monedhave prej 2 lekë dhe dekretet për emisionet e monedhave të tjera. Monedhat e hedhura në qarkullim kishin simbole që paraqitnin pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste.



*0.05 Lek, 1940*

### ***gusht 1940***

Ettore Melis, Drejtor Qendror i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, organizoi një takim me drejtorin e degës së bankës në Korçë, Mario Astarita. Gjatë këtij takimi e ka vënë në dijeni këtë të fundit për përgatitjet e sulmit kundër Greqisë. Ai e ka vënë në dijeni të parashikimit që trupat italiane gjatë operacioneve do të përdornin kartëmonedha shqiptare.

### ***18 shtator 1940***

Drejtori i Degës së Bankës në Korçë, Mario Astarita, bën një udhëtim të shpejtë në Romë për të marrë udhëzime të detajuara lidhur me direktivën për financimin e trupave italiane me franga shqiptare.



*2 Lek 1940*



*pamje pas 10 Lek, 1940*

### ***20 tetor 1940***

Udhëheqja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë i siguroi organeve të Shtetit Italian dhe një sasi kartëmonedhash të huaja, dollarë amerikanë, dhrahmi greke dhe dinarë jugosllavë.

Në kuadrin e veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë të zhvilluar në këtë fazë, duhet theksuar dhe bashkëpunimi i saj me organet më të larta të Shtetit Italian për financimin e ushtrisë me kartëmonedha shqiptare gjatë operacioneve ushtarake.



*Ambjent i brendshëm, foto Vassari.*



## **22 tetor 1940**

Vendosen përfundimisht direktivat kryesore për problemin e financimit të ushtrisë italiane përtej kufijve të Shqipërisë:

- Banka Kombëtare e Shqipërisë do t'i furnizonte trupat italiane që vepronin kundër Greqisë , duke përdorur frangun shqiptar si mjet pagese. Kjo do të zgjaste deri në momentin kur do të shtypeshin monedhat e pushtimit “buonni di cassa” posaçërisht për këtë luftë.
- Furnizimi i ushtrisë italiane me franga shqiptare do të bëhej në tokat e pushtuara prej Italisë deri edhe në zonat më të thella, deri në kohën që do shtypeshin monedhat e pushtimit.
- Shkëmbimi i dhrahmisë me frangat shqiptare do të bëhej më vonë, në momentin kur të ishte vendosur kufiri i ri tokësor-politik.



5 Lek të vitit 1940

## **29 tetor 1940**

Mbështetur në direktivat e Ministrisë së Financave të Italisë, të datës 22 tetor 1940, Amedeo Gambino, udhëheqësi kryesor i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, dha urdhërin “Urdhëresë nr.12 e Këshilltarit të deleguar. Qarkullimi i frangut shqiptar përtej kufijve” (Disposizioni del Consigliere delegato Nr.12 Circolazione del Franco Albanese oltre il confine).

Në bazë të këtij urdhri, trupat italiane që do të vepronin nëpërmjet Shqipërisë, do të furnizoheshin deri në një urdhër të dytë me franga shqiptare, me kartëmonedha dhe me monedha, të cilat do t'i kishin për pagesat përtej kufijve të tanishëm.



*Salla e kontabilitetit, foto Vassari.*

### ***29 tetor 1940- prill 1941***

Programi i Italisë për pushtimin e shpejtë të Greqisë dështoi. Ushtria italiane pësoi disfatë dhe u detyrua të tërhiqej nga tokat shqiptare të Korçës dhe të Gjirokastrës. Ndërkaq, trupat greke hodhën në qarkullim drahminë greke për blerjet për nevoja të ushtrisë dhe për qëllime të tjera, me një shumë prej 50 milionë drahmi.

### ***1 mars 1941***

Autoritetet greke të pushtimit në krahinat shqiptare të Korçës dhe të Gjirokastrës, nxorën një urdhëresë sipas së cilës drahmia greke konsiderohej si e vetmja monedhë me kurs ligjor.

### *INFLACIONI NË SHQIPËRI gjatë periudhës 1939 – 1944*

*Zbatimi i Konventës Ekonomiko-Doganore-Monetare mes Shqipërisë dhe Italisë, sollí me vete në kushtet e koniukturave të Luftës II Botërore, emisionin e tepruar të monedhës shqiptare në qarkullim. Shifrat e mëposhtme vërtetojnë këtë konkluzion:*

<i>Datat</i>	<i>Sasia e kartëmonedhave në qarkullim në franga shqiptare</i>
<i>31.03.1939</i>	<i>11.939.000</i>
<i>31.08.1943</i>	<i>199.606.000</i>
<i>31.12.1943</i>	<i>311.736.339</i>
<i>31.03.1944</i>	<i>322.099.415</i>
<i>31.06.1944</i>	<i>334.075.661</i>
<i>30.09.1944</i>	<i>348.775.115</i>
<i>31.10.1944</i>	<i>379.869.596</i>
<i>30.11.1944</i>	<i>379.808.895</i>

*Karakteristikë për Shqipërinë ishte rritja e monedhës në qarkullim me ritme më të shpejta krahasuar me disa vende të Evropës, siç del edhe nga tabela e mëposhtme:*

*Kartëmonedha në qarkullim në milionë njësi monetare të secilit shtet.*

	<i>QERSHOR 1939</i>	<i>DHJETOR 1945</i>	<i>Rritja në përqindje</i>
<i>SHQIPËRIA</i>	<i>12</i>	<i>380</i>	<i>3.181</i>
<i>BELGJIKA</i>	<i>22.212</i>	<i>71.798</i>	<i>323</i>
<i>BULLGARIA</i>	<i>2.891</i>	<i>69.921</i>	<i>2.419</i>
<i>DANIMARKA</i>	<i>446</i>	<i>1.561</i>	<i>360</i>
<i>FINLANDA</i>	<i>2.200</i>	<i>13.598</i>	<i>618</i>
<i>FRANCA</i>	<i>122.611</i>	<i>579.093</i>	<i>472</i>
<i>GREQIA</i>	<i>8.002</i>	<i>104.083</i>	<i>1300</i>
<i>ITALIA</i>	<i>19.411</i>	<i>382.050</i>	<i>1968</i>
<i>NORVEGJIA</i>	<i>475</i>	<i>1.478</i>	<i>311</i>
<i>HOLLANDA</i>	<i>1.045</i>	<i>1.386</i>	<i>133</i>
<i>ANGLIA</i>	<i>499</i>	<i>1.375</i>	<i>275</i>
<i>RUMANIA</i>	<i>38.683</i>	<i>1.212.925</i>	<i>3105</i>

### **23 prill 1941**

Miratohet dekreti për shkëmbimin e drahmive në franga shqiptare. Sipas këtij dekreti, shkëmbimi i drahmisë me franga shqiptare do bëhej sipas këtyre kushteve :

- Kartëmonedhat në drahmi mund të shkëmbeheshin në franga shqiptare pranë degëve dhe agjencive të Bankës në Prefekturën e Korçës dhe në atë të Gjirokastrës, sipas kursit 1 frangë shqiptare baraz me 100 drahmi.
- Të interesuarit ndaheshin në dy kategori për efekt të masës së drahmive që mund të pranoheshin për shkëmbim: për çdo person me nënshtetësi shqiptare ose italiane, që do të vërtetonte se kishte qëndruar në tokat e pushtuara në kohën e pushtimit grek, ishte caktuar një vlefë maksimale shkëmbimi deri në 20.000 drahmi ose baraz me 200 franga shqiptare. Shkëmbimi mund të bëhej deri në një vlefë maksimale prej 1.000 franga shqiptare ose baraz me 100.000 drahmi për çdo firmë tregtare, me shtetësi shqiptare ose italiane, me qendër në tokat e pushtuara, në rast se ato ishin të regjistruara në dhomat e tregtisë para datës 28 tetor 1940.
- Kartëmonedhat që do të rezultinin mbi kufijtë e mësipërm do të depozitoheshin për shqyrtim të mëtejshëm dhe pa asnjë detyrim.
- Drahmitë do të pranoheshin për shkëmbim brenda datës 24-25-26 prill dhe vetëm pranë selive të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, në prefekturat e Korçës dhe të Gjirokastrës, sipas vendbanimit të paraqitësit.

Rezultatet e shkëmbimit të drahmisë me franga shqiptare qenë këto :

Nga 50.000.000 drahmi që qenë hedhur në qarkullim në krahinat shqiptare të Korçës dhe Gjirokastrës, në fakt u shkëmbyen 651.220 drahmi ose 1,3 për qind gjë që shpjegohet me kursin jo të favorshëm të vendosur nga banka, i cili ishte larg kursit të tregut.

### ***prill 1941***

U diskutua një projekt për bashkimin ekonomik, doganor, valutor mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Projekti parashikonte:

- Banka Kombëtare e Shqipërisë do të shrinte veprimtarinë e saj në Malin e Zi, duke hapur filialet e saj në Cetinje dhe Tivar. Këto filiale, pasi të ishte vendosur forma e Shtetit Malazes, mund të merrnin edhe emërtimin Banka e Malit të Zi. Varianti tjetër ishte të krijohet një bankë e përbashkët dhe të quhej Banka e Shqipërisë dhe e Malit të Zi.
- Në rast se zbatohet varianti i dytë, atëherë monedha e përbashkët do të ishte lira "Almo" që do të thoshte lira "Albano-Montenegrina".
- Këto ndryshime kërkonin edhe ndryshime të tjera lidhur me bazën dhe me mbulesën e monedhës shqiptare.

Projekti i propozuar nuk arriti të zbatohet dhe Banka Kombëtare e Shqipërisë nuk mori pjesë në krijimin e Bankës së Malit të Zi.

### ***23 qershor 1941***

Ministria e Financave të Italisë jep udhëzimet për kryerjen e shkëmbimit të dinarëve jugosllavë me franga shqiptare, sipas disa kriterëve që duheshin zbatuar.

Pasi Gjermania naziste dhe Italia fashiste pushtuan Jugosllavinë, në Romë u vendos që trojet shqiptare, të cilat deri në këtë kohë padrejtësisht përfshiheshin në Mbretërinë e Jugosllavisë, t'i aneksoheshin Shqipërisë.

E vërteta është se qarqet Italiane e bënë këtë bashkim me synimin që të zgjeronin Shqipërinë e kolonizuar nga ana e tyre. Ndërkaq, në Kosovë, në trojet shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi, u përhap frangu shqiptar. Kjo u realizua përmes dy formave:

- Financimi i trupave italiane përtej kufijve të Shqipërisë.
- Shkëmbimet tregtare të cilat filluan të bëheshin nga ana e tregtarëve shqiptarë që blinin mallra në këto troje

Si rrjedhim, u krijua një situatë e re monetare. Njëkohësisht në këto troje vepronte frangu shqiptar dhe dinari jugosllav.

Shkëmbimi i dinarëve jugosllavë me franga shqiptare u realizua në tre faza, në bazë të këtyre kriterëve:

1. kursi i këmbimit do të ishte 100 dinarë=6.08 franga shqiptare;
2. shkëmbimi do të bëhej në afate të shkurtra kohore një, dy apo treditore;
3. kufijtë e shkëmbimit u caktuan: për çdo person në familje; 50 franga shqiptare; për çdo familje, jo më shumë se 200 franga shqiptare; për çdo ndërmarrje kryesore tregtare apo bujqësore, 1000 franga shqiptare;
4. shkëmbimi do të bëhej për llogari të Shqipërisë, e cila do të përballonte (dhe në fakt i ka përballuar humbjet e rastit).



*Pamje e portalit të hyrjes.*

### ***korrik 1941***

Përfundoi faza e parë e shkëmbimit të dinarit me frangun në zonat e Kosovës, të Dibrës, të Strugës.

### ***tetor 1941***

Përfundoi faza e dytë e shkëmbimit të dinarit me frangun në zonat e Ulqinit, të Krajës, të Tuzit.

### ***15 maj-15 qershor 1942***

Përfundoi faza e tretë e shkëmbimit të dinarit me frangun në fshatrat e krahinës së Podgoricës dhe të Tivarit.

Nga veprimet e kryera gjatë tre fazave të shkëmbimit u tërhoqën nga qarkullimi 71 milionë dinarë, nga të cilët u shkëmbyen 69,8 milionë dinarë baraz me 4,2 milionë franga shqiptare, kurse pjesa tjetër prej 1,2 milionë dinarë u refuzua të shkëmbej.

#### *DEPOZITAT BANKARE DHE POLITIKA E KREDITIT gjatë periudhës prill 1939 – shtator 1943*

*Pas prillit të vitit 1939, nisi një konkurrencë e madhe mes grupeve të ndryshme bankare të pranishme në Shqipëri, për zotërimin e sistemit të kreditit. Kjo luftë u zhvillua në tre drejtime kryesore:*

- 1. Zgjerimi i rrjetit bankar.*
- 2. Tërheqja e depozitave bankare.*
- 3. Shpërndarja e kreditit bankar.*

Banka synonte rritjen e numrit të degëve dhe të agjencive në qendrat më të zhvilluara dhe më të populluara. Në këtë drejtim më aktivja ka qenë Banka e Napolit- Shqipëri, e cila siguroi rritjen më të madhe duke kaluar në vitin 1943 edhe Bankën Kombëtare të Shqipërisë.

Sipas viteve, rrjeti bankar paraqitet kështu (në datën 31.12.1942).

Emërtimi	Degët dhe agjencitë bankare				
	1938	1939	1940	1941	1942
Banka Kombëtare e Shqipërisë	8	9	7	13	13
Banka e Napolit-Shqipëri	4	12	9	16	18
Banka Kombëtare e Punës	-	1	1	2	2
Banka Bujqësore e Shtetit	4	-	-	-	-
Banka Eksportimit të Beogradit	1	-	-	-	-
	<b>17</b>	<b>22</b>	<b>16</b>	<b>31</b>	<b>33</b>

Përpjekje të mëdha u bënë nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, Banka e Napolit-Shqipëri, Banka Kombëtare e Punës, për tërheqjen e depozitave bankare të tregtarëve shqiptarë dhe sidomos të depozitave të institucioneve politike e ushtarake që ishin instaluar në Shqipëri.

Në këtë aspekt, më aktivja u përpoq të ishte Banka e Napolit-Shqipëri, por kur çështja e mësipërme u diskutua në Romë, përparësi mori Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Sipas viteve, niveli i depozitimit paraqitet kështu (në milionë franga shqiptare).

Emërtimi i bankave	depozita				
	1938	1939	1940	1941	1942
Banka Kombëtare e Shqipërisë	12,2	44,7	104,2	122,7	107,5
Banka e Napolit-Shqipëri	2,0	4,2	10,9	15,5	30,9
Banka Kombëtare e Punës	-	-	15,7	14,0	-

### **8 shtator 1943**

Italia fashiste kapitullon dhe Shqipëria pushtohet nga Gjermania naziste.

### **11 shtator 1943**

Me një urdhër të Komandës IX italiane, me 11,12 dhe 13 shtator u pezullua krejtësisht veprimtaria e bankave në Shqipëri. Kjo shënonte thellimin e krizës dhe si periudhë pezullimi zgjati deri më 20 shtator 1943. Vetëm Banka Kombëtare e Shqipërisë vazhdoi aktivitetin, veçse në mënyrë tepër të kufizuar.

### **12 shtator 1943**

Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë i dërgon telegram Ambasadës Gjermane në Romë, me anë të të cilit jepte udhëzimet që të vihej dorë menjëherë mbi rezervën e kartëmonedhave shqiptare të depozituara në Romë.

Po atë ditë, Ministri gjerman Neubacher për Evropën Juglindore, kërkonte që përveç rezervës së kartëmonedhave të merreshin edhe klishetë e stampimit, rezerva e arit dhe rezervat në devizë që ishin pronë e Shqipërisë. Aty propozohej që fillimisht klishetë, ari dhe devizat të depozitoheshin në Berlin, në Ricksbank, ndërsa kartëmonedhat të sillleshin në Shqipëri. Aksionin për zbatimin e këtij urdhëri e udhëhoqi konsulli i përgjithshëm gjerman në Romë, Vishter.

U morën gjithsej në Romë :

- rezerva e kartëmonedhave 120.523.902 franga shqiptare;
- rezerva e arit 8.062.826,90 franga shqiptare;
- klishetë e stampimit të kartëmonedhave.

Nga këto, kartëmonedhat u nisën me avion për në Tiranë, kurse pjesa tjetër për në Berlin.

### **16 shtator 1943**

Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm nxori urdhërin "Mbi rregullimin e raporteve midis Shtetit Shqiptar dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë".

Aty ndër të tjera përcaktohej:

- Qendra e Bankës Kombëtare të Shqipërisë do të ishte Tirana.
- Banka Kombëtare e Shqipërisë do të kujdesej për klishetë e reja me objekt nga jeta shqiptare, deri në shkurt të vitit 1944.
- Fitimi që do të rezultonte nga emetimi i monedhave divizionale do t'i përkiste Shtetit Shqiptar. Banka Kombëtare e Shqipërisë urdhërohej t'i derdhte Shtetit Shqiptar kundravleftën e monedhave divizionale në qarkullim deri më 10 shtator 1943.
- Deri në rregullimin përfundimtar të çështjes dhe të llogarive për zëvendësimin e kartëmonedhave në qarkullim, Banka Kombëtare e Shqipërisë urdhërohej të vinte në dispozicion të Shtetit Shqiptar, 4 për qind të shumës së kartëmonedhave në qarkullim me datën 10.09.1943, si paradhënie për llogarinë e kartëmonedhave të zhdukura ose të humbura, të cilat sipas urdhëresës i përkisnin Shtetit Shqiptar.
- Deri në rregullimin përfundimtar të çështjes, kartëmonedhat e emetuara nga Banka Kombëtare e Shqipërisë do të njiheshin si monedhë ligjore edhe në tokat e Kosovës dhe të Dibrës. Ndërkohë, Banka Kombëtare e Shqipërisë do t'i jepte Shtetit Shqiptar 10 milionë franga shqiptare si paradhënie për emisionin e kryer në këto krahina.
- Për ndjekjen dhe për kontrollin e veprimtarisë së bankës, pranë saj caktohej një konsulent teknik, si përfaqësues i Qeverisë Shqiptare.
- Brenda datës 1 shkurt 1944, të paktën 70 për qind e personelit të bankës në të gjitha kategoritë do të ishin shqiptarë dhe do të gëzonin trajtim të njëjtë ekonomik me personelin tjetër.

### **9 shtator 1943**

Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm nxori urdhërin: "Vënie në qarkullim e çeqeve nga ana e Bankës Kombëtare të Shqipërisë".

Aty ndër të tjera përcaktohej:

- Çdo transferim fondesh jashtë shtetit nga ana e Bankës Kombëtare të Shqipërisë pezullohej.
- Banka Kombëtare e Shqipërisë autorizojte të vinte në qarkullim çekat monedhë në franga shqiptare me prerje 100 e 5.000 franga shqiptare dhe që do të kishin fuqi përdorimi për të gjitha pagesat brenda Shqipërisë.

### **21 shtator 1943**

Filloi sjellja e rezervës së kartëmonedhave shqiptare nga Roma në Tiranë.

### **29 shtator 1943**

Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm dërgon një letër për Drejtorinë Qendrore të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ku urdhëron që "të konsiderohen tituj të vlefshëm për efekt të mbulesës së qarkullimit monetar kuitancat që lëshonte kryekonsullata gjermane në Tiranë për kredite, të cilat ajo merre për financimin e ushtrisë".

Ndonëse për shkak të luftës, nuk u bënë ndryshime në statut, në fakt mbulesa e qarkullimit monetar ndryshoi.

### **3 nëntor 1943**

Qeveria Shqiptare i kërkoi Qeverisë Gjermane që ari të kthehej në Shqipëri (AQSH, Fondi i BKSH), "Raport mbi çështjet monetare financiare për t'u shqyrtuar prej komisionit shqiptaro-gjerman", datë 1 dhjetor 1943. Qeveria udhëzoi delegacionin shqiptar që ari shqiptar të depozitohet në Zvicër.

#### **DEPOZITAT BANKARE DHE KREDITI NË SHQIPËRI gjatë muajve shtator 1943 – nëntor 1944**

*Me kapitullimin e Italisë, një krizë më e rëndë përfshiu sistemin bankar. Mbyllja e veprimtarisë së të gjitha bankave në periudhën 11-20 shtator 1943, shënonte paralizimin e sistemit bankar në Shqipëri.*

*Si rrjedhojë, u ngrinë depozitat bankare dhe akordimi i mëtejshëm i kreditit bankar në Shqipëri. Kjo u thellua edhe për faktin se ndërmarjet dhe shoqëritë italiane që vepronin në Shqipëri, e zbehën veprimtarinë e tyre për shkak të kapitullimit të Italisë dhe të prerjes së marrëdhënieve me qendrat e tyre në Itali.*

*Në këtë situatë, veprimtaria e Bankës Kombëtare të Punës dhe e Bankës së Napolit pushoi së ekzistuari.*

*Banka Kombëtare e Shqipërisë, me urdhër të Komitetit të Përkohshëm Ekzekutiv rifilloi veprimtarinë, në atë shkallë sa i nevojitej komandës ushtarake gjermane dhe qeverisë së asaj kohe.*

*Në situatën e re të krijuar, udhëheqja e bankës komunikoi me drejtuesit e qendrës në Romë, dhe vendosi që të bashkëpunonte njëkohësisht me përfaqësuesit gjermanë dhe me ata të Qeverisë Shqiptare, t'i financonte të dyja palët brenda mundësive që kishte, duke ruajtur drejtimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë.*

*Në përputhje me kërkesat e e gjermanëve Banka Kombëtare e Shqipërisë, dha këto kredi :*

*Huatë e marra nga gjermanët (në franga shqiptare):*

<i>Muajt</i>	<i>Çdo muaj</i>	<i>Progresivisht</i>
<i>Shtator 1943</i>	<i>13.000.000</i>	<i>13.000.000</i>
<i>Tetor 1943</i>	<i>23.500.000</i>	<i>36.500.000</i>
<i>Nëntor 1943</i>	<i>10.000.000</i>	<i>46.500.000</i>
<i>Dhjetor 1943</i>	<i>10.000.000</i>	<i>56.500.000</i>
<i>Janar 1944</i>	<i>-</i>	<i>56.500.000</i>
<i>Shkurt 1944</i>	<i>7.500.000</i>	<i>64.000.000</i>
<i>Mars 1944</i>	<i>-</i>	<i>64.000.000</i>
<i>Prill 1944</i>	<i>-</i>	<i>64.000.000</i>
<i>Maj 1944</i>	<i>7.000.000</i>	<i>71.000.000</i>
<i>Qershor 1944</i>	<i>7.000.000</i>	<i>78.000.000</i>
<i>Korrik 1944</i>	<i>3.000.000</i>	<i>81.000.000</i>
<i>Gusht 1944</i>	<i>4.000.000</i>	<i>85.000.000</i>
<i>Shtator 1944</i>	<i>7.000.000</i>	<i>92.000.000</i>
<i>Tetor 1944</i>	<i>7.000.000</i>	<i>99.000.000</i>



### ***nëntor 1943***

Me anë të një note kryekonsullata gjermane në Tiranë, lajmëronte se Rajhu Gjerman ishte gati për të sjellë arin shqiptar në Shqipëri.

### ***shtator-nëntor 1943***

Banka Kombëtare e Shqipërisë, mbështetur në disa urdhëra të Qeverisë Shqiptare u dha gjermanëve hua të shumta që arrinin në disa dhjetëra milionë franga shqiptare.

### ***1 dhjetor 1943***

Publikohet "Raport mbi çështjet monetare financiare për t'u shqyrtuar prej komisionit shqiptaro-gjerman", sipas të cilit dhe sipas premtimeve të përfaqësuesit gjerman Sarg, në bisedimet dypalëshe, Ministri i Rajhut Neubacher do të sillte në Shqipëri 2.000.000 marka ar, për shlyerjen e huave të mëparshme. Premtimet nuk u mbajtën dhe afati u shty deri në 31 dhjetor 1945.

### ***25 nëntor - 27 dhjetor 1943***

Nënshkruhen marrëveshjet shqiptaro-gjermane për problemet ekonomike financiaro-bankare midis përfaqësuesve të Qeverisë Gjermane, kryesuar nga Karl Hudeczek dhe përfaqësuesve të Qeverisë Shqiptare, kryesuar nga Dhimitër Berati. Këto marrëveshje parashikonin masat e mëposhtme:

#### **1. Mbi arin shqiptar**

Që në fillim të pushtimit gjerman, Qeveria Shqiptare e kohës ka kërkuar kthimin e arit të Shtetit Shqiptar, që ky të depozitohet në një bankë zvicerane. Me këtë rast, Qeveria Shqiptare ka marrë zotimin për të financuar brenda mundësive të saj një pjesë të shpenzimeve ushtarake gjermane.

#### **2. Mbi huatë**

Në fakt, pala gjermane duke përfituar nga kjo kërkesë e Qeverisë Shqiptare siguroi një financim të vazhdueshëm të trupave gjermane me monedhë shqiptare në formën e kredive. Deri në fund të vitit 1943, shumica e kredive dhënë trupave gjermane llogaritej 50.000.000 franga shqiptare.

#### **3. Mbi kursin ndërmjet frangut shqiptar dhe markës gjermane**

Përpara kapitullimit të Italisë, 1 frang shqiptar ishte baraz me 0,85 marka gjermane. Në fillim të bisedimeve shqiptaro-gjermane, raporti mes dy valutave ishte 1 frangë shqiptare baraz me 0,8219 marka gjermane. Qeveria Shqiptare kërkonte që raporti midis këtyre dy monedhave të caktohej sipas kursit të para shtatorit të vitit 1943. Sipas përfaqësuesve gjermanë, raporti mes frangut dhe markës gjermane duhet të ishte 1 me 0,63 me pretekstin se ky kurs u përdor nga ushtria gjermane që në fillim dhe ndryshimi i kursit do të sillte turbullira në punën e administratës gjermane. Madje, për të realizuar qëllimet e tyre, përfaqësuesit e Gjermanisë në bisedimet dypalëshe deklaruan se 1 frang nuk vlente as 0,62 marka.

#### **4. Mbi çështjen e kthimit të klisheve**

Pala shqiptare kërkoi që së bashku me arin të ktheheshin edhe klishe të e kartëmonedhave shqiptare të marra në Romë. Përfaqësuesi i Gjermanisë u përgjigj me propozimin për emetimin e kartëmonedhave të reja në Berlin ose në Beograd, duke gjetur si të përshtatshëm këtë të fundit.

#### **5. Mbi tërheqjen e monedhave gjermane të pushtimit që qenë hedhur në fillim në Qarkun e Korçës**

Pala gjermane u shfaq dakord me këtë propozim, por kërkoi që vlefëta e markave të pushtimit të kompensohej me franga shqiptare.

Bisedimet shqiptaro-gjermane zgjatën rreth një muaj. Nuk u pranua kërkesa e Qeverisë Shqiptare për sjelljen e arit në Shqipëri. Arit u vendos të mbahej në Reichsbank. Premtimet e palës gjermane për kthimin e huave në të vërtetë nuk u plotësuan, përkundrazi u vendos që Qeveria Shqiptare të vazhdonte financimin. Kursi u caktua 1 frang shqiptar=0,81 marka.

Marrëveshjet shqiptaro - gjermane i hapën rrugën përdorimit të sistemit tonë monetar për nevojat e ushtrisë gjermane.

### ***janar 1944***

Çështja e arit shqiptar u diskutua rishtas. Ministri Neubacher i ka premtuar përfaqësuesve të Qeverisë kukull se ishte gati të ndërhynte për transferimin e arit në Zvicër dhe në anën tjetër Qeveria Shqiptare duhej të zgjidhte problemin e financimit të ushtrisë gjermane.

### ***shkurt 1944***

Në bazë të premtimeve të reja të dhëna nga gjermanët, Qeveria Shqiptare mori vendim të dërgonte një delegacion në Berlin. Delegacioni kryesohej nga Vehbi Frashëri, Zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe kishte në përbërje të tij edhe dy funksionarë të Bankës Kombëtare Shqiptare, Sandro Bresani e Loro Muzhani. Takimi zgjati nga data 4-6 prill 1944.

Në këto bisedime u vendos që arit shqiptar të mbetet në Berlin.

### ***shkurt 1944***

Duke patur parasysh që sasia e kartëmonedhave u pakësua mjaft, konsullata gjermane kërkoi emetimin e një sasive të re kartëmonedhash, punë që iu ngarkua Bankës Kombëtare Serbe.

### ***6 prill 1944***

U nënshkrua një protokoll sipas të cilit arit shqiptar do të depozitohet jo në Zvicër por në bankën gjermane Reichsbank, në emër të Shqipërisë.

### ***21 prill 1944***

Kryekonsullata gjermane i dërgoi një memorandum qeverisë së Tiranës ku parashikohej financimi i nevojave të ushtrisë gjermane, të cilat llogariteshin në 30 milionë franga shqiptare në muaj.

Memorandumit i ishin bashkëngjitur edhe dy skica të modelit të kartëmonedhave prej 20 franga shqiptare që ishin sjellë nga Vjena. Sipas llogarive të palës gjermane, kartëmonedhat e reja duhej të ishin gati deri në gusht të vitit 1944. Ndërkohë për të përballuar vështirësitë e çastit do të hidheshin në qarkullim çekat monedhë. Qeveria duhej të përzgjidhte mes dy modeleve dhe të përkujdesej për përgatitjen e skicave për monedhat 5,10 dhe 100 franga shqiptare. Pala gjermane kërkoi edhe ndryshimet në statut lidhur me rregulloren e mbulesës së qarkullimit, ku propozohej të pranoheshin edhe kuitancat e lëshuara në rastin e kredive të marra për ushtrinë.

### ***5 maj 1944***

Në Beograd u nënshkrua Protokollin i parë i Beogradit, ku ndër të tjera thuhej se shpenzimet monetare për financimin e ushtrisë gjermane, për ndërtim fortifikatash, për shfrytëzimin e minierave etj., llogariteshin në 30 milionë franga ar në muaj (për muajt maj-korrik) dhe do të mbuloheshin 7 milionë nga Qeveria Shqiptare (kushtet e shlyerjes do të përcaktoheshin me një protokoll të veçantë) kurse pjesa tjetër nga gjermanët duke sjellë napolona ar, mallra etj..

Po ashtu u vendos që deri më 1 gusht, duheshin emetuar kartëmonedhat e reja në një shtypshkronjë të Vjenës të cilat do shërbenin për financimin e ushtrisë gjermane. Në rast mosplotësimi të këtij kushti do të bëhej një protokoll tjetër.

### ***maj 1944***

Përpilohet Protokoll i dytë i Beogradit i cili nuk arriti të nënshkruhej. Ai parashikonte detyra për emetimin e kartëmonedhave të reja shqiptare. Përveç kësaj, parashikonte që shuma prej 30 milionë franga shqiptare që i nevojitej ushtrisë gjermane të financohej :

- 10 milionë nga huatë e Qeverisë Shqiptare;
- 10 milionë nga hedhja në shitje e napolonave ar;
- 10 milionë nga shitja e mallrave gjermanë që do të vinin në Shqipëri nga jashtë.

### ***shtator 1944***

Memorandum i ri i dërguar nga ana e palës gjermane për Qeverinë Shqiptare. Aty vihej në dukje se nuk po zbatoheshin protokollit i parë dhe i dytë i Beogradit, në lidhje me emetimin e kartëmonedhave shqiptare që duheshin për financimin e ushtrisë. Memorandumi kërcënonte për një krizë monetare në Shqipëri.

### ***shtator-tetor 1944***

Krijohet një komision për zgjidhjen e çështjeve lidhur me zbatimin e masës për shtypje kartëmonedhash të reja. U shikua mundësia që kllishetë të përgatiteshin tek firma Kosturi kurse shtypja e tyre të bëhej tek shtypshkronja Luarasi. Sidoqoftë, kjo masë nuk u zbatua për shkak të zhvillimeve të shpejta politike dhe të panikut që kishte Qeveria Shqiptare.

### ***11 tetor 1944***

Me urdhër të Ministrit gjerman për çështjet ekonomike Karl Gostenbauer, togeri i Gestapos Franz Janko bëri kontrollin e Thesarit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe grabiti çelësat e tij.

### ***30 tetor 1944***

Sipas "Procesverballi i tërheqjes së depozitave të Tiranës" (*Verbale di prelevamento giacenze di Tirana*) –AQSH, Fondi i BKSJ gjermanët grabitën komplet thesarin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë 2.740.000 franga shqiptare dhe 13.519 napolona ar të cilat me kursin rreth 510 franga shqiptare napoloni kishin një vlefë të 6.894.690 franga shqiptare. Gjithsej 9.634.690 franga shqiptare.

### ***8 dhjetor 1944***

Banka Kombëtare e Shqipërisë

Drejtoria Qendrore

Gjendja e Degëve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë

Dega e Vlorës pranë së cilës janë atashuar edhe Degët e Gjirokastrës dhe Sarandës.

Në ditën e çlirimit, më 13 tetor, drejtoria është vënë në dispozicionin e autoriteteve ushtarake. Konfirmohet që dega nuk ka pësuar asnjë dëm; kanë shpëtuar të paprekura, ndërtesa, zyrat, arkivi dhe dokumentet. Në momentin e

largimit trupat gjermane kanë tërhequr me forcë shumën që gjendej në arkë, në pothuaj 300.000 franga ari, shumë kjo e transferuar në Tiranë, dhe e dorëzuar gati krejtësisht kësaj qendre.



*Foto e Degës së Bankës Sarandë.*

Drejtoria e Vlorës duke paraparë në anën tjetër faktet, kishte fshehur menjëherë gati 500.000 franga ari, që momentalisht paraqesin disponibilitetin në likuiditete të kësaj dege. Nuk mund të përcaktojmë cilat janë dëmet eventuale të pësuar nga shërbimi i magazinave të përgjithshme, përsa i përket ndërtesës dhe mallrave. Që nga data e çlirimit dega është mbyllur me urdhër nga lart.



*Foto e Degës së Bankës Vlorë.*

Nga lajme të pakonfirmuara marrim vesh se ndërtesa e Bankës në Sarandë ka pësuar vetëm dëme të lehta (thyerje xhamash etj). Nuk dimë si është gjendja e stolive, si të zyrave ashtu dhe të banesave. Kontabiliteti dhe arkivi i vitit të fundit, po ashtu edhe vlerat janë transferuar para disa muajsh në Vlorë.

Për Gjirokastrën dihet se ndërtesa, që prej qershorit të kaluar, ka pësuar dëme prej veprimeve luftarake të gjermanëve. Edhe për këtë degë ishin marrë masat për tërheqjen në Vlorë, duke transportuar atje dokumentet. Fondet e arkës së Degës së Gjirokastrës (356.000 franga ari) ishin tërhequr që nga muajt e fundit nga Komanda Partizane kundrejt një procesverbali të rregullt.

Dega e Korçës është e mbyllur që nga 23 tetori me urdhër të autoriteteve eprore. Hyrja në zyra, në magazina, kasafortat e raftet janë vulosur. Mbetja e arkës në monedha metalike e banknota për gati 900.000 franga ari, 1 118 napolona ar është tërhequr nga Këshilli Nacionalçlirimtar: dorëzimi është bërë me përpilimin e procesverbaleve të rregullta. Njëkohësisht është caktuar nga autoritetet që të mbaheshin në dispozicionin e tyre të gjitha materialet dhe

mallrat e disponueshme në magazina. Me kërkesën e Këshillit Nacionalçlirimtar, autoritetet ushtarake kanë tërhequr nga magazinat pjesë të bereqetit të depozituar atje nga Sasteb dhe afro 11 kuintalë lëkurë, edhe këto të depozituara dhe në pronësi të të tretëve. Dega ka marrë masat për përpilimin e gjendjes kontabël më 31 tetor 1944, dy kopje të së cilës i janë dorëzuar autoriteteve. Ndërtesa, magazinat dhe arkivi nuk kanë pësuar dëme.



*Foto e Degës së Bankës Korçë.*

### ***Dega e Beratit***

Dega ishte mbyllur dhe ishte shpërngulur në Tiranë që nga dhjetori i kaluar. Përfaqësuesi ynë atje na ka lajmëruar se në momentin e nisjes së trupave gjermane nuk kishin ndodhur incidente. Zyrat janë zënë nga një komandë partizane.

### ***Dega e Elbasanit***

Më 18 tetor kur qyteti ishte akoma në duart e gjermanëve, dega e ka furnizuar komandën partizane me 180.000 franga në monedhë. Në mënyrë që veprimi të kishte pamje të rregullt është tërhequr një efekt me garanci, nënshkruar nga tregtarë dhe të njohur të tregut (piacës).

Ndërtesa nuk ka pësuar dëme.

### ***Dega e Prizrenit***

Nga lajmet e ardhura merret vesh se çlirimi është bërë mes datave 18 e 19 nëntor. Dega e personelit nuk ka pësuar dëme. Zyrat u mbyllën me urdhër të autoriteteve të Komitetit Qendror të Çlirimit, dhe atyre i janë dorëzuar vlerat në gati 100.000 franga në kartëmonedha e monedha metalike, e 350.000 franga në çeçeq. Nëpër zyra tani është vendosur një komandë partizane : nuk kemi lajme rreth fatit të pësuar nga lokalet tona të Prishtinës, të zëna që nga shtatori 1944 nga Komanda e Grupit Nacionalist të Kosovës. Shënojmë se ajo drejtori ka kundërshtuar me këmbëngulje shumë herë për kërkesa tërheqesh të mëdha nga ana e ish -Ministrit Deva.

### ***Dega e Shkodrës***

Me largimin e trupave gjermane dhe me çlirimin e qytetit nga formacionet partizane, dega nuk ka pësuar asnjë dëm as përsa i përket sendeve e orendive, as në njerëz. Dega është e mbyllur që nga data 26 nëntor.



*Foto e Degës së Bankës Shkodër.*

Me datë 30 me urdhër të Komandës, Divizioni i Dytë, kasafortat janë mbyllur. Janë tërhequr me urdhër të komandës partizane, një pako me mall nga magazinat e përgjithëshme dhe revolja e rojes së atyre magazinave. Gjendja e arkës së degës në kartëmonedha, në monedha metalike e në çeqe është 129.800 franga shqiptare. Nga ana tjetër, dega disponon module çeqesh për t'u vlerësuar për gati 1.800.000 franga shqiptare.



*Foto e Degës së Bankës Durrës.*

### ***Dega e Tiranës***

Me 30 tetor autoritetet gjermane tërheqën me forcë shumën e arkës së bankës që arrinte gati 9.500.000 franga ar në formë ari dhe kartëmonedha, shumë që nga autoritetet e lartpërmendura thuhej se do të transferohej në Shkodër.

### ***Drejtoria Qendrore***

Në ditët e fundit të tetorit të kaluar janë vënë në dispozicion të autoriteteve partizane 200.000 franga ar, ndër të cilat 60.000 franga ar janë derdhur kundrejt efektit të lëshuar. Përveç kësaj është dorëzuar edhe një kamionçin.

### ***1944***

Dekret i Këshillit të Ministrave mbi emërimin e një Këshilli Gjerimi (Administrimi) të Përkohshëm të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, i përbërë prej 9 deri 11 anëtarë.

#### *Neni 1*

Emërohet një Këshill Administrimi (Gjerimi) i Përkohshëm i Bankës Kombëtare të Shqipërisë i përbërë prej 9 deri 11 anëtarëve.

#### *Neni 2*

Ky këshill formohet prej :

kryeradhë a) 7 anëtarë me kombësi shqiptare të emëruar me dekret ministror të Ministrit të Financave;

kryeradhë b) këshilltarë me kombësi shqiptare që janë në detyrë e që ndodhen në Shqipëri. Mes anëtarëve të sipërpërmendur të kombësisë shqiptare, Ministri i Financave me dekret të tijin emëron Kryetarin e Këshillit të Administrimit të Përkohshëm;

kryeradhë c) 2 anëtarë të një kombësie tjetër të përfaqësuar nga dy funksionarët më të lartë në gradë të Drejtorisë së Institucionit (Bankës) që tani banojnë në Shqipëri dhe në përshtatje me shënimin e shkruar të Drejtorisë Qendrore të Institutit. Këta funksionarë do të vazhdojnë, nga ana tjetër, të ushtrojnë edhe detyrat e tyre aktuale të drejtorisë dhe do të mbajnë detyrat e atributet e tyre në Drejtorinë e Bankës.

#### *Neni 3*

Këshilltarët e emëruar në bazë të këtij dekreti, qëndrojnë në detyrë për gjithë periudhën e jashtëzakonshme të luftës, e sidoqoftë nuk do të mund të revokohen – gjatë kësaj periudhe - para se të kalojë periudha njëvjeçare.

Në rast mungese, të shkakuar për shkak dorëheqjeje, vdekjeje ose tjetër arsyeje të një ose më shumë anëtarëve të Këshillit Administrativ të Përkohshëm, zëvendësimet do të bëhen gjithmonë sipas dispozitave të nenit.

#### *Neni 4*

Kryetari i Këshillit Administrativ të Përkohshëm, një këshilltar i caktuar nga Ministri i Financave, bashkë me të dy këshilltarët për të cilët flitet në kryeradhën c të nenit 2, formojnë Komitetin e Përkohshëm të Administratës.

Kryesia e Komitetit të Përkohshëm të Administratës i takon Kryetarit të Këshillit Administrativ të Përkohshëm, i cili ka votë refuzuese (të drejtë vetoje) në vendimet e Komitetit.

Me kërkesën e kryetarit ose të gjysmës së anëtarëve të komitetit thërritet Këshilli Administrativ i Përkohshëm.

#### *Neni 5*

Në rast mungese të Kryetarit ose të pamundësisë së pjesëmarrjes nga ana e tij, ai zëvendësohet në të gjitha të drejtat (pushtetet e veta) nga këshilltari më i vjetër mes të emëruarve në bazë të nenit 2, kryeradha a-b.

#### *Neni 6*

Këshillit Administrativ të Përkohshëm dhe Komitetit të Përkohshëm të Administratës, të formuar si më sipër, u jepen për kohën e ekzistencës së tyre, të gjitha atributet e parashikuara nga ligji organik dhe nga Statuti i Bankës për Këshillin e Administratës dhe për Komitetin e Administratës, për sa i përket administrimit në Shqipëri (duke përfshirë atë ç'ka parashihet nën neni 43 i ligjit organik dhe neni 43 i Statutit të Bankës) përveçtributeve të posaçme për të cilat bën fjalë neni 7 i këtij dekreti.

#### *Neni 7*

Këshilli i Përkohshëm Administrativ dhe Komiteti i Përkohshëm i Administratës do t'i kushtojnë të gjithë veprimtarinë e tyre, drejtimit sa më të mirë dhe interesit më të madh të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, me theks të veçantë për ekonominë kombëtare. Për këtë qëllim do të ndihmohen nga Drejtoria Qendrore e Bankës, funksionarët e së cilës që nga ky moment janë në shërbim ose të atashuar – sikurse përcaktohet në kumtesën e shkruar të Drejtorisë Qendrore në fjalë – nuk do të mund të pushohen ose të zëvendësohen –gjatë periudhës së luftës – veçse në rastin e një faji të rëndë.

Drejtorisë Qendrore, i përket në mënyrë të veçantë ushtrimi i rregullt i drejtimit të Bankës, qoftë për sa i përket personelit dhe përdorimit të tij, qoftë për sa i takon punëve dhe administrimit, duke ia nënshtruar të vepruarit e vet Komitetit të Përkohshëm të Administratës.



*Fragment nga basorelievi prej qeramike që ndodhet në portalin e hyrjes, autor skulptori italian Biagini.*

### **1944**

Dekret mbi emetimin nga Banka Kombëtare e Shqipërisë e çekave-monedhë me prerje të ndryshme për të çliruar pagesat në vend.

#### *Art. 1*

Banka Kombëtare e Shqipërisë parashikon të vërë në qarkullim çeket monedhë nga 20 franga ar deri në 100 franga ar 200, 500, 1000, 2000, 5000 të parashikuar tashmë në paragrafin 4 të ligjit të datës 21 tetor 1943, neni 14.

#### *Art. 2*

Çeqet e parathëna (sipërpërmendura) kanë aftësi paguese të plotë për pagesat në vend, njëllor me valutën ligjore të shtetit dhe janë të barazvlerësuar me kartëmonedhat.

Çeqet janë të garantuara nga vlera të njëjta (në ar, në valuta të huaja etj.) që shërbejnë si mbulesë për kartëmonedhat.

#### *Art. 3*

Çeqet do të pranohen pa asnjë kufizim nga arkat e shtetit, nga sportelet e Bankës dhe nga zyrat e tjera publike.

#### *Art. 4*

Çeqet do të emetohen me urdhër të së njëjtës Bankë Kombëtare e Shqipërisë dhe janë të transferueshme pa asnjë xhirim.

#### *Art. 5*

Çeqet do të mbahen në qarkullim në mënyrë të përkohshme dhe Banka Kombëtare e Shqipërisë do të lajmërojë për momentin e daljes së tyre nga qarkullimi sapo rrethanat teknike ta bëjnë të mundur, por sidoqoftë jo më vonë se data 31 mars 1945.

#### *Art. 6*

Çeqet janë të përjashtuara nga çfarëdo pulle takse.



*Art. 7*  
Ky dekret hyn në fuqi qysh në datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

*Art. 8*  
Ministri i Financave ngarkohet me zbatimin e këtij dekreti.

### **1944**

Projektdekret - Ligji Mbi krijimin e Komisarariatit të Jashtëzakonshëm pranë Bankës Kombëtare të Shqipërisë

*Art. 1*  
Pranë Bankës Kombëtare të Shqipërisë përkohësisht vihet Komisari i Jashtëzakonshëm.

*Art. 2*  
Komisari i Jashtëzakonshëm do të ushtrojë funksionet që statuti dhe ligji i Bankës i atribuojnë Kryetarit të Këshillit Administrativ të Bankës.

*Art. 3*  
Komisari i Jashtëzakonshëm emërohet me Dekret të Këshillit të Lartë mbi bazën e propozimit të Ministrisë së Financave dhe pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Ministrave.

*Art. 4*  
Komisari i Jashtëzakonshëm hiqet nga detyra, në momentin që Kryetari i Këshillit Administrativ të Bankës Kombëtare të Shqipërisë do të jetë në gjendje të rifillojë me ushtrimin e funksioneve të tij.

*Art. 5*  
Ky dekretligj hyn në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

*Art. 6*  
Ministri i Financave ngarkohet me zbatimin e këtij dekretligji.



*Fragment nga basorelievi prej qeramike që ndodhet në portalin e hyrjes, autor skulptori italian Biagini.*

## 1944

Projektligj "Mbi deklarimin të rënë nga fuqia të Konventës së datës 15 mars 1925 me ish-grupin financiar italian, mbi shpronëzimin për utilitet publik të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe mbi kushtetimin e BANKËS së SHYPËNISË".

Fillimisht duhet thënë se Shteti Shqiptar nuk do të kishte lidhur kurrë me grupin financiar italian, konventën e datës 15 mars 1925, po të kishte paraparë një ndryshim aq radikal mes gjendjes së atëhershme dhe asaj të tanishme.

Duke marrë parasysh se është parim themeltar dhe elementar, që një shtet i pavarur nuk mund të bëjë politikë ekonomike dhe financiare të aftë që të ruajë pavarësinë e tij për sa kohë që Instituti i Emisionit është thujse krejtësisht në duart e një shteti të huaj që ka dëshmuar se ka interesa të kundërt politikë me parimin e pavarësisë shqiptare;

duke qenë se grupi financiar italian pati përdorur rrugë të tërthorta për të shtënë në zotërim edhe pjesën 49 për qind të aksioneve të rezervuara për nënshtetasit shqiptarë;

duke marrë parasysh se grupi financiar italian pas pushtimit të Shqipërisë me datën 7 prill 1939, mori në zotërim edhe pakon e 50.000 aksioneve të ish-grupit jugosllav dhe nuk ia la këto shtetasve shqiptarë;

duke marrë parasysh se Banka ka kryer edhe veprime drejtpërdrejt në kundërshtim me Konventën dhe në dëm të pavarësisë shqiptare:

*u vendos*

art.1-Konventa e datës 15 mars 1925, me grupin financiar italian deklarohet e rënë nga fuqia për çfarëdo efekti.

art.2-Banka Kombëtare e Shqipërisë shpronësohet për interesa publikë. Të 495.000 aksionet e zakonshme dhe 100.000 aksionet themeltare të kësaj Banke janë të anuluar. Ish-aksionerëve u takon tërheqja e kapitalit efektivisht të vërtetuar, 7.50 franga shqiptare për çdo aksion të zakonshëm të anuluar ashtu si dhe një kuotë e njëjtë prej 2 frangash shqiptare për çdo aksion rezervë korresponduar rezervës, vërtetuar me bilancin e datës 30 shtator 1943, prej 1.200.000 frangash shqiptare.

art.3.-Vendin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë për çdo efekt e zë "Banka e Shqipërisë" e cila është e kushtetuar në bazë të këtij ligji.

Kapitali nominal i Bankës së Shqipërisë është 12.500.000 franga shqiptare i ndarë në 595.000 pjesë nga të cilat 495.000 pjesë me vlerë nominale 25 franga shqiptare secila, paguar me tre të dhjetat, e 100.000 pjesë me nga 1,25 franga shqiptare secila, krejtësisht të pagueshme.

art.4.- Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të emisionit të kartëmonedhës në Shqipëri. Kartëmonedha në fjalë, ka fuqi ligjore e të pakufizuar për pagesat në Shqipëri.

art.21- Sapo Asambleja të ketë zgjedhur Këshillin e Rregullt Administrativ, Këshilli Administrativ i përkohshëm dhe Komiteti Ekzekutiv i përkohshëm quhen vetvetiu të rënë.

art.22- Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

art.23- Ministri i Financave ngarkohet me zbatimin e këtij ligji.



*Pamje e Degës së Bankës Elbasan, foto e viteve '30.*

### **31 dhjetor 1944**

Mbi situacionin kontabël më 31 dhjetor 1944 të ish- Bankës Kombëtare të Shqipërisë, dorëzuar Bankës së Shtetit Shqiptar

...

Mbi situacionin kontabël më 31 dhjetor 1944- Banka Kombëtare e Shqipërisë-japim këto sqarime :

Kartëmonedha të emetuara. 385.641.907 franga shqiptare tepriçë që rezulton nga xhirimi që ka bërë Komiteti i Administratës, duke zbritur djegiet e bëra në Shqipëri prej shtatorit 1943, sikundër tregojnë verbalet që gjenden në Zyren e Kontabilitetit.

Në praktikën "Qarkullim" ndodhen pasqyrat e ndryshme mujore si dhe lista e përgjithshme e kartëmonedhave të shtypura nga Banka. Në datën 31 dhjetor 1944 shifra e kartëmonedhave në qarkullim ishte 379.996.770.60 franga shqiptare.

...

Çek monedha në qarkullim. U krijuan në shtator 1943 për të plotësuar mungesën e kartëmonedhave. Tipet e ndryshme të çeqeve u përmblodhën në lista të shënuara me 5/3/1945 nga Zyra e Inspektoriatit të Bankës së Shtetit Shqiptar. Shuma e përgjithshme ka qenë 32.218.220 franga shqiptare.

Arka. Gjendja e Arkës më 31 dhjetor 1944 : 11.175.654,36 franga shqiptare. Kjo shumë përbëhet si më poshtë:

5.645.136,40 franga shqiptare kartëmonedha;

5.389.400 franga shqiptare çek-monedha;

58.997,96 franga shqiptare monedha metalike të vogla;

82.120 franga shqiptare ar i punuar (konjuar) për Shqipëri.

Shumat e mësipërme janë marrë në dorëzim nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Arka e valutave

Gjendja e Arkës më 31 dhjetor 1944, 657.132,13 franga shqiptare e përbërë si vijon :

139.551 franga shqiptare, Ar à la pari pranë Drejtorisë Qendrore;

377 franga shqiptare, Ar à la pari pranë Degës së Tiranës;

517.204,13 franga shqiptare, kartëmonedha të shteteve të ndryshme .

Paradhënie

...

Pjesëmarrje

...

Klientë

...

*Korrespondentë*

...

Debitorë të ndryshëm

...

Kreditorë të ndryshëm

...

Funksionarët e Bankës së Shtetit Shqiptar të ngarkuar me marrjen në dorëzim të situacionit kontabël të ish- Bankës Kombëtare të Shqipërisë konstatojnë se situacioni i datës 31 dhjetor 1944 i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, nuk përfshin gjithë gjendjen e pasurisë të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë, mbasi këtij i mungojnë shumë zëra si : kapital, fond rezervë, fond amortizimesh, fitimet e gjestionit Romë për vite të ndryshme, e të tjera.



*Dy lek i vitit 1944.*

## PERIUDHA 1944-1990

Menjëherë me çlirimin e vendit nga pushtuesit, shteti i ri i drejtuar nga Partia Komuniste Shqiptare, zbatoi disa masa rrënjësore në ekonominë shqiptare për krijimin e bazës ekonomike të pushtetit komunist dhe për futjen e Shqipërisë në rugën e socializmit. Me rëndësi konsiderohej shtetëzimi i pasurisë së të huajve (pushtuesve), konfiskimi i pronave të kundërshtarëve të regjimit komunist, të të arratisurve etj..

### ***viti 1944***

Pak ditë pas çlirimit të Tiranës, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Qarkut, me porosi të Qeverisë Demokratike, në atë kohë me seli në Berat, vendosi bllokimin e veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Njëkohësisht u bllokuan edhe arkivat e këtij institucioni.

Në Berat diskutohet për mënyrën e zotërimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë nga pushteti revolucionar.

### ***15 dhjetor 1944***

Vendoset kontrolli shtetëror mbi prodhimin dhe shpërndarjen, si masë përgatitore për shtetëzimin e mjeteve kryesore të prodhimit.

Shtetëzohen minierat dhe pasuria e të arratisurve politikë. Një muaj më vonë del ligji mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve italianë e gjermanë në Shqipëri. Pasuria e 111 shoqërive aksionere të huaja kaloi pa shpërblim në pronësi të Shtetit Shqiptar.

### **Kostandin Boshnjaku**

Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
17 janar 1945 - 2 prill 1946

Datëlindja: 20 tetor 1888.

Vendlindja: katundi Gjat, krahina e Lunxhërisë, Gjirokastrë.

### **Shkollimi**

1908 përfundoi Institutin Tregtar të Pireut, Athinë, Greqi.

### **Ekspierencë pune**

**1908 - 1911** nëpunës banke në Odesa, Ukrainë.

**1911 - 1914** nëpunës banke në Credit Lyonnais në Petërsburg, Rusi.

**7 mars 1914 - 3 shtator 1914** Drejtor i Thesarit dhe i Borxhit Publik, Durrës, në Qeverinë e Princ Vidit.

**1914 - 1919** Drejtor i Departamentit të Jashtëm në një bankë ruse në Petersburg.

**1919 - 1922** nënkryetar i kolonisë së shqiptarëve në Stamboll.

**10 tetor 1922** i ngarkuar me punë për Shqipërinë në Stamboll, në Sofje dhe në Bukuresht.

**24 dhjetor 1924 - 14 janar 1939** emigrant politik në Vjenë, Sofje dhe Bukuresht.

**1939 - 1943** nëpunës në Këshillin Kontrollues të Bankës së Shtetit.

**1943 - 1944** në mal, pjesëmarrës aktiv në të gjitha forumet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

**17 janar 1945** emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar dhe më vonë anëtar i Këshillit të Administratës.

**22 gusht 1945** Këshilli i Administratës unanimisht vendosi që Banka e Shtetit Shqiptar të marrë pjesë si iniciatore në kushtetimin e Shoqërisë Anonime Tregtare Import Eksport dhe delegon Kostandin Boshnjakun të cilit " ... i ep tagër me nënshkrue n'emën e për llogari të Bankës së Shtetit aksionet e shoqnisë. ...".

**2 dhjetor 1945** u zgjodh deputet i qytetit të Shkodrës, në zgjedhjet e para pluraliste.

**2 prill 1946** me Vendim të Këshillit të Ministrave revokohet i gjithë Këshilli i Administratës së Bankës së Shtetit.

**12 maj 1946** Këshilli i Ri i Administratës vendosi zgjidhjen e Shoqërisë Anonime Import Eksport bazuar në politikën e përgjithshme të shtetit.

**15 maj 1947** arrestohet si pjesëmarrës në grupin e deputetëve kundër Pushtetit Popullor.

**27 prill 1949** falet me dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.8194 me amnisti.

**1949-1953** rron duke përkthyer materiale të ministrive dhe organizatave tregtare.

Vdiq 22 dhjetor 1953, në Tiranë.



### **15 dhjetor 1944**

Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar miraton ligjin nr.20, datë 15.12.1944, i cili ndalon eksportimin e arit, të argjendit, të platinës dhe të gurëve të çmuar. Synon frenimin e inflacionit të mëtejshëm të frangut shqiptar, goditjen e kontrabandës së arit në tregun e brendshëm dhe moslejimin e daljes së tij jashtë kufijve të vendit.

### **viti 1945**

13 janar 1945, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar miraton ligjin "Mbi anulimin e konvencionit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të aksioneve të saj". Shtetëzohet Banka Kombëtare e Shqipërisë. Shteti nuk njeh detyrimet e ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë, kundrejt të tretëve për depozitat në ar dhe në valutë të huaj.

Anulohet marrëveshja e marsit 1925 ndërmjet Qeverisë së Ahmet Zogut dhe grupit financiar italian.

### **13 janar 1945**

Miratohet ligji organik për Bankën e Shtetit Shqiptar, me 7 kapituj, 26 nene, nënshkruar për Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar nga kryetari Dr. Omer Nishani dhe sekretari Koço Tashko.

### **21 janar 1945**

Zhvillohet ceremonia e përirimit për Bankën e Shtetit Shqiptar. Ndër të ftuarit kryesorë : Enver Hoxha, Kryeministër i Qeverisë Demokratike Shqiptare; Hazhi Lleshi, Ministër i Punëve të Brendshme; Hafiz Musa Haxhi Aliu, Kryetar i Komitetit Mysliman; Kryepeshkop Kristofor Kisi, Kryetar i Kishës Katolike; Episkop Irinea Banushi; Kolonel Baba Faja Martaneshi; mjekë (4); Ministria e Shëndetësisë, ministri dhe një përfaqësues tjetër (2); Ministria e Financave, ministri dhe një përfaqësues tjetër (2); Ministria e Jashtme, ministri dhe një përfaqësues tjetër (2); Ministria e Ekonomisë, ministri dhe përfaqësues të tjerë (7); Ministri i Bujqësisë; Ministria e Punëve Botore, ministri dhe një përfaqësues tjetër (2); profesorë (7); tregtarë (2); farmacistë (2) industrialist (1) Banka e Shtetit (11).

Ftesat për shokun Enver Hoxha dhe për shokun Haxhi Lleshi, dërguar nga Këshilli i Administratës - Banka e Shtetit Shqiptar.

Përmbajtja: " Me rastin e hapjes së Bankës së Shtetit Shqiptar, Ju lutemi të merrni pjesë në ceremoninë e inagurimit, që do të zhvillohet nesër, datë 22 janar, n'orën 9 në Selin e Bankës".

### **22 janar 1945**

Fillimi i veprimtarisë së Bankës së Shtetit Shqiptar. Funkcionet kryesore përcakohen në ligjin organik:

Administrimi i Bankës së Shtetit Shqiptar bëhet nga Këshilli i Administratës, që emërohej nga Këshilli i Ministrave. Veprimtaria e Bankës kontrollohej nga Komisioni i Kontrollit që emërohej nga ministri i financave. Banka kishte bilancin e vet vjetor, i cili miratohej nga Këshilli i Administratës, kontrollohej nga Komisioni i Kontrollit dhe i dërgohej Ministrisë së Financave. Shteti garantonte të gjitha veprimet që kryheshin nga Banka e Shtetit Shqiptar, në bazë të ligjit të saj organik.

## Banka e Shtetit Shqiptar

Më 13 janar 1945, me ligj të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, u krijua Banka e Shtetit Shqiptar, e cila filloi veprimtarinë e saj më 22 janar 1945.

Funksionet dhe detyrat kryesore të Bankës së Shtetit Shqiptar ishin:

Nxjerrja e kartëmonedhës në qarkullim, mbulimi i së cilës duhej të sigurohej të paktën baraz me 1/3 e kartëmonedhave të emetuara me ar e argjend (në monedha ose në shufra) të depozituara brenda ose jashtë shtetit, me valuta të huaja etj..

Dhënia e kreditit afatshkurtër, për privatët, për shoqëritë dhe për entet publike kryesisht në formën e paradhënieve, si paradhënie në llogari rrjedhëse, paradhënie të garantuara në formë pengu mbi fonde publike shqiptare, paradhënie për dokumente malli në udhëtim etj..

Banka e Shtetit Shqiptar mund t'i jepte qeverisë paradhënie ose t'i çelte kredi në llogari rrjedhëse pa interes për një shumë deri 30 milionë franga shqiptare.

Shërbimi i arkëtimit dhe pagesave për llogari të privatëve ose të institucioneve.

Kryerja e shërbimit të arkës së shtetit dhe të thesarit të shtetit.

Qendër për mbajtjen e llogarive rrjedhëse, për pranimin e depozitave të kursimit dhe për ruajtjen e depozitave në para, në tituj, në monedha ari e argjendi etj..

Kryerja e veprimeve për shitblerjen e arit dhe të argjendit.

Kryerja e veprimeve të këmbimit të valutave të huaja për llogari të vet ose për llogari të tretëve, si dhe pranimi i depozitave në valuta të huaja.

Lidhja e marrëveshjeve të huasë.

Ngritja e magazinave të përgjithshme për bllokimin e mallrave, për të cilat jepej kredi.

Banka e Shtetit Shqiptar u krijua si një bankë emisioni dhe si një institucion shtetëror i pavarur me personalitet juridik të veçantë. Asaj iu dha nga shteti një kapital prej 10 milionë frangash shqiptare, duke marrë dhe aktivin e pasivin e ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Funksionet dhe detyrat e Bankës së Shtetit Shqiptar në fushën e monedhës dhe të kreditit, janë përsosur vazhdimisht, duke iu përgjigjur gjithnjë e më mirë detyrave të reja që shtroheshin para saj.

Ligji nr. 4021, datë 23.06.1965.

Më 1 korrik 1965, hyri në fuqi ligji i ri nr.4021, datë 23.06.1965 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar", dispozitat e të cilit pasqyronin përvojën e punës 20- vjeçare që nga krijimi i saj më 1945.

Dispozitat kryesore të këtij ligji vlen t'i përmendim si më poshtë :

Banka e Shtetit Shqiptar është institucion shtetëror, është person juridik dhe ka llogari të pavarur. Ajo bën pjesë në sistemin financiar të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe vepron në bazë të ligjeve, të dispozitave të Qeverisë, të urdhërave dhe të udhëzimeve të ministrit të financave. Në këtë ligj përcaktohen funksionet, të drejtat, detyrat, organizimi, fondet etj. Banka e Shtetit Shqiptar:

- a) është i vetmi institucion i nxjerrjes (emisionit) të monedhës;
- b) ka të drejtën ekskluzive të kryerjes së veprimeve juridike në lidhje me arin dhe me valutat e huaja;
- c) është institucioni kryesor i dhënies së kredive, i kontrollit të tyre dhe të fondit të pagave;
- d) është qendër e vetme e llogarive të institucioneve, të ndërmarrjeve dhe të organizatave shtetërore, kooperativiste e shoqërore, kryen shërbimin e arkëtimit e të pagesave midis tyre dhe ushtron kontroll mbi përdorimin e mjeteve monetare të tyre;
- e) kryen shërbimin e thesarit dhe të arkës për buxhetin e shtetit.

Banka e Shtetit Shqiptar nxjerr dhe vë në qarkullim kartëmonedha dhe monedha metalike. Monedhat metalike vihen në qarkullim për llogari të buxhetit të shtetit.

Lloji, sasia dhe prerjet e kartëmonedhave të bankës dhe të monedhave metalike caktohen nga Qeveria.

Njësia monetare në Republikën Popullore të Shqipërisë është leku, i cili është i vetmi mjet qarkullimi e pagese.

*Kartëmonedhat e bankës në qarkullim janë të garantuara nga shteti me mallra, me ar, me metale të tjera të çmueshme, me valuta të huaja dhe me aktivitet të Bankës.*

*Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë të vendosë marrëdhënie dhe të lidhë marrëveshje bankare me bankat e shteteve të huaja, të kryejë pagesa dhe të çelë llogari pranë tyre, si dhe të pranojë çeljen e llogarive për bankat e huaja.*

*Burimet për dhënien e kredive formohen nga mjetet e veta të Bankës, nga tepricat e mjeteve monetare përkohësisht të lira të buxhetit të shtetit dhe të institucioneve, të ndërmarrjeve e të organizatave shtetërore, kooperativiste e shoqërore, të kolektivave dhe të personave, të cilat grumbullohen në Bankë.*

*Njëkohësisht Banka e Shtetit Shqiptar kryen edhe këto funksione :*

- a) kundrejt depozitave në mjete monetare u çel institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave shtetërore, kooperativiste e shoqërore, si dhe personave llogari likuiduese, rrjedhëse ose speciale, duke u paguar kamatë në masën e caktuar nga dispozitat e veçanta të Qeverisë;*
- b) kryen kontroll në institucionet, në ndërmarrjet dhe në organizatat për zbatimin e planeve të arkës dhe të kreditit, si dhe për plotësimin e planeve të tyre financiare;*
- c) kryen financimin dhe kontrollin e meremetimeve të mëdha;*
- d) ka të drejtë të marrë nga ministrinë, nga institucionet e tjera qendrore dhe nga organet e tyre vartëse të dhëna për të bërë studimet e nevojshme për monedhën dhe për kreditë;*
- e) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Qeveria.*

*Banka e Shtetit Shqiptar përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme dhe nga degët e arkat e shërbimit në qytete e qendra të tjera banimi të vendit.*

*Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar :*

- a) udhëheq Bankën dhe përgjigjet për veprimtarinë e përgjithshme të saj;*
- b) përfaqëson Bankën dhe delegon edhe të tjerë që ta përfaqësojnë dhe të nënshkruajnë në emrin e tij;*
- c) emëron dhe pushon nëpunësit e Bankës, që përmban nomenklatura e Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar;*
- d) miraton planet e arkës, të kredive dhe planet financiare të degëve të bankës.*

*Drejtori i Përgjithshëm mund të delegojë nëpunës të tjerë të Bankës që të ushtrojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tij. Degët pranë Drejtorisë së Përgjithshme janë organe planifikimi ose kontrolli të monedhës, të kredive, të investimeve, të fondit të pagave etj. dhe organizojnë e udhëheqin punën e Bankës sipas sektorëve të tyre.*

*Për të ndihmuar Drejtorin e Përgjithshëm krijohet Këshilli i Bankës, që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe përbëhet nga zëvendësdrejtorët dhe nga punonjës të tjerë të Bankës.*

*Këshilli i Bankës është organ konsultativ, punon në bazë të një plani të miratuar, mbledhet sa herë që e kërkon Drejtori i Përgjithshëm dhe shqyrton e jep mendime mbi ato probleme që ky e sheh të nevojshme.*

*Degët e Bankës të rrethëve varen drejtpërdrejt nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës, kurse degët dhe arkat e shërbimit, që ndodhen brenda territorit të një rrethi, varen nga dega e Bankës e atij rrethi.*

*Për të kryer veprimtarinë e saj Banka e Shtetit Shqiptar ka këto fonde:*

- a) fondin e themelimit, të caktuar nga Qeveria;*
- b) fondin rezervë, i cili nuk mund të kalojë kufirin e fondit të themelimit;*
- c) fondin e mjeteve kryesore;*
- d) fonde të tjera që mund të krijohen me vendim të Qeverisë.*

*Banka e Shtetit Shqiptar përpilon, në fund të çdo muaji dhe tremujori, bilancet vërtetuese, kurse në mbylljen e çdo ushtrimi, bilancin vjetor së bashku me llogarinë fitime dhe humbje, që ia paraqet për shqyrtim ministrit të financave dhe për miratim Qeverisë në afatin e caktuar.*



Fitimet e Bankës ndahen si vijon :

- a) 40 për qind në dobi të buxhetit kombëtar;
- b) 60 për qind në shtim të fondit rezervë. Kur fondi rezervë kalon kufirin e fondit të themelimit, e gjithë shuma e fitimit kalon në dobi të buxhetit kombëtar.

Shteti garanton të gjitha detyrimet e Bankës së Shtetit Shqiptar, që rrjedhin nga veprimet e kryera në bazë të këtij ligji.

Banka e Shtetit Shqiptar, në bazë dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji, të dispozitave të Qeverisë, të urdhërave dhe të udhëzimeve të ministrit të financave, jep udhëzime të veçanta që janë të detyrueshme edhe për institucionet, për ndërmarjet dhe për organizatat shtetërore, kooperativiste dhe shoqërore.

Në ligj përcaktohet se ligji nr.522, datë 08.08.1947 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar", dekretligji nr.745, datë 26.11.1949, dekreti nr.1938, datë 04.10.1954, dekreti nr.2282, datë 30.06.1956, dekreti nr.2673, datë 02.06.1958 dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Dekreti nr.5529, datë 25.02.1977.

Në vitin 1977 miratohet dekreti nr. 5529, datë 25.02.1977 " Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar ". Ndryshimet më kryesore në këtë dekret , krahasuar me ligjin nr.4021 të vitit 1965, konsistojnë :

- a) Banka e Shtetit Shqiptar varet nga Ministria e Financave dhe përgjigjet e jep llogari para saj ;
- b) përbërja e Këshillit të Bankës miratohet nga ministri i financave ;
- c) përcaktohen fondet e bankës : fondi i themelimit prej 750 milionë lekësh, fondi rezervë prej 250 milionë lekësh dhe fondi i mjeteve kryesore.

Ministria e Financave në bazë dhe për zbatim të dispozitave të këtij dekreti dhe të dispozitave të Këshillit të Ministrave jep udhëzime që janë të detyrueshme për ministrinë, për institucionet e tjera qendrore dhe për organet e tyre vartëse.

Ligji nr.7377, datë 08.05.1990.

Në vitin 1990, miratohet ligji nr. 7377, datë 08.05.1990 " Për Bankën e Shtetit Shqiptar ", i cili hyn në fuqi më 01.01.1991. Ndryshimet kryesore, në krahasim me dispozitat ekzistuese, konsistojnë :

- a) Banka e Shtetit Shqiptar konceptohet si institucion qendror shtetëror, që zbaton politikën ekonomike të shtetit.
- b) rritet varësia e Bankës së Shtetit Shqiptar nga Këshilli i Ministrave ;
- c) përbërja e Këshillit të Bankës miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm ;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, në bazë dhe për zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe të dispozitave të Këshillit të Ministrave, jep udhëzime që janë të detyrueshme për ministrinë, për institucionet e tjera qendrore dhe për organet e tyre vartëse ;
- e) Banka e Shtetit Shqiptar organizohet sipas parimit me llogari më vete. 90 për qind e të ardhurës neto të planifikuar dhe 70 për qind e asaj mbi plan-derdhjen në buxhetin e shtetit. Pjesa tjetër përdoret për fuqizimin e fondeve të bankës, për investime etj.. Sipas kriterëve të caktuara me dispozita të veçanta.

Dekreti nr. 7440, datë 01.12.1990.

Me dekretin nr. 7440, datë 01.12.1990, për t'i hapur rrugën kreditimit të sektorit privat, në ligjin nr. 7377, datë 08.05.1990, bëhen këto ndryshime kryesore :

- Banka mban llogari bankare për pagesat dhe arkëtimet e klientëve të saj;
- Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatshkurtër klientëve të saj për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatgjatë klientëve për investime të reja, për blerje e rikonstruksione teknike e teknologjike të objekteve prodhuese, të shërbimeve e aktiviteteve të tjera që gjykohen prej saj të leverdisshme ekonomikisht.

### **18 maj 1945**

Shpallet ligji "Mbi ndalimin e tregtisë së arit", duke ia njohur këtë të drejtë vetëm Bankës së Shtetit Shqiptar.

Megjithë masat e forta, nuk qenë mbyllur të gjitha shtigjet e ndikimit të jashtëm. Në qarkullimin monetar ishin të pranishme sasi të mëdha kartëmonedhash, të cilat bëheshin shkak për gjithfarë çrregullimesh.

### **2 qershor 1945**

Ministria e Financave ndalon eksportimin dhe importimin e kartëmonedhave shqiptare dhe shitblerjen dhe eksportimin e valutave të huaja, duke vendosur kështu përfundimisht monopolin shtetëror mbi valutën. Me këtë akt ligjor, Banka e Shtetit Shqiptar ngarkohej të kryente të gjitha veprimet valutore. Monopoli i Bankës së Shtetit Shqiptar mbi import-eksportin e arit dhe të metaleve të tjera u plotësua edhe me monopolin e saj mbi valutat.

Të gjithë ata që ushtronin kontrabandën e metaleve të çmuara dhe të valutave të huaja, në bazë të dispozitave të reja ligjore i përcilleshin gjykatave për ndjekje penale.

### **22 qershor 1945**

Banka e Shtetit Shqiptar shpall vulosjen e kartëmonedhave dhe të çekmonedhave në qarkullim, të emetuara nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Lidhur me vulosjen e kartëmonedhave është shkruar artikulli i mëposhtëm (Gazeta "Rassenca Numismatica" artikulli i shkruar nga Giuseppe Battaglia viti 1978, nr. 1).

"Vulosja mbi kartëmonedhat është një dukuri e rrallë dhe për raste kur duhet të merren masa të jashtëzakonshme, por përse u veprua kështu?"

Me zhvillimin e ngjarjeve të pas Luftës II Botërore edhe në Shqipëri, pas proklamimit të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, filluan të duken shenjat e para të inflacionit dhe keqësimi i gjendjes së mjeteve qarkulluese (kartëmonedhave), gjendje e cila vinte nga pamundësia për të shtypur kartëmonedhë të re dhe për të zëvendësuar atë të emisionit italian që ishte në qarkullim. Në pritje të normalizimit të situatës u mendua që kartëmonedhave në qarkullim t'u vihej një shenjë dalluese, vulë katërkëndëshe me përmasa 52x34 mm, ku shkruhej Banka e Shtetit Shqiptar me shqiponjë dykrenore në mes, në të majtë të së cilës valviten tre pendë. E gjithë vula është e vijëzuar me vija paralele horizontale ku si shqiponja dhe shkrimet janë me hije..."



*Vulë katërkëndëshe me përmasa 52x34 mm.*

### **1945**

Këtë vit Banka e Shqipërisë emetoi serinë e parë të kartëmonedhave të pasluftës, të cilat u hodhën në qarkullim në korrik të vitit 1946.



*Seria e parë e re e kartëmonedhave të vitit 1945.*

### **12 gusht 1945**

U suprimua dhe u likuidua Banka Kombëtare e Punës (Banca Nazionale del Lavoro).

### **6 nëntor 1945**

U suprimua dhe u likuidua edhe Banka e Napolit (Banca di Napoli).

### **nëntor 1945**

Banka e Shtetit Shqiptar, në bazë të ligjit organik u ngarkua edhe me ushtrimin e kreditit bujqësor dhe pranë saj u krijua seksioni i kreditit bujqësor. Krediti bujqësor jepej me afat të shkurtër, me afat të mesëm dhe me afat të gjatë.

Në strukturën e Bankës së Shtetit Shqiptar në vitin 1945 bënin pjesë drejtoria, dega e marrëdhënieve me jashtë, dega e kreditit, dega e kreditit bujqësor, dega e planit ekonomik dhe zyra e kuadrit.

### **dhjetor 1945 - janar 1946**

Në degët e Bankës në Gjirokastrë, në Korçë, në Durrës, në Shkodër dhe në Tiranë konstatohen sasi të mëdha kartëmonedhash me vula të falsifikuara. Rezultoi që falsifikimi ishte bërë në Greqi, në Itali dhe në Jugosllavi, por edhe brenda vendit.

Në vitin 1946, përpara Shtetit Shqiptar shtrohej detyra të kishte monedhën e vet me shenja të reja, që të shprehte realitetin e ri historik të vendit. Në rend të ditës ishte vënë domosdoshmëria e një reforme monetare rrënjësore.

## AKTET KRYESORE LIGJORE DHE NËNLIGJORE TË SISTEMIT BANKAR NË SHQIPËRI 1945-1992

1. Ligji nr.20, datë 15.12.1944 i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar "Mbi ndalimin e eksportimit të metaleve me vleftë (ar, argjend, platin e gurë të çmuar), në çdo trajtë, si monedha, shufra, sende stolie etj.. "Gazeta Zyrtare" nr.2, viti 1944.
2. Ligji organik i Bankës së Shtetit Shqiptar, datë 13.01.1945 i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. "Gazeta Zyrtare" nr.4, viti 1945.
3. Ligji nr. 38, datë 13.01.1945 i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar "Mbi anulimin e konvencionit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të aksioneve të saj". "Gazeta Zyrtare" nr.30, viti 1945.
4. Ligji nr.63, datë 18.05.1945 i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar "Mbi ndalimin e tregtisë së arit". "Gazeta Zyrtare" nr.2, viti 1945.
5. Urdhëresa nr. 7, datë 02.06.1945 e Ministrisë së Financave "Mbi ndalimin e eksportimit dhe importimit të bankënotave shqiptare dhe shitblerjes dhe eksportimit të divizave dhe të valutave të huaja". "Gazeta Zyrtare" nr.14, viti 1945.
6. Urdhëresa nr.9, datë 22.06.1945 e Bankës së Shtetit Shqiptar "Mbi sursharzhimin e bankënotave nga franga shqiptare 20 e 100 çekëmonedhave të çfarëdo premje emetuar nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë ". "Gazeta Zyrtare" nr.17, viti 1945.
7. Urdhëresa e Ministrisë së Financave nr.15, datë 13.08.1945 " Mbi likuidimin e Banca Nazionale del Lavoro". "Gazeta Zyrtare" nr.30, viti 1945.
8. Ligji i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar "Mbi suprimimin dhe likuidimin e Bankës së Napolit në Shqipëri". "Gazeta Zyrtare" nr.71, viti 1945.
9. Dekreti nr.94, datë 11.07.1946 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi shkëmbimin e bankënotave dhe të çekave monedhë emetuar nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe sursharzhuar nga Banka e Shtetit Shqiptar si dhe e çekave monedhë emetuar nga Banka e Shtetit Shqiptar". "Gazeta Zyrtare" nr.66, viti 1946.
10. Urdhëresa nr.8, datë 15.07.1946 e Ministrisë së Financave " Mbi shkëmbimin e kartëmonedhave të vjetra me monedhën e re të Bankës së Shtetit Shqiptar". "Gazeta Zyrtare" nr.66, viti 1946.
11. Dekreti nr.100, datë 02.08.1946 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi kryerjen e shërbimeve të thesarit të shtetit prej Bankës së Shtetit Shqiptar". "Gazeta Zyrtare" nr.81, viti 1946.
12. Dekreti nr.101, datë 03.08.1946 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi krijimin e arkës së përgjithshme të shtetit pranë Bankës së Shtetit Shqiptar". "Gazeta Zyrtare" nr.81, viti 1946.
13. Dekreti nr.184, datë 04.12.1946 " Për disa ndryshime në ligjin organik të Bankës së Shtetit Shqiptar".
14. Dekreti nr.255, datë 26.12.1946 i Presidiumit të Kuvendit Popullor "Mbi shkëmbimin e kartëmonedhave të përdorura ose të dëmtuara të emetuara nga Banka e Shtetit Shqiptar". "Gazeta Zyrtare" nr.2, viti 1947.
15. Dekreti nr.356, datë 07.07.1947 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi heqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave në franga të emisionit të Bankës së Shtetit Shqiptar dhe atyre të mbetura nga emisione të ndryshme në monedha metalike të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe mbi vënien në qarkullim të emisionit të ri". "Gazeta Zyrtare" nr.63, viti 1947.
16. Dekreti nr.440, datë 8 gusht 1947 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi kontrollin e shpenzimeve për financimin e ekonomisë popullore dhe investimeve të tjera". "Gazeta Zyrtare" nr.77, viti 1947.
17. Dekreti nr.441, datë 8 gusht 1947, i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Ligji organik i Bankës së Shtetit Shqiptar". "Gazeta Zyrtare" nr.82, viti 1947.
18. Urdhëresa nr.45, datë 4 shtator 1948 e Këshillit të Ministrave " Mbi ndalimin e eksportimit e të importimit të bankënotave dhe monedhave metalike shqiptare ". "Gazeta Zyrtare" nr.19, viti 1948.
19. Urdhëresa nr.65, datë 26 dhjetor 1947 e Këshillit të Ministrave " Mbi eksportimin dhe importimin e lekëve dhe dinarëve efektivë". "Gazeta Zyrtare" nr.19, viti 1948.
20. Urdhëresa nr.151, datë 20 shtator 1948 e Këshillit të Ministrave " Mbi sistemin e ri të kreditit bankar". "Gazeta Zyrtare" nr.94, viti 1948.
21. Vendimi nr.350, datë 10 gusht 1949 i Këshillit të Ministrave "Mbi tarifën e interesave të kredive të akorduara sektorëve të ekonomisë". "Gazeta Zyrtare" nr.62, viti 1949.
22. Dekreti nr.936, datë 28 shtator 1949 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi heqjen nga qarkullimi të bankënotave në lekë të emisionit të Bankës së Shtetit Shqiptar, të vitit 1947 dhe mbi vënien në qarkullim të emisionit të ri". Gazeta Zyrtare nr.78, viti 1949.
23. Dekreti nr.744, datë 26.11.1949, i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi kontrollin e financimit të ndërtimeve dhe meremetimeve kryesore dhe të akumulimit të mjeteve financiare që destinohen për këtë qëllim". Gazeta Zyrtare nr.91, viti 1949.
24. Vendimi nr.980, datë 22.11.1950, i Këshillit të Ministrave " Mbi bankënotat e dëmtuara të emisionit të Bankës së Shtetit Shqiptar". Gazeta Zyrtare nr.82, viti 1950.
25. Urdhëresa nr.8, datë 17.05.1952 e Këshillit të Ministrave "Mbi kontrollin e fondit të pagës së punës së punonjësve të prodhimit në ndërmarrje industriale, minerale, të ndërtimit dhe në organizatat kooperativiste të prodhimit". Gazeta Zyrtare nr.10, viti 1952.
26. Urdhëresa nr.34, datë 04.10.1952 e Këshillit të Ministrave "Mbi planin e arkës". Gazeta Zyrtare nr.20, viti 1952.

27. Urdhëresa nr.13, datë 10.09.1954 e Këshillit të Ministrave "Mbi dhënien e kredisë me afat të gjatë për ndërtim dhe meremetim banesash të punonjësve". *Gazeta Zyrtare* nr.16, viti 1954.
28. Urdhëresa nr.13, datë 19.09.1956 e Këshillit të Ministrave "Mbi dhënien e kredive në favor të ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike për shpenzime të planifikuara të përdorimit të teknikës së re". *"Gazeta Zyrtare"* nr.14, viti 1956.
29. Urdhëresa nr.16, datë 07.12.1956 e Këshillit të Ministrave "Mbi kredinë e diferencuar". *"Gazeta Zyrtare"* nr.2, viti 1957.
30. Vendimi nr.25, datë 05.02.1957 i Këshillit të Ministrave "Mbi përpilimin e planit të arkës dhe të kreditit nga ana e Bankës së Shtetit Shqiptar". *"Gazeta Zyrtare"* nr.6, viti 1957.
31. Urdhëresa nr. 8, datë 07.04.1958 e Këshillit të Ministrave " Mbi dhënien e kredive për ndërtime e meremetime banesash". *"Gazeta Zyrtare"* nr.6, viti 1958.
32. Dekreti nr.2927, datë 13.07.1959 i Presidiumit të Kuvendit Popullor "Mbi konvertimin e katër huave shtetërore për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së RPSH". *"Gazeta Zyrtare"* nr.6, viti 1959.
33. Urdhëresa nr.13, datë 10.12.1960 e Këshillit të Ministrave "Mbi fondin e pagës së punës së punonjësve në organizatat ekonomike dhe kontrollin e përdorimit të tij". *"Gazeta Zyrtare"* nr.14, viti 1960.
34. Dekreti nr.4028, datë 14.07.1965 i Presidiumit të Kuvendit Popullor "Mbi shkëmbimin e monedhës". *"Gazeta Zyrtare"* nr.6, viti 1965.
35. Dekreti nr.4021, datë 23.06.1965 i Presidiumit të Kuvendit Popullor "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar". *"Gazeta Zyrtare"*, nr.6, viti 1965.
36. Urdhëresa nr.3, datë 05.10.1966 e Këshillit të Ministrave " Mbi dhënien e kredisë me afat të gjatë për përmirësimin e kushteve të banimit". *"Gazeta Zyrtare"* nr.7, viti 1966.
37. Urdhëresa nr.4, datë 05.10.1966 e Këshillit të Ministrave " Mbi kredinë me afat të shkurtër në dobi të ndërmarrjeve shtetërore dhe organizatave kooperativiste të artizanatit dhe të konsumit". *"Gazeta Zyrtare"* nr.7, viti 1966.
38. Urdhëresa nr.5, datë 05.10.1966 e Këshillit të Ministrave " Mbi kredinë me afat të shkurtër dhe të gjatë në dobi të kooperativave bujqësore". *"Gazeta Zyrtare"* nr.7, viti 1966.
39. Dekreti nr.4613, datë 12.12.1969 i Presidiumit të Kuvendit Popullor " Mbi krijimin e Bankës Bujqësore". *"Gazeta Zyrtare"* nr.10, viti 1969.
40. Vendimi nr.187, 23.12.1969, i Këshillit të Ministrave "Mbi funksionet e organizimin e Bankës Bujqësore". *"Gazeta Zyrtare"* nr.10, viti 1969.
41. Urdhëresa nr.1, datë 06.01.1976 e Këshillit të Ministrave "Mbi kontrollin bankar për përdorimin e fondit të pagave". Ndryshuar me urdhëresën nr.6, datë 13.12.1980 të Këshillit të Ministrave "Për kontrollin bankar për përdorimin e fondit të pagave dhe me urdhëresën nr.7, datë 11.12.1985. (Përmbledhës i legjislacionit në fuqi 1945-1985, vëll I, viti 1986.
42. Urdhëresa nr.8, datë 15.11.1976 e Këshillit të Ministrave "Mbi studimin, projektimin, planifikimin dhe financimin e investimeve e ndërtimeve themelore".
43. Dekreti nr.5529, datë 25.02.1977 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar", ndryshuar me dekretin nr.6882, datë 28.04.1984, (Përmbledhës i përgjithshëm i legjislacionit në fuqi 1945-1985, vëll.I, viti 1986.)
44. Dekreti nr.5530, datë 25.02.1977 i Presidiumit të Kuvendit Popullor "Mbi Bankën Bujqësore", ndryshuar me dekretin nr.6882, datë 28.04.1984 (Përmbledhës i përgjithshëm i legjislacionit në fuqi 1945-85, vëll.I).
45. Urdhëresa nr.2, datë 15.03.1977 e Këshillit të Ministrave "Mbi kredinë me afat të shkurtër për ndërmarrjet".
46. Urdhëresa nr.3, datë 15.03.1977 e Këshillit të Ministrave " Mbi kredinë me afat të gjatë për zgjerimin e prodhimit në ndërmarrjet".
47. Urdhëresa nr.4, datë 15.03.1977 e Këshillit të Ministrave " Mbi kredinë me afat të gjatë për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve në qytet dhe në fshat".
48. Urdhëresa nr.5, datë 15.03.1977 e Këshillit të Ministrave " Mbi planin e arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar", Ndryshuar me urdhëresën nr.3, datë 27.08.1982 të Këshillit të Ministrave " Për qarkullimin monetar" dhe me urdhëresën nr.8, datë 11.12.1985. (Përmbledhës i përgjithshëm i legjislacionit në fuqi 1945-1985, vëll.I, viti 1986.
49. Vendimi nr.185, datë 06.07.1982 "Për çeljen e kredive dokumentare për import në valutë të lirë. (Përmbledhës i legjislacionit në fuqi 1945-1985, vëll.I, viti 1986.)
50. Dekreti nr.6882, datë 28.04.1984, përcakton varësinë e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe të Bankës Bujqësore nga Ministri i Financave.
51. Ligji nr.6942, datë 25.12.1984 " Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare".
52. Vendimi nr.70, datë 11.03.1985 i Këshillit të Ministrave " Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare".
53. Dekreti nr.7162, datë 10.10.1987, përcakton Bankën e Shtetit Shqiptar si institucion qendror në vartësi të Këshillit të Ministrave.
54. Ligji nr.7377, datë 08.05.1990 " Për Bankën e Shtetit Shqiptar", *"Gazeta Zyrtare"* nr.3, viti 1990.
55. Urdhëresa nr.3, datë 25.05.1990 " Për kredinë bankare në valutë të lirë".
56. Urdhëresa nr.4, datë 25.05.1990 " Për kreditin bankar".
57. Urdhëresa nr.5, datë 25.05.1990 " Për qarkullimin monetar dhe kontrollin bankar në fondin e pagave".
58. Dekreti nr.7440, datë 01.12.1990 " Për disa ndryshime në ligjin nr.7377, datë 08.05.1990 " Për Bankën e Shtetit Shqiptar".
59. Dekreti nr.7493, datë 01.12.1990 "Për Bankën Shqiptare të Tregtisë". *"Gazeta Zyrtare"* nr.4, viti 1991.
60. Ligji nr.7505, datë 31.07.1991 "Për Bankën e Kursimeve". *"Gazeta Zyrtare"* nr.5, viti 1991.
61. Ligji nr.7520, datë 16.10.1991 "Për Bankën e Bujqësisë dhe të Zhvillimit". *"Gazeta Zyrtare"* nr.8, viti 1991.
62. Ligji nr.7559, datë 22.04.1992 "Për Bankën e Shqipërisë", përcakton shfuqizimin e ligjeve për Bankën e Shtetit Shqiptar.
63. Vjetari statistikor i Bankës së Shtetit Shqiptar, viti 1990.

## **Abdyl Këllezi**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
1946-1948*

*Datëlindja : 20 gusht 1919.*

*Vendlindja : Tiranë.*



### **Shkollimi**

*Në vitin 1938, filloi studimet në një shkollë ushtarake në Itali, Romë.  
Vazhdoi studimet pa shkëputje nga puna, në Fakultetin Ekonomik,  
në Universitetin e Tiranës, ku shquhet për rezultate të mira.*

### **Veprimtari patriotike**

*Në vitin 1939, prill, së bashku me studentët e tjerë ushtarakë shqiptarë, proteston për pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste dhe nuk pranon të betohet për së dyti. Për këtë arrestohet dhe internohet në Itali, në ishullin Ventotene.  
Në fund të vitit 1942, lirohet dhe kthehet në Shqipëri.*

*1942 - 1944, Pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacionalçlirimtare. Në përfundim të luftës ka qenë Komisar i Brigadës XVI.*

### **Ekspierencë pune**

*1944-1946, kryen funksione të ndryshme në administratën shtetërore.*

*1945, emërohet Drejtor Personeli në Bankën e Shtetit Shqiptar.*

*1946, emërohet drejtor në Bankën e Shtetit e Shtetit Shqiptar.*

*Në këtë periudhë, gjithashtu, është i angazhuar si anëtar i delegacionit shqiptar në marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë.*

*1948, emërohet Zëvendësministër i Financave. Kryen detyrën e Ministrit të Financave, në varësi kjo të situatave të ndryshme politike në Shqipëri.*

*Në vitet 1954-1955, kryeson grupin e punës, për studimin e sistemit të pagave, duke u përpjekur të theksojë edhe nevojën e harmonizimit të interesit të përgjithshëm me interesin material.*

*Abdyl Këllezi ka qenë dhe një ndër anëtarët e grupit kryesor të punës, për heqjen e sistemit të triskëtimit.*

*Në vitet 1956-1957, ka dhënë një kontribut me vlerë me sugjerimet dhe mendimet e tij racionale në fushën e financave publike dhe sidomos në fushën e buxhetit e të tatim- taksave.*

*1956-1966, Zëvendëskryeministër për problemet ekonomike dhe të bujqësisë.*

*Në këtë periudhë, gjithashtu bën pjesë si anëtar i delegacioneve ekonomike të Shqipërisë për realizimin e marrëveshjeve ekonomike me BRSS, Çekë, Gjermani etj.. Shquhet si ekonomist-financier.*

*1961-1975, Kryetar i delegacioneve për realizimin e marrëveshjeve ekonomike me Kinën.*

*1966-1969, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës.*

*1969-1975, Kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.*

*Në vitin 1975, shkarkohet nga të gjitha funksionet dhe arrestohet.*

*Pushkatohet në maj të vitit 1977.*

### **11 korrik 1946**

Miratohet dekreti nr.94 "Mbi shkëmbimin e bankënotave dhe të çekave monedhë emetuar nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë sursharzhuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, si dhe e çekave monedhë emetuar nga Banka e Shtetit Shqiptar".

### **15 korrik 1946**

Në një numër të posaçëm të gazetës "Bashkimi", nën titullin e madh "Vihet në qarkullim monedha e re e Bankës së Shtetit Shqiptar", botohet dekretligji dhe urdhëresa e Ministrisë së Financave, shoqëruar me një kryeartikull mbi rëndësinë e këmbimit të monedhës.

### **15-25 korrik 1946**

Banka e Shtetit Shqiptar hodhi në qarkullim emisionin e ri në franga, në kartëmonedha me prerje 5, 20, 100 dhe 500 franga në zëvendësim të emisionit të vjetër.

#### **Reforma monetare**

Zbatimi i politikës së shtetit në lëmin e monedhës dhe të qarkullimit monetar shtron nevojën e marrjes së masave të thella për zotërimin dhe për stabilizimin e tyre. Detyrat më të mprehta dhe më urgjente konsistojnë në zhdukjen e pasojave të periudhës së pushtimit dhe të inflacionit, në mbrojtjen e qarkullimit monetar nga ndikimet e jashtme, në përqëndrimin në Bankën e Shtetit Shqiptar të arit dhe të valutave të huaja.

Me ligjin nr.20, datë 15.12.1944 të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar u ndalua eksportimi i arit, i argjendit, i platinës dhe i gurëve të çmuar.

Më 18 maj 1945 shpallet ligji " Mbi ndalimin e tregtisë së arit ", duke ia njohur këtë të drejtë vetëm Bankës së Shtetit Shqiptar.

Me 2 qershor 1945, Ministria e Financave ndalon eksportimin dhe importimin e kartëmonedhave shqiptare dhe shitblerjen dhe eksportimin e valutave të huaja, duke vendosur kështu përfundimisht monopolin shtetëror mbi valutën. Me këtë akt ligjor, Banka e Shtetit Shqiptar ngarkohej të kryente të gjitha veprimet valutore.

Më 22 qershor 1945, Banka e Shtetit Shqiptar shpall vulosjen e kartëmonedhave të nxjerra në qarkullim, si dhe të çekmonedhave të emtuara nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë. Vulosja e kartëmonedhave do të bëhej nga Banka e Shtetit Shqiptar vetëm për prerjet 20 dhe 100 franga shqiptare, si dhe çekmonedhat me vlefë 20, 100, 500, 1000 dhe 5000 franga shqiptare. Vula kishte trajtën e një drejtkëndëshi, që mbante përbrenda një shqiponjë dykrenare me yll mbi të dhe fjalët "Banka e Shtetit Shqiptar".

Vulosja e kartëmonedhave u bë në të gjithë vendin prej datës 27 qershor deri më 8 korrik 1945. Ajo u krye në fillim në zonat kufitare. Vulosja e kartëmonedhave u bë pa asnjë kufizim shumë. Megjithatë, kur dyshohej për vërtetësinë e pronësisë, shumat mbi 10.000 franga shqiptare depozitoheshin në Bankë për hetim të mëtejshëm, duke e pajisur të interesuarin me një dëftesë.

Kartëmonedhat dhe çekmonedhat që nuk u paraqitën për vulosje u konsideruan të pavlefshme dhe, për pasojë, dolën jashtë qarkullimit monetar. Për depozitat e vendosura në Bankë, për arsye se prej saj nuk disponoheshin, aty për aty, kartëmonedha të vulosura, u parashikua që vlefë e depozitës t'i kthehej pronarit brenda datës 31 gusht 1945.

Vulosja e kartëmonedhave dhe e çekmonedhave të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë pati efekte të ndjeshme në qarkullimin monetar. Në fund të vitit 1945 emisioni ariti në 286.100.000 franga shqiptare, nga 384.396.000 që ishte në fund të vitit 1944. Kartëmonedhat që nuk u paraqitën për vulosje vlerësohen rreth 101.054.765 franga shqiptare.

Megjithëkëtë, urdhëresa e Bankës së Shtetit Shqiptar la jashtë vulosjes rreth 20 për qind të monedhës në qarkullim, mbasi nuk u vulosën kartëmonedhat me prerje nën 20 franga shqiptare.

#### **Reforma monetare e vitit 1946.**

Përpara Shtetit Shqiptar shtrohet detyra që të kishte monedhën e vet me shenja të reja, që të shprehte realitetin e ri historik të vendit. Në rend të ditës vihet domosdoshmëria e një reforme monetare rrënjësore.

### **Në këtë kohë kishte në qarkullim:**

-kartëmonedha të emetuara nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë me prerje 20 dhe 100 franga shqiptare, të periudhës së pushtimit dhe me prerje 20 franga shqiptare të periudhës së Zogut, të vulosura me vulën e Bankës së Shtetit Shqiptar;

-kartëmonedha me prerje 5, 2, 1 dhe 0,40 franga shqiptare të periudhës së pushtimit dhe kartëmonedha të prerjes 5 franga shqiptare të periudhës së Zogut, të pavulosura nga Banka e Shtetit Shqiptar;

-çekmonedha të shtypura në Itali me prerje 5.000, 2.000, 1.000, 200 dhe 100 franga shqiptare të emetuara nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe të vulosura nga Banka e Shtetit Shqiptar;

-çekmonedha të shtypura në Austri me prerje 100 dhe 20 franga shqiptare, të emetuara prej ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të vulosura nga Banka e Shtetit Shqiptar;

-çekmonedha në formularë të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë me prerje 500, 200 dhe 100 franga shqiptare të emetuara në shkurt të vitit 1945 prej Bankës së Shtetit Shqiptar dhe të pavulosura;

-çekmonedha të shtypura dhe të emetuara në prill të vitit 1945 nga Banka e Shtetit Shqiptar dhe të pavulosura.

Me dekretin nr.94, datë 11.07.1946 "Mbi shkëmbimin e bankënotave dhe të çekave monedhë emetuar nga ish- Banka Kombëtare e Shqipërisë sursharshuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, si dhe e çekave monedhë emetuar nga Banka e Shtetit Shqiptar", Banka e Shtetit Shqiptar hodhi në qarkullim emisionin e ri të saj në franga në kartëmonedha me prerje 5, 20, 100 dhe 500 franga. Kursi i këmbimit u caktua 5 franga shqiptare të vjetra me 1 frang të ri, të emetuar nga Banka e Shtetit Shqiptar.

### **Frangu i ri u barazua me frangun ar.**

Nga emisioni i vjetër mbetën përkohësisht në qarkullim kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga ish- Banka Kombëtare e Shqipërisë, prerjet 5,2,1,0.40, 0.20 dhe 0.10 franga.

Nga data 15 deri më 25 korrik 1946 në gjithë vendin u bë këmbimi në raportin 5 franga të vjetra me 1 frang të ri, në degët e Bankës së Shtetit Shqiptar ose në zyrat e këmbimit të caktuara prej saj. Sasia e parave që lejohej të këmbente çdo familje ishte deri në 5.000 franga shqiptare të vjetra baraz me 1.000 franga të reja. Këmbimi mund të bëhej vetëm nga një pjesëtar i familjes për krejt familjen. Shumat mbi shumën e caktuar prej 5.000 frangash shqiptare, depozitoheshin në Bankën e Shtetit Shqiptar në një fond të veçantë për rindërtimin e ekonomisë. Këtij kufizimi nuk iu nënshtruan ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore, kooperativat dhe organizatat e masave.

Duke filluar nga data 15 korrik 1946, në raportin 5 me 1 u korrighuan edhe çmimet e mallrave industrialë dhe bujqësorë, shërbimet publike e private, qiratë, pagat e punës, debi-kreditë e ndryshme, tatimet e taksat etj..

Reforma e dytë monetare, u bë më 10-20 korrik 1947, në bazë të dekretit nr. 356, datë 07.07.1947.

Banka e Shtetit Shqiptar vuri në qarkullim emisionin e ri të monedhës në lekë në kartëmonedhë me prerje 10, 50, 100, 500 dhe 1000 lekë dhe në monedhë metalike me prerje 0.50, 1, 2 dhe 5 lekë.

Këmbimi u bë me raportin 1 frang baraz me 9 lekë ose baraz me 9 dinarë.

Në këtë raport u korrighuan edhe çmimet e mallrave, shërbimet publike e private, qiratë, pagat e punës, debi-kreditë, të ardhurat e shpenzimet, tatimet e taksat etj..

Në korrik të vitit 1947, u caktuan edhe kurset e reja për blerjen e arit dhe për këmbimin në lekë të valutave të huaja. 1 napolon ar blihet me 326 lekë, 1 dollar amerikan (ar) me 84,6 lekë etj.. Kursi i këmbimit të valutave të huaja në lekë u caktua për 1 dollar amerikan 50 lekë, për 1 lirë stërlinë 201,5 lekë, për 1 dinar jugosllav 1 lek etj..

Në shtator të vitit 1947, në bazë të urdhëresës nr.45, datë 04.09.1947 ndalohet eksportimi dhe importimi i kartëmonedhave dhe i monedhave metalike shqiptare.

Në bazë të dekretit nr.936, datë 28.09.1949 Banka e Shtetit Shqiptar vuri në qarkullim emisionin e ri në lekë, në këmbim të emisionit të vitit 1947. Këmbimi u bë i lirë, pa asnjë kufizim dhe në raportin 1 lek i vjetër me 1 lek të ri. Këmbimi u bë nga data 1-7 tetor 1949. Kartëmonedhat e reja të vëna në qarkullim ruajtën prerjet e emisionit të vitit 1947, ndërsa monedhat metalike me prerje 5, 2, 1 dhe 0,5 lekë nuk u këmbyen dhe vazhduan të mbeten në qarkullim. Gjithashtu, u ndalua eksportimi nga Shqipëria dhe importimi në Shqipëri i monedhës lek, në çfarëdo sasive dhe prerjeje.

Kartëmonedhat e emisionit të vitit 1949, me të njëjtat pamje u rishtypën edhe në vitin 1957, duke ndryshuar vetëm vitin nga 1949 në vitin 1957.



Këmbimi i monedhës në vitin 1965, u bë në bazë të dekretit nr. 4028, datë 14.07.1965 dhe u realizua nga data 16 gusht deri më 15 tetor të këtij viti. Këmbimi i monedhës së vjetër në lekë me monedhën e re në lekë, u bë në përpjesëtim 10 lekë të vjetra me 1 lek të ri, pa asnjë kufizim. Banka e Shtetit Shqiptar autorizohet të heqë gradualisht nga qarkullimi monedhën e vjetër në kartëmonedhë me prerje prej 1000, 500, 100, 50 dhe 10 lekë, si dhe monedhën metalike prej 5, 2, 1 dhe 0,50 lekë të viteve 1947, 1949 dhe 1957, dhe të vinte në qarkullim monedhën e re në kartëmonedhë me prerje prej 100, 50, 25, 10, 5, 3 dhe 1 lek dhe monedhën metalike prej 1 lek, 50, 20, 10 dhe 5 qindarka të vitit 1964. Kartëmonedhat me të njëjtat pamje u rishtypën edhe në vitin 1976, duke ndryshuar vetëm vitin nga 1964 në 1976.

Nga 16 gushti 1965, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve, pagat e punës, pensionet, bursat, tatimet e taksat dhe çdo veprim tjetër financiar midis ndërmarrjeve, institucioneve e organizatave shtetërore, kooperativiste e shoqërore ose i shtetasve llogariteshin me monedhën e re, sipas raportit 10 me 1.

## **2 gusht 1946**

Miratohet dekreti nr.100, datë 02.08.1946. Bankës së Shtetit Shqiptar i ngarkohet edhe kryerja e shërbimeve për thesarin e shtetit .

### *Shërbimet për thesarin e shtetit*

Me dekretin nr.100, datë 2 gusht 1946, Bankës së Shtetit Shqiptar iu ngarkua edhe **kryerja e shërbimeve të thesarit të shtetit**, për arkëtimin e të ardhurave dhe për kryerjen e shpenzimeve të shtetit. Banka ka detyrimin të mbajë llogari e depozita për llogari të shtetit, ndërsa ngarkohet edhe me mbajtjen e kontabilitetit, me çeljen e kredive dhe me lëvizjen e përgjithshme të fondeve, si dhe me mbikëqyrjen për rregullshmërinë e veprimeve. Para daljes së këtij dekreti zbatimi i buxhetit të shtetit nga pikëpamja e arkës ndiqej nga seksioni i financës, i cili kishte të drejtë të mbante mjete monetare në masën që e shikonte të nevojshme.

Me dekretin nr.101, datë 03.08.1946, Bankës së Shtetit Shqiptar iu ngarkua kryerja e shërbimit të arkës së përgjithshme të shtetit. Çdo ndërmarrje dhe institucion shtetëror detyrohet të derdhë menjëherë në arkën e Bankës së Shtetit Shqiptar të gjitha paratë, të depozitojë letrat me vlerë dhe sendet e çmuara në përdorim ose në ruajtje. Pas kësaj mase, të gjitha pagesat për shërbimet e shtetit, për ndërmarrjet dhe për institucionet shtetërore realizohen nga Banka e Shtetit Shqiptar, kurse marrëdhëniet financiare të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore rregullohen brenda kufijve të gjendjes së llogarive të tyre në bankë me anën e xhirimeve në llogari nëpërmjet Bankës së Shtetit Shqiptar.

Para daljes së këtij dekreti ndërmarrjet dhe institucionet e ndryshme kishin të drejtë të mbanin në arkat e tyre mjete monetare pa asnjë kufizim në shumë dhe në kohë. Gjithashtu, format e pagesave midis tyre, me para në dorë apo me xhirim në llogari ishin fakultative.

Krijimi i arkës së përgjithshme të shtetit pranë Bankës së Shtetit Shqiptar pati një rëndësi të madhe, pasi krijoi kushte që banka të mobilizonte mjetet monetare përkohësisht të lira të ndërmarrjeve, të organizatave kooperativiste dhe të institucioneve, dhe t'i përdorte ato për dhënie kredish.

Me dekretin nr.440, datë 08 gusht 1947, Bankës së Shtetit Shqiptar krahas kryerjes së funksionit si arkë e përgjithshme e shtetit iu ngarkua edhe kontrolli mbi pagesat e shpenzimeve që i përkisnin buxhetit të shtetit dhe ndërmarrjeve për financimin e ekonomisë dhe të investimeve e meremetimeve të mëdha. Banka kishte të drejtë të kontrollonte në vend dhe të merrte pjesë në kolaudimin e veprave të ndërtimit, si dhe të kërkonte paraqitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për kryerjen e këtij kontrolli.

### **3 gusht 1946**

Miratohet dekreti nr.101, datë 03.08.1946. Bankës së Shtetit Shqiptar i ngarkohet kryerja e shërbimit të arkës së përgjithshme të shtetit.

#### **ROLI I BANKËS SË SHTETIT SHQIPTAR NË FUSHËN E PAGESAVE**

##### **1.Sistemi, organizimi dhe format e pagesave me xhirim në llogari**

*Sistemi i pagesave me xhirim në llogari është tërësia e normave, e kushteve dhe e kriterëve bazë që rregullojnë marrëdhëniet e pagesave midis ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore, institucioneve dhe organizatave politike e shoqërore, si dhe marrëdhëniet e pagesave midis këtyre dhe organeve financiare. Ai organizohet dhe drejtohet në mënyrë të centralizuar nëpërmjet Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*Organizimi i pagesave me xhirim në llogari ka të bëjë me përcaktimin e rregullave bazë, të detyrueshëm për t'u zbatuar nga ndërmarrjet, nga institucionet dhe nga degët e Bankës.*

*Në bazë të dekretit nr.101, datë 3 gusht 1946, marrëdhëniet financiare midis ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore rregullohen nëpërmjet Bankës së Shtetit Shqiptar. Rregulla të plotë për sistemin e pagesave janë përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë, 16.12.1964, si dhe në ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11 mars 1985.*

*Pagesat me xhirim në llogari klasifikohen sipas disa kriterëve të caktuara.*

*Së pari, sipas qëllimit për të cilin kryhen, grupohen në pagesa që kanë të bëjnë me shitblerjen e produkteve të mallrave dhe në përgjithësi të vlerave materiale, për kryerjen e shërbimeve të punimeve etj.; në pagesa për plotësimin e detyrimeve që lindin midis ndërmarrjeve dhe institucioneve, nga njëra anë, dhe sistemit financiar e të kreditit për derdhjet në buxhet dhe për shlyerjen e kredive, nga ana tjetër etj..*

*Së dyti, sipas burimit të mjeteve që përdoren grupohen në pagesa, që kryhen nga mjetet që kanë ndërmarrjet në llogaritë e tyre likuiduese ose rrjedhëse pranë bankës; pagesa që kryhen nga fondet buxhetore, të cilat u jepen institucioneve për të plotësuar detyrat e parashikuara në planet e tyre dhe në pagesa, që kryhen nga krediti bankar.*

*Së treti, sipas vendit ku ndodhen ndërmarrjet dhe institucionet, si dhe degët e Bankës me të cilat ato kanë lidhje, grupohen në pagesa brenda juridiksionit ku vepron dega e bankës dhe në pagesa jashtë juridiksionit ku vepron dega e bankës. Pagesa brenda juridiksionit të degës së bankës quhen ato pagesa që kryhen midis ndërmarrjeve shitëse dhe blerëse, të cilat llogaritë i mbajnë në të njëjtën degë banke, ndërsa pagesa jashtë juridiksionit, ku vepron dega e bankës, quhen ato që kryhen midis ndërmarrjeve shitëse dhe blerëse, të cilat i kanë llogaritë në degë të ndryshme të bankës.*

*Të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet janë të detyruara të mbajnë mjetet e tyre monetare në llogaritë përkatëse pranë bankës, të cilat përdoren vetëm me urdhër të tyre. Mjetet monetare në llogaritë likuiduese ose rrjedhëse mund të përdoren edhe me iniciativë të bankës: kur vihet në zbatim një titull ekzekutiv, kur urdhëron organi drejtues administrativ i ndërmarrjes, kur urdhëron organi shtetëror për zbatimin e dispozitave mbi nxjerrjen e të ardhurave shtetërore, për likuidimin e faturave të paraqitura me kërkesë arkëtimi të ndërmarrjes ose të institucionit dhe të pranuar prej tyre, për shlyerjen e interesit bankar, për shlyerjen e kredisë bankare së cilës i ka kaluar afati etj..*

*Me iniciativë të bankës përdoren edhe mjetet e llogarive buxhetore të caktuara për financimin e investimeve. Banka nuk mund të prekë me iniciativën e saj mjetet monetare që kanë ndërmarrjet dhe institucionet e ndryshme në llogaritë e tyre, kur nga ana e tyre është paraqitur kërkesë me shkrim për rezervim fondesh të nevojshme për pagimin e pagave, për kontributin e sigurimeve shoqërore shtetërore dhe çdo ndalesë tjetër nga pagat.*

*Format e pagesave që përdoren me anë të bankës janë: me kërkesë arkëtimi të pranuar, me urdhër xhirimi, me pagesë të planifikuar dhe me kompensim të detyrimeve.*

*Pagesa me kërkesë arkëtimi të pranuar. Pagesa me kërkesë arkëtimi të pranuar është forma kryesore e pagesave me xhirim në llogari. Pranimi është pëlqimi që ndërmarrja ose institucioni blerës i jep bankës për pagimin e kërkesës së arkëtitimit të bërë nga shitësi. Pranimi bëhet duke u mbështetur në dokumentet që paraqiten për arkëtim në bankë dhe jo mbi mallrat.*

*Pagesa me kërkesë arkëtimi të pranuar kryhet në tre mënyra: me pranim në heshtje, me pranim me shkrim dhe me pranim të mëvonshëm.*

Pagesa me kërkesë arkëtimi të pranuar në heshtje ose me shkrim përdorej kryesisht në marrëdhëniet midis ndërmarrjeve dhe institucioneve, që shërbeheshin nga degë të ndryshme të bankës, pa përjashtuar edhe mundësinë për marrëdhëniet midis klientëve të të njëjtës degë banke. Pranimi në heshtje është më i përhapur, pse shmanj korrespondencën e panevojshme midis klientëve me bankën. Pranimi në heshtje, nënkupton që klienti debitor (blerësi) pranon të kryejë pagesën pa qenë nevoja të njoftojë për këtë bankën, me kalimin e afatit të caktuar prej saj në çdo dokument të paraqitur. Krahas pranimit në heshtje përdoret rrallë edhe pranimi me shkrim, ku ndërmarrja blerëse duhet të njoftojë me shkrim bankën nëse është ose jo dakord, për të pranuar shumën sipas dokumenteve të paraqitura në ngarkim të saj.

Pagesa me kërkesë arkëtimi me pranim më të mëvonshëm përdoret për pagimin e kërkesës së arkëtitimit, kur shitësi dhe blerësi llogaritë i mbajnë në të njëjtën degë banke. Pranimi quhet i mëvonshëm, sepse ndërsa pagesa kryhet nga banka menjëherë, me paraqitjen e dokumenteve nga shitësi, brenda ditës ose ditën e nesërme punëtore, blerësi ka të drejtë të japë pëlqimin (të pranojë ose të mos pranojë) veprimet e bankës brenda afatit të caktuar në secilin dokument.

Kërkesa e arkëtitimit është dokumenti bazë me të cilin shitësi i dërgon bankës së blerësit për arkëtim faturat, situacionet, fletëdaljet, fletëngarkesat, procesverbalet e rakordimit etj., që përfaqësojnë shitblerje mallrash, punime e shërbime të kryera etj..

Blerësi ka të drejtë të mos pranojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e arkëtitimit vetëm në raste të përligjura dhe të mbështetura në dispozita ligjore.

Pagesa me urdhërshirim. Kjo formë pagese ka në bazë urdhërin që blerësi i jep bankës së vet për të paguar nga llogaritë e tij, një shumë të caktuar të shitësit për blerjen e mallrave, të shërbimeve etj..

Urdhërshirimi përdoret nga ndërmarrjet dhe nga institucionet edhe për derdhjen e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit, për krijimin e fondeve të investimeve, për shtesën ose për plotësimin e mungesës së mjeteve xhiruese, për derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore shtetërore, për xhirimin e depozitave të kursimit të punonjësve në favor të arkave të kursimit etj..

Për kryerjen e pagesës klienti urdhëruet plotëson dhe nënshkruan dokumentin (modularin) e parashtypur nga banka. Për pagesat me iniciativën e bankës, brenda kuadrit ligjor, dokumenti nënshkruhet prej saj dhe i bëhet i ditur klientit pages, menjëherë me kryerjen e pagesës, së bashku me nxjerrjen e llogarisë.

Pagesa të planifikuara. Kjo formë pagese me xhirim në llogari përdoret midis ndërmarrjeve dhe institucioneve, të cilat kanë marrëdhënie të përditshme ose të shpeshta midis tyre dhe kryhet në dy mënyra, me xhirim kuotash të planifikuara për periudha të caktuara dhe me paradhënie të planifikuara.

Mënyra e pagesës me xhirim kuotash të planifikuara për periudha të caktuara mbështetet në marrëveshjen që lidhet midis shitësit dhe blerësit, e cila duhet të pranohet edhe nga banka. Në marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Kjo formë ka si anë pozitive mënjanimin e lëshimit dhe të pagimit çdo ditë të faturave, ndërsa pagesa mund të bëhet me mjetet e blerësit ose me kredi bankare.

Marrëveshja vlen për bankën si autorizim për të xhiruar me iniciativë shumat përkatëse, nga llogaritë e blerësit në ato të shitësit, në shumat dhe në afatet e caktura. Shitësi i dërgon faturat përmbledhëse blerësit, pa kaluar nëpërmjet bankës. Diferencat e mundshme nga rakordimi periodik sistemohen nga palët, me urdhër të veçantë për bankën.

Në rast se në ditën e caktuar për pagesë blerësi nuk ka mjete të mjaftueshme për të plotësuar kuotën e caktuar, nuk kryhet pagesë pjesore dhe dokumentet mbahen në qenie (në portofol) deri në ditën kur krijohet gjendja e mjaftueshme në llogari. Në të tilla raste kuotat që vijnë më pas nuk ndryshojnë, por paguhen kur krijohet gjendja e mjaftueshme në llogari.

Mënyra e pagesës me paradhënie të planifikuara përdoret në marrëdhëniet e shitblerjes midis ndërmarrjeve shitëse dhe institucioneve buxhetore si blerëse. Institucionet buxhetore (spitalet etj.) në të tilla raste u japin ndërmarrjeve shitëse një paradhënie për furnizimin me mallra për një periudhë jo më tepër se 30 ditë, e cila caktohet sipas nevojave të përlllogaritura përafërsisht. Në fund të periudhës së caktuar, institucioni buxhetor dhe ndërmarrja shitëse bëjnë rakordimin e llogarive midis tyre. Në këtë rast ndërmarrja shitëse lëshon faturën në ngarkim të institucionit, i cili e likuidon atë tërësisht, duke lëshuar urdhërshirimin përkatës në emër të ndërmarrjes shitëse, pa i ndalur paradhënien. Në këtë mënyrë paradhënia mbetet në dispozicion të ndërmarrjes shitëse gjatë gjithë vitit dhe mbyllet detyrimisht vetëm në fund të vitit. Në vitin e ardhshëm paradhënia përsëritet në një masë më të madhe ose më të vogël sipas llogaritjeve të reja që bëhen.

Pagesa me kompensim të detyrimeve. Kjo formë pagese përdoret për shlyerjen e detyrimeve që lindin midis ndërmarrjeve për furnizime të ndërsjellta mallrash dhe materialesh, për kryerje punimesh e shërbimesh etj.. Në këtë rast ndërmarrjet në vend që t'i shlyejnë detyrimet që kanë midis njëra-tjetrës me anë të bankës për çdo veprim ekonomik, i shënojnë të drejtat dhe detyrimet në një llogari të vetme, të cilën e rakordojnë rregullisht midis tyre. Ndërmarrja debitore i paguan ndërmarrjes kreditore vetëm tepërcën neto të detyrimit të saj, që i mbetet pas kompensimit, jo më rrallë se një herë në muaj. Si dokument bazë për kryerjen e pagesës pranë bankës, shërben nxjerrja e llogarisë ose procesverbali i mbajtur për këtë qëllim dhe i pranuar nga të dyja ndërmarrjet, së bashku me urdhërshirimin.

Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë të ushtrojë kontrolle edhe në fushën e pagesave, si për kontrollin e dokumenteve, ashtu edhe në trajtimin e problemeve ekonomike e financiare të ndërmarrjeve me paaftësi paguese. Ajo analizon shkaqet dhe rekomandon masat që duhen marrë për të përmirësuar gjendjen, siç janë përgatitja në kohë e faturave dhe e situacioneve, paraqitja e tyre në bankë, shpërndarja e mallrave sipas planit, krijimi i kushteve të përshtatshme për mirëmbajtjen e mallrave në ruajtje për llogari të të tretëve, pavarësisht nga arsyet dhe likuidimin e kundërvleftës së mallrave të përdorur, mirëadministrimin dhe shpërndarjen e mallrave nga qendrat tranzite, sidomos në stacionet hekurudhore etj. .

## 2. Organizimi i pagesave ndërkombëtare

Pagesat ndërkombëtare i përshtaten marrëdhënieve tregtare me shtetet e tjera. Me disa vende përdoret pagesa me klering, me monedhë llogaritëse rublën ose dollarin, kryesisht me vendet e kampit socialist, ndërsa me disa të tjera, kryesisht vendet perëndimore, pagesat bëhen në valutë të lirë.

Për pagesat me klering Banka e Shtetit Shqiptar lidh marrëveshje bankare, në bazë dhe për zbatim të marrëveshjeve qeveritare. Secila nga bankat evidencën në llogarinë përkatëse transkacionet për vlerën e mallrave të importuar dhe të eksportuar, në valutën llogaritëse, si dhe detyrimet e tjera për transportin e jashtëm të këtyre mallrave, për shpenzimet e sigurimit gjatë transportit, si dhe për shpenzime të tjera me karakter tregtar e jotregtar.

Pagesat me valutë të lirë realizohen nëpërmjet bankave korrespondente të Bankës së Shtetit Shqiptar në disa shtete.

Format teknike kryesore të pagesave të përdorura në marrëdhëniet me vendet e tjera janë :

### Pagesa e menjëhershme.

Është zbatuar me të gjitha vendet e kleringut që përdorin si monedhë llogaritëse rublën. Ndërmarrja eksportuese e vendit përkatës paraqit në bankën e vet dokumentet që vërtetojnë nisjen e mallrave, e cila kur i gjen në rregull kryen menjëherë pagesën nëpërmjet llogarisë së kleringut, ndërsa dokumentet ia dërgon bankës së vendit të blerësit. Banka e blerësit regjistron, gjithashtu, menjëherë vleftën e dokumenteve në llogarinë klering dhe ia përcjell ato blerësit, i cili nga ana e vet, brenda 14 ditëve pune, ka të drejtë të reklamojë pagesën kur konstaton parregullsi në respektimin e kontratës nga shitësi.

### Pagesa me kredi dokumentare (akreditiv).

Është zbatuar me vendet që pagesat kryhen në valutë të lirë, si dhe me disa vende që marrëdhëniet tregtare e të pagesave kryhen në klering dhe, si monedhë llogaritëse është përdorur dollari amerikan.

Kredia dokumentare është angazhimi që merr banka me porosi të një blerësi, për t'i paguar shitësit një shumë, në një afat të caktuar dhe kundrejt paraqitjes së dokumenteve të caktuara, të cilat provojnë se malli është nisur në drejtim të blerësit. Kreditë dokumentare zakonisht bëhen të përvokueshme (që nuk mund të anulohen pa skaduar afati i pagesës ose pa pëlqimin e të dyja palëve), me qëllim që të garantohet pagesa.

Në veprimet me kredi dokumentare të gjitha palët e interesuara kanë si bazë dokumentet që parashikohen në të dhe jo mallrat. Megjithëse si bazë për çeljen e kredisë dokumentare është kontrata e shitjes, kredia dokumentare merr një karakter të pavarur prej saj dhe me çeljen e kredisë dokumentare të gjitha palët janë të detyruara të zbatojnë kushtet e kredisë.

### Pagesa me kërkesë arkëtimi (inkaso).

Kjo formë pagese është zbatuar kryesisht, për likuidimin e detyrimeve, që lindin midis shitësit dhe blerësit, për marrëdhënie të rastit ose për vlera relativisht të vogla, për të cilat nuk kërkohet nga shitësi çelja e kredisë dokumentare.

Sipas kësaj forme pagese, shitësi dërgon për arkëtim në bankën e vendit të blerësit, dokumentet që vërtetojnë nisjen e mallit ose dokumente të tjera justifikuese. Banka e blerësit i dorëzon dokumentet këtij të fundit dhe kryen pagesën vetëm me pëlqimin e tij, kundrejt pagesës së vleftës së mallit. Pra, pagesa me kërkesë arkëtimi nuk ka garanci nga ndonjë bankë për likuidimin e detyrimit.

### Forma të tjera të pagesave.

Forma të tjera të pagesave janë edhe ato me urdhërxhirimi dhe me çek, të cilat zënë një peshë të parëndësishme të pagesave dhe përdoren kryesisht për veprimet jotregtare edhe për eksportin e perimeve në Perëndim.

Banka e Shtetit Shqiptar, nëpërmjet kontrollit të saj mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme, ndihmon që në lidhjen e kontratave të përcaktohen drejt klauzolat, që kanë të bëjnë me mënyrën e pagesës, me qëllim që zbatimi i tyre praktik t'i shërbejë arkëtitimit të shpejtë të valutës dhe të ushtrohet një kontroll i fortë mbi dokumentacionin e eksport-importit.

### ***nëntor 1946***

Në bazë të një marrëveshjeje të veçantë, krijohet Banka Shqiptaro-Jugosllave, me qendër në Tiranë dhe me degë kryesore në Beograd. Fondi i Bankës u parashikua 6.000.000 franga i ndarë në 600 aksione emërore të patregtueshme (me vlerë emërore 10.000 franga për aksion), në përpjesëtimin 50 për qind për secilën palë.

Gjatë periudhës nga 24 shkurti deri në qershor 1947, pala shqiptare zbaton marrëveshjen dhe paguan detyrimet e veta për fondin e themelimit të bankës, me fonde të Ministrisë së Financave dhe me kredi të dhënë nga Banka e Shtetit Shqiptar. Deri në fund të qershorit të vitit 1947, shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave përfituan 10.430.000 franga kredi, kryesisht për shoqëritë e naftës, Shoqërinë e Minerave dhe për Shoqërinë e Hekurudhave.

Deri në tetor të vitit 1947, pala jugosllave nuk kishte derdhur pjesën e vet të kapitalit, ndërsa pretendonte se e kishte bërë një gjë të tillë.

### ***4 dhjetor 1946***

Miratohet dekreti nr. 184 "Për disa ndryshime në ligjin organik të Bankës së Shtetit Shqiptar".

### ***10 - 20 korrik 1947***

Zbatohet reforma e dytë monetare. Në bazë të kësaj reforme u hoqën nga qarkullimi kartëmonedhat e emisionit të Bankës së Shtetit Shqiptar, të emetuara në vitin 1946, si dhe kartëmonedhat dhe monedhat metalike, të emetuara nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë, të cilat ishin lënë përkohësisht në qarkullim. Banka e Shtetit Shqiptar emeton kartëmonedhën e re në lekë 10, 50, 100, 500 dhe 1000 lekë, si dhe monedhën metalike me prerje 0,50, 1, 2 dhe 5 lekë. Këmbimi u bë në raportin 1 frang baraz me 9 lekë ose baraz me 9 dinarë. Në këtë raport u vlerësuan edhe çmimet e mallrave, shërbimet publike e private, qiratë, pagat e punës, debi-kreditë, të ardhurat e shpenzimet, tatimet e taksat etj..



*Kartëmonedha 10 lekë e vitit 1947.*

### ***korrik 1947***

Caktohen kurset e reja për blerjen e arit dhe për këmbimin valutave të huaja. 1 napolon ar blihet me 326 lekë dhe 1 dollar amerikan (ar) me 84,6 lekë. Kursi i këmbimit të valutave ishte: 1 dollar me 50 lekë, 1 lirë sterlinë me 201.5 lekë, 1 dinar jugosllav me 1 lek shqiptar etj..

Realizohet unifikimi i doganave, i çmimeve dhe parifikimi i monedhave të dy vendeve: Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

## KONTROLLI BANKAR PËR FINANCIMIN E INVESTIMEVE THEMELORE

Në bazë të dekretit nr. 440, datë 08.08.1947, duke filluar nga 1 shtatori i këtij viti, krahas me funksionin si arkë e përgjithshme e shtetit, Bankës së Shtetit Shqiptar iu ngarkua edhe kontrolli mbi pagesat e shpenzimeve që i përkisnin buxhetit të shtetit dhe ndërmarrjeve për financimin e ekonomisë dhe të investimeve nën kufi, si dhe të meremetimeve të mëdha.

Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore ishin të detyruara të paraqitnin në bankë pasqyrën analitike për investimet vjetore të miratuara.

Banka financonte objektet që kishin projekte teknike dhe preventive të miratuara, dhe brenda kufijve të fondeve të planifikuara.

Banka kishte të drejtë të pezullonte financimin e investimeve në rastet kur konstatonte tejkalime të shpenzimeve të preventivuar ose kur mjetet ishin përdorur për ndërtime jashtë planit.

Banka ka të drejtë, gjithashtu, të kontrollojë në vend dhe të marrë pjesë në kolaudimin e veprave të ndërtimit.

Nga 1 janari 1950, në bazë të dekretit nr. 744, datë 26.11.1949, Banka e Shtetit Shqiptar u ngarkua edhe me financimin dhe kontrollin e ndërtimeve mbi kufi. Me miratimin e ligjit nr. 4021, datë 23.06.1965, kontrolli bankar për financimin e investimeve e meremetimeve u pezullua.

Në vitin 1976 Këshilli i Ministrave nxori urdhëresën nr.8, datë 15.11.1976 "Mbi studimin, projektimin, planifikimin dhe financimin e investimeve e të ndërtimeve themelore". Me këtë urdhëresë përcaktohen detyra konkrete për organet investitore, projektuese dhe zbatuese dhe për organet e planit, të financës dhe të Bankës.

Investimet dhe ndërtimet themelore dallohen në investime kufi dhe në investime nënkufi. Në këtë drejtim Banka e Shtetit Shqiptar ka për detyrë të njohë mirë rregullat dhe kompetencat e organeve të ndryshme shtetërore dhe të ekonomisë që lidhen me planifikimin dhe me miratimin e veprave, me projektimin dhe preventivimin, me sheshet e ndërtimit etj. dhe të kërkojë paraqitjen e dokumenteve të nevojshme para se të lejojë financimin e shpenzimeve të kryera. Banka e Shtetit Shqiptar kontrollon nëse vlefat e preventivit për çdo vepër ose grup veprash, sipas rastiit, përputhet me vlefat e miratuara në plan dhe nëse për çdo vepër janë siguruar burimet përkatëse të financimit. Për veprat e ndërtimit që do të kryhen nga ndërmarrjet e ndërtimit, banka duhet të kontrollojë përputhjen e të dhënave, të njoftuara nga investitori me planin e ndërmarrjes së ndërtimit.

Të dhënat mbi vlefatën e plotë të veprës, si dhe mbi afatin e fillimit të punimeve dhe përfundimin e veprës duhet të jenë të njëjta si në planin e investitorit edhe në atë të ndërmarrjes zbatuese. Detyra e bankës është t'i kontrollojë ato, pasi në rast të kundërt, ajo nuk lejon financimin e veprave apo të shpenzimeve që nuk janë parashikuar në plan.

Banka e Shtetit Shqiptar ka për detyrë të ndjekë në vazhdimësi zbatimin e planit të shtetit dhe dispozitat ligjore që rregullojnë investimet dhe ndërtimet themelore. Ajo ushtron kontroll mbi investitorët dhe mbi ndërmarrjet ndërtuese për respektimin e ligjshmërisë në financimin e investimeve dhe për krijimin e përdorimin e fondeve për financimin e tyre.

Plani i investimeve dhe i burimeve të financimit të tyre, që paraqitet në bankë nga investitori, përfshin, për çdo vepër, përveç vlefatës së plotë të ndërtim-montimit edhe fondet vjetore për makineri, pajisje dhe investime të tjera e studime që do të shpenzohen për veprën, si dhe burimet e financimit të tyre. Për kryerjen e kontrollit banka ka të drejtë të kërkojë edhe të dhëna të tjera që lidhen me financimin e investimeve dhe të ndërtimeve themelore.

Kontrolli bankar për financimin e investimeve dhe të ndërtimeve themelore është kontroll i dyanshëm, ai është kontroll dokumentar dhe kontroll në vend.

Kontrolli i bazuar vetëm mbi dokumentet që i paraqiten bankës është i pamjaftueshëm. Ai plotësohet me kontrollin në vend, aty ku ndërtohet vepra apo ku montohen makineritë dhe pajisjet e ndryshme. Këtu banka ushtron kontroll për të parë konkretisht organizimin e punimeve, zbatimin e projekteve, të grafikëve të punimeve, shkallën e mekanizimit të punimeve, cilësinë e punimeve, respektimin e normativave të harxhimit të materialeve, trajtimin e administrimit e materialeve në objekt etj..

Nëpërmjet kontabilitetit teknik që mbajnë ndërmarrjet e ndërtimit, Banka nxjerr problemet, që dalin nga evidentimi i shpenzimeve, për çdo objekt, të krahasuara me shpenzimet e pasqyruara në situacionet dhe bën vërejtjet e propozimet përkatëse dhe kërkon marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes lidhur me kryerjen e shpenzimeve dhe me respektimin e preventivit. Në raste të veçanta, kur e gjykon të nevojshme, banka bën edhe matje metrike të punimeve të raportuara, duke i krahasuar të dhënat e kontrollit të saj me ato që tregohen në situacionet e paraqitura. Kur banka konstaton shkelje të projektit, faturime për punime të pakryera, punime me cilësi të dobët etj. ajo ndërpret financimin dhe kërkon ndreqjen e të metave të vërtetuara.

*Banka e Shtetit Shqiptar nuk lejon tejkalimin e vleftave të plota të veprave, të fondeve vjetore të planifikuara në zërat përkatës të investimeve të depozituara nga investitori, përdorimin e fondeve të një vepre për qëllime të tjera, kryerjen e investimeve që nuk janë në planin e shtetit, përdorimin e mjeteve të veta xhiruese për investime, kryerjen e punimeve pa projektzbatim dhe preventiv përfundimtar etj.. Për shkeljen e dispozitave bankës i është dhënë e drejta të ndërpresë financimin e mëtejshëm të investimeve e të ndërtimeve dhe të kërkojë nga organet përkatëse marrjen e masave ndaj shkaktarëve.*

*Financimi i investimeve bëhet në bazë të situacioneve periodike dhe përfundimtare, progresiv nga fillimi. Për veprat që përbëhen nga disa nënvepra, situacioni përfundimtar hartohet me dorëzimin e secilës nënvepre dhe jo në përfundim të të gjithë veprës.*

*Për rëndësinë që kishin investimet në sektorin e naftës, Bankës së Shtetit Shqiptar iu caktuan detyra të posaçme. Ajo kryen financimin e punimeve të shpim-kërkimit dhe të shpim-shfrytëzimit vetëm mbi bazën e dokumentacionit të nevojshëm. Kur plotësohet metrazhi i projektuar i shpimit dhe për aritjen e rezultetit kërkohet shpimi i mëtejshëm, banka e financon këtë vetëm pasi të jetë gjykuar për përparimin e shpimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për pusët dublorë. Kontroll të fortë ushtron banka veçanërisht mbi avaritë gjatë shpimit që shkaktojnë humbje të kohës dhe ulje të ritmeve të shpimit, si dhe mbi planifikimin e drejtë të shpejtësisë së shpimit metër-sondë-muaj, që është tregues bazë i ndërmarrjeve të shpimit. Kontroll ushtrohet edhe për përvetësimin e shpejtë të puseve, për përpunimin e rezultateve dhe për vënien e tyre sa më parë në shfrytëzim etj.. Gjithashtu, banka bën vërejtje e propozime edhe për pikat e shpimit të puseve të kërkimit, duke kërkuar që për shpimin e një pusi të jenë kryer të gjitha llojet e studimeve gjeologjike, sizmografiometrike etj., dhe kur të dhënat e këtyre studimeve nuk janë bindëse, ajo kërkon kryerjen e studimeve plotësuese.*

*Banka e Shtetit Shqiptar për ndërmarrjet e sistemit të naftës ka të drejtë të kërkojë, përveç dokumenteve të përcaktuara sipas rregullave në fuqi, edhe grafikun e punimeve të shpimit, si edhe ndryshimet e mëvonshme, projektet teknike e preventivat e shpimeve për pusët e veçanta të kërkimit dhe për grup-pusësh të shfrytëzimit 10 ditë para fillimit të punimeve, si edhe planin e përvetësimit të objekteve të veçanta të puseve, para fillimit të punimeve, një kopje të aktit të marrjes në dorëzim të puseve dhe të objekteve të tjera.*

### **8 gusht 1947**

Miratohet dekreti nr.440, datë 08.08.1947. Banka e Shtetit, krahas funksionit si arkë e përgjithshme e shtetit ngarkohet edhe me kontrollin mbi pagesat e shpenzimeve që i përkisnin buxhetit të shtetit dhe ndërmarrjeve, për financimin e ekonomisë nga fondet e investimeve dhe meremetimeve të mëdha. Banka kishte të drejtë të kontrollonte në vend dhe të merete pjesë në kolaudimin e veprave të ndërtimit si dhe të kërkonte paraqitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për kryerjen e këtij kontrolli.

### **gusht 1947**

Ndërmerren hapa për përsosjen e mëtejshme të detyrave dhe të të drejtave të Bankës së Shtetit Shqiptar për kryerjen e shërbimit për arkëtimin dhe pagesat midis ndërmarrjeve, institucioneve shtetërore, kooperativave etj.. Shërbimi i arkëtimit dhe i pagesave bëhet me kërkesë ose me urdhër të klientëve. Banka ushtron kontroll mbi ndërmarrjet dhe dikasteret për kryerjen e shpenzimeve. Ajo ka të drejtë të vendosë marrëdhënie me banka të shteteve të tjera, si dhe të kryejë shërbimin e arkëtimit dhe të pagesave me jashtë shtetit për llogari të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore, të kooperativave dhe të privatëve. Banka e Shtetit Shqiptar u bë i vetmi organ që grumbullonte mjetet e lira të ndërmarrjeve shtetërore, të kooperativave dhe të popullsisë, në llogari dhe në depozita.

### **shtator 1947**

Ndalohet eksportimi dhe importimi i kartëmonedhave dhe i monedhave metalike shqiptare. Në dhjetor të këtij viti lihet i lirë eksportimi dhe importimi i lekëve dhe i dinarëve nga Republika Popullore Shqiptare në Republikën Federale Popullore Jugosllave dhe e kundërta. Zotëruesit e tyre përjashtohen nga detyrimi i denoncimit.

## SISTEMI I KREDITIT BANKAR

### 1. Hapat e parë për krijimin e sistemit të kreditit bankar

Në vitin e parë të veprimtarisë së saj Banka e Shtetit Shqiptar kreditonte sektorin privat të ekonomisë, kryesisht për tregtarët. Kreditë e dhëna për periudhën mars 1945 - mars 1946 paraqiten si më poshtë:

	Gjithsej	Në përqindje		
		Spektori shtetëror	Spektori kooperativist	Spektori privat
Mars-shtator 1945	100	-	-	100
Dhjetor 1945	100	5	-	95
Janar 1946	100	8	8	84
Shkurt 1946	100	23	2	75
Mars 1946	100	35	2	63

Në fund të vitit 1946 sektori shtetëror dhe ai kooperativist përfituan 98 për qind të kreditit, ndërsa sektori privat vetëm 2 për qind.

Nga muaji shtator i vitit 1948, në bazë të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 20.09.1948. Në sistemin e ri të kreditit bankar u vendosën parimet bazë të kreditit bankar, sipas të cilave ndërmarrjeve ekonomike shtetërore dhe organizatave të tjera ekonomike krediti u jepet brenda kufijve të kreditit të planifikuar për objekte të caktuara dhe për nevoja reale të dokumentuara; për çdo kredi të dhënë caktohen afate konkrete të kthimit, ndërsa kreditë e dhëna duhet të garantohen me mallra.

Plani i kreditit i Bankës së Shtetit Shqiptar u jep ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike vetëm të drejtën që të përfitojnë kredi për plotësimin e nevojave të tyre. Përdorimi i kësaj të drejte varet nga masa e plotësimit të planit të prodhimit dhe të qarkullimit të vlerave materiale Prandaj banka e jep kreditin gjithmonë brenda kufirit të planifikuar, por jo më tepër se shpenzimet e kryera në fakt.

Parimi i kthyeshmërisë në afat të kreditit bankar kushtëzohet objektivisht nga vetë procesi i rrethxhimit të fondeve xhiruese. Afatet e kthimit të kreditit janë të ndryshme dhe varen nga qëllimi i përdorimit të tij për mbulimin e nevojave të përkohshme të mjeteve xhiruese apo për mbulimin e nevojave të përhershme të tyre.

Parimi i garancisë së kreditit bankar me vlera të caktuara në materiale e mallra, lidhet drejtpërsëdrejti me qëllimin e përdorimit të kreditit.

Në vitin 1950, në krahasim me vitin 1947, krediti afatshkurtër për ndërmarrjet ekonomike shtetërore u rrit rreth 2 herë, për kooperativat e artizanatit mbi 13 herë, për kooperativat e konsumit e të shitblerjes rreth 7 herë dhe për kooperativat bujqësore 2,5 herë. Gjithashtu, u përmirësua edhe struktura e dhënies së kreditit bankar. Në vitin 1950 për sektorin e industrisë u përdor 22,9 për qind e kreditit, për atë të ndërtimit 4,2 për qind, për bujqësinë 3,1 për qind, për sektorin e tregtisë 44,8 për qind dhe për sektorët e tjerë shtetërore 25,0 për qind. Sektori shtetëror i ekonomisë zinte 63,6 për qind të kreditit afatshkurtër, ndërsa sektori kooperativist 36,4 për qind, kryesisht kooperativat e konsumit dhe ato të shitblerjes.

### 2. Krediti bankar afatshkurtër për ndërmarrjet

Për kreditimin e ndërmarrjeve janë përdorur forma teknike të ndryshme, të cilat kanë evoluar në periudha të ndryshme, në funksion të etapave të ndryshme që kalonte zhillimi ekonomik i vendit.

**Kreditimi për tepricë.** bëhet në varësi të gjendjes së vlerave të kreditueshme në materiale e mallra në një datë të caktuar, pa marrë parasysh qarkullimin e tyre gjatë periudhës pasardhëse. Kur rezervat e vlerave të kreditueshme në materiale e mallra për efekt të grumbullimit të tyre të planifikuar rriteshin, banka jepte kredi për mbulimin e kësaj mbinormative të planifikuar, ndërsa kur rezervat e vlerave të kreditueshme në materiale e mallra për efekt të përdorimit të tyre të planifikuar pakësoheshin, banka kërkonte në afate të caktuara shlyerjen e kreditit të dhënë. Mënyra e kreditimit për tepricë pati përdorim të gjerë në ndërmarrjet e sferës së prodhimit material.



**Kreditimi për xhiro**, bëhet duke marrë parasysh jo lëvizjen e tepcës së vlerave të kreditueshme të materialeve e të mallrave por xhiron e tyre, hyrjet dhe daljet eventuale të këtyre vlerave materiale. Për këtë qëllim ndërmarrjeve dhe organizatave u çelëj nga banka një llogari e veçantë, nëpërmjet së cilës bëheshin të gjitha pagesat për llogari të objektivit që kreditohej, pa marrë parasysh burimet financiare që destinoheshin për mbulimin e tij. Po kështu, të gjitha të ardhurat, nga shitja, kalonin në këtë llogari. Në kreditimin për xhiro respektimi i parimeve themelore të kreditit ndiqej në bazë të një procedure të veçantë, kur bëhej rregullimi i llogarisë speciale të kreditit në data të caktuara. Kjo mënyrë kreditimi përdorej kryesisht për ndërmarrjet dhe për organizatat ekonomike të sferës së qarkullimit.

Në përputhje me urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 07.12.1956, vendoset një formë e re kreditimi: **kreditimi i diferencuar**, i kushtëzuar kryesisht nga realizimi i detyrave të planit.

Për ndërmarrjet ekonomike shtetërore dhe për organizatat kooperativiste që plotësonin detyrat e planit (si planin e prodhimit në sasi, në asortiment e në cilësi, planin e grumbullimit, të shpërndarjes të qarkullimit të mallrave, fitimin e planifikuar, planin e uljes së kostos, rendimentin e punës etj.) kur ato ndodheshin në vështirësi financiare për arsye objektive, Banka u jepte kredi: për nevojat të përkohshme me afat maksimal 30 ditë; për pagimin e faturave e të situacioneve të pranuar me afat maksimal 25 ditë; për pagesën e pagave me afat maksimal 15 ditë etj..

Për ndërmarrjet ekonomike shtetërore dhe për organizatat kooperativiste, që nuk plotësonin detyrat e planit ekonomik dhe të planit financiar, banka jepte kredi nën garancinë e organit epror, brenda disponibiliteteve të saj, me një afat të caktuar në marrëveshje midis ministrisë e institucionit tjetër qendror dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar për ndërmarrjet kombëtare, dhe organeve drejtuese të pushtetit në qarqe e në rrethe dhe degëve të bankës për ndërmarrjet lokale.

Ndërmarrja me një gjendje të dobët ekonomiko-financiare për shkak të mosplotësimit të planit, regjistrohej në listën e ndërmarrjeve që punonin keq. Regjistrimi në këtë listë bëhej me vendim të komisionit të krijuar për këtë qëllim pranë bankës me pjesëmarrjen e kuadrove drejtuese të pushtetit në rrethe, kurse për ndërmarrjet në vartësi të ministrive merrej edhe miratimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar.

Kreditimi i ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme ka disa veçori mbasi atyre për rezervat e mallrave nuk i jepeshin mjete të veta xhiruese nga buxheti i shtetit dhe mbulimi i nevojave të tyre bëhej tërësisht me kredi afatshkurtër. Fillimisht krediti jepej për xhiro dhe bazohej në plotësimin e nevojave në çdo halkë të lëvizjes së mallit të eksportuar ose të importuar, me anë të kalimit nga një objekt krediti në një tjetër. Banka e Shtetit Shqiptar u jepte kredi afatshkurtër ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme, duke u bazuar në natyrën e punës së tyre. Kështu, ndërmarrjes së eksportit i jepej kredi për grumbullim mallrash për eksport, për mallra të nisur për eksport, për ngarkim-shkarkim mallrash; ndërsa ndërmarrjes së importit i jepej kredi afatshkurtër për importimin dhe transportimin e mallrave në valutë të lirë dhe për mallrat në port.

Ndërmarrjeve bujqësore krediti u jepet për sigurimin e rezervave stinore, për shpenzimet e procesit stinor të kulturave bimore, për shpenzimet e rritjes së gjësë së gjallë të destinuar për prodhim ose për shitje, për shpenzimet indirekte të bujqësisë e të blegtorisë etj.. Veçoria kryesore e kreditit afatshkurtër qëndron në faktin se dhënia dhe shlyerja e kreditit bëhej brenda vitit kalendarik dhe jo siç veprohej në sektorët e tjerë të ekonomisë, ku dhënia dhe shlyerja e kreditit bëhej brenda 12 muajve. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore për punimet e vjeshtës pajiseshin me mjete të veta xhiruese, kështu që për këto punime nuk u jepej kredi bankare.

Kreditë që jepte banka klasifikoheshin në tri lloje: në kredi të planifikuara, në kredi pagesash dhe në kredi të paplanifikuara. Kreditë e planifikuara u jepën ndërmarrjeve për të plotësuar planet e tyre të prodhimit e të qarkullimit. Kredi pagesash jepën për dokumentet në udhëtim, pa kufi për të gjitha ndërmarrjet, kurse kreditë e paplanifikuara lidhen me plotësimin e nevojave të përkohshme që u lindin ndërmarrjeve gjatë procesit të plotësimit të planeve, të cilat buronin nga shkaqet objektive që nuk vareshin prej tyre.

Me qëllim që krediti bankar të ndikonte sa më shumë në plotësimin e planeve ekonomike e financiare dhe të forcohej më tej kontrolli bankar me anë të lekut, duke filluar nga 1 janari i vitit 1957, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 05 shkurt 1957, plani i kreditit u bë plan direktiv për Bankën e Shtetit Shqiptar dhe miratohej çdo tremujor nga Këshilli i Ministrave. Bankës i ishte lënë e drejta që gjatë zbatimit të tij, nga tepricat e papërdorura, të bënte ndryshime nga një degë e ekonomisë në një tjetër.

*Në urdhëresën nr. 4, datë 5 tetor 1966, në zbatim të ligjit 4021, datë 23 qershor 1965 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar", duke përgjithësuar edhe përvojën e fituar, u përmirësuan rregullat, kriteret dhe mënyra e planifikimit të kreditit afatshkurtër.*

*Në vitin 1977, Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën nr.2, datë 15.03.1977 "Mbi kredinë me afat të shkurtër për ndërmarrjet" .*

*Plani vjetor i kreditit miratohej nga Këshilli i Ministrave, ndërsa Ministria e Financave, miratonte planin e kreditit për tepricën në fund të tremujorit, brenda kuotave vjetore të planifikuara. Për herë të parë u përcaktua procedura për hartimin, për shqyrtimin dhe miratimin e planit tremujor të kreditit. Procedura për hartimin e planit fillon që në ndërmarrje, në seksionet e komitetit ekzekutiv të rrethit dhe miratohet nga komiteti ekzekutiv i rrethit. Projektplani i miratuar nga komiteti ekzekutiv i dërgohet ministrive përkatëse dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar pas miratimit, planin e kreditit ua dërgon ministrive dhe komiteteve ekzekutive të rretheve.*

*Në tetor të vitit 1979, kjo procedurë u thjeshtua dhe plani i kreditit afatshkurtër për ndërmarrjet iu nënshtrua procedurës së hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të planit ekonomik dhe financiar, në përputhje me metodologjinë e planifikimit. Plani i kreditit bankar afatshkurtër hartohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar në bazë të projektplaneve të kreditit të dërguara nga ministrinë dhe nga institucionet e tjera qendrore, si vjetor dhe të ndarë në tremujorë sipas rretheve. Këshilli i Ministrave miratonte planin vjetor të kreditit për tepricë në fund të vitit, ndërsa Ministria e Financave para fillimit të vitit miratonte planin e kreditit ndarë në tremujorë, për tepricën në fund të çdo tremujori.*

*Nga viti 1982, në bazë të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.09.1982 "Për kreditin bankar" ndarja dhe miratimi i planit të kreditit në tremujorë bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, e cila ua dërgon për zbatim ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore sipas rretheve dhe degëve të Bankës, të ndarë sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore. Ministrinë dhe institucionet qendrore, u njoftojnë seksioneve përkatëse të komiteteve ekzekutive të rretheve planin e kreditit, si vjetor dhe të ndarë në tremujorë. Degët e Bankës në rrethe, së bashku me seksionet përkatëse të komitetit ekzekutiv të rrethit, bëjnë ndarjen e planit të kreditit, si vjetor dhe në tremujorë, për të gjitha ndërmarrjet e rrethit.*

*Në bazë të urdhëresës së mësipërme Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatshkurtër ndërmarrjeve për këto objekte:*

- a) për blerje e grumbullime materialesh e mallrash stinorë;*
- b) për të përbulluar shpenzimet e procesit stinor të prodhimit;*
- c) për materiale, për produkte të gatshme e mallra në ndërmarrjet e prodhimit, të ndërtimit, të tregtisë etj.;*
- d) për gjendjen e planifikuar të mallrave të eksportit në ndërmarrjet e tregtisë së jashtme;*
- e) për gjendjen në fakt të mallrave dhe të materialeve të importit në ndërmarrjet e furnizimit materialo-teknik;*
- f) për meremetime të mëdha, kundrejt fondit vjetor të amortizimit që do të krijohet sipas planit;*
- g) për situacione të paraqitura punëdhënësve për punime të kryera;*
- h) për mallra të nisur, punime e shërbime të kryera në drejtim të blerësve ose të porositësve që ndodhen jashtë juridiksionit të degës së Bankës;*
- i) për nevoja të përkohshme, kur gjykohet e nevojshme, jepet kredi për vlerat materiale, në formën e lëndëve të para, të materialeve kryesore, të materialeve ndihmëse, të lëndëve djegëse dhe të prodhimit në proces, që janë përkohësisht mbi nevojat e normuara të mjeteve xhiruese, për një periudhë të dhënë, të rrjedhura nga faktorë që nuk varen nga puna e ndërmarrjes, por që nuk përbëjnë vlera me qarkullim të ngadalshëm e stoqe dhe garantojnë kthimin e kreditit. Kjo kredi jepet nga dega e Bankës për një afat deri në gjashtë muaj.*

*Banka e Shtetit Shqiptar, kur vëren se ndërmarrjet blejnë ose prodhojnë materiale e mallra të planifikuar ose mbi plan, të cilat mund të shndërrohen në mbinormative, me qarkullim të ngadalshëm ose stoqe, si edhe kur prodhohen me humbje të paplanifikuara, nuk jep kredi të mëtejshme për këto vlera materiale. Gjithashtu, ajo ka të drejtë të ndërpresë dhënien e mëtejshme të kreditit kur ai nuk është kthyer në afatin e caktuar, me përjashtim të rasteve për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për shpenzime stinore të prodhimit, për meremetime të mëdha kundrejt fondit të amortizimit, që do të krijohet sipas planit dhe për mallra të nisur, por gjithmonë brenda planit të kreditit për çdo ndërmarrje.*

Gjithashtu, Banka e Shtetit Shqiptar kur konstaton se krediti nuk është përdorur për qëllimin e dhënë ka të drejtë të ndërpresë menjëherë kreditimin e mëtejshëm dhe të kërkojë kthimin para afatit të kreditit të dhënë. Njëkohësisht kur krediti nuk kthehet në afat ose nuk garantohet me vlera materiale ka të drejtë të ndërpresë, të kufizojë dhënien e mëtejshme të kreditit ose të kërkojë kthimin e menjëhershëm të tij. Për kreditin e pakthyer në afat interesi bankar dyfishohet.

Miratohet urdhëresa nr.3, datë 25 maj 1990, e Këshillit të Ministrave. Banka e Shtetit Shqiptar mund t'u japë ndërmarrjeve që merren me tregti të jashtme dhe atyre që prodhojnë për eksport kredi afatshkurtër dhe afatgjatë në valutë të lirë për këto qëllime:

- a) për të shfrytëzuar koniukturën e favorshme të çmimeve të importit, sidomos të atyre me karakter stinor dhe për të blerë e rishitur mallra me fitim në valutë të lirë;
- b) për të nxitur shtimin e prodhimit të mallrave për eksport ose të artikujve të rinj, kur kanë treg shitjeje në valutë të lirë;
- c) për të blerë disa mallra importi të konsumit të gjerë, shitja e të cilave krijon të ardhura shtesë në valutë;
- d) për të blerë mjete, makineri, pjesë ndërrimi e materiale importi që shërbejnë për rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat ndikojnë në shtimin e të ardhurave në valutë të lirë;
- e) për linja, makineri e pajisje që përmirësojnë procesin teknologjik të prodhimit në degë të ndryshme të ekonomisë, nëpërmjet të cilave kursehen fondet valutore të importit;
- f) për raste të tjera që do të gjykohen me leverdi nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Në bazë të urdhëresës nr.6, datë 25.05.1990 "Për kreditin bankar", Banka e Shtetit Shqiptar u jep ndërmarrjeve kredi afatshkurtër për plotësimin e planit të prodhimit, të shpërndarjes dhe të qarkullimit për këto qëllime:

a. për plotësimin me pjesëmarrje të nevojave të planifikuara të mjeteve xhiruese, pasi përcaktohet normativa e mjeteve të veta të xhros për elementet materiale, të llogaritura mbi bazën e nevojave të tremujorit më të vogël.

b. për nevoja të përkohshme, për tejkalimin e nevojave të planit, për përmirësimin e cilësisë, për vlera materiale që janë përkohësisht mbi nevojat e normuara të mjeteve të veta xhiruese, të rrjedhura nga faktorë që nuk varen nga puna e ndërmarrjes, por që nuk përbëjnë vlera materiale me qarkullim të ngadalshëm e stoqe.

### 3) Krediti bankar afatshkurtër për kooperativat bujqësore

Deri në vitin 1961, Banka e Shtetit Shqiptar u jepte kooperativave bujqësore kredi me afat të shkurtër për të përballuar shpenzimet e prodhimit bujqësor e blegtoral, kryesisht për blerjen e materialeve dhe për shërbimet nga të tretët.

Në vitin 1961, Banka e Shtetit Shqiptar eksperimentoi në disa rrethe dhënien e kreditit afatshkurtër për çdo muaj, kundrejt ditëve të punës të kryera efektivisht nga anëtarët e kooperativave bujqësore deri në masën 50 për qind të shumës së caktuar në planin financiar për një ditë pune.

Nga 1 janari i vitit 1965, kjo formë krediti u shtri për të gjitha kooperativat bujqësore, kurse masa e paradhënies u rrit deri në 65 për qind të shumës së caktuar në planin financiar, për një ditë-pune.

Kreditit kundrejt ditëve të punës jepet në ata muaj dhe për ato shuma që kooperativa bujqësore nuk përballonte nevojat me mjetet e saj. Për dhënien e kreditit kundrejt ditëve të punës të kryera mbaheshin parasysh disa kriterë kryesorë, siç ishte plotësimi i ditëve të punës të planifikuara; lidhja e kontratave me ndërmarrjet dhe me organizatat ekonomike për dorëzimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, ndërsa bëheshin kufizime për ditët e punës joproduuese.

Duke filluar nga 1 janari 1967, në bazë të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 05.10.1966, Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatshkurtër kooperativave bujqësore për të ndihmuar në rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe në zhvillimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike e social-kulturore të fshatit. Në bazë të planit vjetor të kreditit të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kooperativat bujqësore kreditohen:

- për të përballuar shpenzimet e nevojshme të procesit të prodhimit bujqësor e blegtoral, si për kryerjen e punimeve me mjete të mekanizuara nga SMT, për të blerë plehra kimike, insekticide, ushqim kafshësh, inventar të imët etj.;
- për të përballuar nevojat në para kundrejt të ardhurave që parashikoheshin të realizoheshin nga kooperativat bujqësore deri në masën 70 për qind të të ardhurave në para të planifikuara për t'u ndarë anëtarëve gjatë vitit;
- për të përballuar përkohësisht shpenzimet që ishin parashikuar të kryheshin nga fondi i pandarë që realizohej gjatë vitit.

Me krijimin e Bankës Bujqësore nga viti 1970, kreditimi i kooperativave bujqësore bëhet nga Banka Bujqësore.

#### 4) Krediti bankar afatgjatë për zgjerimin e prodhimit për ndërmarrjet

Kreditimi bankar afatgjatë në sektorin shtetëror të ekonomisë nuk përdorej, sepse financimi i investimeve përballohej tërësisht me mjetet e buxhetit të shtetit.

Nga shtatori i vitit 1956, në bazë të urdhërësës nr.13, datë 13 shtator 1956, Banka e Shtetit Shqiptar me qëllim që të ndihmonte për përdorimin e teknikës së re, për mekanizimin dhe përsosjen e teknologjisë së prodhimit, u jepte kredi afatgjatë ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike për të përballuar këto shpenzime kur nuk ishin parashikuar në planin e investimeve. Kreditimi afatgjatë për zhvillimin e teknikës së re jepej me një afat deri në 3 vjet dhe shlyhej nga shtimi i të ardhurave si efekt i uljes së kostos që do të realizohej nga mekanizimi, nga përmirësimi i teknologjisë së prodhimit etj.

Në vitin 1977, në bazë të urdhërësës së Këshillit të Ministrave, nr. 3, datë 15 mars 1977, ndryshuar me urdhërësën nr. 4 datë 21.09.1982, u rishikuan kriteret për dhënien e kreditit afatgjatë për zgjerimin e prodhimit në ndërmarrjet. Kredia afatgjatë për zgjerimin e prodhimit jepet deri në 50 mijë lekë në vit për çdo ndërmarrje nga dega e Bankës së Shtetit Shqiptar, sipas kërkesës së saj dhe deri në 100 mijë lekë nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, në bazë të kërkesës së ministrisë ose të institucionit tjetër qendror. Kredia jepej me afat deri në tre vjet, ndërsa shlyerja e saj bëhej nga fitimi i parashikuar në planin financiar.

Në bazë të urdhërësës nr.3, datë 25 maj 1990 të Këshillit të Ministrave, Banka e Shtetit Shqiptar mund t'u japë kredi afatgjatë në valutë të lirë ndërmarrjeve që merren me tregti të jashtme dhe atyre që prodhojnë për eksport kur këto kanë leverdi ekonomike, kur krijohen të ardhura shtesë në valutë ose ka efekte pozitive në pakësimin e shpenzimeve në valutë.

Në bazë të urdhërësës nr.6, datë 25.05.1990 " Për kreditin bankar ", Banka e Shtetit Shqiptar u jep ndërmarrjeve kredi afatgjatë për plotësimin e planit të prodhimit, të shpërndarjes dhe të qarkullimit për këto qëllime:

- investime të reja me karakter prodhues e shërbime dhe për rikonstruksione teknike e teknologjike të objekteve ekzistuese prodhuese, me përjashtim të investimeve që financohen nga buxheti i shtetit;
- investime që kanë lidhje me nismat që lindin gjatë vitit për zgjerimin e prodhimit, për mekanizimin dhe përsosjen e mëtejshme të teknologjisë së prodhimit.

#### 5) Krediti bankar afatgjatë për kooperativat bujqësore

Kooperativat bujqësore përfitojnë kredi kryesisht për investime me karakter prodhues, pa ndonjë kufi të caktuar pjesëmarrjeje. Parimi i pjesëmarrjes është respektuar në varësi me gjendjen ekonomiko-financiare për secilën kooperativë bujqësore në veçanti.

Kooperativat bujqësore përfitojnë kredi për këto objekte kryesore:

- për ndërtimin dhe për meremetimin e objekteve me karakter prodhimi (hangarë, stalla, depo, shtretër të nxehtë, sera, etj.);
- për ndërtimin e kanaleve dhe të veprave të tjera ujitëse e bonifikuese që u përkisnin vetë kooperativave bujqësore;
- për krijimin e blloqeve me dru frutorë, me ullinj, me vreshta, me agrume, si dhe për kryerjen e shërbimeve deri sa hynin në prodhim;
- për blerjen e makinerive e veglave të ndryshme bujqësore, të mjeteve të transportit, etj.;
- për çeljen e tokave të reja dhe për sistemime agrare dhe punime të thella me mjetet e mekanizuara të shtetit;
- për blerjen e farërave shumëvjeçare;
- për ndërtimin e veprave energjetike dhe për elektrifikimin e fshatit;
- për blerjen e kafshëve të punës dhe të prodhimit, të shpendëve, të bletëve dhe të zgjojeve.

Nga viti 1959, iu kushtua një vëmendje më e madhe planifikimit të kreditit, në mbështetje të planeve të kooperativave bujqësore dhe të mundësive të shtetit për t'i ndihmuar ato me kredi bankare.

Kreditë jepen sipas destinacionit, kundrejt dokumenteve që paraqiten në bankë nga të tretët.

Banka studionte dobën dhe leverdinë ekonomike të objekteve që aplikonin për kredi dhe kur nuk argumentohej, ajo kishte të drejtë të mos jepte kredi.

Me krijimin e Bankës Bujqësore nga viti 1970, kreditimi i kooperativave bujqësore me kredi afatgjatë bëhej nga Banka Bujqësore.

6) Krediti bankar për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve në qytet

Banka e Shtetit Shqiptar ka filluar të japë kredi afatgjatë për ndërtimin dhe për meremetimin e banesave nga viti 1950. Punonjësve u jepej kredi në masën deri 7.500 lekë me një afat kthimi deri 7 vjet.

Në vitin 1954, kredia u jepet punëtorëve, nëpunësve dhe anëtarëve të kooperativave të artizanatit në qytet, për ndërtimin e banesës deri në 70 për qind të vlefës së saj, por jo më shumë se 7.500 lekë dhe me afat kthimi deri në 15 vjet, ndërsa për meremetim, kredia jepet deri në 90 për qind të vlefës së meretimeve, por jo më tepër se 5.000 lekë, me afat kthimi deri në 8 vjet.

Duke filluar nga 1 janari 1959, krediti mund të jepet për të ndërtuar banesa të reja, për të mbaruar një banesë të filluar, si dhe për zgjerime dhe meretime banesash për punëtorët, për nëpunësit, për pensionistët, për anëtarët e kooperativave të artizanatit, si dhe personave që u shpronësohej banesa për nevojat e institucioneve, të ndërmarrjeve dhe të organizatave kooperativiste e shoqërore, ose u dëmtohej nga fatkeqësitë e natyrës, si dhe personave që u shëmbej banesa sipas planit rregullues të qytetit.

Krediti për ndërtim jepej deri në 25.000 lekë dhe me një afat kthimi gjer në 20 vjet, kurse për meremetim banesash krediti jepej gjer në 5.000 lekë dhe me afat kthimi gjer në 15 vjet. Dhënia e kreditit kushtëzohej me depozitën bankare, për një shumë prej jo më pak se 25 për qind të kreditit të kërkuar, e cila duhej të qëndronte në bankë si depozitë të paktën 6 muaj. Përrjashtoj nga ky kusht dhënia e kreditit për meremetimin e banesës kur ajo ishte e domosdoshme dhe e ngutshme.

Në vitin 1961, ndryshohet kufiri maksimal i kreditit për meremetimin e banesave private nga 5.000 lekë në 1.000 – 7.000 lekë, ndërsa afati i kthimit nga 15 vjet në 20 vjet. Banka e jepte këtë kredi pa kërkuar lënien e depozitës së caktuar. Për meremetimin e banesave private të dhëna me qira, kufiri maksimal i kreditit u rrit nga 5.000 lekë në 10.000 lekë, me një afat kthimi deri në 25 vjet. Gjithashtu, Banka e Shtetit Shqiptar filloi të japë kredi për ndërtimin e banesave private në qytetet kryesore, për punëtorët dhe nëpunësit, vetëm kur ata do të ndërtonin banesë në mënyrë kolektive, me dy ose më tepër kate, por jo më të vogla se për 6 familje.

Nga 1 janari 1963 caktohen kritere të reja për dhënien e kredisë për meremetimin e banesave. Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë t'u japë kredi afatgjatë pronarëve privatë për të meretur banesat në qytete, kur këto dëmtoheshin nga fatkeqësitë e natyrës ose nga shkaqe të tjera. Kredia jepej në masën deri në 7.000 lekë me afat kthimi deri në 20 vjet, kur në të banonte vetëm pronari dhe në masën deri në 10.000 lekë me afat kthimi deri në 25 vjet, kur banesa ishte dhënë me qira, tërësisht ose pjesërisht. Nuk jepej kredi për meremetimin e banesave private, kur sipas planit rregullues parashikohej të shembej brenda 5 vjetëve ose kur, sipas vlerësimit të komitetit ekzekutiv të rrethit, këto banesa ishin në gjendje të keqe që nuk lejonin meremetimin. Shtëpitë e meretuara me kredi nuk mund të shiteshin nga pronarët e tyre para se të shlyhej plotësisht kredia.

Në vitin 1966 u përmirësuan rregullat e kriteret për dhënien e kredisë afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit. Banka e Shtetit Shqiptar u jepte kredi afatgjatë punonjësve në qytet me afat deri në 20 vjet, në masën dhe për rastet e mëposhtme:

- deri në 15.000 lekë, për meremetimin, për zgjerimin dhe për adoptimin e banesave ekzistuese, si dhe për rindërtimin e tyre që dëmtoheshin nga fatkeqësitë;
- deri në 7.500 lekë punonjësve që shkonin nga qyteti në fshat, ku ka ose jo kooperativë bujqësore, për të meretur ose për të zgjeruar banesat e tyre personale.

Afatet konkrete të kthimit të kredisë të dhënë caktoheshin nga banka në marrëveshje me huamarrësin.

Shlyerja e kreditit për punonjësit që ishin në marrëdhënie pune, në marrëveshje me të, bëhej me ndalesa mujore nga paga dhe derdeshin në bankë nga qendra e punës ditën e tërheqjes së pagave.

Për kreditin e dhënë personave të ndryshëm, vihej hipotekë mbi banesën për të cilën ishte dhënë krediti. Shtëpitë e meretuara ose të rindërtuara me kredi nuk mund të shiteshin nga pronarët e tyre para se të ishte shlyer krediti i marrë nga banka.

Banka e Shtetit Shqiptar kishte të drejtë të ndërpriste përkohësisht ose përfundimisht dhënien e kreditit dhe të kërkonte me anë padie edhe kthimin para afatit të tij, kur vërtetohej se krediti shpërdorohej dhe nuk përdorej për qëllimin e caktuar.

Në vitin 1974, për objektet e kredisë afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit u bënë disa ndryshime, të cilat konsistonin kryesisht në rritjen e shumës së dhënies së kredisë. Gjithashtu, jepej kredi deri në 15 mijë lekë me afat shlyerjeje deri në 15 vjet për të përfunduar punimet e shtëpive të papërfunduara plotësisht deri në 31.12.1973, si dhe deri në 25 mijë lekë me afat shlyerjeje deri në 25 vjet, banorëve të qytetit, për përballimin e shpenzimeve që u takonin kur do të restaurohej shtëpia e tyre, që ishte shpallur monument kulture. Kredi nuk jepej kur, sipas planit rregullues të qytetit, shtëpia që do të meremetohej parashikohej të shembej brenda 10 vjetëve.

Në vitin 1977, në bazë të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr.4, datë 15 mars 1977, ndryshuar me urdhëresën nr.4, datë 21.09.1982, u vendosën kritere dhe rregulla të reja për dhënien e kreditit afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve në qytet .

Banka e Shtetit Shqiptar u jep kredi afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit:

a) punonjësve të qytetit për të meremetuar ose për të përshtatur shtëpitë ekzistuese, për t'i zgjeruar ato deri 20 metër katrorë sipërfaqe ndërtimi duke e mbështetur pjesën që ndërtohet në një faqe muri të shtëpisë ekzistuese ose dhe mbi 20 metër katrorë sipërfaqe ndërtimi, kur zgjerimi bëhet mbi katin e parë, por jo më shumë se sipërfaqja ekzistuese e këtij kati, deri në 15.000 lekë me afat kthimi deri në 15 vjet;

b) punonjësve të qytetit për restaurimin e shtëpisë së shpallur monument kulture, deri në 20.000 lekë, me afat kthimi deri në 20 vjet.

Kredi bankare afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit nuk jepet në këto raste:

- kur shtëpia në bazë të planit rregullues të qytetit do të priset brenda 10 vjetëve;
- kur shtëpia është jashtë vijës kufitare, me përjashtim të shtëpisë që është shpallur monument kulture dhe duhet të restaurohet;
- kur shtëpia është amortizuar mbi 70 për qind të vlefës së saj;
- kur nuk është kthyer plotësisht kredia e marrë më parë, me përjashtim të rasteve kur shtëpia është shpallur monument kulture ose është dëmtuar nga fatkeqësitë e natyrës;
- kur punonjësi në qytet, krahas punimeve me kredi, kërkon të ndërtojë njëkohësisht dhe ambiente të tjera banimi me shpenzimet e tij;
- kur ka filluar punime për zgjerimin ose për rindërtimin e shtëpisë ekzistuese ose për ndërtimin e shtëpisë së re me mjetet e veta.

Për herë të parë krediti afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit i nënshtrohet gjithë procedurës së planifikimit, si edhe treguesit e tjerë të planit, dhe nuk bëhet vetëm nga banka.

Në bazë të urdhëresës nr.6, datë 25 maj 1990 "Për kreditin bankar", Banka e Shtetit Shqiptar jep kredi afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve si më poshtë:

- punonjësve të qytetit për të meremetuar, për të përshtatur e për të zgjeruar shtëpitë ekzistuese deri në plotësimin e nevojave me sipërfaqe banimi, deri në 20 mijë lekë, me afat kthimi deri në 10 vjet;
- punonjësve të qytetit u jepet kredi e pjesshme për ndërtimin e banesave të reja vetjake jo më shumë se 50 për qind e vlefës së preventivit, deri 25 mijë lekë, me afat kthimi deri në 5 vjet.

Ecuria e kreditit bankar në sektorin shtetëror paraqitet si më poshtë :

Emërtimi	Në milionë lekë					
	1950	1960	1970	1980	1989	
<b>Gjithsej</b>	<b>192</b>	<b>1.261</b>	<b>2.721</b>	<b>6.501</b>	<b>6.402</b>	
1. Industria	44	521	1.082	2.508	2.069	
2. Ndërtimi	8	73	91	309	86	
3. Bujqësia	6	69	230	689	1.317	
4. Tregtia	86	427	870	1.987	1.476	
5. Degët e tjera të ekonomisë	38	51	64	296	231	
6. Mallra të nisur	10	120	284	1.223		
<u>Në përqindje</u>	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
1. Industria	22,9	41,3	39,8	38,6	32,3	
2. Ndërtimi	4,2	5,8	3,3	4,7	1,3	
3. Bujqësia	3,1	5,5	8,5	10,6	20,6	
4. Tregtia	44,8	33,9	32,0	30,6	23,1	
5. Degët e tjera të ekonomisë	19,8	4,0	6,0	4,6	3,6	
6. Mallra të nisur	5,2	9,5	10,4	19,1		

Struktura e kreditit afatshkurtër (teprica më 31 dhjetor) sipas sektorëve të ekonomisë paraqitet si më poshtë :

Emërtimi	Në milionë lekë					
	1950	1960	1970	1980	1989	
<b>Gjithsej</b>	<b>302</b>	<b>1.779</b>	<b>3.947</b>	<b>7.067</b>	<b>7.233</b>	
1. Sektori shtetëror	192	1.261	2.721	6.501	6.402	
2. Sektori kooperativist	110	518	1.228	566	831	
<u>Në përqindje</u>	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
1. Sektori shtetëror	63,8	70,9	68,9	92,0	88,5	
2. Sektori kooperativist	36,2	29,1	31,1	8,0	11,5	

Ecuria e kreditit afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve (teprica më 31 dhjetor) në qytet paraqitet si më poshtë :

#### Në milionë lekë

Viti 1960	29
Viti 1970	64
Viti 1980	94
Viti 1985	86
Viti 1989	83

#### shtator 1947

Banka e Shtetit Shqiptar jep kredi afatshkurtër për ndërmarrjet edhe për financimin e investimeve të planifikuara nga fondi i amortizimit, deri në shumën e amortizimit për t'u maturuar brenda tremujorit.

#### qershor 1948

Hidhet poshtë konventa shqiptaro-jugosllave mbi bashkimin doganor, unifikimin e çmimeve dhe parifikimin monetar.

## **Spiro BAKALLI**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
1948 - 1966*

*Datëlindja: 1 qershor 1912.*

*Vendlindja: Durrës.*

### **Shkollimi**

*Arsimi fillor: Korfuz, Greqi dhe më pas në Liceun Tregtar Torino- Itali.*

*Arsimi i Lartë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti Ekonomik.*

### **Eksperiencë Pune**

**1932 - 1942** nëpunës në Bankën e Punës Durrës (Banca Nazionale del Lavoro).

**1944 - 1948** funksione të ndryshme në administratën shtetërore, partiake si dhe në ushtri.

**1948-1966** Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar dhe njëkohësisht edhe Zëvendësministër i parë i Ministrisë së Financave.

**1966 - 1973** Zëvendësministër i parë i Ministrisë së Financave.



### **Veprimtari patriotike**

**1941 - 1944** Anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare 8 Nëntor 1941.

Anëtar i Grupit Komunist të Korçës, përgjegjës i celulës Durrës.

Sekretar politik i Qarkorit të Partisë Komuniste Shqiptare të Durrësit.

Pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacionalçlirimtare, me këto funksione: Nënkomandant i Çetës së Matit. Komisar i Grupit "Myzeqeja". Anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë. E para Qeveri e Pasluftës.

### **Të tjera**

Më 1973 del në pension për arsye shëndetësore.

Mban një varg medaljesh dhe dekoratash të Luftës dhe të Punës dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Vdes me 21 shkurt 1991.



### **20 shtator 1948**

Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën mbi sistemin e ri të kreditit.

Urdhëresa përcaktonte dhënien e kredive afatshkurtra dhe për qëllime specifike.

### **korrik 1949**

Bëhet emetimi i huave shtetërore. Gjatë periudhës 1949-1955, me dekrete të posaçme të Presidiumit të Kuvendit Popullor u emetuan katër hua shtetërore, si rezultat i të cilave, në buxhetin e shtetit u mobilizuan 158 milionë lekë, që u përdorën kryesisht për financimin e investimeve e të ndërtimeve themelore. Për huatë shtetërore shteti i paguante një interes prej 4 për qind në vit, me një afat shlyerjeje brenda 20 vjetëve.

Me dekretin nr. 891, datë 15.07.1949 u emetua huaja e parë shtetërore në shumën prej 250 milionë lekësh. Kjo hua u emetua për zhvillimin e ekonomisë me një afat njëzetvjeçar (1 mars 1949 -1 mars 1969).



*Huaja e parë shtetërore, 1949.*

Huatë shtetërore në vendin tonë u emetuan si më poshtë :

Viti	Emetimi i huave	Në milionë lekë (të reja)	
		Plotësimi	Në përqindje
14.7.1949	25	30	120
29.1.1952	30	42	140
1.3.1953	40	45	112
7.3.1955	40	41	102
Shuma	135	158	117

### **1 gusht 1949**

Krijohen **Arkat e Kursimit** në varësi të Bankës së Shtetit Shqiptar. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar u krijua Drejtoria e Arkave të Kursimit.

### **tetor 1949**

Hidhet në qarkullim kartëmonedha emetim i vitit 1949, në këmbim të emisionit të vitit 1947. Këmbimi u bë i lirë, pa asnjë kufizim dhe në raportin 1 lek i vjetër me 1 lek të ri, në datat 1-7 tetor 1949. Kartëmonedhat e reja, të vëna në qarkullim, ruajtën prerjet e emisionit të vitit 1947, ndërsa monedhat metalike me prerje 5, 2, 1 dhe 0,5 lekë nuk u këmbyen dhe vazhduan të mbeten në qarkullim.

Ndalohet eksportimi nga Shqipëria dhe importimi në Shqipëri i monedhës Lek, në çfarëdo sasive dhe prerjeje.

Kartëmonedhat e emisionit të vitit 1949, me të njëjtat pamje, u rishtypën edhe në vitin 1957, duke ndryshuar vetëm vitin nga 1949 në 1957.



*Kartëmonedhë e vitit 1949.*

### **nëntor 1949**

Bankës së Shtetit Shqiptar i njihet e drejta për të dhënë kredi afatgjatë për sektorin kooperativist për investime bujqësore, për të blerë vegla, makina e mjete transporti, për ndërtime etj., si dhe punëtorëve e nëpunësve të ndërmarrjeve ekonomike shtetërore për ndërtime banimi.

Kreditit afatgjatë jepej kryesisht për qëllime prodhuese, për zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë në kooperativat bujqësore, me afat kthimi deri në 18 vjet.

Në **vitin 1950**, Banka e Shtetit Shqiptar fillon të japë kredi bankare për ndërtimin dhe për meremetimin e ndërtesave private. Kredia u jepej punonjësve, deri në 7.500 lekë, me afat kthimi deri në 7 vjet.

#### *Kontrolli bankar i fondit të pagave*

*Me urdhëresën nr.8, datë 17.05.1952 të Këshillit të Ministrave "Mbi kontrollin e fondit të pagës" nga 1 korriku i këtij viti vendoset kontrolli bankar për përdorimin e fondit të pagave të punës të punonjësve të prodhimit në ndërmarrjet industriale, të minierave, të ndërtimit dhe në organizatat kooperativiste të prodhimit.*

*Në shtator të vitit 1957 dhe në mars të vitit 1959, bëhen përmirësime në dispozitat ligjore, duke e shtrirë kontrollin bankar për fondin e pagave edhe mbi punonjësit e administratës, në ndërmarrjet e prodhimit dhe të ndërtimit.*

*Në dhjetor të vitit 1960, Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën nr.13, datë 10.12.1960. Kontrolli bankar mbi fondin e pagave, u shtri edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë. Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë të ushtrojë kontroll për përdorimin e fondit të pagave të punës të punonjësve të prodhimit, të ndërtimit, të transportit dhe të tregtisë, në ndërmarrjet shtetërore dhe në organizatat kooperativiste të prodhimit dhe të tregtisë.*

Kontrolli bankar për përdorimin e fondit të pagave bëhet në bazë të disa kriterëve e rregullave të caktuara. Kështu, kontrolli bankar për përdorimin e fondit të pagave për punonjësit e prodhimit, të transportit dhe të tregtisë bëhet në raport me plotësimin e planit mujor të prodhimit, të transportit dhe të qarkullimit të mallrave, ndërsa për punonjësit e ndërtimit, të minierave e të gjeologjisë, që nuk kanë karakter prodhimi bëhet në bazë të planit mujor të fondit të pagave, brenda planit tremujor të fondit të pagës të miratuar.

Me urdhëresën nr.1, datë 06.01.1976, të Këshillit të Ministrave "Mbi kontrollin bankar për përdorimin e fondit të pagave", dhe në vitin 1980, u përmirësua legjislacioni dhe u morën masa të reja për forcimin e kontrollit bankar. Kontrolli i fondit të pagave bëhet në përputhje me treguesit e planit të prodhimit, të vlerës së përpunimit, të ndërtim-montimit, të qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve.

Banka e Shtetit Shqiptar kontrollon përdorimin e fondit të pagave në bazë të planit vjetor të miratuar dhe të detajimit që bëhet nga ministritë, nga institucionet e tjera qendrore dhe nga komitetet ekzekutive të rretheve, si dhe të ndryshimeve që ato mund të bëjnë gjatë vitit në bazë të kompetencave.

Në këtë urdhëresë përcaktohen edhe kriteret, rregullat dhe mënyra e kontrollit bankar në përdorimin e fondit të pagave. Ndërmarrjet që shpërblimin e punës e bëjnë me normë, kanë të drejtë që fondin e pagave për punëtorët që përfshihen në llogaritjen e rendimentit të punës, ta përdorin në përpjesëtim me plotësimin e treguesve të planit dhe duke respektuar rendimentin e punës së planifikuar; ndërsa, për punonjësit që nuk përfshihen në llogaritjen e rendimentit të punës në vlerë, kërkohet respektimi i kufirit të planit të fondit të pagave të miratuar. Mosplotësimi i fondit të pagave për punonjësit që nuk përfshihen në rendimentin e punës në vlerë, nuk mund të mblihdet me tejkalimin e fondit të pagave të punëtorëve, që përfshihen në llogaritjen e rendimentit të punës.

Ndërmarrjet që shpërblimin e punës e bëjnë me kohë dhe vend pune, kanë të drejtë të përdorin fondin e pagave deri në kufirin e planit të miratuar.

Caktimi i ndërmarrjeve ku kontrolli i fondit të pagave do të kryhet në raport me plotësimin e planit ose deri në kufirin e planit të miratuar bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar.

Me urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 11.12.1985, Bankës së Shtetit Shqiptar i njihet e drejta për kontrollin e fondit të pagave në të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet në përputhje me treguesit e planit.

Kontrolli bankar i fondit të pagave për ndërmarrjet bëhet mujor dhe tremujor, kurse për institucionet bëhet tremujor.

Përfshitim për ndërmarrje të veçanta, ku kontrolli bankar i fondit të pagave kryhet mujor dhe progresiv prej fillimit të vitit, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, në bazë të propozimit të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore përkatëse.

Kontrolli bankar i fondit të pagave për punëtorët që përfshihen në llogaritjen e rendimentit të punës, kryhet në përputhje me plotësimin e treguesve të planit të prodhimit, të ndërtim-montimit e të shërbimit (kontroll ekonomik), kurse për punëtorët që nuk përfshihen në llogaritjen e rendimentit të punës dhe për punonjësit që disiplinohen me organikë, kryhet në përputhje me planin e fondit të pagave të miratuara (kontroll kufi).

Kontrolli kryhet i veçantë për çdo degë të ndërmarrjes, në përputhje me treguesit e planit, me fuqinë punëtore, me rendimentin e punës dhe me fondin e pagave, të miratuar për të nga organet që i kanë në kompetencë.

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar cakton ndërmarrjet dhe degët e tyre për të cilat kontrolli i fondit të pagave kryhet në përpjesëtim me plotësimin e detyrave të planit (kontroll ekonomik) ose në përputhje me planin e fondit të pagave (kontroll kufi).

Mbishpenzimi në fondin e pagave si ndërmarrje, llogaritet duke mbledhur vetëm mbishpenzimet në fondin e pagave të degëve dhe të punonjësve që nuk përfshihen në rendimentin e punës, kurse kursimet në fondin e pagave për to nuk i zbriten shumës së mbishpenzimit.

Kursimi relativ në fondin e pagave i tremujorit të kaluar, nuk mund të përdorej në tremujorin në vazhdim dhe në tremujorët e ardhshëm.

Për ndërmarrjet ose për institucionet që dalin me mbishpenzim në fondin e pagave, që mbajnë punëtorë mbi plan të pajustificuar me rritjen e prodhimit, të ndërtim-montimit, të shërbimit ose mbi planin e miratuar, kur kontrolli kryhet kufi, si dhe kur prodhojnë mallra mbi plan, për të cilat nuk ka plan shpërndarjeje, degët e bankës pezullojnë përkohësisht pagat për drejtuesit dhe për punonjësit e degëve ose të zyrave të administratës së ndërmarrjes ose të institucionit.

*Pagat e pezulluara përkohësisht jepen nga dega e Bankës së Shtetit Shqiptar si më poshtë :*

1. *Për mbishpenzimin në fondin e pagave :*

- a) *Për muajin e parë të tremujorit, në bazë të autorizimit me shkrim të përgjegjës të seksionit përkatës të komitetit ekzekutiv të rrethit, pavarësisht nga varësia e ndërmarrjes.*
- b) *Për dymujorin, në bazë të autorizimit me shkrim të titullarit të komitetit ekzekutiv të rrethit, pavarësisht nga varësia e ndërmarrjes.*
- c) *Për tremujorin, në bazë të autorizimit me shkrim të titullarit të ministrisë ose të institucionit tjetër qendror, pavarësisht nga varësia e ndërmarrjes ose e institucionit.*
- d) *Kur ndërmarrja apo institucioni e thellon mbishpenzimin gjatë muajit, gjatë dymujorit dhe gjatë tremujorit pasardhës, ose nuk mbulon mbishpenzimin e tremujorit të mëparshëm deri në fund të tremujorit pasardhës, pagat paguhen në bazë të urdhërit të Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar, pasi të jetë autorizuar pagesa nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.*

2. *Për fuqinë punëtore mbi plan :*

- a) *Kur ndërmarrja mban punëtorë mbi plan për muajin, për dymujorin dhe për tremujorin, të papërligjur me rritjen e prodhimit, të ndërtim-montimit, të shërbimeve dhe me rendimentin e punës të planifikuar, ose mbi planin e miratuar kur kontrolli kryhet kufi, pavarësisht nëse del ose jo me mbishpenzim në fondin e pagave, në bazë të urdhërit të Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar, sipas kërkesës me shkrim të titullarit të ministrisë ose të institucionit tjetër qendror përkatës, ku të jenë përcaktuar shkaqet dhe masat për përmirësimin e gjendjes, brenda tremujorit në vazhdim.*
- b) *Kur ndërmarrja nuk e përmirëson gjendjen ose vazhdon të mbajë edhe gjatë muajit, dymujorit dhe tremujorit pasardhës, punëtorë mbi plan të papërligjur me rritjen e prodhimit, të ndërtim-montimit, të shërbimeve dhe me rendimentin e punës të planifikuar, ose mbi planin e miratuar kur kontrolli kryhet kufi, në bazë të urdhërit të Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar, pasi të analizohet gjendja dhe të autorizohet pagesa nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.*
- c) *Kur ndërmarrja prodhon mallra mbi plan, për të cilat nuk ka plan shpërndarjeje, në bazë të autorizimit me shkrim të titullarit të ministrisë ose të institucionit tjetër qendror përkatës.*

*Personeli drejtues administrativ, inxhiniero-teknik dhe ekonomik i ndërmarrjeve dhe i institucioneve ka përgjegjësi materiale, deri në një pagë mujore, kur ndërmarrja ose institucioni del me mbishpenzim të përsëritur në fondin e pagave dhe nuk ka arsye objektive të përligjura, mban në mënyrë të përsëritur punëtorë mbi plan e nuk i përligj me rritjen e prodhimit, të ndërtim-montimit, të shërbimit dhe të rendimentit të punës të planifikuar, ose mbi planin e fuqisë punëtore kur kontrolli kryhet kufi, si dhe kur prodhon mallra mbi plan, për të cilat nuk ka plan shpërndarjeje.*

*Masa e zhdëmtimit caktohet nga titullarët e ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, ose të komiteteve ekzekutive të rretheve, në bazë të dispozitave në fuqi.*

*Nga 01.07.1990, në bazë të urdhëresës nr.5, datë 25 maj 1990, kontrolli bankar në fondin e pagave për ndërmarrjet bëhet në raport me plotësimin e vëllimit në vlef të produktit mall industrial të shitur, ndërtimit, shërbimeve dhe qarkullimit të mallrave (kontroll ekonomik), kurse për institucionet buxhetore në përputhje me planin e fondit të pagave të miratuara (kontroll kufi).*

## **maj 1952**

Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën nr.8, datë 17.05.1952 "*Mbi kontrollin e fondit të pagës*". Duke filluar nga 1 korriku u vendos kontrolli bankar për përdorimin e fondit të pagave të punës të punonjësve të prodhimit në ndërmarrjet industriale, në miniera, në ndërtim dhe në organizatat kooperativiste të prodhimit.

### **tetor 1952**

Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën nr.34, datë 04.10.1952 "Mbi planin e arkës". Nga 1 tetori fillon hartimi i planit të arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar.

Gjatë vitit 1953, vëmendje i kushtohet analizës së punës së degëve, edukimit tekniko-profesional të punonjësve, kreditimit dhe kontrollit të kreditit bujqësor.

Kreditë e marra nga Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, Kina dhe vendet komuniste marrin rëndësi të veçantë.

#### *Plani i arkës i Bankës së Shtetit Shqiptar*

*Në bazë të urdhëresës nr.34, datë 04.10.1952 të Këshillit të Ministrave "**Mbi planin e arkës**" nga 1 tetori i këtij viti fillon hartimi i planit të arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*Plani i arkës hartohet tremujor. Ai pasqyron shumat e parave që arkëtohen dhe paguhen nga arkat e bankës, duke treguar burimin e të ardhurave dhe qëllimin e pagesave. Në plan përcaktohet edhe shtesa ose pakësimi i emisionit të monedhës në qarkullim për periudhën e planifikuar. Plani i arkës hartohet në bazë të treguesve të planit dhe të konsuntiveve të ndërmarrjeve ekonomike, të organizatave kooperativiste, të institucioneve e administratave shtetërore për të ardhurat dhe shpenzimet e tyre në para. Plani i arkës hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, e cila ia paraqit për miratim Këshillit të Ministrave.*

*Të gjitha ndërmarrjet ekonomike, organizatat kooperativiste, institucionet dhe administratat shtetërore që bënin arkëtime në para, detyrohen t'i derdhnin ato në arkat e bankës në afatin dhe në mënyrën e caktuar prej saj. Banka e Shtetit Shqiptar ngarkohet të organizojë tërheqjen brenda ditës të parave të arkëtuara nga ndërmarrjet ekonomike dhe nga organizatat kooperativiste. Për ndërmarrjet ekonomike që nuk kishin arkëtime në para, banka caktonte kufij që mund të mbanin në arkat e tyre për të përballuar kryerjen e shpenzimeve të vogla e urgjente në para.*

*Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.25, datë 05.02.1957 "**Mbi përpilimin e planit të arkës nga Banka e Shtetit Shqiptar**", i njihet e drejta*

*Ajo mund të bëjë pagesa edhe mbi parashikimet në planin e arkës, por brenda planit ekonomik të shtetit, duke njoftuar brenda 10 ditëve Këshillin e Ministrave. Kur në procesin e zbatimit të planit të arkës vërtetohen mosplotësime nga një sektor, banka ka të drejtë që tepricën e papërdorur për një lloj shpenzimi t'ia kalojë një sektori*

*Centralizimi, organizimi dhe planifikimi i qarkullimit monetar mbi bazat e mësipërme, bëri të mundur që të kalohet nga planet orientative e të përafërta, në planet e arkës direktive për Bankën e Shtetit Shqiptar, që miratohen çdo tremujor nga Këshilli i Ministrave dhe janë të detyrueshëm për zbatim nga të gjitha ndërmarrjet, organizatat kooperativiste dhe institucionet e ndryshme, si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet.*

*Në tetor të vitit 1966, Banka e Shtetit Shqiptar, ngarkohet të hartojë projektplanin vjetor të arkës, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave.*

*Me urdhëresën nr.5, datë 15.03.1977 të Këshillit të Ministrave "Mbi planin e arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar" synohet përsosja e mëtejshme e planifikimit të qarkullimit monetar dhe ngritja në një shkallë më të lartë e rolit dhe e ndikimit të Bankës së Shtetit Shqiptar, në drejtimin me plan të qarkullimit monetar dhe në forcimin e kontrollit bankar me anë të lekut. Për herë të parë, plani i arkës i Bankës së Shtetit Shqiptar pasqyron tërësisht nevojat e ekonomisë për mjete monetare dhe hartohet në mbështetje të treguesve të planit të shtetit, të buxhetit të shtetit dhe të bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve monetare të popullsisë.*

*Plani vjetor i arkës hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, i paraqesin Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar të dhënat e nevojshme për hartimin e planit të arkës, të ndarë në tremujorë.*

*Megjithatë, vazhdon procedura për hartimin, për shqyrtimin dhe për miratimin e planit tremujor të arkës, që fillon me hartimin e projektplanit të arkës nga ndërmarrjet, nga institucionet dhe nga organizatat shoqërore, në nivel lokal, i cili miratohet nga komiteti ekzekutiv i rrethit dhe i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*Në vitin 1979 procedura e hartimit, e shqyrtimit dhe e miratimit të planit të arkës u thjeshtua dhe u bë e njëjlojtë me procedurën që ndjekin të gjithë treguesit e tjerë të planit ekonomik dhe të atij financiar.*

Të ardhurat në para që arkëtonin ndërmarrjet, institucionet dhe kooperativat bujqësore nga shitja e mallrave, nga kryerja e shërbimeve, e punimeve dhe nga burime të tjera detyrohen t'i derdhin në Bankën e Shtetit Shqiptar ose në institucionet e tjera të caktuara prej saj, jo më vonë se dita e nesërme, me përjashtim të ditëve të diela dhe të festave zyrtare. Për njësitë e largëta, afatet e derdhjes së parave caktohen nga dega e Bankës, por këto nuk duhet të jenë më shumë se 7 ditë kalendarike nga dita e realizimit të tyre.

Për një dalje të rregullt të parave nga banka, për efekt të qarkullimit monetar, Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar cakton afate për pagimin e pagave të punonjësve.

Me urdhëresat e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 27 shkurt 1982 dhe nr.8 datë 11 dhjetor 1985, u përsosën më tej dispozitat që disiplinonin qarkullimin monetar.

Planifikimi i qarkullimit monetar përfshinte llogaritjen e sasisë së parasë që dilte nga arkat e Bankës së Shtetit Shqiptar për të përballuar nevojat e qarkullimit ekonomik, sasinë e parasë që kthehej në bankë, sasinë e parasë që mbetej në qarkullim dhe shpejtësinë mesatare të qarkullimi të parasë.

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar 10 ditë para fillimit të tremujorit i raportonte Këshillit të Ministrave për plotësimin e treguesve të qarkullimit monetar për tremujorin përkatës dhe propozonte detyra plotësuese për tremujorin pasardhës.

Në planin e arkës të Bankës së Shtetit Shqiptar, shpenzimet pasqyrojnë të ardhurat monetare të popullsisë ose fuqinë blerëse të saj, ndërsa të ardhurat pasqyrojnë shpenzimet monetare të popullsisë domethënë, mbulimin e fuqisë blerëse me mallra e shërbime të ndryshme.

Dinamika e të ardhurave dhe e shpenzimeve të planit të arkës dhe monedha në qarkullim në fund të pesëvjeçarëve paraqitet si vijon :

Vitet	Të ardhurat	Shpenzimet	Monedha në qarkullim 31.12 Në milionë lekë
1951-1955	5.234	5.286	147
1956-1960	9.137	9.255	265
1961-1965	12.793	12.798	270
1966-1970	17.644	17.936	562
1971-1975	25.838	25.947	671
1976-1980	32.830	32.882	723
1981-1985	40.096	40.346	972
1989			1.281

Ecuria e të ardhurave dhe e shpenzimeve të planit të arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar, sipas zërave, për vitet 1980, 1985 dhe 1989, paraqitet si më poshtë :

Emërtimi	1980	1985	1989
Në milionë lekë			
TË ARDHURAT GJITHSEJ	7.055	8.481	9.827
Qarkullimi i mallrave me para në dorë gjithsej	6.545	7.759	9.079

#### **Nga kjo :**

a) Tregtia shtetërore	5.662	6.631	7.882
- Ministria e Tregtisë së Brendshme	5.319	6.180	7.157
b) Kooperativat bujqësore	883	1.228	1.197
2. Shërbime jetese	333	390	451
3. Shtesa vjetore e depozitave të kursimit	40	85	88
4. Të tjera	137	247	209
SHPENZIMET GJITHSEJ	7.023	8.503	9.873
1. Pagat e punës të ndërmarrjeve dhe institucioneve	4.247	4.943	5.861
2. Pagat e punës të kooperativave bujqësore	1.592	1.961	2.059
3. Sigurimet shoqërore	641	993	1.285
4. Të tjera	543	606	668

### **janar 1954**

U emetua huaja e tretë shtetërore, për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në Shqipëri. Kjo hua u emetua për 20 vjet; 1 janar 1954 deri më 1 janar 1974. Obligacionet e huasë shtetërore, ishin me prerjet si më poshtë:

50, 100, 500, 1 000 lekë.

Këto obligacione jepnin të drejtën për zhvillimin e llotarive. Të ardhurat (interesat) që jepnin të gjitha obligacionet, paguheshin me llotari fitimi. Shuma e fitimeve u caktua për 20 vjet të huasë në masën 4 për qind në vit.



*U emetua huaja e tretë shtetërore, 1954.*

### **viti 1955**

Banka e Shtetit Shqiptar ndërmjetëson për nënshkrimin e një marrëveshjeje mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Italiane për rregullimin e disa çështjeve që rrjedhin nga Traktati i Paqes, nënshkruar më 10.02.1947 "Mbi kthimin nga Qeveria Italiane, Qeverisë Shqiptare, një shumë dollarësh, pagesa e të cilave do të shlyhej me furnizim mallrash."

Vazhdon fokusimi në kreditimin e kooperativave bujqësore dhe në gjetjen e modeleve të reja për kreditin bujqësor.

Krijohet Sektori Ushtarak pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar, me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

### **janar 1957**

Duke filluar nga 1 janari 1957 plani i kreditit bëhet plan direktiv për Bankën e Shtetit Shqiptar dhe miratohet çdo tremujor nga Këshilli i Ministrave. Bankës i lihet e drejta që gjatë zbatimit të planit të kreditit, nga tepricat e papërdorura, të bëjë ndryshime nga një degë e ekonomisë në një tjetër.

Del një urdhër i Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës, miratuar nga Ministri i Financave, mbi personat që janë të autorizuar të jenë në dijeni për shifrën e qarkullimit monetar.

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës nënshkruan marrëveshjen me B/ Eksportales, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, për shtypjen e kartëmonedhave gjatë vitit 1957.



10 Lekë e vitit 1957.

### **5 shkurt 1957**

Këshilli i Ministrave miraton vendimin nr.25, datë 05.02.1957 "Mbi përpilimin e planit të arkës nga Banka e Shtetit Shqiptar".

### **janar 1959**

Duke filluar nga 1 janari i vitit 1959, Banka e Shtetit Shqiptar jepte kredi afatgjatë për të ndërtuar banesa të reja, për të mbaruar një banesë të filluar si dhe për zgjerime dhe meremetime banesash. Kjo kredi u jepej punëtorëve, nëpunësve, pensionistëve, anëtarëve të kooperativave të artizanatit, personave të cilëve u shpronësoheshin banesat për nevojat e institucioneve, të ndërmarrjeve dhe të organizatave kooperativiste e shoqërore, personave, banesat e të cilëve dëmtoheshin nga fatkeqësitë e natyrës, si dhe personave të cilëve u shëmbeshin banesat sipas planit rregullues të qytetit.

Kredia për të ndërtuar një banesë të re, për të mbaruar një banesë të filluar ose për të zgjeruar banesën jepej deri në 25.000 lekë dhe me një afat kthimi deri në 20 vjet, kurse për meremetim banesash kredia jepej deri në 5.000 lekë dhe me afat kthimi deri në 15 vjet. Për të marrë kredinë, kërkuesi duhet të kishte në bankë një depozitë për një shumë prej jo më pak se 25 për qind të kredisë të kërkuar, e cila duhej të qëndronte në bankë si depozitë të paktën 6 muaj. Përfundimisht nga ky kusht dhënia e kredisë për meremetimin e banesës kur ajo ishte e domosdoshme dhe e ngutshme.

### **3 korrik 1959**

Nënshkruhet marrëveshja midis Qeverisë së Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, mbi dhënie ndihme teknike dhe kredie nga Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë.

### **korrik 1959**

Bëhet *konvertimi i katër huave shtetërore në një hua të vetme*, që synon thjeshtimin e veprimeve. Obligacionet e katër huave shtetërore, që konvertoheshin në periudhën 1 janar deri në 31 gusht 1960 u shkëmbyen me obligacionet e huasë së konvertuar me vleftë të barabartë. Obligacionet e huasë shtetërore të konvertuar ishin me prerje 1000, 500, 100 dhe 50 lekë (të vjetër). Obligacioni bazë ishte prerja prej 500 lekësh. Obligacionet e huasë shtetërore të konvertuar përfshinin vleftën e obligacioneve të katër huave dhe që nuk ishin shlyer deri në atë kohë.

Afati i shlyerjes së huasë së konvertuar u caktua 15 vjet, nga 1 janari 1960 deri më 31 dhjetor 1974. Ky afat ishte baraz me afatin mesatar të katër huave shtetërore që ishin emetuar. Interesat prej 4 për qind në vit që jepnin të gjitha obligacionet e huasë do të paguheshin me anë llotarie fitimi gjatë 15 vjetëve. Duke filluar që nga viti 1960 do të hiqeshin 30 llotari fitimi. Obligacionet që nuk do të fitonin në heqjet e llotarive të shlyerjes do të ribleheshin me vleftën nominale.



Në vitin 1967, me iniciativën e marrë nga masat punonjëse, iu falën shtetit një pjesë e obligacioneve, në shumën 38.5 milionë lekë.

### **31 tetor 1959**

Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar i kërkon Zëvendës-presidentit të Bankës së Shtetit në Moskë, mbulimin e mbishpenzimeve në fondin e pagave.



*Huaja shtetërore e konvertuar për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës të RPSH.*

### **10 dhjetor 1960**

Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën nr.13, datë 10.12.1960 "Për kontrollin bankar mbi fondin e pagave", e cila e shtrin kontrollin edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë. Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë të ushtrojë kontroll për përdorimin e fondit të pagave të punës të punonjësve të prodhimit, të ndërtimit, të transportit dhe të tregtisë, në ndërmarrjet industriale, të minierave, të gjeologjisë, të ndërtimit, të tregtisë, të transportit dhe të organizatave kooperativiste të prodhimit dhe të tregtisë.

Në vitin 1961 eksperimentohet në disa rrethe dhënia e kreditit afatshkurtër kundrejt ditëve të punës në kooperativat bujqësore. Banka jep kredi deri në 50 për qind të vlerës së ditës së punës të caktuar në planin financiar të kooperativës.

Importohen nga Republika Demokratike e Gjermanisë makina kontabël elektromekanike "Asscotta", për mekanizimin e proceseve të kontabilitetit.

### **1 janar 1962**

Banka e Shtetit Shqiptar fillon të japë për kooperativat bujqësore, kredi afatgjatë për blerjen me para në dorë të kafshëve të punës dhe të prodhimit nga oborret kooperativiste dhe nga anëtarët e kooperativave bujqësore fqinje. Në vitin 1963, me këtë kredi, kooperativat bujqësore kishin të drejtë të blinin kafshë pune, mjete prodhimi edhe nga ekonomitë bujqësore individuale.

### **1 janar 1963**

Kaktohen kriteret e reja për dhënien e kredisë për meremetimin e banesave. Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë t'u japë kredi afatgjatë pronarëve privatë për të meremetuar banesat në qytete, kur këto dëmtohen nga fatkeqësitë e natyrës ose nga shkaqe të tjera. Kredia jepej në masën deri në 7.000 lekë me afat kthimi deri në 20 vjet, kur në të banonte vetëm pronari dhe në masën deri në 10.000 lekë me afat kthimi deri në 25 vjet, kur banesa ishte dhënë me qira, tërësisht ose pjesërisht.

Nuk jepet kredi për meremetimin e banesave private, kur sipas planit rregullues parashikohet të shembej brenda 5 vjetëve ose kur, sipas vlerësimit të komitetit ekzekutiv të rrethit, këto banesa ishin në gjendje të keqe që nuk lejonin meremetimin. Shtëpitë e meremtuara me kredi nuk mund të shiteshin nga pronarët e tyre para se të shlyhej plotësisht kredia.



*Seri e vitit 1964, e cila u rishtyp në vitin 1976.*

### **1 janar 1965**

Banka e Shtetit Shqiptar ka të drejtë t'u japë kooperativave bujqësore kredi afatgjatë edhe për ndërtimin e veprave energjitike në fshat.

### ***1 korrik 1965***

Hyn në fuqi ligji nr.402, datë 23 qershor 1965 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar".

Përgjithësohet përvoja për periudhën 20-vjeçare duke pasqyruar kushtet e reja të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit. Përfundon kreditimi i sektorit privat të ekonomisë.

### ***16 gusht - 15 tetor 1965***

Realizohet këmbimi i monedhës, në të gjithë vendin, në përpjesëtim 10 lekë të vjetra me 1 lek të ri. Këmbimi i monedhës së vjetër me monedhën e re u bë pa asnjë kufizim. Banka e Shtetit Shqiptar ishte e autorizuar që të hiqte gradualisht nga qarkullimi kartëmonedhat dhe monedhat metalike ekzistuese, emetime të viteve 1949 dhe 1957, të cilat u zëvendësuan me kartëmonedhën e re me prerje 100, 50, 25, 10, 5, 3 dhe 1 lek dhe me monedhën metalike me prerje 1 lek, 50, 20, 10 dhe 5 qindarka të vitit 1964. Kartëmonedhat me të njëjtat pamje u rishtypën edhe në vitin 1976, duke ndryshuar vetëm vitin nga 1964 në 1976.

Nga 16 gushti 1965, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve, pagat e punës, pensionet, bursat, tatimet e taksat dhe çdo veprim tjetër financiar midis ndërmarrjeve, institucioneve e organizatave shtetërore, kooperativiste e shoqërore ose i shtetasve llogaritej me monedhën e re, sipas raportit 10 me 1.

### ***viti 1966***

Në tetor të vitit 1966, Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar u ngarkua të hartojë projektplanin vjetor të arkës dhe ta paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Në tetor të vitit 1966 u përmirësuan më tej kriteret dhe rregullat që kishin të bënin me kredinë afatshkurtër për ndërmarrjet dhe u sistemuan e u konkretizuan më mirë objektet e kreditit, duke i lidhur më mirë me plotësimin dhe me tejkalimin e detyrave të planit të prodhimit dhe të qarkullimit.

Fillon hartimi i planit vjetor të kreditit, ku parashikoheshin burimet dhe përdorimi i tyre, i cili miratohej nga Këshilli i Ministrave, ndërsa planet tremujore të kreditit miratoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar. Degët e Bankës hartonin projektplanet tremujore të kreditit.

Në vitin 1966 përmirësohen rregullat e kriteret për dhënien e kreditit afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit. Banka e Shtetit Shqiptar jepte kredi afatgjatë deri në 20 vjet.

## **Zeqir Lika**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
1 prill 1966 - 15 shkurt 1974*

*Datëlindja: 6 gusht 1921.*

*Vendlindja: Shkodër.*

## **Shkollimi**

*Diplomuar në Fakultetin Ekonomik , Moskë, Bashkimi Sovjetik 1945-1949.*

## **Eksperiencë pune**

**Qershor 1942 - Shkurt 1945,** pjesëmarrës aktiv në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare.

**Shkurt 1945 - Shtator 1945,** funksione partiake në Komitetin e Partisë Shkodër.

**1949 - 1950,** punësohet në Këshillin Ekonomik në Moskë, si përfaqësues i Shqipërisë.

**1950 - 1959** Zëvendëspresident në Komisionin e Planit të Shtetit.

**Mars 1959 - Dhjetor 1959** Dekan i Fakultetit Ekonomik në Universitetin Shtetëror të Tiranës.

**Dhjetor 1959 - Prill 1966** Kryetar i Komitetit Shtetëror të Punës dhe Pagave.

**1 Prill 1966 - 15 shkurt 1974** Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.

**1974** - transferohet në Berat.

## **Llazar Gjika**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
2 shkurt 1974 - 16 Nëntor 1974*

*Datëlindja : 15 mars 1925.*

*Vendlindja : Berat.*

## **Shkollimi**

*Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti Ekonomik*

## **Eksperiencë pune**

**Gusht 1944 - Dhjetor 1945,** pjesëmarrje aktive në Luftën Nacionalçlirimtare

**1 Shkurt 1946 - 1 Shkurt 1974,** punon në Ministrinë e Financave në tre pozicione të ndryshme, ndihmës llogaritar, kryetar dege dhe drejtor.

**2 shkurt 1974 - 16 Nëntor 1974,** Banka e Shtetit Shqiptar , Drejtor i Përgjithshëm.

### **viti 1967**

Përfundon kolektivizimi i bujqësisë. Nga 1 janari i vitit 1967, Banka e Shtetit Shqiptar u jepte kredi afatshkurtra në radhë të parë kooperativave bujqësore të zonave malore e kodrinore me të ardhura të pakta dhe të mesme.

### **1 janar 1967**

U përmirësuan më tej rregullat, kriteret dhe objektet e kreditit afatshkurtër për kooperativat bujqësore.

### **1968**

Emetohen monedha përkujtimore me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



*Monedhë përkujtimore e vitit 1968.*

Gjatë vitit 1968 importohen nga Italia makina kontabël "Olivetti" për mekanizimin e degëve të ekonomisë të pamekanizuara deri atëherë.

### **12 dhjetor 1969**

Miratohet ligji për Bankën Bujqësore, si institucion shtetëror krediti dhe pjesë përbërëse e sistemit financiar, për kooperativat bujqësore. Veprimtarinë e saj, Banka Bujqësore e filloi më 1 janar 1970. Njëkohësisht u caktuan funksionet, detyrat dhe mënyra e organizimit të Bankës Bujqësore.

#### *Banka Bujqësore*

*Banka Bujqësore u krijua në bazë të dekretit nr. 4613, datë 12.12.1969, si institucion shtetëror krediti për kooperativat bujqësore, si pjesë e sistemit financiar të vendit. Veprimtarinë e saj, Banka Bujqësore e filloi më 1 janar 1970. Funksionet, detyrat dhe mënyra e organizimit të Bankës Bujqësore janë përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 23.12.1969.*

*Banka Bujqësore është person juridik, ka llogari të pavarur dhe bilancin e vet si dhe fondin e saj të themelimit (i papërcaktuar).*

*Banka Bujqësore zbaton politikën shtetërore të kreditit për kooperativat bujqësore, organizon grumbullimin e mjeteve monetare përkohësisht të lira të kooperativave dhe, së bashku me mjetet e tjera që vihen në dispozicion nga shteti, i drejton në mënyrë të planifikuar për dhënie e kredive me afat të shkurtër dhe të gjatë, duke u mbështetur në parimet dhe në kriteret bazë të miratuara, në mënyrë që krediti të shërbejë për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit dhe për forcimin ekonomik të kooperativave bujqësore.*

*Banka bujqësore kontrollon përdorimin e drejtë dhe me efektivitet të kredive të dhëna, si dhe merr masat e nevojshme për të siguruar kthimin e tyre.*

*Banka Bujqësore funksionon si qendër llogarie për kooperativat bujqësore dhe kryen shërbimin e arkëtimit dhe pagesave.*

Banka Bujqësore merret në mënyrë sistematike me studimin e problemeve të caktuara ekonomiko-financiare të kooperativave bujqësore dhe me drejtimin më të mirë të ekonomisë dhe administrimin më racional të pronës kooperativiste.

Banka Bujqësore ndihmon dhe përgjigjet për hartimin dhe për miratimin e planit financiar në kooperativat bujqësore. Ajo shqyrton planet financiare të hartuara nga kooperativat bujqësore dhe i ndihmon ato për përmirësimin e treguesve ekonomikë e financiarë të planifikuar.

Zbërthimi i treguesve të planit financiar dhe të kostos dhe zbatimi i detyrave për plotësimin e treguesve të planifikuar përbënte një nga drejtimet më të rëndësishme të punës së bankës. Ajo ka për detyrë të ndjekë përdorimin me vend të mjeteve monetare dhe kryerjen në kohë të pagesave. Gjithashtu, ajo ndjek financimin e rregullt të investimeve të miratuara në planet financiare dhe kontrollon kryerjen e investimeve në bazë të projekteve dhe të preventivave të miratuara.

Banka Bujqësore, gjithashtu, ka për detyrë të ndjekë organizimin e rregullt dhe zbatimin e saktë të llogarisë dhe të kontabilitetit në kooperativat bujqësore, për zbatimin e planit kontabël dhe të sistemit të mbajtjes së llogarive; implementimi i kontabilitetit, përgatitja, shqyrtimi dhe analiza në kohë dhe me cilësi e bilanceve tremujore e vjetore dhe anekseve të tyre, si dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e treguesve ekonomiko-financiarë, janë disa nga çështjet më kryesore në këtë drejtim.

Zbatimi i rregullores "Mbi qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare" forcimi i disiplinës financiare, deri te krijimi i fondeve ligjore e statutore dhe mënjanimi i shumave përkatëse në llogaritë e posaçme bankare; shlyerja e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit e Bankës për kreditë e marra, përbëjnë gjithashtu, drejtime të rëndësishme të punës së bankës.

Me dekretin nr.5530, datë 25.02.1977, sfera e veprimtarisë së Bankës Bujqësore, përveç kooperativave bujqësore, u shtri edhe mbi ndërmarrjet dhe institucionet e sistemit të bujqësisë, që janë nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve. Njëkohësisht u përsosën më tej edhe funksionet e detyrat e Bankës Bujqësore, të cilat konsistojnë në këto drejtime kryesore :

Banka Bujqësore vetë ose në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe me seksionet e bujqësisë të komiteteve ekzekutive të rretheve, ka për detyrë të bëjë analiza e studime për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, për domosdoshmërinë e leverdinë ekonomiko-shoqërore të investimeve e ndërtimeve në ndërmarrjet e institucionet e sistemit të bujqësisë dhe në kooperativat bujqësore. Banka Bujqësore u jep kredi ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore dhe kryen financimin e investimeve dhe të ndërtimeve sipas planit. Lidhur me këtë, ajo ushtron kontroll për përdorimin e kreditit, për krijimin dhe për përdorimin e drejtë të fondeve të investimeve e të ndërtimeve.

Banka Bujqësore ushtron kontroll për përdorimin e fondit të pagave në ndërmarrjet bujqësore.

Banka Bujqësore shqyrton dhe i paraqit Bankës së Shtetit Shqiptar të dhënat e nevojshme për hartimin e planit të arkës, për të ardhurat dhe për shpenzimet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet e institucionet e sistemit të bujqësisë dhe me kooperativat bujqësore.

Banka Bujqësore përqëndron llogaritë e pagesave dhe të arkëtimeve të ndërmarrjeve e të institucioneve të sistemit të bujqësisë dhe të kooperativave bujqësore, si dhe kryen arkëtimet dhe pagesat.

Njëkohësisht, u bë edhe riorganizimi i Bankës Bujqësore në qendër e në rrethe. Varësia e Bankës Bujqësore i kalon Ministrisë së Financave. Në qendër u krijua Këshilli i Bankës, përbërja e të cilit miratohet nga ministri i financave. Degët e Bankës Bujqësore në rrethe varen drejtpërdrejt nga Drejtoria e Përgjithshme, me qendër në Tiranë.

Fondi i themelimit të Bankës Bujqësore u caktua në shumën prej 250 milionë lekësh.

Shteti garanton të gjitha detyrimet e Bankës Bujqësore që rrjedhin nga veprimet e kryera në bazë të dekretit për Bankën Bujqësore.

Bilanci vjetor i Bankës Bujqësore miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe të ardhurat e saj i kalojnë buxhetit të shtetit.

Me dekretin nr.6882, datë 28.04.1984 Banka Bujqësore varet nga ministri i financave.

##### 5. Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit

Me ligjin Nr.7520, datë 16.10.1991 krijohet Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit si institucion i pavarur dhe bën pjesë në sistemin bankar. Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit trashëgon të gjithë veprimtarinë e Bankës Bujqësore.

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit u ngarkua edhe me pranimin e depozitave të kursimit të popullsisë dhe të personave juridikë a fizikë, vendas a të huaj në lekë e në valutë.

Fondi i themelimit të Bankës së Bujqësisë dhe Zhvillimit u caktua në shumën prej 450 milionë lekë.

Organet drejtuese të Bankës janë : Këshilli i Bankës, Drejtori i Përgjithshëm dhe Komisioni i Kontrollit. Këshilli i Bankës është organ vendimor, i cili organizon, kontrollon dhe përgjigjet për gjithë veprimtarinë e saj. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga Këshilli i Ministrave. Komisioni i Kontrollit kontrollon zbatimin e statutit dhe të vendimeve të Këshillit të Bankës. Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit varet nga Ministria e Financave.

## **ALEKS VERLI**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
2 Nëntor 1974 - Mars 1976*

*Datëlindja: 7 Korrik 1920.*

*Vendlindja Muzinë, Delvinë, Sarandë.*

*Vdekja -11 prill 1977.*

### **Shkollimi**

*Shkolla fillore Sarandë*

**1934- 1943** kryen 7 vjet dhe ka lënë pa mbaruar vitin VIII dhe të fundit të Liceut të Korçës. Vitin shkollor 1935-36 e ka ndërprerë për arsye ekonomike.

**1951-1954**, studjon në Akademinë Ushtarake "V.M.Molotov" në Kalinin të Bashkimit Sovjetik, ku ka mbaruar shkëlqyeshëm specialitetin "Komandant Shtabi Prapavije". Diplomuar më 24 prill 1954.

### **Eksperiencë pune**

**1943**, lë studimet në Liceun e Korçës dhe deri në 1944 merr pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare si komisar kompanie, intendent dhe Shef i Seksionit Ekonomik të Ushtrisë.

**1945**, Zëvendëskryetar i Drejtorisë Ekonomike të Ushtrisë.

**1946**, Kryetar i Intendencës së Përgjithshme.

**1948**, caktohet nëpunës i lartë, në Ministrinë e Financave.

**1949**, Drejtor i Prapavijave të Ushtrisë.

**1954**, Zëvendëministër i Mbrojtjes dhe Drejtor i Prapavijave pranë Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë.

**1956**, Ministër i Financave.

**1974**, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit dhe këshilltar pranë Këshillit të Ministrave.

**1958 deri në 1974**, Deputet në Kuvendin Popullor për katër legjislatura rresht.

*Vdiq më 11 prill 1977.*



### ***viti 1974***

Në vitin 1974, bëhen disa ndryshime në dispozitat për kredinë afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit.

### ***6 janar 1976***

Këshilli i Ministrave miraton urdhëresën nr.1, datë 06.01.1976 "Mbi kontrollin bankar për përdorimin e fondit të pagave". Në vitin 1980, u morën masa të reja për forcimin e kontrollit bankar në këtë fushë.

Kontrolli i fondit të pagave bëhet në përputhje me treguesit e planit të prodhimit, të vlerës së përpunimit, të ndërtim-montimit, të qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve.

### ***12 maj 1976***

Banka e Shtetit Shqiptar, e krijuar pas shtetëzimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë kishte trashëguar prej saj edhe aksionet që Banka Kombëtare e Shqipërisë kishte pranë Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare në Bazël të Zvicrës (BIS Bazel). Më 12 maj 1976, Ministri i Financave Lefter Goga i dërgon një letër Kryeministrit për largimin e Bankës së Shtetit nga pjesëmarrja me aksione pranë BIS Bazel.

Kërkesa e Ministrisë së Financave për largimin e Bankës së Shtetit nga pjesëmarrja me aksione pranë BIS Bazel, miratohet nga Zëvendëskryeministri i Parë Adil Çarçani, duke e argumentuar këtë me Kushtetutën e re të vitit 1976.

### ***26 maj 1976***

Zhvillohet një konsultë pranë Ministrisë së Financave, ku marrin pjesë Ksenofon Nushi nga Ministria e Punëve të Jashtme, Aranit Çela nga Gjykata e Lartë, Hasan Banja nga Instituti i Studimeve Ekonomike, Luan Omari nga Akademia e Shkencave, Arben Puto nga Fakulteti i Shkencave Juridiko-Politike, Ismet Elezi nga Kryeministria.

Shumica e pjesëmarrësve në konsultë shfaqën mendimin që Banka e Shtetit Shqiptar të mos largohet nga BIS Bazel.

### ***15 nëntor 1976***

Këshilli i Ministrave nxori urdhëresën nr.8, datë 15.11.1976 "Mbi studimin, projektimin, planifikimin dhe financimin e investimeve e të ndërtimeve themelore". Synon vënien në baza më të drejta të studimit, të projektimit, të planifikimit dhe të financimit të veprave, brenda fondeve të caktuara nga shteti. Problemet që lidhen me studimin, me projektimin, me planifikimin dhe me financimin e investimeve e ndërtimeve themelore janë të lidhura organikisht njëra me tjetrën. Ato përcaktojnë detyra konkrete për organet investitore, projektuese e zbatuese, si dhe për organet e planit, të financës dhe të Bankës.



## **Kostaq Postoli**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
1 mars 1976 - 15 korrik 1984*

*Datëlindja: 30 janar 1934.  
Vendlindja : Korçë.*

### **Shkollimi**

*Shkolla 7- vjeçare : "22 Tetori", Korçë  
Shkolla e mesme : Teknikumi Financiar " 11 Janar ", Tiranë, shtator 1950  
- qershor 1953  
Shkolla e lartë : Instituti i Lartë Ekonomik (sot Universiteti Shtetëror i  
Tiranës, Fakulteti Ekonomik) , shtator 1953 - qershor 1957, Titulli  
Ekonomist me specialitet financiar.*



### **Eksperiencë pune**

*16 korrik 1957- 31 mars 1958, ekonomist në Byronë e Çmimeve në Këshillin e Ministrave  
1 prill 1958 - 16 shkurt 1963, kryeinspektor i financimit në Seksionin e Financës të Komitetit Ekzekutiv të Komitetit të Partisë të rrethit Korçë.  
17 shkurt 1963 - 15 dhjetor 1970, Shef i Seksionit të Financës në Komitetin Ekzekutiv të Komitetit të Partisë të rrethit Korçë.  
16 dhjetor 1970 - 31 janar 1973, Kryetar i Degës së Planit në Uzinën e Instrumenteve Korçë.  
1 prill 1973 - 28 shkurt 1976, Instruktor për ekonominë në Komitetin e Partisë së Punës së Shqipërisë, Korçë.  
1 mars 1976 - 15 korrik 1984, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.  
16 korrik 1984 - 15 dhjetor 1989, Kryetar i Komitetit të Çmimeve dhe Standardeve pranë Këshillit të Ministrave.  
16 dhjetor 1989- 31 korrik 1991, Drejtor i Institutit të Arkave dhe Sigurimeve Tiranë.  
1 gusht 1991 - 30 prill 1998, në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Kursimeve Tiranë. (ka kryer detyra të ndryshme: Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, drejtor drejtorie, specialist dhe këshilltar i drejtorit të Përgjithshëm).  
nga 1 maj 1998, pensionist.*

### ***25 shkurt 1977***

Miratohet dekreti nr.5530 "Mbi Bankën Bujqësore". Sfera e veprimtarisë së Bankës Bujqësore, përveç kooperativave bujqësore u zgjerua dhe u shtri edhe mbi ndërmarrjet dhe institucionet e sistemit të bujqësisë, që ishin nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve.

### ***mars 1977***

Miratohet urdhëresa nr.5, datë 15.03.1977 e Këshillit të Ministrave "Mbi planin e arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar".

### ***mars 1977***

Miratohet urdhëresa nr.2, datë 15.03.1977 e Këshillit të Ministrave "Mbi kredinë me afat të shkurtër për ndërmarrjet". Me përmirësimet që janë bërë në vitet 1979-1982, janë përcaktuar kritere dhe rregulla të reja. Kredia u planifikohet dhe u jepet ndërmarrjeve, duke u bazuar në natyrën dhe në veçoritë e degëve të ndryshme të ekonomisë për ato raste kur, sipas rregullave në fuqi, nuk financohen me mjetet e veta xhiruese.

### ***20 maj 1977***

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, i dërgon një telegram Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare ku kërkohet shitja e këtyre aksioneve dhe kreditimi i llogarisë së Bankës së Shtetit Shqiptar pranë BIS Bazel (pra vendoset largimi nga BIS Bazel).

### ***tetor 1979***

Në tetor të vitit 1979 procedura e hartimit të planit të kredisë dhe të planit të arkës së Bankës së Shtetit Shqiptar i nënshtrohet procedurës së hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të planit ekonomik dhe financiar të Shtetit.

### ***28 prill 1984***

Miratohet dekreti nr.6882, datë 28.04.1984. Banka e Shtetit Shqiptar varet nga Këshilli i Ministrave dhe jo nga Ministria e Financave, ndërsa Banka Bujqësore varet nga Ministria e Financave.

## **Andrea Nako**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
16 korrik 1984 - 15 korrik 1985*

*Datëlindja: 14 shtator 1934.*

*Vendlindja: Leskovik (Katundi Zguralec).*

## **Shkollimi**

*Shkolla fillore Katundi Zguralec-Leskovik.*

*Shkolla 7-vjeçare "Jani Vreto", Leskovik.*

*Shkolla e mesme , Teknikumi Ekonomik "Nako Spiru", Tiranë.*

**1957-1962:** *Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti Ekonomik ,  
Ekonomist për Industri ( pa shkëputje nga puna).*



## **Eksperiencë pune**

*Korrik 1953-Tetor 1953 Inspektor tatimor në administratën lokale në Leskovik.*

*1953- 1978 Funksione të ndryshme në Ministrinë e Financave, si inspektor tatimor, revizor, kryerevizor,  
kryetar dege dhe drejtor drejtorie.*

*1978- 1982 Zëvendësministër i Financave.*

*1982- 1984 Kryetar i Komitetit të Çmimeve dhe Standardeve në Kryeministri.*

*1984 - 1985 Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*1985- 1990 Ministër i Financave.*

*1990 - 1991 Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.*

*1991 Del në pension.*

## **Të tjera**

*Për merita të veçanta në punë është dekoruar me urdhëra dhe medalje të klasave të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.*

*Vdiq më 13 gusht 1998.*

### ***dhjetor 1985***

Miratohet urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.7, datë 11.12.1985. Rregullat dhe kriteret e kontrollit bankar për përdorimin e fondit të pagave, u forcuan më tej. Kështu, Banka e Shtetit Shqiptar ushtron kontroll në fondin e pagave në të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet, për përdorimin e tij në përputhje me treguesit e planit.

Kontrrolli bankar i fondit të pagave për ndërmarrjet bëhet mujor dhe tremujor, kurse për institucionet bëhet tremujor.

Përfundim për ndërmarrje të veçanta, ku kontrolli bankar i fondit të pagave kryhet mujor dhe progresiv prej fillimit të vitit, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, në bazë të propozimit të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore përkatëse.

### ***tetor 1987***

Miratohet dekreti nr.7162, datë 10.10.1987. Banka e Shtetit Shqiptar varet nga Këshilli i Ministrave dhe përgjigjet e jep llogari para tij.

#### *Banka e Kursimeve*

*Me ligjin nr.7505, datë 31.07.1991, krijohet Banka e Kursimeve si institucion shtetëror i pavarur, si pjesë në sistemin bankar, nga ndarja e Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve.*

*Funksionet dhe detyrat kryesore të Bankës së Kursimeve janë :*

- a) Kryen veprimtari për depozitat e kursimit të mjeteve monetare në lekë dhe në valutë për shtetasit shqiptarë dhe të huaj.*
- b) Jep kredi afatshkurtër dhe afatgjatë.*
- c) Kryen shërbime të ndryshme bankare.*

*Rregullat, kushtet dhe afatet për depozitat e kursimit caktohen nga Banka e Kursimeve.*

*Objektet e kredisë , si dhe rregullat dhe kushtet për dhënien dhe për kthimin e saj caktohen nga Banka e Kursimeve.*

*Për të ushtruar veprimtarinë e saj Banka e Kursimeve ka fondin e themelimit prej 50 milionë lekësh, fondin rezervë dhe fondin e mjeteve kryesore.*

*Organet e Bankës janë Këshilli i Bankës, Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave dhe zëvendësit e tij.*

*Banka e Kursimeve kontrollohet nga Kontrolli i Shtetit. Bilanci i saj miratohet nga Këshilli i Bankës dhe i paraqitet Këshillit të Ministrave.*

*Banka e Kursimeve është person juridik me qendër në Tiranë dhe ka rrjetin e saj në rrethe (degë, agjenci e zyra bankare).*

## **Kamber Myftari**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar*

*16 shtator 1986 - 28 shkurt 1989*

*Datëlindja: 15 shtator 1944*

*Vendlindja: Malinë, Pogradec*



### **Shkollimi**

*1959-1963 Teknikumi Ekonomik "Nako Spiru", diplomuar "Ekonomist i mesëm i punës";*

*1966-1970, diplomuar si ekonomist i lartë kontabël, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik.*

### **Eksperiencia pune:**

**20 gusht 1963 - 15 shtator 1966**, Miniera e Gurit të Kuq - Pogradec, ekonomist; kryetar i degës plan - norma - furnizim - shpërndarje.

**1 janar 1971 - 15 shkurt 1972**, Kooperativa Bujqësore Velçan - Pogradec, me detyrën Kryetar Kooperative.

**16 shkurt 1972 - 31 mars 1973**, Dega e Bankës Bujqësore - Pogradec me detyrën Drejtor i Degës.

**1 prill 1973 - 15 shtator 1976**, instruktor për ekonominë, në Komitetin e Partisë të rrethit Pogradec

**16 shtator 1976 - 15 dhjetor 1981**, Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar, me detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Emisionit dhe Qarkullimit Monetar.

**16 dhjetor 1981 - 15 shtator 1986**, Dega e Bankës së Shtetit Shqiptar në Durrës, me detyrën e Drejtorit të Degës.

**16 shtator 1986 - 28 shkurt 1989**, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar. Gjatë këtij mandati realizohet kalimi i Bankës së Shtetit Shqiptar nga varësia e Ministrisë së Financave, në varësi të Këshillit të Ministrave.

**1 mars 1989 - 25 korrik 1991** Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.

**26 korrik 1991 - 15 gusht 1992**, pas dorëheqjes nga zëvendësdrejtor i përgjithshëm në korrik 1991, ekonomist i pagesave në Bankën e Shtetit Shqiptar.

**16 gusht 1992 - 5 nëntor 1992**, ekonomist i pagesave në Bankën e Shtetit Shqiptar.

**6 nëntor 1992 - 19 nëntor 1995**, pas krijimit të Bankës së Shqipërisë, Inspektor në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

**20 nëntor 1995 - 20 dhjetor 1995**, Përgjegjës i Sektorit të Inspektiveve në vend të Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë

**21 dhjetor 1995 - 11 janar 1996**, Inspektor në Departamentin e Mbikëqyrjes .

**12 janar 1995 - 8 maj 1997**, Kontrollor Mbikëqyrës në Departamentin e Emisionit dhe të Administrimit të Parasë.

**9 maj 1997 - 18 gusht 1997**, Drejtor i Degës së Bankës së Kursimeve nr.1 në Tiranë

**19 gusht 1997 - 11 nëntor 1997**, Drejtor i Drejtorisë së Pagesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Kursimeve.

**12 nëntor 1997 - 11 dhjetor 2000**, Banka e Shqipërisë - Departamenti i Mbikëqyrjes, Zëvendësdrejtor dhe Përgjegjës i Sektorit të Inspektiveve.

**12 dhjetor 2000 - 23 maj 2002**, Zëvendësdrejtor i Departamentit të Emisionit dhe Përgjegjës i Sektorit të Emisionit dhe Administrimit të Parasë në Bankën e Shqipërisë.

**23 maj 2002 e në vazhdim**, Drejtor i Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë.

**18 tetor 2002 e në vazhdim**, Kryetar i Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, që nga krijimi dhe fillimi i veprimtarisë së agjencisë.

## **Qirjako Mihali**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
Mars 1989 - dhjetor 1990*

*Datëlindja : 13 Maj 1929.  
Vendlindja : Korçë.*

### **Shkollimi**

*Shkolla 7-vjeçare Korçë.*

*1947-1951, Shkolla e mesme, Politeknikumi Tiranë*

*Shtator 1951- gusht 1956, Shkolla e lartë, Instituti i Naftës Moskë, titulli  
Inxhiner ekonomist*



### **Eksperiencë pune:**

*Gusht 1956- nëntor 1966, Kryetar i Degës së Planit dhe më pas drejtor në Uzinën e Përpunimit të Naftës, Cërrik.*

*Nëntor 1966- maj 1975, Drejtor Azotiku Fier.*

*Qershor 1975 - prill 1977, Sekretar i Parë në Komitetin e Partisë Durrës e më pas në Tiranë.*

*Maj 1977 - tetor 1982, Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.*

*Nëntor 1982 - dhjetor 1984, Ministër i Financave.*

*Tetor 1984- shtator 1986, Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.*

*Shtator 1986- tetor 1988, Sekretar i Parë në Komitetin e Partisë Durrës*

*Tetor 1988 - dhjetor 1990, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit  
Pensionist nga 31 dhjetori 1990*

### **maj 1990**

Miratohet urdhëresa nr.3, datë 25.05.1990 e Këshillit të Ministrave. Banka e Shtetit Shqiptar mund t'u japë ndërmarrjeve që merren me tregti të jashtme dhe atyre që prodhojnë për eksport, kredi afatshkurtër dhe afatgjatë në valutë të lirë.

Miratohet urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.5, datë 25 maj 1990 "Mbi kontrollin bankar në fondin e pagave".  
Miratohet urdhëresa nr.6, datë 25.05.1990 "Për kreditin bankar".

### **dhjetor 1990**

Miratohet dekreti nr.7440, datë 01.12.1990 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7377, datë 8 maj 1990 "Për Bankën e Shtetit Shqiptar", në bazë të të cilit Banka e Shtetit Shqiptar mban llogari bankare për pagesat dhe arkëtimet e klientëve të saj.

Ajo u jep kredi afatshkurtër klientëve të saj për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, ndërsa kredi afatgjatë u jep klientëve të saj për investime të reja, për blerje e për rikonstruksione teknike e teknologjike të objekteve prodhuese, të shërbimeve e aktiviteteve të tjera, që gjykohen prej saj të leverdisshme ekonomikisht. I hapet rruga kreditimit të sektorit privat të ekonomisë.

Miratohet dekreti nr. 7493, datë 31 korrik 1991 "Për Bankën Shqiptare të Tregtisë".

## **Niko Gjyzari**

*Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar  
1 Janar 1991 - 31 Gusht 1991*

*Datëlindja : 10 Nëntor 1934.  
Vendlindja : Vlorë.*

### **Shkollimi**

*Shkolla 8-vjeçare "Naim Frashëri" Vlorë.  
Shkolla e mesme, Teknikumi Financiar "11 Janari" Tiranë.  
Shkolla e lartë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti Ekonomik,  
përfunduar në 1961*



### **Eksperiencë pune**

*8 qershor 1956 - 30 shtator 1969, inspektor pranë Seksionit të Financës të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Vlorë*

*1 Tetor 1969- 15 mars 1974, Shef i Seksionit të Financës pranë Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Vlorë.*

*16 Mars 1974 - 30 tetor 1975, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave Tiranë.*

*1 Nëntor 1975- 30 Tetor 1984, Zëvendësministër i Financave.*

*16 Shkurt 1984-15 Korrik 1985, Ministër i Financave.*

*16 Korrik 1985-15 Maj 1990, Kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit*

*16 Maj 1990-31 Dhjetor 1990, Ministër Shteti dhe Sekretar i Përgjithshëm pranë Kryeministrit.*

*1 Janar 1991-31 Gusht 1991, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*1 Shtator 1991 - 31 Gusht 1992, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*Në vazhdim manaxher i përgjithshëm i "Sofimpex"*

## PERIUDHA 1991-2002

Në procesin e transformimit të një vendi me ekonomi të centralizuar në një vend me ekonomi të mbështetur në tregun e lirë, krahas problemeve madhore si përballimi i inflacionit dhe sigurimi i ritmeve të qëndrueshme të rritjes ekonomike, që përbëjnë kushte bazë të një transformimi të suksesshëm, një vend qendror zë transformimi dhe reforma e sistemit financiar dhe veçanërisht në sektorin bankar.

Në këta 12 vjet tranzicioni është shënuar një progres i dukshëm jo vetëm në drejtim të qëndrueshmërisë makroekonomike, por edhe në zbatimin e reformave të thella strukturore përfshirë dhe reformën e sektorit bankar. Pavarësisht nga kushtet e pafavorshme të nisjes të ekonomisë shqiptare dhe të sektorit bankar, sistemi bankar shqiptar është zhvilluar hap pas hapi duke u zgjeruar me banka të reja private, nëpërmjet privatizimit dhe ristrukturimit të bankave shtetërore, nëpërmjet shtrirjes së rrjetit bankar, përsosjes së legjislacionit dhe sistemit të pagesave, përsosjes së teknologjisë dhe shërbimeve bankare, rritjes së nivelit të kreditimit, rritjes së nivelit të frytshmërisë dhe shtimit të shërbimeve të tjera bankare.

Si pjesë e reformës ekonomike të filluar në vitin 1992, reforma e sistemit bankar filloi si reformë institucionale me ndryshimin e bazës ligjore. Kuvendi, në prill të vitit 1992, miratoi ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe ligjin "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë". Këto ligje shënuan kalimin e sistemit bankar nga një nivelor në një sistem bankar prej dy nivelesh. Mbi bazën e këtyre ligjeve u hap rruga procesit të licencimit të bankave të reja private dhe rregullimit të sistemit bankar nga banka qendrore.

Banka e Shqipërisë u krijua si bankë e nivelit të parë, banka qendrore e vendit, ndërkohë që tri banka të tjera shtetërore: Banka e Kursimeve, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Tregtare Agrare, përbënin nivelin e dytë të sistemit bankar. Banka e Kursimeve ishte pasardhëse e Institutit të Kursimit me një status të ri si një bankë universale. Banka Kombëtare Tregtare ishte shkrire e aktivitetit tregtar të brendshëm të Bankës së Shtetit Shqiptar me Bankën Shqiptare të Tregtisë.

### *Banka Shqiptare e Tregtisë*

*Me dekretin nr. 7493, datë 01.12.1990 krijohet Banka Shqiptare e Tregtisë, si person juridik që ka për qëllim kryerjen e veprimtarisë bankare me qendër në Tiranë dhe me rrjetin e saj. Banka Shqiptare e Tregtisë trashëgon një pjesë të veprimtarisë së Bankës së Shtetit Shqiptar, kryesisht në fushën e tregtisë së jashtme dhe të valutës.*

*Banka Shqiptare e Tregtisë kishte këto të drejta e detyra :*

*Merr pjesë në veprimtari dhe në marrëveshje me karakter ekonomik e financiar, që personat juridikë a fizikë shqiptarë zhvillojnë dhe përfundojnë me personat juridikë a fizikë të huaj.*

*Hyn në marrëdhënie dhe lidh marrëveshje bankare me bankat e tjera për çeljen dhe për mbajtjen e llogarive në klering ose në valutë të lirë, si dhe pranon dhe vendos depozita bankare.*

*Mban llogari bankare për arkëtimet dhe për pagesat në valutë të huaj dhe në monedhë kombëtare për llogari të klientëve të saj, si dhe kryen arkëtimet dhe pagesat për veprime tregtare e jotregtare.*

*Kryen këmbime valutore për nevojat e veta dhe të klientëve të saj brenda dhe jashtë shtetit.*

*Tregton tituj me vlerë dhe dokumente tregtare e financiare.*

*Ndihmon dhe kontrollon klientët e saj në veprimtarinë e tyre, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në përdorimin e fondeve në valutë dhe në monedhën kombëtare.*

*Lëshon dhe pranon garanci bankare.*

*Kryen investime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.*

*Krijon banka të përbashkëta dhe ndërmarrje të ndryshme me fondet e saj.*

*Banka Shqiptare e Tregtisë jep kredi në valutë dhe në monedhë kombëtare me afatet dhe me kushtet e përcaktuara prej saj.*

*Banka Shqiptare e Tregtisë ka Këshillin Administrativ. Ajo drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili vepron në përputhje dhe brenda kompetencave të caktuara nga Këshilli Administrativ ose nga statuti.*

*Banka Shqiptare e Tregtisë gjithashtu, ka të drejtë të çelë degë ose përfaqësi jashtë shtetit. Degët e Bankës në rrethe varen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe japin llogari para tij.*

*Banka Shqiptare e Tregtisë ka fondin e themelimit prej 600 milionë lekësh, fondin rezervë prej 200 milionë lekësh, si dhe fondin e mjeteve kryesore.*

*Banka Shqiptare e Tregtisë kontrollohet nga Kontrolli i Shtetit. Bilanci i saj miratohet nga Këshilli Administrativ dhe i paraqitet Këshillit të Ministrave.*



### ***15 qershor 1991***

Shqipëria bëhet anëtare pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar. Si bankë e Qeverisë Shqiptare dhe në të njëjtën kohë agjente e saj, llogaria e kuotave të Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar në *sdr* (Special Drawing Rights) mbahet si llogari e veçantë pranë Bankës së Shqipërisë.

### ***31 korrik 1991***

Miratohet ligji nr.7505, datë 31.07.1991 "Për Bankën e Kursimeve".

### ***tetor 1991***

Shqipëria bëhet anëtare e Bankës Botërore, kohë prej të cilës Banka ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me autoritetet shqiptare. Është nënshkruar me Bankën një marrëveshje që ka të bëjë me objektivat e reformës ekonomike dhe me praninë e Bankës Botërore në Shqipëri.

### ***tetor 1991***

Shqipëria i bashkohet Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), strukturë brenda Bankës Botërore, kraut huadhënës të Bankës. Objektivi kryesor i huadhënies në Shqipëri është ndihma në heqjen e varfërisë dhe në eliminimin e barrierave më të mëdha për zhvillimin ekonomik, për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri. Veprimet financiare do të kanalizohen përmes Bankës së Shqipërisë

### ***shtator-tetor 1991***

Misioni i Asistencës teknike MAE/LEG viziton Bankën e Shqipërisë me synim vlerësimin e përgjithshëm të legjisllacionit bankar shqiptar.

Stafi i misionit MAE ka në përbërje të vet ekspertë të bankave qendrore të Danimarkës, të Finlandës, të Italisë, të Portugalisë, të Spanjës dhe të SHBA. Që prej kësaj kohe misioni MAE viziton Bankën e Shqipërisë në mënyrë periodike për të këshilluar Guvernatorin dhe për të ofruar asistencë teknike për çështje të ndryshme të sistemit bankar.

### ***13 dhjetor 1991***

Shqipëria bëhet anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) sipas ligjit "Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim". Pranë Bankës së Shqipërisë hapet një llogari për mbajtjen e kuotave të anëtarësimit të Shqipërisë në BERZH dhe për reflektimin e marrëdhënieve të mëtejshme.

### ***dhjetor 1991***

Misioni i Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, MAE viziton Bankën e Shqipërisë duke punuar me të për të identifikuar rrugët dhe për të mundësuar hartimin e strategjisë së reformimit të Bankës së Shtetit Shqiptar, duke shndërruar atë në një institucion me të gjitha atributet e një banke qendrore moderne.

### ***prill-maj 1992***

Misioni i Asistencës Teknike MAE të Fondit Monetar Ndërkombëtar viziton Bankën e Shqipërisë me synim implementimin e strategjisë së krijimit të një banke qendrore me të gjitha atributet, duke bërë rekomandime mbi përmirësimin e operacioneve në Bankën e Shqipërisë.

#### **4 maj 1992**

Presidenti i Republikës dekreton ligjin nr. 7559, datë 22.04.1992 "Për Bankën e Shqipërisë" (Dekreti nr. 172) dhe ligjin nr. 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" (Dekreti nr. 173).

#### **30 maj 1992**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë, mbështetur në ligjin nr. 7559, datë 22.04.1992 "Mbi Bankën e Shqipërisë", pas zbatimit të një procedure demokratike, me votim të fshehtë propozon si kandidat të mundshëm për t'u zgjedhur Guvernator, zotin Ilir Hoti. Këtë propozim Këshilli Drejtues ia paraqet për miratim Presidentit të Republikës.

#### *Këshilli Drejtues*

*Adrian Fullani,  
Ardian Kamberi,  
Bedri Çollaku,  
Limos Malaj,  
Fahri Hoxha,  
Halo Agaj,  
Ilir Hoti,  
Stefan Sevo,  
Kristaq Luniku,  
Everest Musta  
Adrian Xhyheri.*

#### **22 qershor 1992**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr vendimin "Për fillimin e disa masave të programit të reformës ekonomike":

norma të ndryshme interesi për kreditë dhe depozitat duke u mbështetur tek treguesit e inflacionit dhe në kërkesat e tregut;

sistem i lirë i kurseve të këmbimit;

*liberalizim i regjimit të tregtisë së jashtme.*

#### **qershor 1992**

Banka e Shqipërisë në mbështetje të ligjit numër 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" jep licencën paraprake për të vepruar si bankë për :

Bankën Kombëtare të Shqipërisë.

Bankën Tregtare të Shqipërisë.

*Bankën e Kursimeve të Shqipërisë.*

#### **25 qershor 1992**

Banka e Shqipërisë i jep licencën Bankës Kombëtare të Shqipërisë për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë mbështetur në ligjin nr. 7559, datë 22.04.1992 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 7560, datë 28 prill 1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

## **Ilir Hoti**

*Guvernator i Bankës së Shqipërisë  
Maj 1992 -shtator 1993*

*Datëlindja 10 maj 1957.*

*Vendlindja : Shkodër.*

*1980, diplomohet me rezultatin shkëlqyeshëm në Financë dhe Kontabilitet pranë Fakultetit të Ekonomisë Agrare, Universiteti Bujqësor, Tiranë.  
1991, specializohet duke u çertifikuar për Inxhinieri Financiare në American University.*



## **Eksperienca pune**

*1981, analist financiar në Bankën Bujqësore Durrës.*

*1985, kryespecialist për analizë financiare dhe kreditin në Bankën Bujqësore Durrës.*

*1988, Drejtor i Bankës Bujqësore, Durrës.*

*1991, Drejtor i Bankës Shqiptare të Tregtisë, dega Durrës.*

*1991, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*1992, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.*

*1998-2002, Drejton zbatimin e disa projekteve në fushën bankare dhe në atë të finances.*

*2002, angazhohet si lektor për trajnime në fushën e finances në Kosovë, pranë agjencive zhvillimore të OSBE, UNMIK etj..*

## **Veprimtaria pedagogjike**

*1983 - 1991: Universiteti Bujqësor Tiranë, Fakulteti i Ekonomisë Agrare, lektor i jashtëm për lëndët " Financë" dhe "Analizës Ekonomike e Financiare".*

## **Të tjera**

*1991, Zëvendësguvernator i Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar -Washington D.C.*

*1992, emërohet Guvernator i Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar -Washington D.C.*

### **30 qershor 1992**

Me anën e dekretit nr. 237, datë 30 qershor 1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, emërohet zoti Ilir Hoti, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

### **qershor –korrik 2002**

Banka e Shqipërisë përfundon implementimin e strategjisë për krijimin e një banke qendrore me të gjitha tiparet dhe cilësitë e një banke moderne, duke pasur ndihmën e Misionit të Asistencës Teknike pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, MAE.

### **1 korrik 1992**

Me vendimin nr.288 të Këshillit të Ministrave "Për sistemin valutë", miratohen disa akte të rëndësishme lidhur me këmbimin valutë në një ekonomi tregu, ndër të cilat :

Kursi i këmbimit të lekut me valutat e huaja të përcaktohet në treg mbështetur në kërkesën dhe ofertën.

Banka e Shqipërisë përcakton bankat dhe agjentët e tjerë të këmbimeve valutore.

Banka e Shqipërisë llogarit dhe shpall çdo ditë kursin mesatar që mbizotëron në treg.

Të gjitha firmat dhe individët që veprojnë në sektorin e eksportit, veprimet me valutën t'i kryejnë nëpërmjet sistemit bankar.

Firmat dhe individët janë të lirë të mbajnë llogari në valutë në bankat brenda vendit.

Vetëm bankat autorizohen të hapin llogari jashtë shtetit.

Bankat janë të detyruara të mbajnë rezervë mbulesë 100 për qind për depozitat në valutë.

Për pagesat dhe për transaksionet korente nuk ka kufizime. Për të rritur efektivitetin dhe

kontrollin mbi transferimin jashtë shtetit të kapitaleve do të vendosen disa kufij.

Transferimi i kapitalit jashtë vendit bëhet me miratim të Bankës së Shqipërisë.

Hyrjet e kapitalit të regjistruar mund të transferohen lirshëm në rrethana normale.

Dërgesa e fitimit dhe dividendit të këtij kapitali, transferohet lirshëm në vendin e origjinës.

### **11 korrik 1992**

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zoti Ilir Hoti i propozon Këshillit të Ministrave zotin Kristaq Luniku në pozicionin e Zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

### **14 korrik 1992**

Banka e Shqipërisë iu dërgon bankave të nivelit të dytë Sistemin Raportues lidhur me gjendjen financiare të bankave, që bankat çdo muaj duhet të fillojnë të paraqesin në Bankën e Shqipërisë si autoriteti mbikëqyrës i sistemit bankar.

Mbi këtë bazë, filloi dhe puna për ndarjen e Bilancit të Bankës Qendrore nga llogaritë e Bankës së Shtetit Shqiptar.

(Ndarja e bilancit të Bankës së Shtetit Shqiptar në pjesën e bankës qendrore dhe në pjesën e bankës tregtare sipas të dhënave të tremujorit III të vitit 1991.)

### **16 korrik 1992**

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë nxjerr udhëzimin "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave "Për sistemin e tregut valutë"". Aty ndër të tjera trajtohen :

- përdorimi i kursit të tregut për këmbimet valutore,
- përcaktimi, që në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë kontratat dhe veprimet e tregtisë të kryhen në lekë.

### ***korrik 1992***

Banka e Shqipërisë i jep 22 subjekteve të drejtën për të vepruar si agjente në tregun valutor.

### ***20 korrik 1992***

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 301, emëron zotin Kristaq Luniku, Zëvendësguvernator të Bankës së Shqipërisë.

### ***26 korrik 1992***

Bordi i Drejtorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar përfundon për herë të parë, konsultimet për Shqipërinë rreth Artikullit IV, i cili kryhet në mënyrë ciklike për një periudhë prej 12 muajsh. Drejtorët mirëpritën veprimet e ndërmarra nga Shqipëria, ndërkohë që kërkuan më shumë punë dhe vëmendje për të luftuar hyrjen në hiperinflacion. Ata theksuan nevojën e reformave strukturore si çelësi për të ardhmen ekonomike në vend, sidomos privatizimin, reformën në sektorin financiar dhe në bazën ligjore.

Pas zgjedhjeve kombëtare të vitit 1992, qeveria e re demokratike nisi një program për fillimin e procesit të tranzicionit për kalimin drejt një ekonomie tregu. Programi mbështetej nga financime të jashtme në shuma të mëdha, duke përfshirë një hua për importet kritike akorduar nga Banka Botërore, një marrëveshje për një hua stand-by 12- mujore me Fondin Monetar Ndërkombëtar si dhe mbështetje për bilancin e pagesave dhe asistencë nga donatorë të tjerë të Bashkimit Evropian.

### ***5 gusht 1992***

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr.332 emëron: zotin Ilir Hoti , Guvernator i Bankës së Shqipërisë, Guvernator i Republikës së Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar.

### ***gusht 1992***

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij, nr.334, me propozim të Bankës së Shqipërisë, emëron zotin Ardian Xhyheri, Drejtor të Përgjithshëm të Bankës Kombëtare.

### ***26 gusht 1992***

Miratohet nga Bordi i Drejtorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, marrëveshja e parë për Shqipërinë në formën *stand-by*, me anë të së cilës i akordohet Qeverisë Shqiptare një hua në një vlerë prej 20 milionë *sdr*, hua e cila skadon në 25 gusht 1993.

### ***4 shtator 1992***

Banka e Shqipërisë iu dërgon bankave të nivelit të dytë kursin fiks të fiksuar të valutave të huaja në raport me lekun, që do të përdoret për evidentimin e tyre në kontabilitet duke bërë rivlerësimin e të gjitha llogarive në valutë. Ndërsa blerjet në sportele do të evidentohen me kursin fleksibël.

### **shtator 1992**

Banka e Shqipërisë përfiton një grant nga programi *Phare*, program i financuar nga Komuniteti Evropian, në kuadrin e nxitjes dhe përmirësimit të shërbimeve të investimeve, të shërbimeve bankare dhe të shërbimeve financiare në përgjithësi.

### **17 shtator 1992**

Letër e Këshillit të Ministrave lidhur me bashkëpunimin midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, një ndër fushat e bashkëpunimit është përcaktuar dhe: "Krijimi i bankave të përbashkëta ose private me kapitale të diasporës."

### **shtator 1992**

Banka e Shqipërisë e përcaktuar si një ndër përfituesit e programit *Phare*, për periudhën janar 1992 deri qershor 1993, përfiton një grant për nxitjen e shërbimeve financiare, bankare dhe investimeve.

### **tetor 1992**

Presidenti i Republikës me dekretin nr.323, emëron Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të përbërë nga: Elisabeta Gjoni, Këshilltare e Presidentit të Republikës për çështjet ekonomike; Robert Çeku, Zëvendësministër i Financave; Halit Xhafa, pedagog, Fakulteti Ekonomik, Universiteti Shtetëror i Tiranës.

### **20 tetor 1992**

Nënshkruhet marrëveshja midis Bankës së Shqipërisë dhe Banca di Roma për themelimin e Bankës Italo-Shqiptare. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 89, datë 18.06.1998 vendosi pajisjen e Bankës Italo-Shqiptare me licencë për të vazhduar veprimtarinë bankare në përputhje me ligjin nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

### **nëntor 1992**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë emeton obligacionet për mbulimin e kredive të pakthyera të kooperativave bujqësore, 1.9 miliardë lekë për kryerjen e veprimeve me Bankën e Bujqësisë dhe të Zhvillimit.

### **nëntor 1992**

Bankën e Shqipërisë e viziton Misioni i Asistencës Teknike pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN-së), MAE, me qëllim implementimin e politikave monetare. Rekomandohen çështje për modernizimin e sistemit financiar shqiptar.

### **dhjetor 1992**

Banka e Shqipërisë nxjerr disa udhëzime për ndryshime në sistemin e pagesave, të cilat kanë fuqinë e një urdhëri të detyrueshëm për t'u zbatuar nga bankat. Këto udhëzime përbëjnë sistemin e ri të pagesave, që përmban:

- Urdhërhirime, kërkesë - arkëtimet dhe çeket e lëshuara nga ndërmarrje paguhen vetëm në qoftë se ka gjendje në llogaritë e tyre në bankë.
- Radhën e shlyerjes së detyrimeve e përcakton vetë ndërmarrja.

-Në qoftë se ndërmarrja nuk ka gjendje në llogari për urdhërhirimet, kërkesë- arkëtimet dhe çeket e lëshuara, ajo gjohet nga banka në masën 5 për qind të shumës së prapësuar por jo më shumë se 50.000 lekë.  
-Mjete të sistemit të pagesave janë urdhërhirimi, kërkesë - arkëtimi dhe çeku.

*Bankat e nivelit të dytë :*

- Banka Kombëtare e Shqipërisë
- Banka Shqiptare e Tregtisë
- Banka e Bujqësisë dhe Zhvillimit
- Banka e Kursimeve

### ***5 dhjetor 1992***

Banka e Shqipërisë në mbështetje të ligjit numër 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" i jep licencën për të vepruar si bankë, Bankës Arabo-Shqiptare Islamike.

### ***11 dhjetor 1992***

Banka e Shqipërisë i jep Bankës së Kursimeve licencën nr. 2, për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.

### ***18 dhjetor 1992***

Drejtorja e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, kryen ekzaminimin e parë në vend, në Bankën e Kursimeve, me objekt "kreditin në valutë, kreditin në lekë dhe rezervat valutore".

### ***30 dhjetor 1992***

Vendimi nr.1 i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë për bashkimin e Bankës Shqiptare të Tregtisë me Bankën Kombëtare Shqiptare dhe për krijimin e Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë.

Ky vendim është paraprirë nga vendimi i Bordit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i datës 28 dhjetor 1992, mbështetur në materialin e lënë nga misioni i Bankës Botërore "Mbi organizimin e sistemit bankar".

### ***1 janar 1993***

Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë fillon aktivitetin bankar.

### ***shkurt 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton një udhëzim "Mbi normat e mbikëqyrjes për nivelin maksimal të kredive" propozuar nga Drejtorja e Mbikëqyrjes.

### ***shkurt 1993***

Banka e Shqipërisë krijon Qendrën e Trainimit të Bankierëve pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Tiranës.

### ***mars-prill-qershor 1993***

Banka e Shqipërisë dhe Misioni i Asistencës Teknike, MAE, pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, që viziton Bankën e Shqipërisë në këtë periudhë, bashkëpunojnë për sistemin e pagesave dhe kleringut, për tregjet e bonove të thesarit dhe për ligjin "Mbi çekun dhe kambialet".

#### *Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë*

<i>Ilir Hoti</i>	<i>Guvernator,</i>
<i>Kristaq Luniku</i>	<i>Zëvendësguvernator dhe Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Monetar dhe Statistikës,</i>
<i>Adrian Fullani</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Jashtme,</i>
<i>Fahri Hoxha</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Emisioni dhe të Administrimit të Parasë,</i>
<i>Everest Musta</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit,</i>
<i>Halo Agaj</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Organizim Personelit,</i>
<i>Bedri Çollaku</i>	<i>Drejtor i Mbikëqyrjes,</i>
<i>Stefan Sevo</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit.</i>

### ***prill 1993***

Një përfaqësues rezident i Fondit Monetar Ndërkombëtar, zoti Wei Ding, vendoset në Tiranë. Kjo intensifikon më tepër marrëdhëniet midis Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Qeverisë Shqiptare në përgjithësi, dhe Bankës së Shqipërisë në veçanti.

### ***28 prill 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton udhëzuesin metodik "Për analizën e portofolit të huave dhe fondet rezervë për mbulimin e rreziqeve" të përgatitur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes.

Sipas udhëzimit huatë me probleme klasifikohen:

- *hua nënstandarde, kalon afati i maturimit, e pakthyer mbi 60 ditë-norma e provigjonimit 20 për qind;*
- *hua të pasigurta, kalon afati i maturimit, e pakthyer mbi 90 ditë-norma e provigjonimit 50 për qind;*
- *hua të humbura, kalon afati i maturimit, e pakthyer mbi 180 ditë-norma e provigjonimit 100 për qind.*

Mbështetur në këtë udhëzues u hartuan edhe disa pasqyra për raportimin çdo tremujor në Bankën e Shqipërisë nga bankat e nivelit të dytë.

### ***28 prill 1993***

Drejtorja e Mbikëqyrjes harton pyetësoin "Për kontrollin e brendshëm", si udhëzues për fushën e kontrollit të brendshëm të bankave.

### ***29 prill 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton dokumentin e përgatitur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes "Mbi përcaktimin e kapitalit, rezervës dhe ndarjen e fitimit të bankave tregtare.

Miratohet shuma minimale e kapitalit të paprekshëm (000/lekë).

Banka Kombëtare Tregtare	2.700
Banka e Kursimeve	700
Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit	800



Përdorimi i fitimit neto dhe përqindjet e ndarjes së fitimit neto:

	Shtohet kapitali i paprekshëm	Shtohet fondi minimal i rezervës
Banka Kombëtare Tregtare	60	20
Banka e Kursimeve	65	20
Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit	65	20

Fondi minimal i rezervës deri në 100 për qind të shumës minimale të kapitalit të paprekshëm. Përbërja dhe raporti i kapitalit bazë dhe kapitalit plotësues. Kapitali bazë përbëhet nga :

- shuma minimale e kapitalit të paprekshëm;
- fondi minimal i rezervës (rezerva ligjore).

Kapitali plotësues përbëhet nga :

- rezerva statutoare;
- rezervat e rivlerësimit të aktiveve;
- rezerva për rreziqe të përgjithshme për humbje të paplanifikuara;
- të tjera rezerva dhe fonde.

Kapitali bazë duhet të jetë jo më pak se 50 për qind e totalit të kapitalit (kapitali bazë plus kapitalin plotësues).

### ***prill-maj 1993***

Banka e Shqipërisë diskuton me Misionin e Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, LEG/MAE, që viziton Bankën e Shqipërisë draftin e ligjit "Mbi çekun", ligjin "Mbi notat e premtimit", disa rishikime dhe korigjime në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" si dhe draftin për Statutin e Bankës së Shqipërisë.

### ***14 maj 1993***

Nënshkruhet marrëveshja midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës së Shqipërisë lidhur me kalimin e pronësisë nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit tek Banka Kombëtare Tregtare të disa sipërfaqeve toke dhe të një vlere pasurie të paluajtshme (aktive fikse). Kjo pasuri është përdorur si pjesëmarrje e Bankës Kombëtare Tregtare tek Banka Arabo-Shqiptare Islamike.

### ***qershor 1993***

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 8, datë 5 qershor 1993 vendosi riprodhimin jashtë vendit, pranë shoqërisë angleze "Thomas De LA Rue" të kartëmonedhave 200, 500 dhe 1000 lekëshe. Rishtypja e këtyre kartëmonedhave është bërë e domosdoshme si pasojë e ritmeve të rritjes së monedhës në qarkullim dhe e parashikimeve të bëra nga Drejtoria e Politikës Monetare dhe Statistikave.

### ***qershor 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton udhëzimin "Mbi politikat e kreditit dhe procedurat e kreditimit të bankave të nivelit të dytë", i përgatitur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, dhe dërguar bankave për zbatim.

### ***qershor 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton një udhëzim "Për kryerjen e veprimeve me personat e lidhur me bankën" të propozuar nga Drejtoria e Mbikëqyrjes.

### ***qershor 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton normat e mbikëqyrjes për pozicionet e hapura në monedhë të huaj. Këto norma së bashku me udhëzim metodik "Për rreziqet nga këmbimet valutore" të përgatitur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, iu janë dërguar bankave për zbatim dhe raportim.

### ***korrik 1993***

Zyrtarisht fillon aktiviteti i Bankës Italo-Shqiptare. Kapitali i saj 10 milionë usd, i nënshkruar nga Banca di Roma dhe Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë.

Në zbatim të marrëveshjes së datës 26 nëntor 1992, midis Bankës së Shqipërisë, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Banco di Roma, Kuvendi Shqiptar me anën e ligjit nr. 7649, datë 16.12.1992 "Për krijimin e Bankës së Përbashkët Italo-Shqiptare" ka miratuar krijimin e kësaj banke si dhe statutin e saj.

Gjithashtu, mbështetur në ligjin nr. 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" kjo bankë u regjistrua dhe si person juridik, në Gjykatën e rrethit Tiranë.

### ***29 korrik 1993***

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë në vendimin e tij nr.11, mbështetur në gërmën "d" të nenit 49, të ligjit nr.7559, datë 22.04.1992 "Për Bankën e Shqipërisë" vendosi miratimin e Statutit të Bankës së Shqipërisë, si akt nënligjor mbi bazën e të cilit organizohet dhe vepron Banka e Shqipërisë.

Në nenin 3, pika 1 të këtij Statuti thuhet:

Banka e Shqipërisë e ka qendrën në Tiranë dhe filiale në rrethet: Tiranë, Shkodër, Korçë, Lushnje, Mat, Elbasan dhe Gjirokastrë.

### ***14 korrik 1993***

Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar miraton marrëveshjen ESAF (Enhanced Structural Adjustment Facillites), një hua me terma të zbutur që FMN jep për vendet anëtare, të cilat janë duke ndërmarrë programe reformash ekonomike për të forcuar bilancin e tyre të pagesave dhe për përmirësimin e rritjen ekonomike të tyre. Ato mbartin një interes prej 0.5 për qind në vit. Kredia kap një vlerë prej 42.36 milionë sdr dhe përfundon më 13 korrik 1996.

### ***gusht 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miraton udhëzimin "Për minimumin e kërkesave që duhet të plotësojnë administratorët dhe drejtuesit e bankave tregtare", i përgatitur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, dhe dërguar bankave për zbatim. Ky udhëzim nxirret në zbatim të ligjit numër 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

### ***gusht-shtator***

Banka e Shqipërisë bashkëpunon në fushën e mbikëqyrjes bankare me ekspertët e Misionit të Asistencës Teknike MAE, pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar.

### ***19 tetor 1993***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zoti Ilir Hoti jep dorëheqjen nga posti i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

### ***tetor 1993***

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë i propozon Presidentit të Republikës, zotin Dylber Vrioni, në postin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

## **Dylber Vrioni**

*Guvernator i Bankës së Shqipërisë,  
Shtator 1993 - Dhjetor 1994*

*Datëlindja: 4 qershor 1946.*

*Vendlindja: Berat.*



## **Shkollimi**

**1953-1960** Shkolla 7-vjeçare "Lidhja e Prizrenit", Tiranë.

**1960-1964** Shkolla e mesme "Sami Frashëri", Tiranë.

**1964-1970** Universiteti i Tiranës, Dega e Inxhinierisë Mekanike.

## **Eksperiencë pune**

**1971-1976**, Uzina Mekanike Peshkopi, inxhinier

**1976-1986**, Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Mekanike, konstruktor makinash e pajisjesh si dhe detyra drejtuese projektimi.

**1986-1990**, Uzina Elektroteknike Tiranë, drejtues i sektorit të teknologjisë në byronë teknike.

**1991 - 1993**, funksione partiake.

**1992**, Deputet i Tiranës në Kuvendin e Shqipërisë.

**1993**, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

**Dhjetor 1994**, Ministër i Financave dhe Zëvendëskryeministër, për reformën ekonomike dhe privatizimin.

**1996**, Deputet i Beratit në Kuvendin e Shqipërisë.

**Korrik 1996**, Ministër i Privatizimit.

**Korrik 1997**, Firmë konsulence për menaxhim të përgjithshëm, menaxhim financiar, projektsh zhvillimi dhe negociata të ndryshme biznesi.

### **tetor 1993**

*Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë*

<i>Dylber Vrioni</i>	<i>Guvernator,</i>
<i>Kristaq Luniku</i>	<i>Zëvendësguvernator,</i>
<i>Bedri Çollaku</i>	<i>Drejtor i Mbikëqyrjes,</i>
<i>Everest Musta</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit,</i>
<i>Stefan Sevo</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit,</i>
<i>Halo Agaj</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Organizimit Personelit,</i>
<i>Rexhina Bajraktari</i>	<i>Drejtoreshë e Drejtorisë së Informatikës,</i>
<i>Fahri Hoxha</i>	<i>Drejtor i Drejtorisë së Emisionit dhe të Administrimit të Parasë,</i>
<i>Adrian Fullani</i>	<i>Drejtori i Drejtorisë së Jashtme.</i>

### **nëntor 1993**

Banka e Shqipërisë paraqet Raportin Vjetor për vitin 1992 (raporti i parë i saj si Bankë Qendrore).

### **dhjetor 1993**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë i jep licencën nr.5 Bankës Dardania, për të vepruar si bankë me qendrën e saj në Tiranë, në zbatim të ligjit numër 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

### **mars 1994**

Banka e Shqipërisë diskuton gjatë vizitës të Misionit të Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, STA, pranë Bankës së Shqipërisë, mbi çështje të statistikave monetare dhe bankare dhe, përmirësimin e tyre.

### **mars- maj 1994**

Banka e Shqipërisë dhe misioni i asistencës teknike MAE pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, që viziton Bankën e Shqipërisë, bashkëpunojnë për identifikimin e nevojave me subjekt shtëpitë e kleringut të çeqeve.

### **12 maj 1994**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr.1 miratoi rregulloren "Për dhënien e licencave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë".

Baza ligjore për miratimin e kësaj rregulloreje nga Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë janë nenet 6 dhe 16 të ligjit nr. 7559, datë 22 prill 1992 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe nenet 8 dhe 14 të ligjit "Për sistemin bankar në Shqipëri". Kjo rregullore krijon bazën rregullatore dhe përcakton kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet e ndryshme për marrjen e licencës për të kryer aktivitet bankar.

### **25 korrik 1994**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 5 miraton rregulloren për emetimin e letrave me vlerë të qeverisë në formë regjistrimi, si dhe procedurat e blerjes dhe të maturimit të tyre.

### **shtator 1994**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë miraton rregulloren për rirfinancimin e bankave të nivelit të dytë dhe të institucioneve të tjera që iu ka dhënë licencë për të pranuar depozita si dhe për të kryer transaksione kreditimi, duke iu dhënë hua kundrejt kolateraleve dhe riskontimit të letrave me vlerë të tregtueshme.

### **shtator 1994**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë miraton rregulloren "Mbi procedurat e llogaritjes dhe kontrollit të rezervës së detyrueshme" si një nga instrumentet e politikës monetare me anën e të cilit banka qendrore kontrollon ofertën e parasë duke ndryshuar normat në përqindje të saj.

### **21 shtator 1994**

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë miraton për herë të parë "Metodikën për paraqitjen e gjendjes monetare".

### **26 shtator 1994**

1. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.12 miraton: "Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 1993".
2. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr.13 miraton: Për herë të parë "Deklaratën e Politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 1994 dhe objektivat për gjashtëmujorin e dytë 1994".
3. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendim nr.14 miraton: Shitjen e aksioneve të Bankës së Shqipërisë tek "Bank of Attica".

### **shtator 1994**

Miratohet rregullorja e "CLEARINGHOUSE" për sistemin e pagesave.

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë:*

*Dylber Vrioni - Kryetar  
Elisabeta Gjoni - Anëtare  
Kristaq Luniku - Anëtar  
Robert Çeku - Anëtar  
Halit Xhafa - Anëtar*

### **23 dhjetor 1994**

Me anë të dekretit nr. 996, Presidenti i Republikës emëron zotin Kristaq Luniku Guvernator të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Bankës së Shqipërisë.

### **14 shkurt 1995**

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.70 emëron zotin Palok Kolnikaj dhe zonjën Rexhina Bajraktari, Zëvendësguvernatorë të Bankës së Shqipërisë.

### ***9 mars 1995***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr.7 miraton studimin mbi strukturën e prerjeve, përmasave, elementet e sigurisë dhe sasinë e emisionit të ri të monedhës shqiptare.

### ***mars 1995***

Këshilli i Ministrave miraton "Memorandumi i Mirëkuptimit midis Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë" mbi akordimin e grantit prej 35 milionë ecu për mbështetjen e bilancit të pagesave, Banka e Shqipërisë ngarkohet si agjente për të vepruar në emër të qeverisë.

### ***mars 1995***

Nënshkruhet "Memorandumi i Mirëkuptimit midis Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë", në kuadrin e asistencës makroekonomike. Memorandumi u nënshkrua për palën shqiptare nga Ministria e Financave dhe për Bankën e Shqipërisë nga Guvernatori Kristaq Luniku. Banka e Shqipërisë do të veprojë si agjent i Qeverisë Shqiptare për zbatimin e pikave të parashikuara nga ky memorandum. Bazuar në këtë dokument u akordua granti prej 35 milionë ecu për mbështetjen e bilancit të pagesave.

### ***7 prill 1995***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 12 miraton sasinë e prodhimit të parë të emisionit të ri të monedhës shqiptare i ndarë në strukturë për çdo prerje.

Sasia 85 milionë copë kartëmonedha në vlerë 56.4 miliardë lekë dhe 62.5 milionë copë monedha metalike me vlerë 1.020 milionë lekë.

## **Kristaq Luniku**

*Guvernator i Bankës së Shqipërisë  
Dhjetor 1994 - prill 1997*

*Datëlindja: 3 gusht 1962.*

*Vendlindja: Korçë.*

### **Shkollimi**

*Diplomuar në Fakultetin Ekonomik, dega Financë.  
1999 ka përfunduar MBA Business School, në Universitetin e  
Miçiganit, SHBA.*



### **Eksperiencë pune**

*1986 - 1992, funksione të ndryshme në Bankën e Shtetit Shqiptar në degë dhe në Drejtorinë e Përgjithshme.  
1992 - 1994, Zëvendësguvernator i Bankës së Shqipërisë .  
1994 - 1997, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.  
1997 e në vazhdim Banka Botërore- FMN.*

*Aktualisht punon në Bankën Botërore, si Këshilltar i Drejtorit Ekzekutiv për Evropën Juglindore. Fushat e veprimtarisë profesionale janë :*

*Evropa dhe Azia Qendrore, Kina, Koreja e Jugut, Tajlanda.  
IFC, MIGA investimet dhe politikat.  
Komiteti i Auditimit, Manaxhimi i Riskut (World Bank Group).  
Bankë, Reforma në Financë dhe Pensione.  
Zhvillimi i Sektorit Privat dhe Garantuesit e IBRD.  
Shkrirjet dhe blerjet e korporatave.  
Investimet në kushtet e pasigurisë.  
Konkurrenca në industrinë e fluturimeve ajrore.  
Analiza e biznesit dhe modelet e vlerësimit.  
Liberalizimi i sektorit energjetik në SHBA.*

### ***21 prill 1995***

Banka e Shqipërisë boton broshurën "Të njohim e të përdorim çekun". Mbështetur në dekretin nr.3702, datë 08.07.1963 dhe në ligjin nr.7782, datë 26.01.1994 "Për disa shtesa dhe ndryshime në dekretin nr.3702, datë 8.7.1963".

Në datën 21.04.1995 vendoset futja e çekut të Bankës së Shqipërisë si mjet pagese.

### ***maj 1995***

Banka e Shqipërisë ngarkohet si agjente për zbatimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Republikës së Austrisë në shumën 20 milionë shilinga austriake në kuadrin e bilancit të pagesave. Në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, Banka e Shqipërisë ngarkohet edhe si administratore e fondeve të akorduara.

### ***maj 1995***

Këshilli i Ministrave miraton në parim kontratën financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimit për shumën prej 10 milionë ecu, për financimin e projekteve të ndryshme në Shqipëri. Banka e Shqipërisë ngarkohet si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e kontratës dhe për të vepruar në emër dhe për llogari të Qeverisë.

### ***maj 1995***

Miratohet marrëveshja për shlyerjen e borxhit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore për shumën prej 25 milionë usd. Banka e Shqipërisë ngarkohet për kryerjen e veprimeve të nevojshme me fondet e akorduara sipas marrëveshjes.

### ***14 qershor 1995***

Këshilli Drejtues i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr.22 miraton rregulloren "Për dhënien e licencave për të vepruar si bankë private në Republikën e Shqipërisë".

Në këtë rregullore përcaktohen të gjitha kërkesat për marrjen e një licence për të hapur një bankë. Kërkesa për kapital minimal për hapjen e një banke është :

100 milionë lekë për bankë private me kapital tërësisht shqiptar;

200 milionë lekë për bankë private me kapital tërësisht të huaj ose me kapital shqiptar dhe të huaj.

### ***27 korrik 1995***

Këshilli i Ministrave miraton vendimin nr.394 "Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit ndërmjet KFW-së dhe Bankës së Shqipërisë dhe marrëveshjen e garancisë në këtë kuadër ndërmjet KFW dhe Republikës së Shqipërisë".

Bazuar në vendimin e mësipërm, miratohet nënshkrimi i marrëveshjes së kredisë dhe garancisë së projektit ndërmjet agjencisë së kjuar me financimin e Shtetit Gjerman, KFW dhe Bankës së Shqipërisë, në shumën prej 7 milionë dm, ku përfshihet edhe krijimi i "Fondacioni për Financimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe për Zhvillim". (FEFAD)

### ***nëntor 1995***

Pireas Bank Greqi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e licencës për të vepruar si bankë në Shqipëri.



### **21 nëntor 1995**

Nënshkruhet urdhër i përbashkët i Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit "Mbi shtypjen e bonove të privatizimit nga Banka e Shqipërisë".

### **23 nëntor 1995**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr.7, vendos dhënien e kredive lehtësuese afatgjata për strehimin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë dhe për përmirësimin e kushteve të banimit. Në zbatim të tij hartohet udhëzimi përkatës dhe ngrihet komiteti i dhënies së kredisë.

### **23 nëntor 1995**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr.7, i jep licencën për të vepruar si bankë "Bankës Kombëtare Tregtare", në zbatim të ligjit numër 7560, datë 28.04.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

### **18 dhjetor 1995**

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr. 705 vendos miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për ndihmën për bilancin e pagesave, për mbështetjen e programit të zvoglimit të borxhit tregtar shqiptar.

Banka e Shqipërisë ngarkohet të veprojë si agjente e Qeverisë Shqiptare, për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

### **janar 1996**

Banka Kombëtare e Greqisë paraqet kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e licencës për hapjen e një dege të saj në Shqipëri.

### **29 janar 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.1, miraton Njoftimin Zyrtar LO 1/96 "Mbi kredinë lombard".

Kredia lombard, e cila filloi të zbatohet si një instrument i politikës monetare, paraqet një kredi afatshkurtër plotësisht të kolateralizuar me letra me vlerë të qeverisë ose me letra me vlerë afatshkurtra, të pranuar nga Banka e Shqipërisë.

Çdo bankë e nivelit të dytë, për të zgjidhur problemet e përkohshme të mungesës së likuiditetit, përfiton kredinë lombard në masën 5 për qind të kapitalit të miratuar në licencën e marrë në Bankën e Shqipërisë.

Bankat kanë të drejtë të shfrytëzojnë këtë mundësi vetëm dy herë në muaj dhe afati i kthimit është deri në dy javë pune.

### **29 janar 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton disa ndryshime në rregulloren "Mbi refinancimin kundrejt kolateraleve dhe riskontimit të letrave me vlerë të tregtueshme". Kredia e refinancimit është një kredi plotësisht e kolateralizuar që jepet për një afat tremujor, pasi janë përdorur mundësitë e tjera.

### **janar - shkurt 96**

Banka e Shqipërisë merr vendimin për mbylljen e filialeve në Tiranë dhe në Mat.

### **5 mars 1996**

Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, për rakordimin e saldosh të llogarish të speciale për veprimet e kleringut në usd. Ky memorandum nënshkruhet në kuadrin e marrëveshjes për rristrukturimin e borxhit të jashtëm të vendit.

### **6 mars 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton rregulloren "Mbi funksionimin e tregut me pakicë të bonove të thesarit në Shqipëri".

Banka e Shqipërisë krijon dhe mbështet tregun sekondar dhe me pakicë të bonove të thesarit të Qeverisë Shqiptare. Tregu sekondar është një treg me shumicë në të cilin bonot tregtohen midis tregtarëve të tregut primar. Tregtarë të tregut primar janë: banka, institucione financiare dhe brokera të licencuar që autorizohen nga Banka e Shqipërisë për të marrë pjesë në ankandet e tregut primar. Tregu me pakicë i bonove të thesarit është tregu në të cilin tregtarët e tregut primar mund të shesin dhe të riblenjë bonot e thesarit nga publiku, duke përfshirë shoqëritë, organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse dhe individët.

### **11 mars 1996**

Presidenti i Republikës dekreton shpalljen e ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë".

### **14 mars 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.4 miraton dhënien e licencës degës së Bankës Kombëtare të Greqisë në Tiranë, për të ushtruar aktivitetin bankar në Republikën e Shqipërisë, në bazë të ligjit nr.8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë", datë 14.06.1995.

### **28 mars 1996**

Këshilli Mbikëqyrës deklaron të mbyllur tenderin e organizuar në gusht 1995 dhe shfuqizon vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës së Shqipërisë nr. 2, datë 28.08.1995, për shtypjen e emisionit të ri të kartëmonedhës, pasi shoqëritë fituese nuk zbatuan kushtet e vendosura nga Banka e Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës miraton prokurim të drejtpërdrejtë për prodhimin e emisionit të ri të kartëmonedhës dhe zgjedhjen e shoqërisë angleze Thomas De La Rue me prokurim të drejtpërdrejtë për shtypjen e emisionit të ri të kartëmonedhës shqiptare.



*Seri e vitit 1996 (emisioni i ri).*

**28 mars 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton krijimin e Departamentit të Bursës, si pjesë përbërëse e strukturës së Bankës së Shqipërisë.

**12 prill 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.7 vendos të miratojë aderimin e Bankës së Shqipërisë si anëtare në Grupin e Mbikëqyrjes të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

**30 prill 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të japë miratimin paraprak për krijimin e "Bankës Tirana" krijuar nga aksioneri kryesor Banka e Pireut, Greqi, mbështetur në ligjin nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

**30 prill 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mos miratojë dhënien e licencës paraprake për krijimin e degëve të tyre në Shqipëri të Alpha Credit Bank dhe Banka Joniane Popullore, Greqi. Arsyeja e këtij mosmiratimi është që Këshilli Mbikëqyrës e shikon më me përparësi hapjen e bankave të inkuorporuara në Shqipëri se sa degët e bankave të huaja. Vendim politik i Këshillit Mbikëqyrës.

### **30 prill 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos (me vendim qarkullues) të përfundojë kontratën për riprodhimin e kartëmonedhave në qarkullim, për të plotësuar nevojat e ekonomisë me shoqërinë "AB TUMBA BRUK", Suedi.

### **11 qershor 1996**

Nënshkruhet marrëveshja mbi organizimin dhe mënyrën e qeverisjes së Grupit të Mbikëqyrësve Bankarë të Vendeve të Evropës Lindore. Bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.7, datë 12.04.1996, Banka e Shqipërisë është mes 15 bankave qendrore dhe autoriteteve rregullatore nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.

### **28 qershor 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.15, vendos:

1. të miratojë rregulloren "Për dhënien e licencave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë" në bazë të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë". Shuma e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për hapjen e një banke është 200 milionë lekë;

2. të mos miratojë dhënien e licencës paraprake për krijimin e bankës "Iliria" sh.a. me aksioner zotin Vehbi Alimuça. Arsyeja e këtij mosmiratimi është mosplotësimi i kërkesave të ligjit nr.8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" për licencimin e një banke.

### **16 gusht 1996**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.16, pika 8 miraton:

1. rregulloren e mbikëqyrjes bankare "Mbi mjaftueshmërinë e fondeve të veta (kapitalit) të Bankës së Shqipërisë". Kjo rregullore sjell disa elemente të reja:

- bankat e llogarisin vetë raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- detyron bankat e nivelit të dytë të llogarisin dhe të raportojnë çdo tre muaj këtë tregues në Bankën e Shqipërisë,
- niveli minimal i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit përcaktohet 8 për qind, sipas direktivave të Komitetit të Baselit për një mbikëqyrje efektive, duke eliminuar dy nivelet 15 për qind për bankat e huaja dhe 8 për qind për bankat shtetërore.
- Saktësohet trajtimi i llogarive jashtë bilancit.

2. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.16, pika 9 miraton:

rregulloren e mbikëqyrjes bankare " Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave të nivelit të dytë". Kjo rregullore sjell disa elemente të reja:

- zëvendëson udhëzimin e mëparshëm, i cili kryesisht nuk është zbatuar nga bankat;
- vë theksin më shumë në kërkesat lidhur me arsimin, me eksperiencën, me kualifikimin dhe me reputacionin e administratorëve të bankave;
- ndalon marrjen në punë të një administratori që është larguar nga puna në bankë apo institucion tjetër financiar, për shkak të shkeljes së legjislacionit, rregulloreve të miratuara apo të shpërdorimit të detyrës;
- u lihet bankave që të përcaktojnë rregulla të përshtatshëm etikë për administratorët dhe për punonjësit e tyre.

### ***nëntor 1996***

Nis faza e parë e hartimit të Planit Kontabël për sistemin bankar. Kjo gjë u realizua në kuadrin e programit *Phare* lidhur me reformën bankare dhe në përputhje me memorandumun e mirëkuptimit të nënshkruar midis Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë. Plani i ri kontabël do të ndërtohej në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe me rekomandimet e Komunitetit Evropian për kontabilitetin.

Projekti realizohet me ndihmën e ekspertëve francezë të kompanisë “Ernst & Young” dhe do të zhvillohet në tre faza:

Faza I	Nëntor 1996 - Shkurt 1997.
Faza II	Mars 1997-Nëntor 1997.
Faza III	Janar1998 –Nëntor 1998.

Ky projekt realizohet me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian, programi *Phare*.

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr. 911, datë 02.12.1996 vendosi për krijimin e Komisionit të Posaçëm Qeveritar për negocimin e marrëveshjes së re me Bashkimin Evropian. Në këtë komision merr pjesë edhe Banka e Shqipërisë me një anëtar.

### ***27 dhjetor 1996***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë merr vendimin për licencimin e Bankës Alpha Credit të Greqisë për hapjen e një dege të saj në Republikën e Shqipërisë.

### ***9 janar 1997***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë nxjerr urdhërin nr. 02/01/97, ku përcaktohen:

- teprica maksimale e lejuar e një llogarie rrjedhëse, në lekë apo në valutë të klientit është 100 milionë lekë. Çdo tepricë mbi këtë kufi në fund të ditës do të kalojë në depozitë me afat;
- afati minimal i maturimit të një depozite është 1 javë;
- çdo klient pavarësisht nga numri i llogarive në një bankë, nuk lejohet të tërheqë në *cash* më shumë se 30 milionë lekë ose kundërvleftën e saj në valutë;
- për tërheqjet mbi 10 milionë lekë banka do të njoftohet nga klienti 5 ditë pune përpara.

### ***9 janar 1997***

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë nxjerr urdhërin nr. 02/02/97 “Për disa masa për ekzekutimin e buxhetit të shtetit për vitin 1997”, i cili përmban:

- veprimet e kryera nga bankat për llogari të buxhetit të shtetit të njoftohen çdo ditë jo më vonë se ora 14;
- pagesat për llogari të buxhetit të shtetit dhe për rimbursimin e bankave do të kryhen kundrejt gjendjes kreditore të llogarisë “Depozitë e qeverisë”;
- bankat do të dërgojnë urdhër për pagesa vetëm kundrejt gjendjes kreditore të llogarisë;
- bankat nuk lejohet të krijojnë shpenzime të parimbursuara për llogari të buxhetit të shtetit, rastet e konstatuara do të penalizohen.

### ***16 janar 1997***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton Statutin e Bankës së Shqipërisë. Ky statut i hartuar në bazë të ligjit përcakton pozicionin juridik të Bankës së Shqipërisë lidhur me statusin e saj të përcaktuar nga ligji, detyrat konkrete dhe procedurat bazë mbi të cilat ushtron aktivitetin e saj Banka e Shqipërisë.

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë:*

*Kristaq Luniku  
Elisabeta Gjoni  
Uran Veseshta  
Omer Stringa  
Baki Berberi  
Albert Gajo*

*Gubernurator  
Zëvendësgubernurator  
anëtar Këshilli  
anëtar Këshilli  
anëtar Këshilli  
anëtar Këshilli*

**16 janar 1997**

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr.44, vendosi ngrirjen e llogarive të fondacioneve “Xhaferi” dhe “Populli” në të gjitha bankat tregtare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. Me këtë vendim, bankat tregtare detyrohen të ngrijnë edhe ato llogari që janë furnizuar me mjete monetare nga këto fondacione.

**16 janar 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 3, pika 1 miraton:

1. “Mbi manualin e ekzaminimit bankar”, përgatitur nga Departamenti i Mbikëqyrjes, i cili përmban:

Objektivat, procedurat dhe përgatitjet paraprake.

Analizën e menaxhimit.

Analizën e aktiveve dhe klasifikimi i kredive.

Analizën e kontrollit të bankës.

Analizën e kapitalit.

Menaxhimin e këmbimeve valutore.

Konkluzionet e ekzaminimit dhe vlerësimin e bankës sipas sistemit CAMELS.

2. Me vendimin nr. 3, pika 2, miraton “Sistemin raportues të bankave të nivelit të dytë”.

Ky sistem, përveç informacionit për veprimtarinë e bankave, i cili ka plotësime dhe saktësime nga i mëparshmi, jep edhe informacion të përgjithshëm për bankat. Në informacionin e përgjithshëm përfshihen:

-të dhëna për këshillin drejtues dhe për anëtarët e tij;

-të dhëna për strukturën organizative dhe për rjetin e bankës;

-informacion për aksionerët e bankës etj..

3. Me vendimin nr. 3, pika 3, miraton rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

Në kushtet kur skemat piramidale janë në lulëzimin e tyre dhe kur ligji për parandalimin e pastrimit të parave nuk ekzistonte po ashtu edhe ndonjë njësi përgjegjëse për këtë problem nuk ishte krijuar, Banka e Shqipërisë merr iniciativën dhe përgatit e miraton rregulloren për të parandaluar përdorimin e sistemit bankar si rrugë për pastrimin e parave. Kjo rregullore vendos disa kufij lidhur me tërheqjen dhe me depozitimin e *cash*-it, vendos disa kërkesa për identifikimin e klientit, liston operacione të cilat mund të konsiderohen si të dyshimta, përcakton dhe detyrimin e bankës për raportim.

4. Me vendimin nr. 3, pika 4, miraton “Statutin e Bankës së Shqipërisë”.

**21 janar 1997**

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr.27 vendosi ngritjen e një komisioni të posaçëm qeveritar për të vlerësuar përmasat reale të fenomenit të huamarrjes në skemat piramidale, pasojat e tij dhe masat që duhen marrë në dobi të huadhënësve, duke synuar mosdëmtimin e mëtejshëm të tyre.

### **3 shkurt 1997**

Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr.47 vendosi që :

- Shpërndarja e pasurive të fondacioneve, të cilat kanë ushtruar veprimtarinë e tyre huamarrëse do të fillojë më 05.02.1997.
- Mjetet monetare do të ngurtësohen pranë bankave, të cilat do të bëjnë shpërndarjen e tyre.
- Banka Kombëtare Tregtare do të shpërndajë pasuritë e fondacionit "Demokracia Popullore Xhaferi", kurse Banka e Kursimeve të fondacionit "Populli".
- Shpërndarja do të bëhet me dy faza:

Faza I- 5 shkurt 1997, mjetet monetare të ngurtësuara në banka në përqindje sipas përcaktimit të Komisionit të Posaçëm. Faza II- do të fillojë me përfundimin e shitjes së të gjitha pasurive të tjera. Të ardhurat që do të grumbullohen sipas kësaj pike, u shpërndahen huadhënësve sipas kuotës së huadhënies personale.

### **13 shkurt 1997**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 6, pika 3 vendos anëtarësimin e Bankës së Shqipërisë në shoqata dhe në federata ndërkombëtare:

Qendra e Trainimit të Bankierëve të Bankës së Shqipërisë, në "Rrjetin Evropian të Institucioneve Bankare të Trainimit";  
Drejtoria Qendrore e Bankës së Shqipërisë, në Shoqatën Universitare Evropiane të Kërkimeve Financiare;  
Departamenti i Bursës së Tiranës, në Federatën Euro Aziatike të Bursave.

### **26 shkurt 1997**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.7, pika 3 miraton rregulloren " Mbi klasifikimin e huave dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë". Sipas kësaj rregulloreje përcaktohet klasifikimi i kredive mbështetur në standardet ndërkombëtare në 5 kategori:

- hua standarde, të siguruara mirë dhe të pagueshme rregullisht sipas afateve të caktuara;
- hua në ndjekje, principali dhe interesi janë paguar 30-90 ditë më vonë se afati i maturimit;
- hua nënstandarde, hua të paguar mirë, principali dhe interesi i papaguar prej 91-180 ditë, klienti nuk ka aftësi për të paguar;
- hua të dyshimta, klienti nuk ka paguar këstin për një periudhë 180-360 ditë dhe ka rrezik të jetë jolikuid;
- hua të humbura, klienti nuk ka paguar për më shumë se 360 ditë.

Normat e provigjionimit në përputhje me klasifikimin e portofolit janë:

- hua standarde 1%
- hua në ndjekje 5%
- hua nënstandarde 20%
- hua të dyshimta 50%
- hua të humbura 100%

### **26 shkurt 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.7/4 miraton rregulloren "Për normat e mbikëqyrjes për nivelin maksimal të kredive".

Normat e mbikëqyrjes :

shuma maksimale e kredisë dhënë një huamarrësi të vetëm ose grupi huamarrësish të lidhur nuk mund të kalojë 15 për qind të fondeve të veta (kapitalit) të bankës;

shuma e kredive dhënë 10 huamarrësve më të mëdhenj të mos kalojë 140 për qind të fondeve të veta të bankës; të gjitha kreditë e mëdha ( që kalon 10 për qind të fondeve të bankës) të mos kalojnë 6 herë fondet e veta të bankës.

### ***mars 1997***

Duke marrë në konsideratë pasigurinë dhe dëmtimet që pësoi sistemi bankar gjatë ngjarjeve të marsit të vitit 1997, Këshilli Mbikëqyrës vendosi ndërprerjen e aktivitetit të degëve të Bankës së Shqipërisë në Shkodër e Gjirokastrë dhe kufizimin e aktivitetit të degëve të Korçës dhe të Lushnjes.

### ***11 prill 1997***

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.12 miraton disa ndryshime në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave". Ndryshimi qëndron në riformulimin e nenit 16 të rregullores :

-për çdo klient tërheqja në *cash* brenda një dite të mos kalojë 30 milionë lekë ose 10 mijë usd. Për shuma mbi 10 milionë lekë klienti do të njoftojë bankën 5 ditë pune përpara;

-banka ndalohet të pranojë derdhje në *cash*, në ditë për klient mbi shumat prej 10 milionë lekësh ose ekuivalentin në monedhë tjetër.

-përfshirja nga kjo, bankat mbështetur në aktivitetin e klientit mund të pranojnë edhe shuma mbi 10 milionë lekë.

Miratimi i ndryshimeve në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave" kishte për qëllim përfshirjen e këtyre kufizimeve lidhur me tërheqjet e *cash*-it nga klientët e bankave të vendosura me një urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Arsyeja e vendosjes së këtyre kufizimeve ishte ruajtja e bankave nga kriza likuiditeti, si efekt i tërheqjeve të mëdha të shoqërive huamarrëse, si dhe përfshirja në sistemin rregullativ të mbikëqyrjes bankare të këtyre kufizimeve.

### ***9 prill 1997***

Kuvendi Popullor me vendimin e tij nr.305, liron nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës zotin Uran Veseshta dhe emëron në vend të tij zotin Qamil Tusha.

### ***21 prill 1997***

Presidenti i Republikës me dekretin nr. 1781 emëron zotin Qamil Tusha, Guvernator të Bankës së Shqipërisë.



## **Qamil Tusha**

*Guvernator i Bankës së Shqipërisë  
Prill 1997 - Shtator 1997*

*Datëlindja: 10 shkurt 1958.  
Vendlindja: Burrel, Mat.*

### **Shkollimi**

**Shtator 1974 - Qershor 1978** Shkolla e mesme e përgjithshme "Haki Fejzo" Burrel.

**Shtator 1979 - Qershor 1983**, diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë Agrare në Institutin e Lartë Bujqësor Kamëz, Tiranë, Dega Financë.



### **Eksperiencë pune**

**Gusht 1983 - Maj 1989**, shef investimesh dhe ekonomist në degën Mat të Bankës së Shtetit Shqiptar.

**Maj 1989 - Prill 1992**, Drejtor i Degës së Bankës Mat, në Bankën e Shtetit Shqiptar.

**Prill 1992 - Qershor 1992**, Shef i kontrollit të degës Tiranë, në Bankën e Shqipërisë.

**Qershor 1992 - Janar 1993**, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Bankës Shqiptare të Tregtisë. Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit të Bankës Shqiptare të Tregtisë.

**Janar 1993 - Prill 1997**, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë; Anëtar Bordit të kompanisë Gjeo-Alba.

**Prill 1997 - gusht 1997**, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, Kryetar i Këshillit Drejtues të Bankës së Shqipërisë, Anëtar i Bordit të Entit Kombëtar të Zonave të Lira.

**Nëntor 1997 - Shtator 1999**, pa punë.

**Shtator 1999 - 2003**, Komisioni i Letrave me Vlerë - Shef i divisionit të Monitorimit.

**2003**, emigrant SHBA.

### **22 maj 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.15/5/97, miraton disa ndryshime në rregulloren "Për dhënien e licencave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë". Ndryshimi qëndron :

" Shuma minimale e kapitalit të kërkuar , të nënshkruar mund të paguhet në monedhën shqiptare (lekë) ose në dollarë amerikanë, që përbëjnë kundravleftën e kapitalit minimal në lekë, vlerësuar me kursin e ditës së kryerjes së veprimit. Pasqyrimi në kontabilitet bëhet më monedhën e paguar."

### **2 qershor 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.16/4/97, miraton disa ndryshime në rregulloren nr.1, datë 28.06.1996 "Për dhënien e licencave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë". Ndryshimi qëndron:

" Shuma minimale e kapitalit të kërkuar , të nënshkruar për kontributin në para, për një bankë është jo më pak se 350 milionë lekë ose kundravlefta e saj në usd."

Gjatë kësaj periudhe në ndryshim nga periudha 1992-1997 ku zhvillimi ekonomik i Shqipërisë u karakterizua nga rritje ekonomike dhe vendosja e një stabiliteti të treguesve makroekonomikë, si pasojë e krizës politike dhe financiare që përshkoi vendin për efekt të rënies së skemave piramidale, monedha kombëtare u zhvlerësua. Në këtë periudhë kemi një nënçmim të theksuar të kursit të lekut ndaj dollarit (nga 100 lekë/usd në 170 lekë/ usd). Ky nënçmim i lekut bëri që Këshilli Mbikëqyrës të vendosë rritjen e kapitalit minimal të kërkuar për hapjen e një banke nga 200 milionë në 350 milionë lekë.

### **8 gusht 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.19/2/97, miraton disa ndryshime në rregulloren "Për tregun e këmbimeve valutore". Këto ndryshime konsistojnë :

" Banka e Shqipërisë në mbështetje të nenit 60 të ligjit nr. 8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë" përcakton politikën e këmbimeve valutore, të cilën e zbaton në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore."

" Në Republikën e Shqipërisë zbatohet regjimi luhatës i kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave të tjera. Kursi i këmbimit të lekut zbatohet në bazë të ofertës në treg."

### **8 gusht 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij 19/3/97 i jep miratimin paraprak me kushte Albanian-American Bank Corporation për të vepruar si bankë në Shqipëri.

### **30 gusht 1997**

Presidenti i Republikës me dekretin nr. 1887 emëron zotin Shkëlqim Cani, Guvernator të Bankës së Shqipërisë.

### **30 gusht 1997**

Presidenti i Republikës me dekretin nr. 1888 emëron zotin Fatos Ibrahim, Zëvendësguvernator të Bankës së Shqipërisë.

## **SHKËLQIM CANI**

*Guvernator i Bankës së Shqipërisë  
30 gusht 1997 e vazhdim*

*Datëlindja: 6 maj 1956.  
Vendlindja: Tiranë.*

### **Shkollimi**

**1972-1976**, Shkolla e mesme "50 vjetori i Pavarësisë", Tiranë.

**1976-1980**, Diplomuar në Degën e Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

**1981-1983**, përfundon Kursin e Plotë Pasuniversitar dyvjeçar të degës së Tregtisë së Jashtme, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Njohuri të thelluara në tregtinë ndërkombëtare, teknikat dhe transaksionet bankare, e drejta në tregtinë e jashtme, marketingun ndërkombëtar, politika e import-eksportit.

**Shkurt-Maj 1985**, Kurs në Politikat dhe Instrumentet Bankare (Analizë Krediti, Vlerësim Projektsh, Këmbime Valutore, Financime të eksporteve dhe importeve etj.) pranë Laenderbank, Vjenë, Austri.

**Janar-Mars 1989**, Kurs i thelluar në Politikat e Analizën e Kreditit, Kuadrin Ligjor e Institucional të Garancive Financiare të Eksportit pranë Deutsche Bundesbank dhe KfW, Gjermani.

**Maj 1994**, Certificate of Studies in Business Administration, Kolegji Heidelbergense Tiffinae, Ohioensis, SHBA.

**Qershor 1994**, Certificate of Studies in Politics and Governmental Policies, Kolegji Heidelbergense Tiffinae, Ohioensis, SHBA.

**1991**, Fiton gradën shkencore "Doktor në Ekonomi", në fushën bankare.

**2003**, Fiton titullin "Profesor".



### **Eksperiencë pune**

*Që nga Gushti 1997, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.*

*1980-1981, Specialist krediti, Banka e Shtetit Shqiptar, Dega e Tiranës.*

*1981-1983, Specialist Eksport-importi, Drejtoria e Përgjithshme, Banka e Shtetit Shqiptar.*

*1984-1985, Ekonomist (Kërkime), Departamenti i Jashtëm, Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar.*

*1985-1990, Drejtor i Departamentit të Jashtëm dhe anëtar i Bordit, Banka e Shtetit Shqiptar*

*1990-1991, Drejtor i Përgjithshëm, Banka Shqiptare e Tregtisë.*

*Shkurt-Qershor 1991, Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.*

*1991-1992, zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Banka Shqiptare e Tregtisë.*

*1991-1996, Deputet në Kuvendin e Shqipërisë.*

*1996-1997, Këshilltar financiar.*

*1997, Deputet në Kuvendin e Shqipërisë.*

### **Veprimtaria pedagogjike**

*1981-1989, Anëtar i Katedrës së Financës dhe Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë.*

*1981-1989, Pedagog i jashtëm në programin universitar dhe pasuniversitar, pranë Fakultetit të Ekonomisë. Temat kryesore të leksioneve: Paraja dhe Banka, Teknikat Bankare Ndërkombëtare, Analiza e veprimtarisë financiare të ndërmarrjeve, Kontabilitetit.*

*1983-1990 and 1997-2002, drejtues teme për studentë diplomatë të shkollës së lartë; drejtues i dy mikrotezave në MBA; oponent në dy teza doktorate në fushën e kontabilitetit dhe atë bankare.*

*1998-2002, lektor i jashtëm në kurse universitare dhe pasuniversitare në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe të Universitetit Bujqësor si dhe në Shkollën e Magjistraturës.*

### **18 shtator 1997**

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë :*

*Shkëlqim Cani - Kryetar  
Fatos Ibrahim - Zëvendëskryetar  
Omer Stringa - Anëtar  
Qamil Tusha - Anëtar  
Sabah Hilmia - Anëtar  
Llazi Balliu - Anëtar  
Artur Kasimati - Anëtar*

### **10 tetor 1997**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.22, miraton me vërejtje përmirësimin e dispozitave ligjore të ligjit nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë".

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë :*

*Shkëlqim Cani - Kryetar  
Fatos Ibrahim - Zëvendëskryetar  
Omer Stringa - Anëtar  
Sabah Hilmia - Anëtar  
Llazi Balliu - Anëtar  
Artur Kasimati - Anëtar  
Drini Salko - Anëtar*

### **7 nëntor 1997**

Fondi Monetar Ndërkombëtar miraton një kredi për Shqipërinë në një vlerë prej 8.825 sdr ose rreth 12 milionë usd në kuadrin e asistencës për emergjencën e paskonfliktit, për të mbështetur programin ekonomik të qeverisë për vitin 1997-1998.

### **3 dhjetor 1997**

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë :*

*Shkëlqim Cani - Kryetar  
Fatos Ibrahim - Zëvendëskryetar  
Dhame Pite - Anëtar  
Sabah Hilmia - Anëtar  
Llazi Balliu - Anëtar  
Omer Stringa - Anëtar  
Drini Salko - Anëtar*

### **1998 - 2002**

"Këshilli Mbikëqyrës, në zbatim të objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, ka ndjekur me vëmendje zhvillimet e ekonomisë shqiptare dhe për këtë qëllim ka hartuar e miratuar për çdo vit Programin Monetar. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës në fund të çdo gjashtëmujori, duke filluar që nga fundi i vitit 1997 e në vazhdim, bazuar në zhvillimet ekonomike dhe në arritjet e treguesve monetarë e financiarë, ka nxjerrë deklaratat gjashtëmujore "Për Politikën Monetare të Bankës së Shqipërisë".

Këto deklarata u janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, si dhe janë publikuar për median".

### **23 janar 1998**

Presidenti i Republikës me dekretin nr.1983 dekreton shpalljen e ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë". Me këtë ligj sanksionohet pavarësia e Bankës së Shqipërisë. Ajo është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Në këtë ligj, paraqiten më të detajuara detyrat dhe detyrimet e Bankës së Shqipërisë, detyrimi për t'u përgjigjur para Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë; si dhe objektivi i saj kryesor: arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve etj..

### **13 shkurt 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 6, lidhur me shpërndarjen e kufirit të kreditit për bankat përcakton gjithashtu që :

"Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare lejohen të japin kredi vetëm për të pastrehët dhe për Ujësjellësin e Bovillës, që garantohen dhe financohen nga Buxheti i Shtetit". Kjo, pasi ka filluar procesi i privatizimit të dy bankave shtetërore.

Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si mbikëqyrëse e sistemit bankar, vendos ndërprerjen e aktivitetit kredidhënës për dy bankat shtetërore, të cilat hyjnë në procesin e privatizimit, si një tregues kujdesi për të ruajtur këto banka nga përkeqësimi i mëtejshëm i portofolit të kredive dhe i situatës së tyre financiare dhe për rrjedhojë që çojnë në uljen e vlerës së shitjes së tyre.

### **26 shkurt 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 9, miraton rregulloren " Mbi procedurat e përqendrimit të transaksioneve në llogaritë e bankave të nivelit të dytë, pranë Departamentit të Pagesave".

### **26 shkurt 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 10, vendos ndërprerjen e menjëhershme dhe totale të aktivitetit kreditues të Bankës Dardania. Arsyeja e vendosjes së këtij kufizimi ishte përkeqësimi i gjendjes së portofolit të kredive të kësaj banke.

### **24 shkurt 1998**

Në kuadrin e bashkëpunimit midis Qeverisë Greke dhe asaj Shqiptare, Shtetit Shqiptar, të përfaqësuar nga Banka e Shqipërisë, i akordohet një asistencë makroekonomike në shumën prej 3 miliardë gdr, me qëllim mbështetjen e bilancit të pagesave. Sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të datës 13.02.1998 "Mbi miratimin e kushteve të akt marrëveshjes që do të lidhë Banka e Shqipërisë me Bankën e Greqisë", huaja do të përdorej për rritjen e rezervave valutore, me qëllim rritjen e kapitalit për ndjekjen e një politike të fortë dhe të shëndetshme makroekonomike dhe monetare.

### **31 mars 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 41, miraton rregulloren e mbikëqyrjes bankare "Mbi likuiditetin e bankave".

Në këtë rregullore përcaktohet që raporti i likuiditetit të bankave të jetë jo më pak se 100 për qind.

### **31 mars 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 42, miraton rregulloren "Mbi pozicionet e hapura valutore". Normat e lejuara:

një raport maksimal 10 për qind të pozicionit të hapur valutor neto ndaj fondeve të veta në çdo monedhë;

një raport maksimal 20 për qind të pozicionit të hapur valutor neto ndaj fondeve të veta për të gjitha monedhat e huaja së bashku.

### **31 mars 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 43, miraton ndryshime të rregullores "Për dhënien e licencave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë". Shuma minimale e kapitalit të nënshkruar, të paguar për kontributin në para, për një bankë rritet në jo më pak se 700 milionë lekë.

Këshilli Mbikëqyrës rrit në mënyrë të ndjeshme kapitalin minimal të kërkuar për hapjen e një banke me qëllim përafrimin me standardet ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive dhe, nga ana tjetër, mundësimin e hyrjes në tregun bankar të partnerëve seriozë.

Ky vendim i Këshillit Mbikëqyrës pati efekte jo vetëm për bankat e reja që kërkonin të hynin në sistemin bankar por edhe për ato ekzistuese. Këshilli Mbikëqyrës vendosi që shuma e kapitalit minimal të kërkuar prej 700 milionë lekë, të plotësohej edhe nga bankat ekzistuese për t'i vënë ato në të njëjtat kushte konkurrence me bankat e reja që do të krijoheshin. Ky detyrim do të përmbushej nga bankat ekzistuese në një hark kohor prej 3 vjetësh, me dy faza (faza I- brenda 18 muajsh në 500 milionë lekë dhe faza II- brenda 18 muajsh të plotësohej niveli prej 700 milionë lekësh).

### **31 mars 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 51, miraton rregulloren "Mbi klasifikimin e huave dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë". Nuk përbën ndonjë ndryshim cilësor vetëm realizon disa saktësime.

### **15 prill 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 47, miraton projektligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe ia dërgon Këshillit të Ministrave.

### **8 maj 1998**

Nënshkruhet Kontrata e Qeverisjes për Bankën e Kursimeve. Kjo kontratë nënshkruhet midis ekipit administrues të Bankës dhe Këshillit Drejtues të saj, me miratimin në parim të Ministrisë së Financave dhe të Bankës së Shqipërisë, si dhe me asistencën dhe mbështetjen e Bankës Botërore.

### **19 maj 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 57, miraton udhëzimin "Për rezervën minimale të detyrueshme për pasivitetet në lekë dhe në valutë". Rezerva minimale e detyrueshme është 10 për qind të detyrimeve

ndaj të tretëve në lekë dhe në valutë, duke përfshirë edhe letrat me vlerë dhe duke përjashtuar depozitat dhe llogaritë e bankave tek njëra-tjetra. Për rezervën e detyrueshme nuk paguhen interesa nga Banka e Shqipërisë.

### **13 maj 1998**

Fondi Monetar Ndërkombëtar miraton në kuadrin e programit të huave ESAF, një hua trevjeçare, me një vlerë prej 35.3 milionë sdr ose rreth 47 milionë usd, për të mbështetur programin ekonomik të Qeverisë Shqiptare për periudhën 1998-2001. Huaja skadon në 31 korrik 2001.

### **9 korrik 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 94, vendosi të revokojë licencën e Bankës Tregtare Agrare, me kërkesë të aksionerit të saj Ministrisë të Financave. Likuidimi i bankës u realizua duke kaluar një pjesë të aktiveve të saj të mira tek Banka e Kursimeve dhe tek Banka Kombëtare Tregtare ndërsa aktivet e këqija tek Agjencia e Trajtimit të Kredive.

### **2 korrik 1998**

Presidenti i Republikës dekreton ligjin nr. 8365 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

### **10 gusht 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 105, vendosi t'i japë licencën Bankës Amerikane të Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

### **10 gusht 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 106, vendosi të japë miratimin paraprak të licencës së Bankës FEFAD, për të vepruar si bankë, në mbështetje të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë".

### **10 gusht 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 107, vendosi të japë miratimin paraprak të licencës së "Bankës Tregtare Ndërkombëtare të Detit të Zi" për të vepruar si bankë, në mbështetje të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë". Kjo bankë ka marrë licencën për të filluar aktivitetin bankar me emër të ndryshuar "Banka Ndërtregtare Sh.A."

### **shtator 1998**

Neni 23 i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1998 "Për Bankën e Shqipërisë" i jep të drejtën Bankës së Shqipërisë të bashkëpunojë, mbi baza reciprociteti me autoritetet respektive të huaja të mbikëqyrjes bankare, për të mbikëqyrur dhe për të inspektuar banka që veprojnë në juridiksionin e tyre, si dhe të shkëmbejnë informacione për çdo bankë që vepron në juridiksionin e tyre. Mbi këtë bazë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton vendimin nr. 130, datë 01.10.1998 "Mbi parimet bazë të bashkëpunimit me bankat qendrore të vendeve të tjera për mbikëqyrjen bankare", si dhe autorizon Guvernatorin të nënshkruajë në emër të Bankës së Shqipërisë marrëveshjet e bashkëpunimit.

### **15 tetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 137, miraton projektligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe ia nis për miratim Këshillit të Ministrave.

### **26 tetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 142, vendosi t'i japë miratimin paraprak për licencë Bankës së Parë të Investimeve me qendër në Bullgari për hapjen e një dege të saj në Shqipëri.

### **15 tetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 136, miraton rregulloren "Për rezervën e detyrueshme për depozitat monetare (detyrimet ndaj të tretëve) në lekë dhe në valutë".

Rezerva e detyrueshme do të mbahet në lekë, në dollarë amerikanë, në marka gjermane, në lireta dhe në dhrahmi. Detyrimet në valuta të tjera do të konvertohen në dollarë amerikanë. Rezerva e detyrueshme do të jetë 10 për qind e detyrimeve monetare dhe 5 për qind e saj, mund të mobilizohet gjatë muajit. Kjo rregullore parashikon edhe masat për mosplotësimin e rezervës së detyrueshme.

### **26 tetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.141, miraton Statutin e Bankës së Shqipërisë. Ky statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Bankës së Shqipërisë, personaliteti juridik, objekti i veprimtarisë, pushteti dhe kompetencat e së cilës rregullohen nga ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

### **19 nëntor 1998**

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.725 vendos privatizimin e shoqërisë anonime "Banka Kombëtare Tregtare"sh.a.

### **20 nëntor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 148, miraton rregulloren "Për sistemin dhe instrumentet e pagesave", që ka për qëllim funksionimin normal të sistemit të pagesave. Pagesat kryhen në lekë ose në valutë, me para në dorë ose në llogari. Banka e Shqipërisë organizon shërbimin e kleringut të pagesave në lekë.

### **20 nëntor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.147, miraton rregulloren "Për dhënie kredie për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë". Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe i dokumentacionit që kërkohet në rast të akordimit të kredisë me kushte lehtësuese për punonjësit e saj, si një e drejtë e dhënë nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë".

### **11 dhjetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 161, miraton Sistemin Raportues të bankave të nivelit të dytë. Ky sistem mbështetet në planin e ri të llogarive. Sistemi merr në konsideratë rekomandimet e shoqërisë Ernst&Young, që përgatiti Manualin e Kontabilitetit Bankar.



### **16 dhjetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 170, miraton krijimin e fondit të pensioneve në masën 15 për qind të fondit të pagave për personelin e Bankës së Shqipërisë, duke filluar që nga viti 1998 e në vazhdim.

### **16 dhjetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e nenit të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë, vendosi të rilicencojë për të vazhduar veprimtarinë si bankë:

- me vendimin nr. 162, datë 11.12.1998 -Bankën Kombëtare Tregtare;
- me vendimin nr. 163, datë 11.12.1998 -Bankën e Kursimeve;
- me vendimin nr. 164, datë 11.12.1998 -Bankën Dardania;
- me vendimin nr. 165, datë 11.12.1998 -Bankën Arabo-Shqiptare Islamike.

### **16 dhjetor 1998**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 173, miraton rregulloren "Për dhënien e licencave për të kryer veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë". Kjo rregullore u hartua në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Janë bërë detajime të mëtejshme të kërkesave, por nuk ka ndryshim të kapitalit minimal të kërkuar.

### **17 janar 1999**

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e Mbikëqyrjes Bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Greqisë. Marrëveshja midis dy bankave qendrore ka si qëllim mbikëqyrjen e përbashkët të degëve të bankave greke, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre edhe në Shqipëri, si dhe mbikëqyrjen në të ardhmen të bankave shqiptare, të cilat do të kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Greqisë.

### **17 shkurt 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.12, miraton Statutin e ri të Bankës së Shqipërisë me të cilin shfuqizohet statuti i vitit 1998. Hartimi i këtij statuti ka si qëllim kryesor një përcaktim më të qartë të procedurave operative dhe administrative në Bankën e Shqipërisë, brenda kompetencave që ligji për Bankën e Shqipërisë i jep kësaj të fundit, dhe duke i dhënë në njëfarë mënyre hapësirë disa elementeve, të cilat në ligj janë përcaktuar në konceptin e përgjithshëm të tyre.

### **shkurt 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton rregulloren "Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja". Kjo rregullore thekson më shumë se rregullorja e mëparshme kërkesat lidhur me kualifikimin, me reputacionin dhe me përvojën në punë të administratorëve të bankave dhe detyrimin e miratimit të tyre para fillimit të punës në banka dhe në degët e bankave të huaja. Rishikimi i rregullores lidhet me ndryshimet legjislative. Baza ligjore e saj është ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

### **3 mars 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 22, i jep licencën Bankës FEFAD sh.a, për kryerjen e veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë.

### **18 mars 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 26 miraton rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë". Subjekte jobanka janë konsideruar ato subjekte që kryejnë aktivitetet e përcaktuara për t'u kryer nga bankat, në nenin 26 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" me përjashtim të grumbullimit të depozitave.



*Banka e Shqipërisë, 1999.*

### **31 mars 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 39, miraton udhëzimin "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive dhe depozitave në banka".

### **13 prill 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 45, miraton dhënien e licencës Degës në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

### **5 maj 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton, disa akte rregullative të mbikëqyrjes bankare si rezultat i ndryshimit të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë":

- me vendimin nr. 57, udhëzimin " Për kapitalin rregullator të bankës";
- me vendimin nr. 58, rregulloren " Për mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës"; parashikohet rritja e nivelit të mjaftueshmërisë së kapitalit nga 8 për qind në 12 për qind, mbështetur në rekomandimet e Komitetit të Baselit për mbikëqyrjen bankare pasi merr në konsideratë edhe rreziqet e tregut;
- me vendimin nr. 59, rregulloren " Për pozicionet e hapura në valutë";
- me vendimin nr. 63, rregulloren " Për veprimtarinë valutore". Për herë të parë në këtë rregullore, mbështetur në detyrimin e nenit 60, të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" jepen përcaktimet e termave "veprime në llogarinë kapitale" dhe "veprime në llogarinë korente". Gjithashtu, u përcaktuan dhe kërkesat për dokumentacionin justifikues dhe kufizimet sasiore lidhur me transfertat bankare.

### **2 qershor 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton, disa akte rregullative të mbikëqyrjes bankare si rezultat i ndryshimit të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë":

- me vendimin nr. 71, rregulloren " Për raportin e likuiditetit";
- me vendimin nr. 72, rregulloren "Për risqet e mëdha".

### **7 korrik 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 77, miraton rregulloren "Mbi tregun sekondar dhe me pakicë të bonove të thesarit".

### **7 korrik 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 78, miraton rregulloren "Për kontrollin e risqeve të mëdha".

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë :*

*Shkëlqim Cani - Kryetar  
Fatos Ibrahim - Zëvendëskryetar  
Dhame Pite - Anëtar  
Sabah Hilmia - Anëtar  
Llazi Balliu - Anëtar  
Drini Salko - Anëtar  
Sulo Hadëri - Anëtar  
Tonin Kola - Anëtar*

### **19 tetor 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr. 105, miraton dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, Bankës Ndërtregtare (Shqipëri) në Tiranë. Kjo bankë ka marrë licencën paraprake me emrin "Banka Tregtare Ndërkombëtare e Detit të Zi", por vendosi të ndryshojë emrin.

### **nëntor 1999**

Banka e Shqipërisë dhe Misioni i Asistencës Teknike MAE, pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, që viziton Bankën e Shqipërisë, bashkëpunojnë mbi çështje të rëndësishme të mbarëvajtjes së sistemit bankar dhe të detyrave që duhet të përmbushë një bankë qendrore, duke përfshirë administrimin e parasë, përgjegjshmërinë e bankës qendrore, mbikëqyrjen bankare, rregullimet e kujdesshme bankare dhe sistemin e pagesave.

### **3 nëntor 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij:

- nr. 107, miraton rregulloren "Për pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive tregtare të bankave dhe të degëve të bankave",
- nr.108, miraton rregulloren "Për kontrollin e brendshëm në banka dhe në degët e bankave të huaja".

### **17 nëntor 1999**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin e tij nr.113, miraton heqjen e kufirit të kredisë për bankat si një instrument direkt i politikës monetare i përdorur nga Banka e Shqipërisë. Që nga ky moment Banka e Shqipërisë do të përdorë vetëm instrumente indirekte për zbatimin e politikës monetare.

Këshilli Mbikëqyrës vendos që bankat, të cilat kanë mbi 20 për qind të kredive me probleme të ndërpresin aktivitetin kredidhënës.

### **17 nëntor 1999**

Këshilli Mbikëqyrës miraton vendimin e tij nr. 114 "Për caktimin e afateve në rritjen e kapitalit të bankave". Të gjitha bankat deri në datën 31.03.2001 duhet të plotësojnë kapitalin minimal të kërkuar për hapjen e një banke prej 700 milionë lekësh.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 115, vendos të pranojë shoqërinë IMI( International Micro Investitionen) me seli në Frankfurt mbi Main, si aksionere të bankës FEFAD me 15 për qind të kapitalit.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 111, miraton "Strategjinë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë".

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 117, miraton disa ndryshime në rregulloren "Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë". Ky ndryshim kishte për qëllim të theksonte më shumë faktin që në vlerësimin e rrezikut për kredinë dhe në klasifikimin e saj merret fillimisht në konsideratë gjendja financiare e kredimarrësit. Burim sekondar është sigurimi i kredisë.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 118, miraton disa ndryshime në rregulloren "Për pozicionet e hapura në valutë". Këto ndryshime kishin për qëllim:

- përfshirjen edhe të metaleve të çmuara , të cilat konsiderohen njëloj si monedhat e huaja;
- llogaritjen e pozicionit të hapur për monedhat përbërëse të euros, të cilat konvertohen -në euro dhe kështu i raportohen edhe Bankës së Shqipërisë;
- raporti maksimal për çdo monedhë nga 10 deri në 20 për qind;
- raporti maksimal për të gjitha monedhat së bashku nga 20 deri në 30 për qind.

### **19 janar 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 03, miraton udhëzimin "Për likuiditetin e bankave". Ky udhëzim zëvendësoi rregulloren përkatëse, pasi u gjykua se kjo rregullore ishte shumë kufizuese dhe me rekomandimin edhe të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar u kalua në një udhëzim, që t'i tregojë bankave si të administrojnë likuiditetin e tyre. Ky udhëzim nuk e përmban më kufirin prej 100 për qind.

### **15 mars 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 23, miraton rregulloren " Për bankat kooperativë". Kjo rregullore përcakton rregullat, kushtet, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm për krijimin dhe për funksionimin e bankave kooperativë.

### **29 mars 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 26, vendos përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Subjekte të tilla janë ato të cilat kryejnë aktivitet kredidhënës, por origjina e burimeve financiare rrjedh nga organizatat ndërkombëtare apo nga qeveri të vendeve të tjera në formën e ndihmës falas për efekt të zhvillimit të biznesit të vogël apo të mesëm në Shqipëri, dhe që nuk zhvillojnë aktivitetin e grumbullimit të depozitave.

### **3 maj 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 43, miraton disa shtesa në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë". Shtesa e rregullores ka të bëjë me kërkesat e Bankës së Shqipërisë për dhënien e lejes një banke, për të hapur degë jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **17 maj 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 49, vendos heqjen e nivelit të interesit minimal për depozitat me afat gjashtëmujor në lekë për bankat me kapital shtetëror.

### **21 qershor 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 53, miraton rregulloren "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë". Qëllimi kryesor në këtë rregullore është rritja e transparencës së Bankës së Shqipërisë duke përcaktuar dhe detyrimet e saj. Nga ana tjetër, në këtë rregullore përcaktohen rregullat për nxjerrjen e informacionit dhe përcaktimi i atij informacioni, i cili është konfidencial dhe nuk lejohet nxjerrja e tij.

### **5 korrik 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 60, miraton rregulloren "Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare". Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i normave mbikëqyrëse për të gjitha subjektet jobanka që ushtrojnë aktivitetet financiar për matjen, për administrimin dhe për kufizimin e rrezikut që ato ndërmarrin, duke përcaktuar dhe detyrimin e raportimit të tyre në Bankën e Shqipërisë.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 61, miraton udhëzimin "Për administrimin e rrezikut të normës së interesit". Qëllimi i këtij udhëzimi është dhënia e rekomandimeve lidhur me administrimin e rrezikut, që vjen si rezultat i pozicionit të bankës, të aktiveve, të pasiveve dhe të zërave jashtë bilancit të saj, në lidhje me lëvizjen e normës së interesit si dhe me vlerësimin nga banka të mjaftueshmërisë dhe të efektivitetit të rrezikut të normës së interesit.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 62, miraton "Manualin e Ekzaminimit Bankar" dhe "Sistemin e klasifikimit të bankave CAMELS".

### **19 korrik 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 64, vendos rimunerimin e rezervës së detyrueshme që bankat e nivelit të dytë mbajnë në Bankën e Shqipërisë.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 65, vendos të lejojë aktivitetin kreditues të Bankës Kombëtare Tregtare, pasi ajo ka transferuar më parë të gjitha kreditë me probleme tek Agjencia e Trajtimit të Kredive.

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 66, vendos të miratojë heqjen e nivelit minimal të interesave për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor në lekë, për bankat me kapital shtetëror.

### **6 shtator 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin e tij nr. 74, vendos të miratojë heqjen e nivelit minimal të interesave për depozitat me afat tremujor në lekë, për bankat me kapital shtetëror.

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë :*

*Shkëlqim Cani - Kryetar  
Fatos Ibrahim - Zëvendëskryetar  
Dhame Pite - Anëtar  
Sabah Hilmia - Anëtar  
Llazi Balliu - Anëtar  
Drini Salko - Anëtar  
Tonin Kola - Anëtar  
Sulo Hadëri - Anëtar  
Bajram Muça - Anëtar*

**tetor 2000**

Numri i punonjësve të Bankës së Shqipërisë është 334 vetë.

administrata qendrore	252 vetë
administrata lokale	82 vetë

**3 nëntor 2000**

Në Pallatin e Kongreseve , Tiranë, u zhvillua Konferenca e Parë Kombëtare "Informacioni Statistikor në Shqipëri". Organizimi i kësaj konference, ishte një ide e Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, INSTAT dhe me pjesëmarrjen e një auditori të gjerë, prodhues dhe përdorues të statistikave, përfaqësues të institucioneve shtetërore etj. Qëllimi i kësaj konference kishte të bënte me vlerësimin e burimeve të informacionit, llojin e informacioneve që ofrojnë aktorët e ndryshëm ekonomikë, shkallën e besueshmërisë së tyre, prezantimin i alternativave për diversifikimin e burimeve të informacionit statistikor etj..

**19 dhjetor 2000**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.100, miraton Statutin e ri të Bankës së Shqipërisë me të cilin shfuqizohet statuti i vitit 1999. Me këtë statut të ri përcaktohen qartësisht statusi juridik, selia, objekti i veprimtarisë, objektivat, kapitali, bilanci i Bankës së Shqipërisë, dhe përcaktohen më konkretisht detyrat kryesore të administratorëve të Bankës së Shqipërisë në funksion të skemës dhe të strukturës organizative në Bankën e Shqipërisë.

**19 dhjetor 2000**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 101, miraton rregulloren "Për pagesat elektronike". Kjo rregullore ka për qëllim

- të modernizojë sistemin e pagesave në Republikën e Shqipërisë;
- të formulojë parimet kryesore për instrumentet elektronike të pagesave;
- të përcaktojë kriteret kryesore që duhet të plotësohen, që mjetet e reja të pagesave të zhvillohen në dobi të klientit, për siguri dhe dobi, dhe për emetuesin, produktivitet dhe siguri të madhe.

**3 janar 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.03, miraton projektligjin "Për sigurimin e depozitave". Qëllimi i këtij projektligji ishte rregullimi i sigurimit dhe i kompensimit të depozitave; rregullimi i krijimit, i kompetencave

dhe i veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, e cila vendos për sigurimin e depozitave në degën e bankës, dhe që themelohet si person juridik publik me qendër në Tiranë.

Agjencia, brenda kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, gëzon pavarësi operacionale dhe financiare nga çdo subjekt tjetër. Me këtë projektligj përcaktohet, gjithashtu, Banka e Shqipërisë në rolin e autoritetit mbikëqyrës, dhe jepen kompetencat e saj.

### ***17 janar 2001***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.06, miraton vendimin për caktimin e shoqërisë "Deloitte & Touche" si kontrolllore e jashtme për llogaritë, për regjistrat dhe për bilancin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2000 dhe vitin 2001. Financimi i këtij shërbimi do të bëhet nga Banka Botërore, ndërsa Banka e Shqipërisë do të përballojë shpenzimet, për tatimet dhe taksat përkatëse.

### ***7 shkurt 2001***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.08, miraton rregulloret "Për instrumentet indirekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë" dhe konkretisht rregulloret:

- a- "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes";
- b- "Mbi kredinë njëditore";
- c- "Mbi kredinë lombard";
- d- "Mbi transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota";
- e- "Mbi depozitën njëditore".

### **Fillimet dhe konsolidimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë (Politika Monetare në dekadën e kaluar).**

Për herë të parë politika monetare në Shqipëri u ideua dhe u zbatua në mesin e vitit 1992, ku si pjesë e marrëveshjes së mbështetjes të FMN-së për Shqipërinë u prezantuan disa vendime, të cilat synonin vendosjen e kontrollit mbi ofertën e parasë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit. Që në ligjin e parë të Bankës së Shqipërisë u cilësua se objektivi kryesor i saj është ruajtja e vlerës së monedhës kombëtare dhe si rrjedhim i saj do të ishte siguri i stabilitetit të çmimeve të konsumit.

Si objektivi i ndërmjetëm u zgjodh baza monetare, ndërkohë që si instrumente bazë për kontrollin monetar ishin dy: kufiri i kredisë dhe përqindja e interesit për depozitat me lekë të vendosura në bankat me kapital shtetëror. Që nga korriku i vitit 1992 (vazhdon akoma dhe në ditët e sotme) u adoptua një regjim fleksibël i kursit të këmbimit ndërkohë që transaksionet në llogarinë korente u liberalizuan plotësisht.

Këto masa së bashku me adoptimin e një politike fiskale të shtrënguar, liberalizimin e një pjese të madhe të çmimeve të konsumit, çuan në një frenim të menjëhershëm të zhbalancimit të mëtejshëm të ekuilibrit makroekonomik. Inflacioni galopant i viteve 1990 - 1991 filloi të bjerë, shoqëruar me një stopim të rënies së mëtejshme të prodhimit etj.. Konsolidimi makroekonomik i vendit vazhdoi me hapa të shpejtë në vitet 1993 - 1995. Duhet theksuar se ndër faktorët që ndikuan në arrijtjen e këtij konsolidimi një vend të veçantë zë dhe politika monetare me vendimet e saj. Rritja e menjëhershme e përqindjes së interesit dhe kontrolli i vendosur mbi kredinë për ekonominë, bënë që të ndalohej hemorragjia e madhe monetare dhe në fund të vitit të vitit 1995 rritja e çmimeve të konsumit të ishte vetëm 6.01 për qind.

Periudha dyvjeçare në vijim, 1996-1997, përkon me "lulëzimin" dhe "perëndimin" e firmave piramidale. Përqindjet e larta të firmave "zëvendësuan" totalisht përqindjen e interesit të ofruar nga sistemi bankar e për rrjedhim, efektiviteti i politikës monetare arriti në nivelin zero. Përqindjet e larta çuan në prurje të mëdha depozitash në sportelet e këtyre firmave, ndërkohë që investimi i tyre në prodhim dhe në letra me vlerë ishte minimal, krahasuar me shumën e mbledhur. Për më tepër u vu re fenomeni i riinvestimit jo vetëm të principallit po edhe të interesave. Pamundësia e administrimit të depozitave nga ana firmave bëri që këto të fundit t'i depozitonin ato në llogari rrjedhëse në bankat tregtare, duke iu krijuar atyre rezerva të tepërta në sasia tejet të mëdha, të cilat shkonin direkt në blerje bonosh thesari. Si përfundim, në fund të vitit 1996, inflacioni rezultoi 3 herë më i lartë nga ai i vitit paraardhës duke reflektuar një rritje të madhe të kredisë për qeverinë nga ana e sistemit bankar. Pasojat e falimentimit të firmave rentiere ishin të gjithanshme dhe për rrjedhim ato sollën dhe një faturë të madhe ekonomike. Në fund të vitit 1997, rënia e prodhimit u shoqërua me një përshpejtim të inflacionit, përkeqësim të pozicionit të jashtëm të vendit, dhe me shtim të papunësisë. Megjithatë përpjekjet e bëra nga ana e Bankës së Shqipërisë duke rritur përqindjen e interesit në rreth 32 për qind filluan të jepnin frutin e tyre. Rezultatet e politikës monetare dhe të asaj fiskale u bënë më të prekshme në fund të vitit 1998, ku si pjesë e Programit të Emergjencës Pas Konfliktit, nënshkruar me FMN-në, u imponuan disa kufizime sasiore në rritjen e rezervave valutore për neto, në rritjen e kredisë së Bankës së Shqipërisë për Qeverinë dhe në rritjen e kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë.

Inflacioni në vite.

Inflacioni mbi baza vjetore në %	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
	6.01	17.40	42.08	8.69	-1.04	4.21	3.53	2.10

Gjatë vitit 1999 Shqipëria u detyrua të përballonte eksodin biblik të popullsisë së Kosovës por, për shumë arsye, inflacioni mbeti në kuota të ulëta. Duke filluar që nga ajo kohë e deri në fund të vitit 2000, përqindja e interesit është ulur në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, në terma realë ajo ka mbetur shumë e lartë. Nga ana tjetër, reagimi i tregut nuk ka qenë i menjëhershëm dhe kjo, përveç të tjerash, reflektohet edhe në diferencën e lartë që ekziston midis përqindjes minimale të interesit për depozitat me përqindjen e yield-it të bonove të thesarit. Në këto kushte, duke parë të arsyshëm eliminimin e kufijve të poshtëm për depozitat me afat në lekë për bankat me kapital shtetëror, Banka e Shqipërisë synoi të shkelë një rrugë të re, atë të kontrollit monetar nëpërmjet tregut.



Operacionet e Politikës Monetare dhe Instrumentet e përdorura nga ana e Bankës së Shqipërisë për ushtrimin e kësaj politike.

Operacionet e politikës monetare	Tipi i transaksioneve		Maturiteti	Frekuenca	Procedura
	SHTIM LIKUIDITETI	Tërheqje likuiditeti			
OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR					
Ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo)	Marrëveshje e riblerjes (Repo)	Shtatë ditë	Javore	Ankand standard
Ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo)	Marrëveshje e riblerjes (Repo)	Një ditë	Ditore	Ankande të shpejta
Ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo)	Marrëveshje e riblerjes (Repo)	Një muaj	Mujore	Ankande të shpejta
Ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo)	Marrëveshje e riblerjes (Repo)	Tre muaj	Tre mujore	Ankande të shpejta
Blerje dhe shitje me të drejta të plotë, të letrave me vlerë	Blerje me të drejta të plota	Shitje me të drejta të plota		E pastandardizuar	Procedura dy palëshe Ankande të shpejta
Instrumentat mbështetëse					
Kredia lombard	Hua e kolateralizuar		Deri në tre muaj	E pastandardizuar	Procedura dypalëshe
Kredi njëditore	Hua e kolateralizuar		një ditë	Sipas vendimit të bankave të nivelit të dytë	
Depozitë njëditore		Depozitë	një ditë	Sipas vendimit të bankave të nivel të dytë	

### **7 shkurt 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.9, miraton rregulloren "Për rezervën e detyrueshme për depozitat monetare në lekë dhe në valutë". Në këtë rregullore përcaktohen:

- subjektet e mbajtjes të rezervës së detyrueshme që janë bankat dhe degët e bankave të huaja, që autorizohen të kryejnë veprimtari bankare në Shqipëri në bazë të ligjit nr. 8365, datë 2 shkurt 1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
- llojet e depozitave monetare (detyrimet ndaj të tretëve) në lekë dhe në valutë për të cilat llogaritet rezerva e detyrueshme;
- baza e rezervës së detyrueshme, që janë depozitat monetare të subjekteve në lekë dhe në valutë;
- mënyra e llogaritjes së rezervës së detyrueshme;
- periodha e mbajtjes së rezervës së detyrueshme dhe data e llogaritjes;
- masat për mosplotësimin e rezervës së detyrueshme etj..

### **7 shkurt 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.11, miraton vendimin "Mbi një ndryshim në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë", duke realizuar bashkimin e Departamentit të Politikës Monetare me Departamentin e Kërkimeve në një departament të vetëm.

### **21 shkurt 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.12, miraton rregulloren "Për veprimtarinë valutore". Objekt i kësaj rregulloreje janë veprimet valutore, që kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe subjekte të kësaj rregulloreje janë pjesëmarrësit dhe operatorët e tregut, në veprimtarinë valutore. Sipas kësaj rregulloreje veprimet valutore kryhen nëpërmjet llogarisë së kapitalit dhe llogarisë korente, dhe rregullorja përcakton konkretisht se cilat transaksione përfshihen në secilën llogari. Në rregullore përcaktohen lëvizjet e kapitalit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilat subjektet, rezidente ose jorezidente duhet të marrin paraprakisht miratim me shkrim nga Banka e Shqipërisë, përveç disa rasteve të përcaktuara si përjashtime në rregullore; kriteret e transferimit të kapitalit jashtë Republikës së Shqipërisë, zyrat e këmbimeve valutore dhe të drejtat që ato kanë etj..Pjesë e rregullores janë edhe 4(katër) udhëzime:

"Mbi shumat në valutë që mund të hyjnë dhe të dalin në territorin e Republikës së Shqipërisë"; "Mbi pagesat dhe transfertat jotregtare në valutë deri në 25 mije usd ose ekuivalentin në çdo monedhë tjetër"; "Mbi licencimin e zyrave të këmbimit valutor" dhe "Mbi raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore".

### **21 shkurt 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.13, miraton rregulloren "Për menaxhimin e rrezikut të kredisë". Qëllimi i kësaj rregulloreje është administrimi i rrezikut të kredisë në mënyrë që banka të minimizojë humbjet e mundshme nga kreditë dhe nga aktivet e tjera. Në këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyrat e klasifikimit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës, duke llogaritur një nivel të përshtatshëm fondesh rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë dhe aktivet e tjera.

### **28 shkurt 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.14, miraton disa amendamente në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të cilat kanë të bëjnë me ndryshime në nenet 3; 4; 30;32;44;46;72 dhe 73 të ligjit ekzistues.

#### ***4 prill 2001***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 25, miraton disa projekt amendamente në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të cilat do t'i dërgohen për miratim instancave përkatëse. Ato kanë të bëjnë me disa shtesa e ndryshime duke u bazuar kryesisht në detyrimet që burojnë nga neni 161 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, si edhe në disa shtesa dhe ndryshime të tjera, të cilat evidentojnë dhe garantojnë nga pikëpamja politiko-legjislative pavarësinë e Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e politikës monetare.

#### ***18 prill 2001***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 32, vendosi t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, emërimin e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë zotin Marian Vangjel Gjermani, me detyrë Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë.

#### ***18 prill 2001***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.33, miraton "Dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar aktivitetet bankar Bankës Tregtare të Kuvaitit (në formim)".

#### ***2 maj 2001***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 34, miraton rregulloren "Për nxjerrjen dhe sjelljen nga jashtë shtetit të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor". Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë sasinë dhe procedurat për nxjerrjen dhe sjelljen nga jashtë shtetit, të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, të cilat kanë kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.



*Foto e Këshillit Mbikëqyrës, në sallën ku mbahen mbledhjet e këtij këshilli.*

### **16 maj 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.37, miraton rregulloren "Mbi rregullat procedurale të Bankës së Shqipërisë". Kjo rregullore ka për objekt organizimin e punëve në Bankën e Shqipërisë, linjat e raportimit dhe përgjegjësitë administrative në Bankën e Shqipërisë. Ajo përmban veprime operacionale, procedura të brendshme dhe interpretime në drejtimin e veprimtarisë administrative në Bankën e Shqipërisë, mënyrën e respektimit të parimit të besimit reciprok dhe të bashkëpunimit; kompetencat që i rezervohen Administratorëve; krijimin e komiteteve në Bankën e Shqipërisë etj..

### **16 maj 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.39, miraton udhëzimin "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja". Objekti i këtij udhëzimi është vendosja e procedurave për miratimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të emëruar nga bankat. Në këtë udhëzim përcaktohet dokumentacioni që duhet të paraqesë banka në Bankën e Shqipërisë për miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar, të emëruar dhe të drejtën e miratimit ose të refuzimit nga Banka e Shqipërisë lidhur me këtë dokumentacion dhe me kritere të tjera të përcaktuara në këtë udhëzim.

### **6 qershor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.42, miraton rregulloren "Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare". Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit ndërmjet aktivitetit të lirë të investimit të bankave në kapitalin e shoqërive tregtare dhe respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse. Objektivi i vendosjes të raporteve mbikëqyrëse sipas kësaj rregulloreje është që bankat të mos ushtrojnë në mënyrë të pakufizuar investimin në kapitalin e shoqërive tregtare, në mënyrë që ato të mos përballen në mënyrë të pakontrolluar, me rreziqe të kësaj natyre.



*Mozaik në hollin e Bankës së Shqipërisë.*

### **6 qershor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.44, vendosi të hapen dhe të funksionojnë llogaritë personale të punonjësve të Bankës së Shqipërisë. Llogaritë personale do të pasqyrojnë veprimet financiare që rrjedhin nga shpërblimet e ndryshme dhe nga kryerja e pagesave për shërbimet, që do të bëhen për llogari të punonjësve të Bankës së Shqipërisë.

### **20 qershor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.50, miraton skemën për caktimin e kodit të identifikimit bankar, për bankat e nivelit të dytë. Me këtë vendim i bëhen disa ndryshime kodit të identifikimit bankar (K.I.B.), të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr 38, datë 03.05.2000.

### **4 korrik 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.57, miraton rregullat "Mbi marrëdhëniet e punës të personelit në Bankën e Shqipërisë", nëpërmjet të cilave përcaktohen marrëdhëniet juridike të punës të personelit në Bankën e Shqipërisë. Në këto rregulla përcaktohen :

klasifikimi i personelit të Bankës së Shqipërisë; marrëdhëniet juridike të punës;  
vlerësimi i rezultateve individuale në punë; zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve dhe transferimi i detyrueshëm;  
paga dhe shpërblimet; të drejtat dhe detyrat e personelit të Bankës së Shqipërisë; ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Bankën e Shqipërisë; masat disiplinore: kualifikimi dhe karriera e nëpunësit; dosja dhe regjistri i personelit; kohëzgjatja e punës dhe pushimet; rregulla etike për personelin e Bankës së Shqipërisë etj..

### **4 korrik 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.60, miraton të shtypen disa lloj kartëmonedhash dhe monedhash për qëllime numizmatike dhe konkretisht :

-seri monedhash metalike, për qëllime numizmatike, pa kurs ligjor me tematikë " 90-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë"; monedhë metalike për qëllime numizmatike, pa kurs ligjor, me tematikë "Antikiteti Shqiptar"; kartëmonedhë për qëllime numizmatike, me kurs ligjor, me tematikë "90 - vjetori i Shpalljes së Pavarësisë".

### **1 gusht 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.69, miraton krijimin e "Komitetit të Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit", si organ këshillimor i Administratorëve të Bankës së Shqipërisë. Funkzioni kryesor i komitetit është hartimi i planeve dhe i politikave afatmesme e afatgjata të teknologjisë dhe informacionit, i vendimeve të investimit dhe programeve për administrimin e rrezikut. Komiteti ka nën vëmendje të gjitha rastet e projektet e Teknologjisë së Informacionit, duke përfshirë: burimet e informacionit (bazat e të dhënave të brendshme e të jashtme, regjistrimet, sistemet e të dhënave të tregut); "hardware and software"; komunikimin e të dhënave; mediat informative (tekst, të dhëna, grafike, imazhe) publikimet elektronike; dhe shërbimet me bazë "Web" dhe internetit.

### **15 gusht 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.72, miraton rritjen me 0.5 pikë përqindjeje të normës fikse të interesit për repot, duke arritur në 7 për qind nga 6.5 për qind që ishte më parë.

### **2 tetor 2001**

Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Rregullimit të Mbikëqyrjes Bankare të Turqisë, institucionit më të lartë mbikëqyrës dhe rregullues në Republikën e Turqisë. Kjo marrëveshje ka si qëllim mbikëqyrjen e kujdesshme dhe bashkëpunimin midis institucioneve mbikëqyrëse të të dyja vendeve, lidhur me shkëmbimin e informacionit midis tyre dhe me mbikëqyrjen e bankave turke, që ushtrojnë veprimtarinë në Shqipëri, por edhe veprimin e anasjelltë në të ardhmen.

### **3 tetor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.79, miratoi udhëzimin "Për çertifikatat e depozitave". Sipas këtij udhëzimi përcaktohet: forma e çertifikatave të depozitave si një formë e caktuar e grumbullimit të depozitave me afat; emetuesit e këtyre çertifikatave; madhësia minimale e tyre; afati i maturimit; norma e interesit; rezerva e detyrueshme për çertifikatat e depozitave; kontabiliteti i tyre etj..

### **17 tetor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.81, miratoi rregulloren "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, me afat maturimi njëmuor dhe tremujor". Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe procedurat, që do të zbatohen nga Banka e Shqipërisë, për realizimin e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes me afat maturimi njëmuor / tremujor.

Marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes për një periudhë njëmuore / tremujore, si instrument i zbatimit të politikës monetare, realizohen nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet ankandëve, që synojnë administrimin e likuiditeteve në sistemin bankar. Në këtë rregullore përcaktohen, gjithashtu, edhe procedurat e ankandit; të pastrimit dhe të rregullimit të llogarive etj..

### **7 nëntor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 84, miraton një ndryshim në vendimin nr.100, datë 19.12.2000 "Për miratimin e statutit të Bankës së Shqipërisë". Qëllimi i këtij ndryshimi ka të bëjë me përcaktimin e kompetencës së nënshkrimit, të ekzekutimit dhe të qarkullimit të dokumentacionit nga dhe në Bankën e Shqipërisë, si dhe me kufijtë e veprimit të pagesave, nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, dhe jo nga Këshilli Mbikëqyrës siç ishte parashikuar në vendimin nr.84, datë 19.12.2000.

### **7 nëntor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.83, miratoi rregulloren "Për eksport – importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare". Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret për sasinë dhe procedurat për eksport - importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor dhe për nxjerrjen dhe sjelljen nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor.

### **7 nëntor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.86, miratoi disa ndryshime në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit". Ndryshimet konsistojnë në dhënien e të drejtës së inspektorëve të Departamentit të Mbikëqyrjes, që kur e gjykojnë të arsyeshme, bazuar në kriteret e miratuara nga Administratorët e Bankës së Shqipërisë, të mund të kërkojnë për çdo bankë, në afate kohore të përcaktuara ose të pacaktuara, një raport mjaftueshmërie më të madh se raporti minimal.

**BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**S T A T U T**

**I**

**BANKËS SË SHQIPËRISË**

Miratur me vendimin nr. 100 datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nryshuar me vendimin nr. 84, datë 7.11.2001. Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" (si më poshtë ligji), Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton Statutin e Bankës së Shqipërisë.

Dispozitat e statutit zbërthejnë dhe detajojnë kërkesa të ligjit për "Bankën e Shqipërisë".

Përcaktimet në këtë statut kanë të njëjtin kuptim si në ligjin për "Bankën e Shqipërisë".

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Objekti i Statutit**

Ky Statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Bankës së Shqipërisë, personaliteti juridik, objektivat, pushteti dhe kompetencat e së cilës rregullohen nga ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

**Neni 2**

**Statusi Juridik, Sella dhe Objektet e Veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë**

- 2.1 Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" dhe me aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i saj, me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë, dhe konform qëllimit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
- 2.2 Banka e Shqipërisë është person juridik publik me seli në sheshin Skënderbej nr.1, Tiranë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka të drejtë të ndryshojë vendndodhjen e selisë të Bankës së Shqipërisë.
- 2.3 Banka e Shqipërisë, brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj si dhe në ushtrimin e detyrave të caktuara.

2.4 Banka e Shqipërisë ka si objekt të veprimtarisë së saj :

- a) hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës monetare në Republikën e Shqipërisë;
- b) hartimin, miratimin dhe zbatimin e regjimit të këmbimit valutor dhe të politikës së kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- c) dhënien e licencave ose revokimin e tyre për bankat, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë bankare me qëllim sigurimin e stabilitetit bankar;
- d) disponimin dhe administrimin e rezervës valutore të saj;
- e) veprimin me cilësinë e bankierit, të këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
- f) mbarëvajtjen e sistemit bankar shqiptar në veçanti dhe të sistemit financiar në përgjithësi;
- g) nxitjen e funksionimit normal të sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë;
- h) tregtimin e letrave me vlerë, shpërndarjen e letrave me vlerë për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe emetimin e letrave me vlerë për llogari të saj;
- i) mbikëqyrjen e pagesave ndërkombëtare, që rrjedhin nga veprime tregëtare dhe jotregëtare me jashtë, si dhe angazhimet e bankave të licencuara në Shqipëri, që kanë lidhur kontrata me shtete, banka apo me shoqëri të huaja;
- j) hartimin e bilancit të pagesave të Shtetit Shqiptar, si dhe organizimin dhe drejtimin e sistemit të statistikave të këtij bilanci pagesash;
- k) të drejtën ekskluzive për të qenë emetuesi i vetëm i kartëmonedhës dhe i monedhës kombëtare që ka kurs ligor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të drejtën e përcaktimit të formave, peshave, modelit dhe karakteristikave të tjera të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike kombëtare, të cilat kanë kurs ligjor, si dhe të monedhave e kartëmonedhave, që do të shtypen për qëllime numizmatike.
- l) hartimin e planeve të emetimit dhe sigurimin e furnizimit të rregullt me kartëmonedha dhe me monedha metalike, për të plotësuar kërkesat e ekonomisë për para;
- m) licencimin ose revokimin e licencës për agjentët e këmbimeve valutore, mbikëqyrjen dhe rregullimin e agjentëve të këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat sipas rregullores së këmbimeve valutore të përgatitur nga Banka e Shqipërisë.

### Neni 3

#### Objektivat dhe Kapitali i Bankës së Shqipërisë

3.1 Objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve.

Objektivat e tjerë të Bankës së Shqipërisë të kushtëzuar nga objektivi kryesor i saj, duhet të nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar të bazuar në parimet e tregut.

3.2 Banka e Shqipërisë në përputhje me objektivin e saj kryesor, mbështet zhvillimin e politikave të përgjithshme ekonomike të Republikës së Shqipërisë.

3.3 Kapitali i Bankës së Shqipërisë përbëhet nga :

- a) fondi i themelimit të Bankës, që akordohet dhe është në pronësi të Shtetit Shqiptar, dhe është në shumën 750 milionë lekë;
- b) fondi i rezervës së përgjithshme, që është 500 për qind i fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë.



## **Neni 4**

### **Bilanci**

- 4.1 Viti financiar në Bankën e Shqipërisë hapet më datë 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor. Banka e Shqipërisë mban, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe me standardet ndërkombëtare, llogari dhe regjistra që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.
- 4.2 Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe të cilët do të shprehin opinionin e tyre për këtë qëllim.
- 4.3 Bilanci i Bankës së Shqipërisë miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës, pas paraqitjes të raportit përkatës nga Departamenti i Kontrollit, dhe mbyllet në fund të çdo viti financiar.
- 4.4 Në fund të çdo viti financiar, Banka e Shqipërisë përgatit raportin dhe llogaritë financiare, të cilat paraqiten në Kuvendin Popullor dhe në Këshillin e Ministrave nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit financiar të Bankës. Banka e Shqipërisë publikon çdo muaj përmbledhjen e bilancit të saj.

## **Neni 5**

### **Vulat**

- 5.1 Banka e Shqipërisë ka stemën e saj zyrtare të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas formës së mëposhtme :
- 5.2 Vula Zyrtare në Bankën e Shqipërisë përdoret së bashku me nënshkrimet e autorizuara në Bankën e Shqipërisë.
- 5.3 Vula Zyrtare e Bankës së Shqipërisë është në formë të rumbullakët, në qendër vendoset stema dhe rreth saj shkruhen "Republika e Shqipërisë" dhe "Banka e Shqipërisë", si dhe shënimet e nevojshme për identifikim, sipas formës së mëposhtme :
- 5.4 Këshilli Mbikëqyrës përcakton :
  - a) kategoritë e nëpunësve, të punonjësve të autorizuar të Bankës së Shqipërisë për përdorimin e Vulës Zyrtare, si dhe mënyrën e verifikimit të saj me origjinalin;
  - b) elementet formale dhe specifike të Vulës Zyrtare të Bankës së Shqipërisë si dhe vulat datare, të cilat do të jenë në qarkullim.
- 5.5 Vula Zyrtare e Bankës së Shqipërisë vendoset në dokumentet që janë parashikuar në aktet ligjore, nënligjore ose zakonin bankar.
- 5.6 Përveç Vulës Zyrtare, në Bankën e Shqipërisë përdoren edhe vula të tjera të zakonshme, që përfaqësojnë struktura të Bankës së Shqipërisë ose elemente të tjera (vula datare). Forma, lloji dhe veçoritë e tyre miratohen nga njëri prej administratorëve të Bankës së Shqipërisë, sipas fushës përkatëse.

## KREU II

### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

#### Neni 6

- 6.1 Banka e Shqipërisë organizohet në mënyrë të centralizuar me seli në Tiranë dhe degë në qendrat e tjera administrative në Shqipëri.
- 6.2 Banka e Shqipërisë ka të drejtë të hapë filiale, degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi në qendrat administrative brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Organizimi, shpërndarja dhe juridiksioni i filialeve, degëve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

#### Neni 7

##### Organet vendimore dhe ekzekutive

- 7.1 Banka e Shqipërisë organizohet dhe drejtohet nga organet e saj vendimore dhe ekzekutive.
- 7.2 Organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë është Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryen veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" dhe Statutin.
- 7.3 Veprimtaria ekzekutive në Bankën e Shqipërisë realizohet nëpërmjet organeve të saj të përcaktuara në nenin 12 të këtij Statuti. Objekti i veprimtarisë së organeve ekzekutive përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës, administratorët apo autorizimet e përgjithshme dhe të posaçme.

#### Neni 8

##### Administratorët

Banka e Shqipërisë drejtohet dhe administrohet nga Guvernatori, Zëvendësguvernatori i Parë dhe Zëvendësguvernatori i Dytë. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët realizojnë detyrat dhe funksionet e tyre në përputhje me dispozitat ligjore, me statutin, me aktet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe me aktet e tjera nënligjore.

#### Neni 9

##### Guvernatori

- 9.1 Guvernatori është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës dhe vepron si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë.
- 9.2 Guvernatori monitoron dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti veprimtarinë e zëvendësguvernatorëve dhe të organeve ekzekutive në Bankën e Shqipërisë.

- 9.3 Guvernatori nxjerr urdhra me karakter të posaçëm, udhëzime, rekomandime dhe opinione në zbatim të ligjit dhe të akteve nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës.
- 9.4 Guvernatori përgjigjet për :
- a) hartimin, paraqitjen në Këshillin Mbikëqyrës të politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore, si dhe të politikave të tjera të Bankës së Shqipërisë;
  - b) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës duke përfshirë zbatimin e politikës monetare, të kreditit dhe të këmbimeve valutore;
  - c) zbatimin e politikave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme, për administrimin e procedurave ekzekutive si dhe për qeverisjen e punëve administrative të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë;
  - ç) koordinimin e punës në Bankën e Shqipërisë që të sigurohet zbatimi i vendimeve, i rregulloreve dhe i udhëzimeve me karakter të përgjithshëm të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- 9.5 Guvernatori me propozim të organit vartës ekzekutiv paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës buxhetin vjetor administrativ të Bankës së Shqipërisë. Buxheti faktik, i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, i aneksohet Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë.
- 9.6 Guvernatori përfaqëson Bankën e Shqipërisë në marrëdhëniet e punësimit.
- 9.7 Guvernatori përfaqëson Bankën e Shqipërisë në marrëdhënie me subjekte të treta, të huaja ose vendase ose jorezidente.
- 9.8 Guvernatori nënshkruan në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë.
- 9.9 Për çështje specifike dhe të një karakteri të veçantë për Bankën e Shqipërisë, Guvernatori mund t'i delegojë kompetencat e tij komiteteve të veçanta, të cilat si organe kolegjiale krijohen me miratim të Këshillit Mbikëqyrës. Përbërja e këtyre komiteteve përgjigjet nga Guvernatori sipas fushave përkatëse dhe strukturës së Bankës së Shqipërisë.
- 9.10 Përveç kur Këshilli Mbikëqyrës i miraton shprehimisht, komitetet që krijohen si në pikën 9.9, nuk kanë të drejtë të nëndelegojnë kompetencat në një organ tjetër.

## **Neni 10**

### **Zëvendësguvernatori i Parë**

- 10.1 Zëvendësguvernatori i Parë asiston dhe përgjigjet përpara Guvernatorit për çështje të lidhura me zhvillimet në sistemin bankar dhe me rolin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në këtë sistem, të politikave të administrimit të parasë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, duke influencuar në arritjen e politikave kredituese.
- 10.2 Zëvendësguvernatori i Parë përgjigjet për paraqitjen e informacioneve e raporteve në Këshillin Mbikëqyrës jo më pak se një herë në muaj, për mbarëvajtjen e mbikëqyrjes së sistemit bankar shqiptar në veçanti dhe të sistemit financiar në përgjithësi, dhe për hartimin dhe realizimin e buxhetit të Bankës së Shqipërisë.
- 10.3 Zëvendësguvernatori i Parë monitoron dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti veprimtarinë e strukturave të caktuara në

Bankën e Shqipërisë me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe organizon dhe drejton mbledhje periodike të tyre.

Në mbledhjet periodike mund të ftohen për raportime, referime dhe këshillime nëpunës, ekspertë ose specialistë të tjerë të punësuar ose jo në Bankën e Shqipërisë, që kanë lidhje me çështjen objekt diskutimi.

10.4 Zëvendësguvernatori i Parë përgatit dhe lëshon urdhra për përdorim të brendshëm, të detyrueshëm për zbatim në Bankën e Shqipërisë si dhe nxjerr rekomandime e opinione.

## **Neni 11**

### **Zëvendësguvernatori i Dytë**

11.1 Zëvendësguvernatori i Dytë asiston dhe përgjigjet përpara Guvernatorit për :

- a) zbatimin e politikës rregullatore dhe juridike;
- b) zbatimin e politikave të administrimit të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
- c) mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave të përdorimit të mjeteve financiare të Bankës së Shqipërisë;
- dh) për zbatimin e procedurave në drejtimin e përgjithshëm ekzekutiv dhe administrativ në Bankën e Shqipërisë.

11.2 Për vlerësimin periodik të administrimit në përgjithësi në Bankën e Shqipërisë, Zëvendësguvernatori i Dytë përgatit dhe paraqet raporte në Këshillin Mbikëqyrës si më poshtë:

- a) për marrëdhëniet kontraktore juridike civile të Bankës së Shqipërisë;
- b) për ecurinë e procedurave dhe të praktikave administrative.

11.3 Zëvendësguvernatori i Dytë monitoron dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti veprimtarinë e strukturave të caktuara në Bankën e Shqipërisë me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe organizon dhe drejton mbledhje periodike të tyre. Në mbledhjet periodike mund të ftohen për raportime, referime dhe këshillime nëpunës, ekspertë ose specialistë të tjerë të punësuar ose jo në Bankën e Shqipërisë.

11.4 Zëvendësguvernatori i Dytë përgatit dhe lëshon urdhra të brendshëm, të detyrueshëm për zbatim në Bankën e Shqipërisë si dhe nxjerr rekomandime e opinione.

## **KREU III**

### **VEPRIMTARIA EKZEKUTIVE**

## **Neni 12**

12.1 Veprimtaria ekzekutive në Bankën e Shqipërisë organizohet nëpërmjet njësive organizative të saj në përputhje me strukturën administrative të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

12.2 Struktura administrative e Bankës së Shqipërisë përbëhet nga :

- a) Administrata në qendër:
  - i) departamentet;
  - ii) Kabineti i Guvernatorit.
- b) Administrata lokale:
  - i) degët.
  - ii) Shtypshkronja.

### **Neni 13**

#### **Departamenti**

- 13.1 Departamenti në Bankën e Shqipërisë është njësi organizative në strukturën e Bankës së Shqipërisë me fuqi administrative dhe ekzekutive.

Departamenti organizon, administron dhe drejton punën me objekt të përcaktuar, në përputhje me rolin dhe me funksionin sipas rregullores së brendshme të tij të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Departamenti drejtohet nga drejtori i departamentit. Drejtori i departamentit është drejtues ekzekutiv. Departamenti mund të ndahet në drejtori, sektorë dhe zyra.

- 13.2 Departamentet në Bankën e Shqipërisë klasifikohen:
- a) departamente me funksione kryesore (parësore);
  - b) departamente me funksione shërbimi dhe ndihmëse (dytësore);
  - c) departamente me funksione shërbimi (tretësore).

Përcaktimi konkret i departamenteve sipas këtij klasifikimi bëhet nga Këshilli Mbikëqyrës.

### **Neni 14**

- 14.1 Drejtorët e departamenteve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin, me statutin, me rregulloren përkatëse të çdo departamenti dhe rregulloret e tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 14.2 Çdo drejtor departamenti përgjigjet për :
- i) hartimin e projekteve dhe të studimeve, që paraqiten për miratim në Këshillin Mbikëqyrës ;
  - ii) organizimin dhe drejtimin e punës në njësinë organizative që i është besuar;
  - iii) zbatimin me efikasitet, në kushte normale dhe në kohë të të gjitha detyrave të deleguara nga Këshilli Mbikëqyrës, Guvernatori, Zëvendësguvernatori i Parë dhe i Dytë;
  - iv) zbatimin me efikasitet, në kushte normale dhe në kohë të të gjitha përgjegjësiave dhe pushteteve të parashikuara në rregulloren e brendshme të njësisë organizative dhe në rregulloret e tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 14.3 Çdo vend vakant në postin e drejtuesit të departamentit për shkak të vdekjes, dorëheqjes, transferimit, kualifikimit pasuniversitar ose të ndonjë shkakut tjetër plotësohet nga Guvernatori për një afat të pacaktuar, por jo më shumë se një vit kalendarik, deri në emërimin nga Këshilli Mbikëqyrës.

## **Neni 15**

### **Degët**

- 15.1 Banka e Shqipërisë, përveç administratës qendrore me seli në Tiranë për ushtrimin e veprimtarisë ekzekutive të saj, ka degë në rrethe të tjera të Shqipërisë, aktiviteti i të cilave rregullohet me rregullore të veçantë.
- 15.2 Me degë do të kuptohet njësi organizative e Bankës së Shqipërisë nën varësinë e kësaj të fundit, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë.

## **Neni 16**

### **Personeli**

- 16.1 Marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë rregullohen nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë" dhe rregullorja e personelit, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- 16.2 Anëtarët e personelit të Bankës së Shqipërisë emërohen dhe largohen nga Guvernatori, përveç atyre që emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 16.3 Anëtarët e personelit emërohen dhe stimulohen në bazë të parimeve të kualifikimit profesional, publicitetit, transparencës, barazisë së palëve dhe jo diskriminimit.
- 16.4 Në bazë të akteve të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori vendos mbi emërimin e punonjësve brenda çdo njësie të Bankës së Shqipërisë. Vendimi është i publikueshëm.
- 16.5 Njësitë dhe strukturat organike të Bankës së Shqipërisë vendosen nën drejtimin administrativ të administratorëve sipas rregullave proceduralë të miratuar. Në bazë të rregullave proceduralë, administratorët përcaktojnë përgjegjësitë individuale sipas njësive dhe strukturave të miratuara.
- 16.6 Çdo anëtar i personelit të Bankës së Shqipërisë duhet të informohet për pozicionin e tij/saj në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë, për mënyrat e raportimit dhe për përgjegjësitë profesionale.
- 16.7 Për zbatimin e ligjit, të statutit dhe të rregullave procedurale të Bankës së Shqipërisë në marrëdhënie me anëtarët e personelit nxirren akte administrative. Aktet administrative janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e personelit të Bankës së Shqipërisë.
- 16.8 Këshilli Mbikëqyrës miraton rregulloren e personelit dhe të kodit etik të punonjësve të Bankës së Shqipërisë, e cila përmirësohet sipas propozimit të organit vartës ekzekutiv.

## **Neni 17**

### **Kontrolli**

Departamenti i Kontrollit në veprimtarinë e tij drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm dhe bazohet në ligjet dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Inspektori i Përgjithshëm i paraqet Këshillit Mbikëqyrës raporte e rekomandime për problemet që dalin nga kontrollat e ushtruara, dhe çertifikon bilancet tremujore në pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë.

Inspektorët e Departamentit të Kontrollit emërohen dhe largohen nga Guvernatori , me propozim të Inspektorit të Përgjithshëm.

Objektet dhe procedurat e kontrollit përcaktohen në rregulloren e brendshme të këtij departamenti.

Rregullorja e brendshme e Departamentit të Kontrollit propozohet nga Inspektori i Përgjithshëm dhe miratohet në Këshillin Mbikëqyrës.

## KREU IV

### MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

#### Neni 18

- 18.1 Procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës në Bankën e Shqipërisë janë përcaktuar në rregulloren “Për funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
- 18.2 Këshilli Mbikëqyrës vendos dhe gjykon mbi procedurat e votimit në mbledhjet e tij. Për raste të veçanta, urgjente dhe të rëndësishme, votimi në Këshill Mbikëqyrës mund të realizohet me mjete elektronike të testuara komunikimi. Mënyra e votimit duhet të shënohet në procesverbal dhe të verifikohet nga Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës.

## KREU V

### TË NDRYSHME

#### Neni 19

- 19.1 “Kompetencat e nënshkrimit, ekzekutimit dhe qarkullimit të dokumentacionit nga dhe në Bankën e Shqipërisë, si dhe limitet e veprimit të pagesave, do të përcaktohen me udhëzim të veçantë të nxjerrë nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.”.
- 19.2 Çdo ndryshim në librin e nënshkrimeve të autorizuara duhet t’i njoftohet palëve të interesuara.
- 19.3 Në bazë të nenit 2 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës , administrator dhe nëpunës i Bankës së Shqipërisë sipas të drejtave të deleguara dhe detyrave të ngarkuara, nuk duhet të kërkojë apo të përfaqësojë interesat , udhëzimet apo porositë e organeve të tjera qendrore publike.
- 19.4 Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, nëpunësit dhe punonjësit (personeli) e Bankës së Shqipërisë gjatë ushtrimit të pushteteve dhe të detyrimeve të njohura nga ligji, Statuti ose ndonjë rregullore tjetër e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, mund të zhdëmtohen ose rimbursohen nga Banka e Shqipërisë për shpenzime të arsyetuara, të argumentuara dhe të dokumentuara, që shkaktohen nga ndjekja e veprimeve, mosveprimeve, procedurave civile dhe penale dhe çdo pasojë tjetër e kryer në detyrë ose në përfaqësimin e institucionit me të tretët. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur subjektet e lartpërmendura kanë vepruar me keqdashje ose nga neglizhenca.

- 19.5 Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, nëpunësit dhe punonjësit (personeli) e Bankës së Shqipërisë gjatë dhe pas ushtrimit të pushteteve dhe të detyrimeve të njohura nga ky Statut dhe nga ligji, detyrohen të ruajnë sekretin e informacionit, dokumenteve dhe të shënimeve, të çështjeve të përfunduara ose të papërfunduara, për përdorim të brendshëm ose për jashtë Bankës së Shqipërisë.
- 19.6 Në prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve të Bankës së Shqipërisë ndiqen parimet e transparencës, të publikimit, të barazisë së palëve, të jodiskriminimit dhe të administrimit me eficiencë, në përputhje me aktet përkatëse të prokurimit në Bankën e Shqipërisë.
- 19.7 Këshilli Mbikëqyrës miraton të gjitha aktet në zbatim të ligjit dhe Statutit të Bankës së Shqipërisë për çdo rast që konsiderohet e nevojshme apo e përshtatshme për të administruar veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

## **Neni 20**

- 20.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen ose të revokohen në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë votash.
- 20.2 Ky statut, së bashku me ndryshimet e tij, publikohet dhe depozitohet pranë Bankës së Shqipërisë për inspektim në çdo kohë brenda orarit zyrtar.
- 20.3 Statuti i Bankës së Shqipërisë miratuar me vendimin nr.141 datë 26.10.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe ndryshuar me vendimin nr.12 datë 17.02.1999 shfuqizohet.

Shkëlqim CANI

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS





*Salla e Këshillit Mbikëqyrës.*

### **6 dhjetor 2001**

Në Pallatin e Kongreseve, Tiranë, u zhvillua *Konferenca e Dytë Kombëtare "Shqipëria midis Reformave të Brendshme dhe Integritit Evropian"*. Organizimi i kësaj konference, ishte një ide e Bankës së Shqipërisë dhe me pjesëmarrjen e një auditori të gjerë, përfaqësues të institucioneve financiare bankare, institucioneve shtetërore vendase apo të huaja etj. Qëllimi i kësaj konference kishte të bënte me reformën institucionale në Shqipëri, me hapat e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, me reformën në sistemin financiar në Shqipëri etj..

### **29 dhjetor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.102, miraton udhëzimin "Për parandalimin e pastrimit të parave". Ky udhëzim shërben për hartimin e politikave dhe të procedurave të bankave dhe për krijimin e kushteve për zbatimin e tyre, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave. Në rregullore përcaktohen procedurat e identifikimit dhe të raportimit nga ana e bankave, strukturat përkatëse bankare dhe përgjegjësitë e tyre sipas kësaj rregulloreje etj..

### **29 dhjetor 2001**

Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.104, miraton "Politikën e sigurisë së informacionit". Qëllimi për të cilin hartohet dhe zbatohet kjo politikë për sigurinë e informacionit ka të bëjë me mbrojtjen e Bankës së Shqipërisë nga ndërhyrjet, nga veprimet keqdashëse ose aksidentale, të cilat ndikojnë direkt dhe çenojnë sigurinë kombëtare, reputacionin e imazhin e saj. Kjo politikë zbatohet mbi të gjithë përdoruesit e informacioneve të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë dhe ofruesit e shërbimeve; të gjitha asetet e informacionit, të cilat përfshijnë mjetet, të dhënat, programet, dokumentet në letër dhe personelin.

### **13 shkurt 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.05, miraton hapjen e llogarive për individë në degët e Bankës së Shqipërisë, me qëllim lehtësimin e kryerjes së procedurave për blerjet në tregun primar të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

## **Karakteristikat e politikës monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë**

Duke bërë disa konkluzione të përgjithshme për gjithë periudhën 1992 - 2000, mund të nënvizohet se në përgjithësi politika monetare është karakterizuar:

- Nga një objektiv final eksplicit që është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në çdo vit (përfshirë vitin 1996 - 1997) si pjesë e programeve të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i ekonomisë së vendit, ka pasur objektiva sasiore për inflacionin në fund të vitit ushtrimor, ndonëse gjykimi i përdorur asnjëherë nuk ka qenë transparent. Megjithatë, rrugët për të arritur këtë stabilitet, në përgjithësi, kanë qenë të paqarta. Gjatë gjithë periudhës nuk është zbuluar ndonjë lidhje e fortë midis rritjes së parasë dhe inflacionit. Në përgjithësi, me përjashtim të rasteve të rralla, niveli i programuar i rritjes së agregatëve monetarë nuk është përputhur me nivelet e faktuara, e megjithatë, inflacioni është mbajtur nën kontroll (në shumë raste shumë poshtë objektivit).

- Nga vendosja e një objektivit të ndërmjetëm për rritjen e parasë. Rritja e parasë është konsideruar nga Banka e Shqipërisë si një objektiv i ndërmjetëm, i cili do të çojë në përbushjen e objektivit final. Në fakt paraja (baza monetare) është nga të vetmit tregues që Banka e Shqipërisë mund ta kontrollojë në mënyrë të plotë. Pavarësisht kësaj nuk ka rezultuar që lidhja midis këtij treguesi dhe inflacionit të jetë e fortë, e për rrjedhim të tjerë faktorë, ku mund të veçohet kursi i këmbimit, vlerësohet të jenë përcaktues më të drejtpërdrejtë të sjelljes së presioneve inflacioniste në ekonomi.

- Nga aplikimi i kufizimeve sasiore në krahun e aktiveve. Që në gjashtëmuorin e dytë të vitit 1992 u vendosën nivele kufi të sipërme dhe të poshtme për gjendjen e treguesve të tillë si mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë (kufi i poshtëm), për mjetet e brendshme neto të sistemit bankar (kufi i sipërm) i ndarë në kredi neto për qeverinë dhe kredi për ekonominë. Të ashtuquajturat kritere të arritjes së suksesit vazhdojnë të përdoren dhe sot ndonëse diçka më ndryshe nga vitet e para të tranzicionit. Pa u ndalur konkretisht në llojin e atyre që përdoren aktualisht, do të theksojmë se, të paktën për periudhën 1998 - 2000 të tre objektivat sasiore janë realizuar shumë brenda kufijve të vendosur, ndërkohë që realizimi faktik i treguesve monetarë sidomos i rezervës së parasë dhe agregatëve monetarë është larg nivelit të programuar të tyre.

- Nga një kontroll i parasë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Vetëm në tremujorin e tretë të vitit 2000, u hoq dorë në mënyrë përfundimtare nga zbatimi i instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar, kur Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nxori "jashtë lojë" nivelin minimal të përqindjes së interesit për depozitat në lekë, të vendosura në bankat e nivelit të dytë me kapital shtetëror. Ndërkohë, kufizimet në akordimin e kredisë së re ishin hequr në një fazë më të hershme.

- Nga një eficiencë e ulët e mekanizmit të transmissioinit monetar. Duke filluar që nga tremujori i tretë i vitit 2000, Banka e Shqipërisë filloi të kontrollojë ofertën e parasë, nëpërmjet aplikimit të instrumenteve të tërthorta, ku vendin kryesor e zënë anakandet e repove në tregun e parasë. Në të vërtetë historia e aplikimit të instrumenteve jo të drejtpërdrejta është më e hershme, që nga mesi i vitit 1992. Pavarësisht kësaj duhet theksuar se efektiviteti i tyre ka qenë i ulët dhe në të gjitha rastet kryesisht vendimet janë transmetuar nëpërmjet përqindjes administrative të interesit. Kjo është e vërtetë për aq kohë sa është tentuar të frenohet rritja e mëtejshme e inflacionit, sepse në periudhat e tjera kur është tentuar relaksimi i politikës monetare edhe kjo masë ka rezultuar jo shumë e efekshme. Parë nga ky këndvështrim, me të drejtë mund të shtrohet pyetja a do të jetë e aftë përqindja e repove për të përçuar vendimet e Bankës së Shqipërisë në ekonomi. Përgjigja e kësaj pyetjeje është relativisht e vështirë. Tregu monetar megjithë përpjekjet e Bankës së Shqipërisë është akoma një treg i pazhvilluar, jofleksibël, i koncentruar etj.. Numri i transaksioneve në të është akoma i vogël, ku njëra palë në shumicën e rasteve është Banka e Kursimeve si dhe vëllimi i transaksioneve të realizuara nuk është ndonjë shumë e rëndësishme. Është fakt prej shumë vitesh që gllabërues i rezervave të tepërta ka qenë vazhdimisht buxheti i shtetit. Kufizimet e mbikëqyrjes bankare i penguan bankat me kapacitete të mëdha kreditimi (BKT dhe BK) të financojnë ekonominë e, për rrjedhim, të gjitha rezervat e tyre të tepërta u shndërruan në shpenzime buxhetore. Kjo situatë bëri që dhe tregu i emetimit të bonove të thesarit të jetë një treg i mbizotëruar nga Banka e Kursimeve gjë që është reflektuar në ruajtjen e një diference relativisht të lartë midis yield-it të bonove dhe kostos së bankave. Edhe pse ka disa kohë që tregu rregullohet nëpërmjet shitblerjes së repove është e paqartë nëse ekziston ndonjë nivel kufi për gjendjen e rezervave të tepërta në sistem.

*Normalisht ekziston një nivel i tillë, i cili gjykohet si optimal dhe ruajtja e të cilit realizohet nëpërmjet manipulimit që banka qendrore i bën përqindjes bazë të interesit.*

*Nga një gjendje e lartë e kredisë për Qeverinë. Fillimisht në formë të drejtpërdrejtë e më pas me anë të emetimit të bonove të thesarit u arrit që pjesa dërmuese e borxhit të Qeverisë të blihet nga sistemi bankar. Në këtë mënyrë, buxheti u shndërrua në "konsumatorin" më të madh të parasë gjë që reflektohet dhe në faktin se në fund të vitit 2000, borxhi i qeverisë ndaj sistemit bankar arrin rreth 150 miliardë lekë ose 66.5 për qind të totalit të borxhit të brendshëm. Një ulje e kërkesës për para nga ana e buxhetit do të ulte yield-in e bonove dhe anasjelltas një rritje e kërkesës për para nga ana e qeverisë do të rriste yield-in e bonove, pavarësisht faktit nëse Banka e Shqipërisë do të ulë apo do të ngrejë përqindjen e repove në tregun e parasë. Ndryshimi i përqindjes së interesit nga banka qendrore dhe mishërimi i saj në treg gjendet në ndryshimin me kahje të njëjtë të përqindjes së kredive, të investimit në letra me vlerë, të çmimit të aktiveve fikse, të pritjeve në përgjithësi etj.. Në rastin e vendit tonë, kur ekziston një treg ndërbankar i pazhvilluar, një treg primar bonosh thesari shumë i koncentruar dhe një treg formal kredish ku huazohet më shumë monedhë të huaj, kuptohet që sinjalet e bankës qendrore vështirë të depërtojnë në "terren" e, për rrjedhim, dhe eficientia ngelet në nivele shumë modeste.*

### **27 shkurt 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.11, miraton rregulloren "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre". Në këtë rregullore përcaktohen afatet, procedurat, kushtet, për miratimin ose për refuzimin e dhënies së licencës, për pezullimin ose për revokimin e saj për kryerjen e veprimtarive të përcaktuara në ligjin nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit". Si subjekte të kësaj rregulloreje janë shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre. Dhënia e licencës për subjektet e kësaj rregulloreje publikohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në njërin nga gazetat me tirazh më të madh.

### **13 mars 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.17, miraton rregulloren "Për administrimin e fondit të pensionit për personelin e Bankës së Shqipërisë". Rregullorja përcakton regjimin e fondit të pensionit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për aq kohë sa Banka e Shqipërisë do të bëjë administrimin e tij. Rregullorja përcakton marrëdhëniet e personelit të Bankës së Shqipërisë me fondin e pensionit dhe :

- parimet bazë të krijimit të fondit të pensionit për personelin e Bankës së Shqipërisë;
- parimet bazë të ndërtimit të formulës së pensioneve dhe kartelës së llogarisë personale të anëtarëve të fondit; balancimin financiar të formulës së pensionit (përfitime të përcaktuara me kontributet e përcaktuara);
- rregullat teknike dhe procedurat për caktimin, për administrimin dhe për pagimin e pensioneve; rregullat financiare të administrimit të fondit etj..

### **27 mars 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton "Marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave për vitin 2002". Objekti i kësaj marrëveshjeje është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, në fushat e mëposhtme:

- mbajtja e llogarisë bankare të Qeverisë në Bankën e Shqipërisë (agjentit fiskal);
- kryerja e funksioneve të arkës së buxhetit të shtetit nëpërmjet sistemit bankar;
- kredia e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
- derdhjet e mundshme gjatë vitit, nga fitimi i planifikuar i Bankës së Shqipërisë.

### **10 prill 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.27, miraton rregulloren "Mbi politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore". Sipas kësaj rregulloreje objektivat e administrimit të rezervës valutore janë:

- ruajtja e rezervës nëpërmjet investimit në institucione dhe instrumente financiare me një nivel të njohur dhe të pranuar rreziku;
- garantimi i plotësimit në çdo kohë të nevojave për mjete financiare likuide të Bankës;
- reduktimi i kostos oportune, që shoqëron investimin e rezervës, duke konsideruar dy objektivat e mësipërm. Në këtë rregullore, përcaktohen nivelet hierarkike të procesit të miratimit të administrimit të rezervës valutore; instrumentet e investimit të rezervës valutore, dhe si të tilla rregullorja parashikon: depozitat me afat; bono thesari, fix bis, letrat me vlerë, nota thesari, MTI Bis etj..

Një rëndësi të veçantë rregullorja i kushton rreziqeve të procesit të administrimit të rezervës valutore, të cilat janë: rreziku i kreditit; rreziku i likuiditetit; rreziku operacional; rreziku i tregut; rreziku i kursit të këmbimit; rreziku i ndryshimit të normës së interesit. Gjithashtu, është përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit të performancës së investimit dhe mënyra e raportimit nga strukturat përkatëse në Bankën e Shqipërisë.

### **24 prill 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.30, miraton shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike (përkujtimore) me dhe pa kurs ligjor në vitin 2003, sipas tematikave, të dhënave teknike, tirazhit dhe pamjeve të : monedhës metalike prerja 50 lekë me tematikë "100-Vjetori i vdekjes së Jeronim de Radës, 1903 – 2003" (përkujtimore), pa kurs ligjor; si dhe të monedhës metalike, prerja 50 lekë me tematikë "Antikiteti shqiptar" me kurs ligjor.

### **8 maj 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.32, miraton udhëzimin "Për sekretin bankar". Qëllimi i hartimit të këtij udhëzimi ka të bëjë me procedurat që lidhen me detyrimin ligjor që kanë bankat e nivelit të dytë për të ruajtur sekretin e informacionit të klientëve të tyre. Sipas këtij udhëzimi informacioni i klientit trajtohet vetëm nga personat e autorizuar në bankë.

Gjithashtu, ky udhëzim ndalon trajtimin e informacionit të klientit për qëllime vetjake nga personat e autorizuar në bankë; për qëllime përfitimi nga persona të tretë jashtë bankës; si dhe për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në nenin 26 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Në këtë udhëzim përcaktohet, gjithashtu, se dhënia dhe asgjësimi i informacionit të klientit sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore mund të bëhet nga administratori i bankës.

### **12 qershor 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.40, miraton kërkesën e Bankës së Kursimeve, për hapjen e degës së saj në Kosovë.

Për herë të parë një bankë e licencuar për të vepruar në Republikën e Shqipërisë merr leje për hapjen e një dege jashtë Shqipërisë

### **12 qershor 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.45 miraton udhëzimin "Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave". Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat, procedurat dhe detyrimet e palëve kur një bankë merret në administrim të përkohshëm nga Banka e Shqipërisë, kur vendoset në kujdestari dhe kur një bankë likuidohet.

Sipas këtij udhëzimi, vendimin për vendosjen e bankës në kujdestari e merr Guvernatori, në rastet kur raporti ndërmjet kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të saj me rrezik, dhe zërave jashtë bilancit është më pak se gjysma e raportit minimal të kërkuar dhe kjo nuk është korigjuar edhe pas kalimit të afatit të dhënë nga Banka e Shqipërisë. Ndërsa të drejtën për vendosjen e bankës në likuidim si dhe revokimin e licencës së bankës e ka Këshilli Mbikëqyrës, i cili vendos për vënien në likuidim kur konstatohen një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme: gjykata ka marrë vendimin për likuidimin e shoqërisë kur është ngritur padi nga kreditorë të bankës, në rastin e përcaktuar në nenin 51 (c) të ligjit për bankat (likuidim i detyruar); ose në rastet përcaktuara në nenet 44/2/g dhe 51/1, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (likuidim i detyruar).

### ***21 qershor 2002***

Fondi Monetar Ndërkombëtar jep miratimin e tij përfundimtar për huanë tre vjeçare në kuadrin e PRGF (Poverty Reduction Growth Facility) me një vlerë prej 28 milionë sdr ose rreth 36 milionë usd. Huaja jepet për të mbështetur programin ekonomik të Qeverisë Shqiptare. Ajo pason ratifikimin nga Bordi Ekzekutiv i Bankës Botërore të datës 20 qershor, lidhur me Strategjinë e Rritjes dhe Reduktimit të Varfërisë në vend. Huaja është e vlefshme deri më 20 qershor 2005.

### ***26 qershor 2002***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.51, miraton "Manualin e veprimeve korigjuese ndaj bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i hartimit të këtij manuali është përcaktimi i politikës së Bankës së Shqipërisë, për përdorimin e kompetencave në zbatimin e përgjegjësive të saj për marrjen e veprimeve korigjuese, në përgjigje të shkeljeve nga bankat të ligjeve, të akteve nënligjore dhe/ose në rast se konstatohet ushtrimi i veprimtarisë të pasigurtë dhe të paqëndrueshme bankare.

Sipas këtij manuali, veprimi korigjues, zbatohet në formën e këshillave apo të rekomandimeve, të memorandumëve të mirëkuptimit, të masave ndëshkimore dhe dënimeve, sipas nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 8365, datë 2 korrik 1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Politika e përcaktuar në këtë manual synon përdorimin nga Banka e Shqipërisë, të veprimeve të tilla si memorandumumi i mirëkuptimit dhe i urdhrave për një veprimtari të sigurtë dhe të shëndoshë bankare, që përfshijnë institucionet financiare ("bankat") të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë.

### ***10 korrik 2002***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.54, miraton rregullat "Mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit me specialistë të jashtëm, për nevoja të Bankës së Shqipërisë". Qëllimi i këtyre rregullave ka të bëjë me faktin që Banka e Shqipërisë, mbështetur në politikat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, krijon mundësi të bashkëpunimit me të gjithë ata specialistë, të cilët vënë në shërbim të nevojave të saj energjitë dhe kapacitetet e tyre intelektuale, duke mundësuar kryerjen e punimeve, në funksion të realizimit të nevojave dhe të objektivave strategjike të saj.

Për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të këtij bashkëpunimi, i është lënë kompetencë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, që të miratojë krijimin e strukturave të nevojshme, të cilat do të funksionojnë në përshtatje me zhvillimet e politikave në këtë fushë.



*Mozaik në hollin kryesor të Bankës së Shqipërisë.*

### **24 korrik 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.59, miraton matricën "Mbi nivelin e vendimmarrjes për mbikëqyrjen bankare". Qëllimi i hartimit të kësaj matrice ka të bëjë me përcaktimet e kompetencave të miratimit në Bankën e Shqipërisë, në fushën e mbikëqyrjes bankare.

### **24 korrik 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.59, miraton që bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë të kenë të drejtë të kryejnë edhe veprimtari bankare, që lidhet me metalet e çmuara.

### **25 korrik 2002**

Kuvendi i Shqipërisë miraton me ligjin nr.8893, datë 25.07.2002 "Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998". Këto shtesa e ndryshime kanë si qëllim kryesor rritjen dhe forcimin e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë dhe përshtatjen e ligjit në fuqi me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

### **28 gusht 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.66, miraton pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare të "Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a".

Licenca paraprake kësaj banke i është dhënë me emrin "Banka Tregtare e Kuvajtit", por në fazën e licencimit përfundimtar banka vendosi të ndryshojë emrin.

### **28 gusht 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.67, miraton rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre". Qëllimi i miratimit të kësaj rregulloreje është përcaktimi i normave dhe i rregullave të mbikëqyrjes së shoqërive të kursim -kreditit dhe të unioneve të tyre, në bazë të kompetencës së dhënë nga ligji për Bankën e Shqipërisë si autoriteti mbikëqyrës i shoqërive të kursim-kreditit dhe i unioneve të tyre. Kjo rregullore përcakton rregulla për këto subjekte që lidhen me mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit; me kreditë dhe normat e interesit

për kreditë, me klasifikimin e kredive, me llogaritjen e provigjoneve, me cilësinë e portofolit të kredive; me mjaftueshmërinë e kapitalit; me likuiditetin; me raportimin, me kontrollin etj..

### ***28 gusht 2002***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.68, miraton konfigurimet e vizatimeve të monedhave metalike që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2003, dhe konkretisht për monedhën metalike, prerja 50 lekë, me tematikë "100-vjetori i vdekjes së Jeronim De Radës", vizatimi me numër 20/b; dhe me tematikë "Antikiteti shqiptar", vizatimi me numër 20/a. Këshilli vendosi që rregullimet në pamjet e lira të monedhave metalike përkujtimore që do të shtypen në vitin 2003, të bëhen sipas sugjerimeve të komisionit të vlerësimit të vizatimeve.

### ***11 shtator 2002***

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.71, miraton rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".

Kjo rregullore është nxjerrë bazuar në kompetencën që ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ka dhënë Bankës së Shqipërisë si i vetmi autoritet, që lëshon licencën si akt administrativ për dhënien e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë bankare. Sipas kësaj rregulloreje, shumta e kapitalit fillestar minimal të paguar (kontributi në para), për licencimin e një banke është jo më pak se 700 milionë lekë.

Kjo rregullore përmban në mënyrë të detajuar kërkesat për aksionet e propozuara të bankës, përcaktimin e aksionerëve direkte dhe indirekte të bankës, në zbatim të parimit 2, të Komitetit të Bazelit, për një mbikëqyrje të kujdesshme si dhe rritjen e transparencës së procesit të licencimit nëpërmjet publikimit të kërkesave.



*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.*

*Nga e majta në të djathtë ulur :*

*Dr. FATOS IBRAHIMI - Zëvendëskryetar dhe Zëvendësguvernator i Parë, Prof.Dr. SABAH HILMIA - Anëtar, Prof.Dr. SHKËLQIM CANI - Kryetar dhe Guvernator - Prof.Asocc. Dr. DRINI SALKO-Anëtar*

*Nga e majta në të djathtë në këmbë :*

*Prof.Dr. SULO HADËRI – Anëtar, BAJRAM MUÇA – Anëtar, Prof.Asocc. Dr. TONIN KOLA – Anëtar, LLAZI BALLIU - Anëtar*

### *Banka e Shqipërisë në procesin e integrimit.*

Në "Strategjinë e zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në vitin 1999, u përcaktua se modeli institucional i Bankës së Shqipërisë, është ai i Bankës Qendrore Europiane (BQE). Natyrisht krahasueshmëria e Bankës së Shqipërisë me praktikat dhe standartet e BQE dhe ato evropiane do të realizohet dhe përsoset paralelisht me zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga ana tjetër, zona e veprimit të euros mbulon një pjesë të madhe të vendeve të cilat, aktualisht dhe në perspektivë, mendohet se do të jenë partnerët kryesorë ekonomikë të vendit. Që tani shkëmbimet ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian zënë për qind dhe mendohet të rriten në vëllim dhe peshë specifike në të ardhmen. Sigurisht, duke zgjedhur Bankën Qendrore Europiane si model, nuk kemi parasysh as madhësinë e kapitalit, as strukturën organizative të saj dhe as rolin e funksionet e saj në shkallë evropiane e botërore, por përshtatjen graduale me standartet evropiane dhe kërkesat e integrimit ekonomik e financiar me Evropën e zhvilluar.

Për këtë arsye, në strategjinë e zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë, afrimi me modelin e zgjedhur institucional u mendua të bëhej me etapa, duke krijuar kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në periudhën afatgjatë në institucionet evropiane dhe më gjerë. Realizimi do të bëjë të mundur, gjithashtu, afrimin relativisht të shpejtë të sistemit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të matur të sistemit bankar sipas direktivave të Bashkimit Evropian dhe parimeve të njohura e të pranura të BIS Bazel.

Integrimi në Bashkimin Evropian është shpallur si objektivi strategjik i Shtetit Shqiptar, një ndër objektivat që gëzon edhe konsensusin në radhët e popullsisë dhe të politikës. Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse në procesin e integrimit duke qenë anëtare e organizmave përkatës të krijuar brenda vendit. Megjithatë, në këtë proces Banka e Shqipërisë ka një rol më të veçantë pasi përqendrimi i saj do të jetë kryesisht në politikën monetare dhe të kursit të këmbimit dhe direktivat evropiane për mbikëqyrjen bankare, për legjislacionin bankar dhe për statistikën.

Procesi i integrimit të Shqipërisë në strukturat e Bashkimit Evropian, përfshin jo vetëm reformat e brendshme ekonomike dhe përgatitjet individuale të vendit për anëtarësim. Ai përfshin njëkohësisht forcimin e kooperimit dhe të bashkëpunimit rajonal. Iniciativat rajonale në kuadrin e Paktit të Stabilitetit i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi, dhe Shqipëria është pjesëmarrëse aktive të këto procese. Duke synuar vazhdimisht pjesëmarrjen në proceset integruese, edhe Banka e Shqipërisë është aktive në të gjitha forumet dhe iniciativat e vendeve të rajonit të Ballkanit.

Në procesin e përgatitjes së vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Banka e Shqipërisë po i kushton një vëmendje të veçantë përbushjes së kriteve normative të përcaktuara në traktatet e ndryshme të Evropës të cilat ndikojnë në këto drejtime kryesore:

- thellimin e stabilitetit ekonomik;
- nxitjen e sipërmarrjes së lirë;
- ristrukturimin dhe fuqizimin e tregut financiar;
- nxitjen e përmirësimit të shërbimeve bankare.

Politika monetare ka në qendër të saj arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe mbajtjen e inflacionit në nivel 2-4 për qind. Ajo e arrin këtë objektivi nëpërmjet politikave të përshtatshme për normat e interesit, duke u mbështetur tërësisht në instrumentet indirekte të politikës monetare, në kushtet e regjimit të kursit të luhatshëm të këmbimit të lekut, duke synuar minimizimin e luhatjeve të mëdha dhe spekulative të tij.

Banka e Shqipërisë kontributin e saj kryesor në lidhje me përbushjen e objektivit të thellimit të stabilitetit makroekonomik e jep nëpërmjet hartimit të politikës monetare në funksion të arritjes së objektivit për inflacionin. Marrëveshja ESAF-2 (e cila u shndërrua në marrëveshjen PRGF) e nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar përcaktoi një sërë objektivash që vendosnin kuadrin brenda të cilit duhej të zhvillohej ekonomia shqiptare. Në tërësi, është vlerësuar se po përbushen objektivat e kësaj marrëveshjeje, ku kontribut ka edhe Banka e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë, duke synuar një stabilitet të përgjithshëm dhe zhvillim ekonomik, e shikon kreditimin e ekonomisë vendase si një nga kushtet kryesore për nxitjen e sipërmarrjes së lirë.

Sistemi bankar shqiptar është segmenti më i madh dhe më i zhvilluar i tregut financiar në Shqipëri. Bankat me kapital privat po bëhen gjithmonë e më tepër aktive në treg duke zvogëluar dominimin e bankës së vetme shtetërore, Bankës së Kursimeve.



### **13 nëntor 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.84, miraton rregulloren "Për llogaritë rezervë në Lekë të bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë". Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndjekja dhe administrimi i "Llogarisë rezervë" do të kryhet në funksion të plotësimit të : ruajtjes së nivelit minimal të lejueshëm, për llogaritë rezervë të bankave të nivelit të dytë në lekë, sipas kufirit të përcaktuar në rregulloren në fuqi "Për rezervën e detyrueshme për depozitat monetare në lekë dhe në valutë"; rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, si dhe të marrëdhënieve administrative funksionale brenda departamenteve të Bankës së Shqipërisë, në lidhje me administrimin e kësaj llogarie, si dhe minimizimit të rrezikut të likuiditetit nëpërmjet ndjekjes dhe administrimit gjatë gjithë ditës së punës të gjendjes së kësaj llogarie.

### **27 nëntor 2002**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miraton me vendimin nr. 87, udhëzimin "*Politika e përdorimit të internetit*". Qëllimi i miratimit të këtij udhëzimi është përcaktimi qartë i politikës së Bankës së Shqipërisë për përdorimin e internetit si dhe i mjeteve të tjera të teknologjisë së informacionit që e shoqërojnë atë. Kjo politikë është e detyrueshme për të gjithë punonjësit e Bankës dhe për çdo person të jashtëm (kontraktor, konsulent, nëpunës të përkohshëm, personeli i shitjeve etj.) i cili mund të aksesojë sistemet dhe infrastrukturën e teknologjisë dhe informacionit të Bankës së Shqipërisë.

### **5 dhjetor 2002**

Banka e Shqipërisë organizon Konferencën III Kombëtare: "*Banka e Shqipërisë dhe roli i saj në dekadën e dytë të tranzicionit*". Organizimi i kësaj konference, ishte një ide e Bankës së Shqipërisë dhe me pjesëmarrjen e një auditori të gjerë, përfaqësues të institucioneve financiare bankare, institucioneve shtetërore vendase apo të huaja etj. Qëllimi i kësaj konference kishte të bënte me zhvillimin dhe reformat institucionale të Bankës së Shqipërisë, me sistemin financiar shqiptar në kushtet e tranzicionit etj..



*Kryeministri i Shqipërisë, z. Fatos Nano*

*Foto nga Konferenca III Kombëtare "Banka e Shqipërisë në dekadën e dytë të tranzicionit".*

Në konferencë pati 16 referues dhe 2 personalitete përshëndetës (Ambasadori i Britanisë së Madhe në Shqipëri, David Landsman dhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Fatos Nano). 10 referues ishin të huaj, emra të njohur në fushën e kërkimeve ekonomike dhe të bankingut qendror. Nga referuesit, 5 përfaqësonin akademikët. Me organizimin e kësaj konference u kalua në një fazë të re, atë të forcimit të tiparit shkencor të konferencave të Bankës së Shqipërisë.

### **17 dhjetor 2002**

Në Pallatin e Kongreseve, Tiranë, u zhvillua Konferenca "Roli i sistemit bankar në përmirësimin e klimës së biznesit". Organizimi i kësaj konference, ishte një ide e Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Kombëtare të Greqisë, e mbështetur nga komuniteti i biznesit dhe kishte si qëllim kryesor krijimin e një klime dhe ambienti sa më atraktiv për sektorin privat në Shqipëri.

### **27 dhjetor 2002**

Gubernatori i Bankës së Shqipërisë miraton udhëzimin "Mbi përdorimin e sistemit S.W.I.F.T". Në këtë udhëzim përcaktohen procedurat e përdorimit të sistemit S.W.I.F.T në Bankën e Shqipërisë, mënyra e përgatitjes dhe e dërgimit të informacionit nga departamenti përkatës, procedura e punës që ndiqet nga çdo përdorues i sistemit S.W.I.F.T në Bankën e Shqipërisë etj..

### **viti 2002**

#### Politika monetare

U shënuan hapa përpara në drejtim të punës parapërgatitore për adoptimin e regjimit të *inflation targeting*. Departamenti i Kërkimeve dhe Politikave Monetare (DKPM), demonstroi një nivel të kënaqshëm të bashkëndimit të punës në përputhje me rekomandimet e misionit të asistencës teknike.

#### Rezerva valutore

Krahasuar me fundin e vitit 2001, në fund të vitit 2002 rezerva valutore rezultonte e rritur në masën 13.8 për qind, për një shumë absolute prej 101.5 milionë dollarë amerikanë. Në fund të vitit 2002, vlera e rezervës valutore ishte 838.9 milionë dollarë amerikanë.

Administrimi i rezervës valutore gjatë vitit 2002 është kryer në një mënyrë e cila përputhej me opinionin e ndërtuar nga specialistët mbi zhvillimet e pritshme në tregjet ndërkombëtare financiare. Për ndërtimin e këtij opinionin janë shfrytëzuar materiale, komente, analiza të institucioneve të njohura financiare, si edhe përvoja në rritje e vetë specialistëve.

#### Sistemi kontabël

Viti 2002, shënoi një progres të dukshëm në drejtim të ndërtimit të sistemit kontabël në Bankën e Shqipërisë sipas praktikave më të mira të bankave qendrore. Këtij qëllimi i shërbeu realizimi i projektit "Implementimi i projektit ATM" (*Accounting & Treasury Management*) dhe implementimi i manualit kontabël për Bankën e Shqipërisë. Implementimi i sistemit ATM, u krye gjatë periudhës shtator 2001-tetor 2002

## EVOLUIMI I STRUKTURËS JURIDIKE TË BANKËS QENDRORE

4 Shkurt 1863

BANKA OTOMANE SI BANKË EMISIONI

Kapitali: anglo-francez.

Veprimtaria: kryesisht në fushën e kreditit.

4 Tetor 1913

BANKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË

Akti që e ka miratuar

Marrëveshja e Qeverisë së Ismail Qemalit me përfaqësues të Wiener Bank Verein, dhe me përfaqësues të Banca Commerciale Italiana.

Kapitali :

Koncesion 60- vjeçar nga data e themelimit të bankës, me të drejtë zgjatjeje.

Drejtimi dhe organizimi

Banka do të drejtohej nga një Këshill Administrimi me përbërje nga dy grupet themeluese dhe me element shqiptar. Këshilli ia delegonte fuqitë e veta Komitetit të Drejtimit me dy deri në katër anëtarë.

Aktivitetet kryesore:

Banka do të ishte i vetmi agjent financiar i qeverisë, si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Vetëm ajo kishte privilegjin të tregtonte për llogarinë e qeverisë bonot e thesarit dhe letra të tjera me vlerë të qeverisë.

11 mars 1925

BANKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË

Akti : Konventë e nënshkruar nga përfaqësuesit e Qeverisë Shqiptare dhe të asaj italiane.

Kapitali :

Kapital nominal prej 12.500. 000 franga ari (dymbëdhjetë milionë e gjysmë).

Aktivitetet kryesore:

- banka ka privilegjin ekskluziv të nxjerrjes së kartëmonedhës, që do të ketë një kurs ligjor e një fuqi të patundshme për pagesat në Shqipëri;
- banka depoziton fondet e shtetit, do të ketë shërbimin e thesarit dhe të negociojë huanë qeveritare e të bashkive etj..

12 korrik 1925

BANKA KOMBËTARE

Akti :

Ligji "Mbi pranimin e Konventës për Bankën Kombëtare, të konvencionit për huanë prej 50.000.000 franga ari për punë botore, të ligjit organik të Bankës Kombëtare, të ligjit mbi rregullimin e monedhave. (botuar në Fletoren zyrtare 31 korrik 1925, Nr.40).

13 janar 1945

BANKA E SHQIPTAR

Akti : Ligji i miratuar nga Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar , për anulimin e koncensioneve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të aksioneve të saj. Me këtë ligj organik u krijua Banka e Shtetit Shqiptar, si institucioni më i rëndësishëm i sistemit financiar të shtetit shqiptar.

Kapitali

10.000.000 fr.sh. të derdhura nga shteti nëkushtetutimin e bankës

Aktivitetet kryesore:

- Ushtrimi i emisionit të kartmonedhës dhe emëtimit të monedhës prej metali;
- Skontimi i efekteve të tregëtisë që rrjedhin nga veprimtaritë tregtare, domethënë të emetuara ose të hequra për qëllime tregëtare industriale dhe bujqësore;

- Akordimi i paradhënies të garantuara nga pengu mbi fonde publike shqiptare, nga nota pengu të nxjerra prej magazinave të përgjithshme etj.

#### Administrimi dhe drejtimi

Banka drejtohet nga një këshill i administratës prej 9 personash. Përveç Këshillit krijohet edhe Komiteti i Administratës, kompetenca kryesore e të cilit kishte të bënte me drejtimin e përhershëm të Bankës, si dhe me delegacionet me të cilat e ngarkon Këshilli. Në bankë funksionon edhe Komisioni i Kontrollit, i cili krijohet për kontrollimin mbi drejtimin e llogarive të bankës.

22 dhjetor 1945

BANKA E SHETIT SHQIPTAR

Akti:

Ndryshime në ligjin organik të Bankës së Shtetit Shqiptar me ligjin nr.184 datë 22.12.1945.

Ndryshimet konsistojnë kryesisht në :

- rritjen e shumës së paradhënies për t'i çelur kredi në llogari rrjedhëse Qeverisë pa interes për nevojat normale të thesarit, nga shuma 30.000.000 franga shqiptare, në shumën 100.000.000 franga shqiptare;
- disa ndryshime në strukturën organizative të bankës.

8 gusht 1947

BANKA E SHETIT SHQIPTAR

Akti:

Dekret nr.441, datë 08.08.1947 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar".

23 qershor 1965

BANKA E SHETIT SHQIPTAR

Akti:

Ligji nr.4041, datë 23.06.1965 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar".

25 shkurt 1977

BANKA E SHETIT SHQIPTAR

Akti:

Dekreti nr.5529, datë 25.02.1977 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar".

Më këtë dekret përcaktohet Banka e Shtetit Shqiptar si institucion shtetëror që bën pjesë në sistemin financiar të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Aktivitetet kryesore

- të nxjerrë dhe të emetojë monedhën;
- të japë kredi;
- të kryejë sipas planit financimin e investimeve dhe të ndërtimeve;
- të kryejë veprimet e thesarit dhe të arkës për buxhetin e shtetit etj.

Statusi juridik

Person juridik me qendër në Tiranë, me rjetin e saj në rrethe, varësia nga ministri i financave.

Fondi i Bankës së Shtetit

Fondi i themelimit të Bankës së Shtetit Shqiptar përbëhet nga

- fondi i themelimit prej 750 milionë lekësh;
- fondi rezervë prej 250 milionë lekësh;
- fondi i mjeteve kryesore.

Drejtimi dhe organizimi

Në Drejtorinë e përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar krijohet Këshilli i Bankës së Shtetit Shqiptar si organ konsultativ, që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili miraton edhe përbërjen e Këshillit.

28 prill 1984

BANKA E SHETIT SHQIPTAR

Akti:

Dekret nr.6882, datë 28.04.1984 "Për një ndryshim në dekretin nr.5529 datë 25.02.1977 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar".

8 maj 1990

BANKA E SHETIT SHQIPTAR

Akti:

Ligji nr.7377 datë 08.05.1990 "Për Bankën e Shtetit Shqiptar".

Shfuqizon dekretin nr.5529, datë 25.02.1977 "Mbi Bankën e Shtetit Shqiptar".

Me këtë ligj krijohet Banka e Shtetit Shqiptar, si institucion qendror shtetëror, që zbaton politikën ekonomike për zhvillimin dhe për forcimin ekonomik-financiar të ndërmarrjeve, të institucioneve dhe të kooperativave bujqësore.

Aktivitetet kryesore

Ky ligj i dha Bankës së Shtetit autoritetin për të:

- nxjerrë -emetuar monedhën;
- dhënë kredi në lekë e në valutë;
- kryer financimin e investimeve dhe të ndërtimeve themelore;
- kryer veprimet e thesarit dhe të arkës për buxhetin e shtetit;etj.

Statusi juridik

Banka e Shtetit Shqiptar është person juridik me qendër në Tiranë, me rrjetin e saj në rrethe. Varet nga Këshilli i Ministrave dhe përgjigjet dhe jep llogari para tij.

Fondi i Bankës së Shtetit Shqiptar

Fondi i themelimit të Bankës së Shtetit Shqiptar përbëhet nga

- a) fondi i themelimit prej 750 milionë lekësh;
- b) fondi rezervë prej 250 milionë lekësh;
- c) fondi i mjeteve kryesore.

Bilanci vjetor i Bankës së Shtetit Shqiptar miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Drejtimi dhe organizimi

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar krijohet Këshilli i Bankës së Shtetit Shqiptar si organ konsultativ, që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili miraton edhe përbërjen e Keshillit.

22 prill 1992

BANKA E SHQIPËRISË

Akti:

Ligji nr.7559, datë 22.04.1992 "Për Bankën e Shqipërisë".

Me këtë ligj Banka e Shqipërisë fitoi të gjitha funksionet e një banke qendrore ndërsa Banka Kombëtare mori funksionet tregtare të Bankës së Shtetit Shqiptar.

Në këtë ligj si objektivi i Bankës së Shqipërisë përcaktohet ruajtja e vlerës së brendshme e të jashtme të monedhës kombëtare nëpërmjet zbatimit të politikës monetare.

Aktivitetet kryesore

Ky ligj i dha Bankës së Shqipërisë autoritetin për:

- miratimin dhe zbatimin e politikës monetare;
- rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar dhe për ruajtjen e stabilitetit të Lekut;
- të licencuar bankat e reja dhe për të mbikëqyrur veprimtarinë e tyre, me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar;
- zbatimin e politikës së shtetit për kursin e këmbimit;
- të emetuar dhe për të nxjerrë në qarkullim monedhën shqiptare;
- të shërbyer si bankë e bankave të nivelit të dytë, etj.

*Statusi juridik*

*Person juridik me qendër në Tiranë, që përgjigjet përpara Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë.*

*Fondi i themelimit*

*Fondi i themelimit të Bankës së Shqipërisë është 500 milionë lekë. Ai akordohet dhe është i tëri në dorëzani ekskluzive të shtetit. Ai nuk mund të transferohet ose të hipotekohet.*

*Administrimi dhe drejtimi*

*Drejtimi dhe administrimi i Bankës së Shqipërisë kryhet nga Këshilli i Drejtuesve të Departamenteve, nga Guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët.*

*Në bankë ushtron veprimtarinë e tij si organ vendimor Këshilli Mbikëqyrës, detyrat e të cilit përcaktohen në Statutin e Bankës së Shqipërisë.*

22 shkurt 1996

**BANKA E SHQIPËRISË**

**Akti:**

*Ligji nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë".*

*Me këtë ligj u përcaktua objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë që është "të sigurojë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve", gjë e cila nuk ishte e shprehur në ligjin e mëparshëm. Qartësimi i këtij objektivi do t'i shërbente Bankës së Shqipërisë për të nxitur dhe për të mbështetur zhvillimin e sistemit të këmbimeve valutore të tregut të brendshëm financiar dhe të sistemit të pagesave në mbështetje edhe të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit. Çdo objektiv tjetër i Bankës së Shqipërisë kushhtëzohet me arritjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë.*

*Të drejta të tjera që burojnë nga ky ligj:*

- të lidhë kontrata dhe të emetojë obligacione;
- të nxjerrë aktet nënligjore;
- të blejë të ketë, të përdorë dhe të zotërojë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së saj etj..

*Aktivitetet kryesore*

*Ky ligj i dha Bankës së Shqipërisë autoritetin për:*

- hartimin dhe zbatimin e politikës monetare (kjo ndërkohë që me ligjin e mëparshëm Banka e Shqipërisë ka patur vetëm të drejtën e miratimit dhe jo të hartimit të politikës monetare);
- rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar dhe për ruajtjen e stabilitetit të Lekut;
- të licencuar bankat e reja dhe për të mbikëqyrur veprimtarinë e tyre, me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar;
- të qenë emetuesja e vetme e monedhës dhe e kartëmonedhës kombëtare në Republikën e Shqipërisë;
- të administruar rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë etj.

*Statusi juridik*

*Person juridik i pavarur me qendër në Tiranë.*

*Fondi i themelimit*

*Fondi i themelimit të Bankës së Shqipërisë është 750 milionë lekë, dhe akordohet dhe është i tëri në dorëzani ekskluzive të shtetit. Ai nuk mund të transferohet ose të hipotekohet.*

*Administrimi dhe drejtimi*

*Përcaktohet krijimi i Këshillit Mbikëqyrës, si organi që ngarkohet për miratimin dhe për përshtatjen e politikave për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe për mbikëqyrjen e realizimit të tyre. Në Bankën e Shqipërisë përcaktohet krijimi edhe i Komitetit Drejtues i cili përbëhet nga Guvernatori, Zëvendësguvernatori Parë, Zzëvendësguvernatori i Dytë dhe drejtorët e departamenteve.*

*Në Bankën e Shqipërisë ka dhe një Departament Kontrolli, që drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm.*

21 dhjetor 1996

BANKA E SHQIPËRISË

Akti :

Ligji nr.8173, datë 21.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8076 datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë".

6 gusht 1997

BANKA E SHQIPËRISË

Akti:

Ligji nr.8230, datë 06.08.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr.8173, datë 21.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8076 datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë "

Me këtë ligj bëhen disa ndryshime në ligjin në ligjin nr. 8076, datë 22.02.1996, dhe që kanë lidhje kryesisht me përbërjen dhe me mënyrën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

23 dhjetor 1997

BANKA E SHQIPËRISË

Akti:

Ligji, nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"

Me këtë ligj sanksionohet pavarësia e Bankës së Shqipërisë. Ajo është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara.

Disa nga të drejtat dhe detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë :

- a) të lidhë kontrata dhe të nxjerrë akte normative;
- b) të tregtojë letra me vlerë,
- c) të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin ç saj kryesor;
- d) të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor, si dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- dh) të licencojë ose të revokojë këtë licencë bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
- e) të disponojë dhe të administrojë rezervat e saj valutore;
- ë) të veprojë me cilësinë e bankierit, të këshilltarit dhe të agentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
- f) të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave.

Me këtë ligj Banka e Shqipërisë :

- Përgjigjet para Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë;
- Ka si objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve;
- Ka të drejtë të veprojë si agente fiskale për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara në marrëveshje me Ministrinë e Financave;
- ka të drejtë ekskluzive dhe është emëtuese e vetme e kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Fondi i themelimit

Fondi i themelimit të Bankës së Shqipërisë është 750 milionë lekë. Ai mund të rritet me propozimin e Bankës së Shqipërisë dhe me miratimin e Ministrisë së Financave. I tërë fondi i themelimit akordohet dhe është në pronësi ekskluzive të Shtetit Shqiptar. Ky fond nuk mund të transferohet ose hipotekohet. 6 gusht 1997

#### *Organizimi dhe drejtimi*

*Banka e Shqipërisë organizohet, drejtohet dhe kryen veprimtarinë e saj nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës (si organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë), administratorëve, që janë guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët, si dhe personelit, siç përcaktohet në këtë ligj. Elementet e reja që ka sjellë ky ligj dhe që janë shprehje e sanksionimit të pavarësisë së Bankës së Shqipërisë qëndrojnë kryesisht tek:*

*mënyra e vendimmarjes; zgjedhja e Këshillit Mbikëqyrës, zgjedhja e Guvernatorit, afatet e qëndrimit të tij në detyrë; kompetencat e ekzekutivit; kufizimi i të drejtës për të dhënë kredi direkte për qeverinë përtej një kufiri të caktuar nga ligji etj.*

29 korrik 1998

BANKA E SHQIPËRISË

Akti:

*ligji nr. 8384, datë 29.07.1998 "Për shtimin e një dispozite tranzitore në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".*

*Dispozita tranzitore e shtuar në ligjin e mëparshëm, ka të bëjë kryesisht me mandatin e disa prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të cilët ishin të zgjedhur dhe të emëruar në bazë të ligjit nr.8230, datë 06.08.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë". Sipas këtij ligji të ri ata qëndrojnë në këtë funksion deri në mbarim të mandatit të tyre.*

25 korrik 2002

BANKA E SHQIPËRISË

Akti:

*Ligji nr. 8893, datë 25.07.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998.*

*Shtesat dhe ndryshimet e bëra me këtë ligj konsistojnë kryesisht në detyrimet që burojnë nga neni 161 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417 datë 21.10.1998, si edhe në disa shtesa dhe ndryshime të tjera të cilat evidentojnë dhe garantojnë nga pikëpamja politiko-legjislative pavarësinë e Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e politikës monetare.*

*Ndryshimet dhe shtesat kryesore që ka sjellë ligji i ri janë si vijon:*

- *Janë bërë dy shtesa në ligjin nr.8269 datë 23.12.1997, që kanë të bëjnë me zbatimin e pikës 1 të nenit 161 të Kushtetutës, sipas të cilit Banka e Shqipërisë ka të drejtën e zbatimit të pavarur të politikës monetare.*
- *Është shtuar një pikë e veçantë, me të cilën i jepet e drejta Bankës së Shqipërisë që të përdorë në mënyrë të pavarur mjetet (instrumentet) e politikës monetare me të cilat ajo realizon objektivin kryesor të saj, që është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si dhe objektivave të tjerë të politikës monetare.*
- *Është ndryshuar mënyra e zgjedhjes dhe e emërimit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.*
- *Është bërë një shtesë në nenin 46 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, e cila konsiston në shmangien e konfliktit të interesit të pozicionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës.*
- *Është ndryshuar pika 1 e nenit 63 dhe me këtë ndryshim Bankës së Shqipërisë i përcaktohet detyrimi që të mbajë dhe të administrojë jo vetëm rezervën e saj valutore (siç ishte neni i ndryshuar), por duhet të mbajë dhe të administrojë të gjithë rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë si dhe komponentët përbërës të kësaj rezerve, të cilët me ligjin e ri nuk pësojnë ndryshime.*



## BIBLIOGRAFIA

### BURIMET ARKIVORE

#### ***ARKIVI QENDROR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË***

##### ***Fondi i Bankës së Shqipërisë***

Fondet 279, 1006 të viteve 1925, 1927, 1930, 1931, 1935, 1939, 1940, 1943, 1944, 1945, 1977.

Fondi i Ministrisë së Oborrit Mbretëror  
Fondi i Parlamentit  
Fondi i Kryeministrit  
Fondi i Ministrisë së Punëve Botore  
Fondi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve  
Fondi i Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare  
Fondi i Ministrisë së Financave  
Fondi i Ministrisë së Jashtme  
Fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme  
Fondi i Legatës Italiane  
Fondi i Bankës Bujqësore të Shtetit Shqiptar  
Fondi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë  
Fondi i Bankës së Napolit "Dega Shqipëri"  
Banka Kombëtare e Punës  
Fondi i Degës së Bankës Kombëtare Korçë  
Fondi i Degës së Bankës Kombëtare Shkodër

#### ***ARKIVI I INSTITUTIT TË HISTORISË SË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:***

##### **DOKUMENTE SHQIPTARE TE BOTUARA**

Anuari statistikor i Republikës Popullore të Shqipërisë, 1958.  
Fletorja zyrtare, 1925-1938.  
Buxheti konsuntiv i vitit financiar 1930-1931, botim i Ministrisë së Financave të Mbretërisë Shqiptare, Tiranë, 1935.  
Buxheti konsuntiv i vitit financiar 1931-1932, botim i Ministrisë së Financave të Mbretërisë Shqiptare, Tiranë, 1938.  
Buxheti konsuntiv i vitit financiar 1932-1933, botim i Ministrisë së Financave të Mbretërisë Shqiptare, Tiranë, 1938.  
Buxheti konsuntiv i vitit financiar 1933-1934, botim i Ministrisë së Financave të Mbretërisë Shqiptare, Tiranë, 1938.  
Ligje, dekretligje e rregullore të vitit 1933, Tiranë, 1943.  
Shqipëria në vitin 1937, vëll. I, Tiranë, 1937.  
Shqipëria në vitin 1937, vëll. II, Tiranë, 1938.  
Tregtia e Jashtme e Shqipërisë në vitin 1938, Tiranë, mars 1939.

## DOKUMENTE TË HUAJA TË BOTUARA

Annuario statistico italiano 1941.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1931, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 27 Aprile 1932, Roma, 1932.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1931, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 29 Aprile 1933, Roma, 1933.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1933, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 1 Maggio 1934, Roma, 1934.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1934, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 29 Maggio 1935, Roma, 1935.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1935, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 15 Maggio 1936, Roma, 1936.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1936, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 7 Maggio 1937, Roma, 1937.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1937, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 29 Aprile 1938, Roma, 1938.

B.N.A. (Banca Nazionale d'Albania) Relazione sul bilancio al 31 Dicembre 1938, presentata alla assemblea generale degli azionisti del 10 Giugno 1939, Roma, 1939.

Dokumentet angleze për vitet 1930-1939 (përkthim shqip).

## SHTYPI PERIODIK SHQIPTAR

### ***Gazeta***

"Arbnia", Tiranë, 1929-1931, 1935-1937.

"Besa", Tiranë, 1931-1936.

"Bashkimi i Kombit", Tiranë, 1943-1944.

"Demokratia", Gjirokastër, 1925-1939.

"Dielli", Boston, 1909-1944.

"Drita", Tiranë, 1936-1939.

"Dajti", Tiranë, 1924-1926.

"Gazeta e Korçës", Korçë, 1920-1939.

"Jeta e re", Vlorë, 1927-1939.

"Kombi shqiptar", Tiranë, 1929-1932.

"Kosova", Kostancë, 1932-1933.

"Kuvendi kombëtar", Bukuresht, 1933-1935.

"Liria Kombëtare", Gjenevë (Zvicër), 1925-1935.

"Ora", Tiranë, 1929-1932.

"Populli", artikuj të ndryshëm, Shkodër, 1920-1924

"Përlindja e Shqipërisë", Vlorë, 1913-1914.

"Republika", Shkodër, 1923-1925.

"Sazani", Villeurbanne, Francë, 1938-1939.

"Shqipëria e re", Kostancë (Rumani), 1919-1936.

"Shtypi", Tiranë, 1937-1939.

"Telegrafi", Tiranë, 1926-1928.

"Vatra", Tiranë, 1933-1936.

"Vullneti i popullit", Tiranë, 1930-1932.

### ***Revista***

"ABC", Tiranë, 1936.

"Bota e Re", Korçë 1936-1937.

## MATERIALE STUDIIMI DHE RAPORTE TË INSITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE

*Albania: From Isolation Toward Reforms, Author/Editor: Blejer, Mario I ; Mecagni, Mauro ; Sahay, Ratna ; Hides, Richard ; Johnston, Barry ; Nagy, Piroška ; Pepper, Roy, Series: Occasional Paper, No. 98, June 15, 1992.*

*Author/Editor: Van Rijckeghem, Caroline ; Fiscal Affairs Department, Series: Working Paper No. 94/123, October 01, 1994.*

*Supporting Transition in Central and Eastern Europe: An Assessment and Lessons from the IMF's Five Years' Experience - Address by Michel Camdessus, Second Annual Francisco Fernández Ordóñez Address, Madrid, December 21, 1994.*

*The Social Safety Net in Albania, Author/Editor: Koliadina, Natasha ; European I Department, Series: Working Paper No. 96/96, August 01, 1996.*

*Albania-Recent Economic Developments, Series: IMF Staff Country Reports No. 97/21, April 17, 1997.*

*Press Release: IMF Approves Emergency Post Conflict Assistance for Albania, Nov.07,1997.*

*Reducing Inflation - Lessons from Albania's Early Success, Author/Editor: McNeilly, Caryl ; Schiesser-Gachnang, Doris ; IMF Institute, Series: Working Paper No. 98/78, May 01, 1998.*

*Inflation and Money Demand in Albania, Author/Editor: Kalra, Sanjay ; European I Department, Series: Working Paper No. 98/101, July 01, 1998.*

*IMF Survey:Conference on key issues in reform of international monetary system; Bretton Woods Committee annual meeting; Mexico's request for Stand-By; Albania's ESAF Arrangement; second quarterly release of joint debt statistics, June 21, 1999.*

*Public Information Notice: IMF Concludes Article IV Consultation with Albania, June 22, 1999.*

*Albania - Staff Report for the 1999 Article IV Consultation, Request for Second Annual Arrangement Under the Enhanced Structural Adjustment Facility and Request for Augmentation , Series: IMF Staff Country Report No. 99/50, June 22, 1999.*

*Albania Letter of Intent, December 21, 1999, This Letter of Intent of the government of Albania describes the policies that Albania intends to implement in the context of its request for financial support from the IMF, December 21, 1999.*

*Finance & Development, March 2000 - The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes , by Christopher Jarvis: During 1996-97, Albania was convulsed by the dramatic rise and collapse of several huge financial pyramid schemes. This article discusses the crisis and the steps other countries can take to prevent similar disasters, March 01, 2000.*

*The International Monetary and Financial Committee member for the constituency consisting of Albania, Greece, Italy, Malta, Portugal, and San Marino, April 16, 2000.*

*Inflation in Albania, Author/Editor: Rother, Philipp ; European I Department, Series: Working Paper No. 00/207, December 01, 2000.*

*Volume 47, Number 1, 2000 - The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania, by Chris Jarvis, What lessons can be drawn from the unprecedented growth and spectacular collapse of financial pyramid schemes in Albania?*

*Albania Letter of Intent, Memorandum of Economic and Financial Policies, and Technical Memorandum of Understanding, January 12, 2000.*

*Albania: First Review Under the Third Annual Arrangement Under the Poverty Reduction and Growth Facility and Request for Waiver of Performance Criteria—Staff Report; Series: Country Report No. 01/29, February 05, 2001.*

*Financial Sustainability and Reform Options for the Albanian Pension Fund , Author/Editor: Treichel, Volker ; European I Department, Series: Working Paper No. 01/47, April 01, 2001.*

*Albania: 2001 Article IV Consultation and Review Under the Poverty Reduction and Growth Facility—Staff Report and Public Information Notice on the Executive Board Discussion, Series: Country Report No. 01/117, July 27, 2001.*

*Albania: Selected Issues and Statistical Appendix*, Series: Country Report No. 01/118, July 30, 2001.  
*The International Monetary and Financial Committee statement on behalf of the constituency comprising Albania, Greece, Italy, Malta, Portugal, and San Marino*, November 17, 2001.  
*A Model of Exchange Rate Regime Choice in the Transitional Economies of Central and Eastern Europe*, Author/Editor: Klyuev, Vladimir ; European I Department, Series: Working Paper No. 01/140, September 01, 2001.  
*Stabilization Policies and Structural Reforms in Albania Since 1997—Achievements And Remaining Challenges*, Author/Editor: Treichel, Volker ; European I Department, Series: Policy Discussion Paper No. 02/2, March 01, 2002.  
 Describes the country's macroeconomic, structural, and social policies in support of growth and poverty reduction, as well as associated external financing needs and major sources of financing, May 20, 2002.  
*Albania — Letter of Intent, Memorandum of Economic and Financial Policies, and Technical Memorandum of Understanding*, January 7, 2003.  
 Each Public Information Notice contains a background section, a table of selected economic indicators, and an Executive Board assessment. March 07, 2003.  
*Albania: Report on the Observance of Standards and Codes—Fiscal Transparency Module*  
 Series: Country Report No. 03/202 July 08, 2003.  
*Albania: Joint Staff Assessment of the Poverty Reduction Strategy Paper Annual Progress Report* Series: Country Report No. 03/219 July 23, 2003.

## LITERATURA

*Albania - Income Distribution, Poverty, and Social Safety Nets in the Transition, 1991-1993*  
*Albania Country Report* - botim tremujor i Economist Intelligence Unit (EIU) for the period January 2001 - May 2003.  
*Albania Country Profile 2002*, botim i Economist Intelligence Unit (EIU), United Kingdom, 2002, f 52.  
*Albania Country Profile 2003*, botim i Economist Intelligence Unit (EIU), United Kingdom, 2003, f 54.  
 Alberti, M., Discorso inaugurale pronunciato dal presidente nell' Assemblée costitutiva della Banca Nazionale di Albania Romë, 1925.  
 Aleksejev, A. M. *Vojennaja valuta*, Moskë 1948.  
 Aleksandrov, M. A. Finansi Italii, monografi që ruhet në Bibliotekën e Institutit ekonomiko-financiar të Leningradit.  
 Baldaçi, A., *La Balcania alla pace di Bucarest*, në Studi speciali albanesi, Romë 1933, vol. II  
*L'Italia e il nostro commercio con I Montenegro e con L'Albania settentrionale*, në Studi speciali albanesi, Rome, viti 1933, vol. II.  
 Banka e Shqipërisë, *Monedhat dhe kartëmonedhat e Shqipërisë*, Tiranë, korrik 2002.  
 Banka e Shqipërisë, *Komentari i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe amendamentet e bëra atij*.  
 Banka e Shqipërisë, *Plani i zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë (2003-2005)*  
 Banka e Shqipërisë, *Komentari i Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"*  
 Banka e Shqipërisë, *Raportet Vjetore, shqip (1993-2002)*  
 Banka e Shqipërisë, *"Prania në Publik e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë" 1997-2002*.  
 Banka e Shqipërisë, *Legjislacioni bankar shqiptar*  
 Banka e Shqipërisë, *Licencimi i bankave dhe jobankave*.  
 120 vjet Bankë Kombëtare e Bullgarisë, Sofia 1999.  
 Borgata, G., Moneta e credito in Albania, në "Principi di economia albanese", Padova, 1941.  
 Bregel, E.J., *Kredit I kreditnaja sistema kapitalizma*, Moskë, 1948.  
*Sudni kapital i kredit*, Moskë, 1955.  
 Carocci, V., *La politica estera del'Italia fascista 1925-1928*, Bari, 1969.  
 Catalano, F., *L'economia italiana di Guerra 1935-1943*, Milano, 1960.  
 Demaria, G., .Il problema della politica economica albanese e lo sviluppo del reddito nazionale, në librin: "Principi

- di economia albanese*", Padova, 1941.
- Di Nardi, G., *Le finanze pubbliche d'Albania*, në Principi di economia albanese, Padova, 1941.
- Fishta, I., *Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1925-1944)*. Botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Tiranë, 1971.
- Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe roli i tij për pushtimin e Shqipërisë 1936-1939*, Tiranë 1999.
- Historia e Dhomës së Tregtisë, Shkodër shek. XIX-XX*, Tiranë 2001.
- "Reformat e Italisë fashiste në sistemin monetar dhe të kreditit në Shqipëri pas 7 prillit 1939 dhe karakteri i tyre kolonizues imperialist", në revistën "Ekonomia popullore", viti 1967, N. 2.
- "Gjendja politike dhe ekonomike në çerekun e parë të shekullit XX dhe përpjekjet për krijimin e sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri", në Buletinin shkencor të Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, viti 1968, N. 7.
- "Reformat e Italisë fashiste në sistemin monetar e të kreditit në Shqipëri pas 7 prillit 1939 dhe karakteri i tyre kolonizues imperialist", në "Probleme ekonomike", 1976, nr.2.
- "Ndërhyrja e imperializmit italian e gjerman në financat e Shqipërisë në vitet 1925-1944", në: "Ekonomia popullore", viti 1965, nr. 6 dhe viti 1966, nr. 1,2,3,4 dhe 5.
- Fishta, I. dhe Doçi M., *Ndërhyrja e kapitalit të huaj në financat e Shqipërisë në periudhën 1925-1944*, në revistën "Ekonomia popullore", viti 1965 N. 6 dhe viti 1966 N. 1, 2, 3, 4, 5.
- Fishta, I. Kareco, Th., *Prona private në Shqipëri, (1924-1944)*, (Përmes burimeve arkivore e bibliografike), Tiranë, 1996.
- Fishta, I. Toçi, V., *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë, 1983.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1985.
- Frashëri, S. *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?* Tiranë, botim i vitit 1962.
- Formentini, P., *La Banca Nazionale d'Albania ed il suo riordinamento monetario*, në "Rivista Bancaria", Milano, Giugno 1927, N. 6.
- Credito e Moneta in Albania, në "Rivista Bancaria", Milano 15 settembre 1929.
- Frei, L. I., *Kreditnaja i valutnaja politika kapitalistiçeskikh gosudarstv*, Moskë, 1962.
- Gaselato E. Lodolini A. Welczovsky A., *Bografia finanziaria italiana*, Rome 1931.
- Gibert, F., *Les pays d'Albanie et leur histoire*, Paris, 1914.
- Haxhi, A., *Masat revolucionare që janë zbatuar për stabilizimin dhe zotërimin e qarkullimit monetar, përmbajtja dhe karakteri i tyre*, në revistën "Ekonomia popullore", viti 1964, N. 4.
- Aspekte të politikës së ndjekur nga Banka Kombëtare Shqipërisë në lëmin e monedhës dhe të kreditit gjatë periudhës së pushtimit (1939-1944), në "Studime Historike", viti 1965, N. 2.
- Hilmia Sabah, Ibrahim Fatos, *Ekonomia Bankare*, Nr.1.
- Historia e Shqipërisë*, grup autorësh, botim i Universitetit Shtetëror Tiranë, Tiranë 1965, Vëll. II.
- Hilmia, S., *Disa aspekte të politikës së çmimeve nën regjimin feudalo-borgjez të Zogut*, në: "Studime historike", 1975, nr. 2.
- Aspekte kryesore të politikës së çmimeve në RPSSH*, Tiranë, 1976.
- Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë, 1984.
- Kalmes, A., *La situation economique et financière de l'Albanie*, Geneve, septembre, 1922.
- Kastrati, H., *Mendimet ekonomike të Gaspër Gugës*, botuar në Buletinin shkencor të Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, viti 1964, N. 4.
- Koka, V., *Marëveshjet italo-shqiptare të marsit 1936*, në Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës (seria shkencat shoqërore), 1962, N. 2.
- Gazeta "Liria kombëtare", tribunë e ideve të revolucionit demokratik në Shqipëri (1925-1935)*, në "Studime historike", 1965, nr. 1.
- Lenti, L., *Gli scambi internazionali d'Il'Albania*, në *Principi di economia albanese*, Padova, 1941.
- Ligje Dekret Ligje e Rregullore të vjetit 1925*, botimet e Këshillit të Shtetit Vol.2 i përmbledhjes së ligjeve, Tiranë 1938.
- Moskoni, A., *Discorso pronunciato dal presidente, per l'inaugurazione della nuova sede di Tirana*, Roma 1938.

Voi voini, Moskë 1954.

Misja, V., *Gjendja dhe karakteristikat e industrisë para çlirimit*, në: "Referatë e kumtesa – mbajtur në sesionin shkencor të Fakultetit të Ekonomisë kushtuar 50-vjetorit të Pavarësisë", Tiranë, 1961, nr. 1.

Pano, A., Llogaritjet e para të të ardhurave kombëtare dhe analiza e tyre kritike, në referate dhe kumtesa, botim i Universitetit Shtetëror Tiranë (Fakulteti i Ekonomisë) viti 1967.

Pasko, Dh., *Tri problema në lidhje me Bankën Kombëtare* (me disa anekse), Kostancë-Rumani, 1932.

Pastorelli, P., *Italia e Albania 1924-1927*, Firenze, 1967.

Pelegriani, B., *Verso la Guerra? Il dissidio fra l'Italia e l'Austria*, Romë 1906.

Postoli Kostaq, "Sistemi monetar dhe krediti bankar, Tiranë 1983.

Ratti, A., *Le vicende dell'economia albanese e la fortuna del franco*, në "Rasegna monetaria", Roma, XXXiii, 1936.

Selenica, T., *Shqipëria në 1923*, Tiranë 1923.

Sejko, M., Qëllimet grabitqare të pushtuesve fashistë italianë dhe pasojat e tyre në tregtinë e jashtme të Shqipërisë gjatë viteve 1939-1944, në revistën "Ekonomia popullore", viti 1965, N. 1.

Shkoza Haxhi, *Financat e Shqipërisë 1839 – 1934*, Tiranë 1935.

Schmid Neke M., *Entstehung und Ausbau der Konigstiktatur in Albanien 1912-1939*, Munchen, 1987.

Toçi, V., Projektet dhe orvatjet imperialiste për zotërimin e tregut shqiptar të monedhës dhe të kreditit dhe lufta kundër tyre (1920-1924), në "Studime Historike", viti 1968, N. 2.

Zoga, K., *Krijimi dhe zhvillimi i sistemit monetar dhe i kreditit në Republikën Popullore të Shqipërisë*, Tiranë 1963.

*Kreditit agrar në Shqipëri*, monografi që ruhet në Bibliotekën e Universitetit Shtetëror Tiranë.

*Kreditit dhe bankat bujqësore në Shqipëri (1888-1970)*, Tiranë, 1973.

Zelka, L., "Përlindja e Shqipërisë, Gazeta e Qeverisë së Vlorës (1913-1914), Tiranë, 1997.

Vaughan, Whitehead, Daniel., *Albania in Crisis., The Predictable Fall of the Shining Star*, botim i Edward Elgar (EE), United Kingdom, 1999, 360 f.



#### *Shënim*

*Autorët e këtij botimi kanë synuar të paraqesin qartë dhe thjeshtë faktet historike, pa ulur kërkesat themelore dhe shkencore. Nuk duhet të harrojmë se një punim i tillë bëhet për herë të parë në historinë e Bankës Qendrore. Për të realizuar këtë botim është kërkuar të kapërcehen mjaft vështirësi, duke u mbështetur në dokumente të Arkivit Qendror të Shtetit, në literaturën e botuar brenda dhe jashtë vendit si dhe në modele të këtij lloji të bankave të tjera qendrore. Autorët e këtij botimi janë të vetëdijshëm se, në këtë botim të parë ka edhe zbrazëti. S'ka dyshim se në të ardhmen, njohja e historisë së Bankës Qendrore do të zgjerohet e do të thellohet më tej dhe do të kemi një botim të mirëfilltë shkencor në këtë fushë. Jemi të bindur se për këtë do të ndihmojnë shumë edhe lexuesit, të cilët i ftojme t'i dërgojnë Bankës së Shqipërisë vërejtjet e sugjerimet e tyre, si dhe të dhëna historike që nuk përfshihen në këtë vepër.*



*Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.  
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;  
Faks : 355-4-223558  
[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)*

*Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni  
Sektorin e Publikimeve, Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun.  
Tirazhi : 2000 kopje*